



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# ZHVILLIMI I KULTURËS ISLAME TE SHQIPTARËT GJATË SHEKULLIT XX

---

Dr. Ramiz Zekaj

Botuar nga AITTC

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit dhe botuesit

Parathënje .....	8
Kreu I .....	14
Politika Antifetare Dhe Pasojat E Saj Mbi Kulturën Islame Gjatë Shek. Xx .....	14
Qëndrimi I Politikave Të Huaja Ndaj Cështjes Shqiptare .....	16
Konvertimi I Detyruar Me Dhunë .....	17
Shpronësimi I Tokave Të Shqiptarëve .....	21
Persekutimet E Klerit Dhe Shkatërrimi I Institucioneve Të Kultit Islam .....	27
Sinjalet E Para Ndaj Rrezikut Komunist .....	29
Përballja Me Komunizmin .....	32
Pushteti Dhe Lufta E Tij Kundër Fesë .....	39
Xhamia E Durrësit Para Prishjes .....	40
Shtetëzimi I Pronave Fetare .....	42
Reagimet E Klerit .....	46
Vazhdon Lufta Kundër Fesë .....	49
Kreu Ii .....	53
Arsimi Islamik Shqip Në Trevat Shqiptare .....	53
Arsimi Fillor .....	53
Arsimi I Mesëm Islamik .....	60
Medresetë Në Maqedoni Barrierë Kundër Shkombëtarizimit .....	61
Medreseja E "Isa Beut" Shkup .....	64
Medresetë E Kosovës Vatra Të Edukimit Fetar E Kombëtar .....	68
Medreseja E Ulët "Alaud-Din" Prishtinë .....	70
Medreseja E Mesme "Alaud-Din" Prishtinë .....	72
Medresetë Brenda Shtetit Shqiptar .....	78
Rrjeti I Medreseve Në Territorin E Mbretërisë Shqiptare Në Vitet '30 Të .....	79

Medreseja E Përgjithshme - Tiranë .....	90
Plani Mësimor Për Tre Vjetët E Arsimit Fillor .....	92
Arsimi I Lartë Islamik Shqiptar (Fakulteti I Studimeve Islame - Prishtinë).....	96
Ndërtesat E Kulturës Islam Dhe Roli I T Yre	
Në Edukimin Fetar, Etik Dhe Kuturor Të Shqiptarëve.....	101
Xhamitë E Para Në Trojet Tona: .....	103
Roli I Xhamisë Në Aspektin Shpirtëror:.....	107
Roli Social Dhe Shoqëror I Xhamisë.....	109
Xhamitë Më Të Përmendura Në Territoret	
Shqiptare Të Trashëguara Nga E Kaluara Dhe Ato Të Ndërtuara Në Shek. Xx .....	113
Kreu Iii .....	116
Shtypi Periodik Fetar Islam Shqip I Shekullit Xx	
Në Trojet Shqiptare Dhe Në Diasporë .....	116
Shtypi Islam Shqip Në Gjysmën E Parë Të Shekullit Xx.....	117
Shtypi Islam Në Gjuhën Shqipe Pas Luftës Së Dytë Botërore .....	125
Botime Të Ndryshme Me Karakter Fetar Islam Në Gjuhën Shqipe.....	137
Kur'ani Në Gjuhën Shqipe.....	142
Përkthime Të Pjesshme Të Kur'anit Botuar Në Libra Të Ndryshëm .....	145
Përkthime Të Pjesshme Të Kur'anit Botuar Në Periodikë Të Kohës .....	147
Lexuesit E Kur'anit Në Trevat Shqiptare (Kurrat - Hafizët).....	149
Hadithet Në Gjuhën Shqipe .....	152
Letërsia Dokumentare Shqipe Për Personalitetin E Profetit Të Islamit.....	161
Jefëshkrimet Kushtuar Personalitetit Të Profetit .....	168
Trajtimet E Besimit Islam, I Personaliteteve Dhe Ndikimi I Tyre Në Kulturën Kombëtare Njëpërmjet Veprimtarive Laike	175
Kreu Iv.....	185

Figura Të Shquara Islame Dhe Kontributi I Tyre	
Në Edukimin Kulturor Dhe Shpirtëror Të Shqiptarëve.....	185
Personalitete Të Kulturës Islame Që Kanë Jetuar E Kontribuar Në Fund Të Shek.Xix	
- Gjysma E Parë E Shek. Xx.....	189
Said Najdeni.....	189
Hoxhë Voka I Dibrës.....	189
Tahir Efendi Llluka Pishtarë I Shkollimit Shqip Në Kosovë.....	191
Kadri Gjata.....	193
Dëshmori I Çështjes Kombëtare.....	193
Mulla Isuf Kraja (Krajë, 1849 - Shkodër, 1912).....	194
Hafiz Ali Riza Ulqinaku.....	197
Autori I Mevludit Shqip.....	197
Haziz Lila. Mësuesi I Gostivarit Dhe I Strugës.....	199
Hoxhë Muglica Martiri I Arsimit Shqip.....	199
Hoxhë Voka Personaliteti I Shqar Rexhep Voka.....	200
Kadri Lutfulla Prishtina, Luffetar Për Bashkimin Kombëtar.....	203
Vildan Faik Dibra Mrojtësi I Alfabetit Shqip.....	204
Hoxhë Hasan Vogli Gjuhën Shqipe Do Ta Mbrojmë Edhe Me Gjak.....	206
Haxhi Ali Elbasanit Përfaqësuesi I Unitetit Kombëtar.....	207
Qamil Bala Drejtori I Parë I Medresesë (Tiranë).....	209
Mehmet Akif Ersoj Personalitet Shqiptaro Turk.....	210
Haxhi Vehbi Dibra (Agolli) Komentatori Më I Mirë I Kur'anit Në Gjuhën Shqipe.....	211
Sali Niazi Dede Kryegjyshi Botëror I Bektashinjve.....	214
Mulla Hasan Masurica Hoxha Inovator.....	215
Ismail Ndroqi Një Jetë Kushtuar Islamizmit Dhe Çështjes Kombëtare.....	217

Hafiz Ymer Shemsiu Prishtinë 1895 - Sazli 1945.....	219
Arif Shala Vëllezër Mos E Braktisni Drenicen.....	221
Baba Ali Tomorri Një Nga Viktimat E Komunizmit.....	222
Ma'ruf Al-Arnauti Shkrimtari I Shquar Arab Me Origjinë Shqiptare (1892-1948).....	223
Mulla Idriz Gjilani Udhëheqësi Shpirtëror, Politik E Ushtarak.....	227
Hafiz Ibrahim Dalliut Burri Që Nuk U Mposht Nga Persekutimet.....	229
Haxhi Hafiz Ismet Dibra I Arrestuar Për Bindje Fefare.....	232
Abdulhaqim Hiqmet Dogani Pedagogu Nga Gostivari.....	233
Hafiz Ali Korça Hoxha I Përndjekur.....	235
Personalitete Të Kulturës Islame Që Kanë	
Ushtruar Aktivitetin E Tyre Edhe Në Gjysmën E Dytë Të Shek. Xx.....	237
Sadik Bega Drejtor I Revistës "Kultura Islame".....	237
Ferid Vokopola Përfaqësues I Misticizmit Islam.....	239
Haxhi Hafiz Mahmut Dashi Studjues I Apasionuar Dhe Ligjërues I Rrallë.....	240
Osman Muderrizi Studius I Veprave Letrare Me Alfabet Arab.....	242
Hafiz Ali Kraja Teologu I Lartë.....	243
Esat Myftia Personifikimi I Modestise.....	244
Mulla Rexhepi Drenice 1905 - 1976.....	246
Haki Sharofi Drejtor I Revistës "Zani I Naltë".....	247
Vexhi Buharaja Orientologu Me Dimensione Të Mëdha.....	248
Sali Efendi Myftia. Themeluesi I Qendres Islamike Shqiptaro - Amerikane.....	250
Hamid Gjylbegaj Demokrati I Pakorruptuar.....	252
Binaze Kacabaci-Dauti Hoxha Hanmi.....	253
Mulla Ismaili Atdhetar Dhe Fetar I Patrembur.....	254
Vejsel Xheladin Guta Fe E Atdhe Janë Të Pandara.....	256

Mulla Zekë Bërdyna Një Jetë Për Besimin Islam,	
Arsimim Në Gjuhën Amtare Dhe Kombin Shqiptar .....	258
Hasan Efendi Nahi Dijetari, Myderrizi Gojëmbël .....	259
Haxhi Rashid Efendi Osmani Mësues E Profesor I Nderuar .....	261
Mulla Hysen Latifi Themelues I Qendrës Shqiptare Islame Në Bruksel .....	262
Shuajb Muharrem Arnauti Huluntues I Njohur I Librave Të Kulturës Islame.....	263
Nasrud-Din Albani (Shqiptari) Hadithologu Më I Shquar I Këtij Shekulli .....	266
Abdulkadër Arnauti Kolos I Kulturës Dhe Dijeve Islame.....	269
Haxhi Vehbi Sulejman Gavoci Shtudiuës I Apasionuar Dhe Ligjërues I Rrallë .....	270
Hilmi Maliqi (Sheh Mala) Personalitet I Shquar Fetar, Arsimor Dhe Kombëtar .....	272
Hafiz Sabri Kaçi Punëtori I Shquar Për Besimin Islam .....	274
Imam Vehbi Ismaili Personalitet I Shkencës Islame Në Të Gjitha Mjediset Shqiptare.....	277
Sherif Ahmeti Përkthyesi Në Shqipe I Kur´anit.....	279
Hoxhallarë Dhe Mësues Njëkohësisht, Që Provuën Edhe Burgjet E Serbit.....	281
Ramadan Govori (Mulla Rama) .....	281
H. Hajdar Ef. Jashari.....	282
Sadri Prestreshi .....	283
Haxhi Hafiz Jakup Dugagjini .....	283
Summary .....	284

*"Na shqiptarët, prej çdo feje qofshim, jemi të tanë vllazën gjaku dhe vllazën (vatani) atdheu. Do të shkojmë mbarë e mirë shoq me shoq si jemi tue shkue, do të punojmë së bashku për lulëzimin e atdheut tonë dhe do ta mbrojmë atë me gjakun tonë."*

*Hafiz Ibrahim Dalliu*

*"Kemi tri fe, por kemi vetëm një Atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell e një Zot. Detyrë mbi detyrat kemi bashkimin dhe mbrojtjen e atdheut."*

*Mulla Idris Gjilani*

## PARATHËNJE

Studimi me temë "Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX" përfshin tërë hapësirën e trojeve shqiptare si dhe diasporën, duke kontribuar kështu në njohjen e botës islame shqiptare. Nga pikpamja kohore, studimi rrok shekullin e fundit. Por, për hir të vazhdimsisë e parapregatitjes së lexuesit bëhet një vështrim retrospektiv, por gjithmonë pa pretendimin që të bëjë objekt analize shekujt e mëparshëm.

Punimi është një përpjekje e angazhim shumëvjeçar intensiv hulumtuesh jo vetëm në arkivat dhe bibliotekat e Republikës së Shqipërisë, por dhe në ato të medreseve të Prishtinës e të Gjakovës, në Republikën e Kosovës, si dhe në bibliotekën "Is'hak Beu" të medresesë së Shkupit dhe atë të Bashkësisë Islame të Podgoricës në Republikën e Malit të Zi. Me anë lidhjesh të ndryshme, janë

shfrytëzuar edhe botimet e bëra nga qendra Islame Shqiptare e Miçiganit, si dhe të New Jerseyt e të New Yorkut të SHBA-së.

Që ky studim të bëhej sa më i plotë, është mbajtur lidhje edhe me qendra të tjera të diasporës shqiptare, si ato të Torontos (Kanada), të Brukselit (Belgjikë) etj., që kanë bërë botime të konsiderueshme, ndonse jo të plota për temën që shtjellohet në punimin tonë. Po ashtu, janë pasur parasysh edhe botime të tjera në gjuhën shqipe të vendeve të ndryshme të Lindjes.

Bibliografia për këtë temë është përgjithsisht e pasur. Ajo përfshin libra, monografi, përmbledhje studimesh etj., të cilat kanë trajtuar krahas të tjerash, edhe çështje apo aspekte të kulturës islame në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti. Në këtë kuadër do të përmendim materialet e studjuesve si: të Dr. Muhamet Pirrakut, Dr. Haki Kasumit, Dr. Jashar Rexhepagiqit etj., të teologëve dhe hulumtuesve si: Hfz. Ibrahim Dalliu, Hfz. Ali Korça, Baba Ali Tomorri, Ilo Mitkë Qafzezi, Haki Sharofi, Sherif Ahmeti, Vehbi Ismaili, Vexhi Demiraj etj. Njëkohësisht ka edhe autorë të huaj që kanë prekur problemin fetar islam në trevat shqiptare, siq janë: Dr. Branko Babiq, Bozhina Ivanoviq, Roberto Maroco dela Roka, Edwin E. Jacques etj.

Por me përjashtim të ndonjë kumtese të mbajtur në ndonjë tubim të studjuesve shqiptarë apo ndërkombëtar, dhe të ndonjë artikulli botuar në ndonjë revistë, deri me sot nuk ekziston ndonjë punim apo monografi e plotë që të ketë bërë objekt të drejtpërdrejtë kulturën islame të shqiptarët. Përveç kësaj, trajtesat e mësipërme, pa mohuar kontributin e tyre (sidomos të Dr. Haki Kasumit), kanë një sërë mangësish të karakterit njohës e metodologjik, por që nuk janë të pakta edhe ato që kanë ndikim të njëanshëm ose pragmatik. Kjo e fundit më tepër reflekton tek autorët e huaj.

Edhe në Republikën e Shqipërisë për gjatë sistemit socialist totalitar, ka pasur disa botime kushtuar fesë në përgjithësi dhe asaj islame në veçanti. Ndër të tjera po të përmendim: "Ateizmi shkencor", botim i Universitetit të Tiranës, (1986), "Akuzojnë fenë", botim i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, "Ç'është feja", "Populli mposht fenë" etj, por të gjitha këto punime i përshkon në bosht - denigrimi i fesë, mohimi i kulturës fetare, madje paraqitja e saj si antikulturë, që "ka pasur për mision të lejë në errësirë e padije popullin, të përligjë sundimin e klasave të pasura" etj.

Edhe ndonjë botim me pretendime studimore, si artikulli "Lufta frontale kundër fesë në vitet 60" i cili ndonse sjell një informim të pasur faktik e jep tablo historike përgjithësisht realiste, nuk u ka shpëtuar politizimeve e defekteve të tjera të kohës.

Në hartimin e studimit tonë jemi nisur nga grumbullimi, përzgjedhja, klasifikimi dhe sistemimi i materialit faktik, materjal ky i vjelur nga fondet arkivore dhe bibliotekare si brenda, ashtu dhe jashtë territorit shqiptar.

Materiali është sistemuar sipas temave: Politika antifetare sllavo-komuniste, institucionet teologjike dhe ato kulturore islamike, shtypi, si dhe përsonalitetet e shquara të kulturës.

Mbështetja në metodën e analizës dhe të sintezës, krahas asaj krahasuese, ka mundësuar evidentimin e dukurive kulturore të reja, të panjohura ose të keqinterpretuara nga politizimi që i është bërë ngjarjeve historike, proceseve kulturore. Kjo metodë ka bërë të mundur që zhvillimi i kulturës islame të shihet në harmoni me zhvillimin kulturor, etik e social të krejt popullit shqiptar.

Funksionet e institucioneve teologjike kulturore të islamit në Shqipëri, fluksi i medias islame, konceptohen në frymën e mirëkuptimit ndërkonfesional (karakteristikë për vendin tonë), me synimin e

një harmonie gjithëkombëtare, por, njëherazi, ato konceptohen edhe në frymën e mospajtimit me idetë ateiste dhe frymën antifetare e atë komuniste.

Vemendje e veçantë i është kushtuar pasqyrimin të rrolit të qendrave islamike të diasporës shqiptare në konsolidimin e vetëdijes kombëtare, kundër asimilimit të saj.

Kultura islame te shqiptarët si pjesë e kulturës së popullit shqiptar për lehtësi shikimi është parë në katër segmente, që pasqyrojnë problemet dhe zhvillimet e saj në përgjithësi dhe konkretisht: Politika antifetare sllavo-komuniste dhe pasojat e saj mbi kulturën islame. Arsimi islamik në trevat shqiptare në të gjitha hallkat e tij. Shtypi islamik shqip (vepra, studime origjinale e të përkthyer), dhe e katërta personalitetet e kulturës islame.

Këto përbëjnë krerët kryesorë të punimit, i cili paraprihet nga një parathënie hyrje mbi gjendjen e kulturës islame deri në fillim të shekullit XX, politikat antifetare të sllavo komunizmit dhe pasojat e saj mbi kulturën islame.

Në *kreun e parë* jepet një tablo e përgjithshme lidhur me të mbijetuarit e doktrinës islame dhe rrolin që ajo pati në ruajtjen e identitetit kombëtar. Këtu sidomos vihet theksi mbi politikat antifetare të sllavo-komunizmit dhe pasojat e saj mbi kulturën islame, duke filluar nga fillimi i shekullit e deri te zhvillimi i ngjarjeve në vjetët e fundit pas ringjalljes së institucionit të besimit në vend.

Në *kreun e dytë* trajtohet arsimi islamik. Sythi i parë i këtij kreu i kushtohet arsimit të ulët (Mejtepeve) në trevat shqiptare. Ku trajtohet rrjeti, struktura dhe anët organizative të tij. Përshkrimi i arsimit fillor islamik, për mungesë të dhënash faktike, paraqet veshtirësi të mëdha. Janë shfrytëzuar arkivat e meshihateve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, por nuk janë pasqyruar mejtepet e zonës së Çamërisë, ku, sipas dëshmimeve gojore, ka pasur një rrjet të fuqishëm.

Në vazhdim të këtij kreu kemi shtjelluar arsimin e mesëm islam (Medresetë), shpërndarjen e tij në trojet tona, duke u ndalur përveç ecurisë historike edhe te planet e programet mësimore të tyre. Gjithashtu bëhet fjalë për tekstet e përdorura në këtë hallkë shkollë. Përpjekje janë bërë për të analizuar përmbajtjen e tyre. Dokumentacioni për këtë hallkë arsimit është edhe më i plotë. Ecuria e kësaj hallke të arsimit ka pasur baticat dhe zbaticat e veta, që janë kushtëzuar, sidomos, nga kthesat historike. Natyrisht shkollat e mesme islame të këtyre viteve të fundit gjejnë pasqyrim më të gjerë, sepse edhe materiali është më i plotë. Për të dhënë një ide më të qartë lidhur me strukturën, organizimin dhe rolin e tyre, jemi ndalur edhe në përmbajtjen e rregulloreve dhe të statuteve të tyre. Këto shkolla nuk kanë qenë identike në shumë aspekte, prandaj ne jemi ndalur, sipas rastit, në medresetë e Kosovës, në ato të Maqedonisë etj.

Në këtë kre në një syth më vete kemi trajtuar edhe arsimin e lartë islamik. Fizionominë e këtij arsimit e kemi përshkruar duke marrë si model shkollën e lartë të arsimit në Prishtinë. Elemente të arsimit të lartë ka pasur edhe medreseja e përgjithshme e Tiranës, gjë që reflektohet në programin e saj.

Ne *kreun e tretë* trajtohen gjerë botimet dhe shtypi islamik shqip në trojet dhe diasporën shqiptare. Për këtë na është dashur të bëjmë një punë të mundimshme, sepse ai është i shpërndarë në pesë kontinente: në Europë, në Amerikë, në Azi, në Australi dhe në Afrikë. Për lehtësi studimi, e pamë të udhës që botimet me karakter fetar në shqip t'i grupojmë mbi bazën e fizionomisë që kanë ato: organet e shtypit periodik, tekstet mësimore për mësimin e besimit mysliman, përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe, mevludet etj., duke dhënë kështu, për herë të parë, një klasifikim rracional.

Në këtë kre, për herë të parë, analizohen organe shtypi në menyrë të plotë. Për sigurimin e tyre na është dashur një punë e madhe. Shumica dërrmuese e këtyre organeve janë krejtësisht të panjohura për publikun shqiptar, si për shembull "Përpjekja jonë", që del në New Jersey, "Drita e Lahorës" etj.

Një vend të rëndësishëm në këtë kapitull zënë edhe përkthimet e pjesshme të Kur'anit, të Tefsirit (komenteve) të Kur'anit, dhe, krahas tij, edhe të haditheve në gjuhën shqipe. Gjatë hulumtimit të përkthimeve të Kur'anit jemi ndeshur edhe me dorëshkrime të pergatitura nga grupe teologësh shqiptarë, të cilët kanë njohur mirë terminologjinë fetare dhe korrespondencat e tyre në gjuhën shqipe. Ketu janë përfshirë edhe mevludet, të cilat, përveç rëndësisë së tyre si letërsi fetare, paraqesin edhe vlera të veçanta gjuhësore, sepse janë shkruar nga autorë të krahinave të ndryshme të Shqipërisë: nga Shkodra, Ulqini, Korça, Kosova, Tetova, si dhe nga shqiptarët e diasporës etj.

Në *kreun e katërt* trajtohen personalitetet e kulturës e fesë islame, si dhe ndihmesat e tyre në qështjen kombëtare. Këto figura janë klerikë të shquar, si Hfz. Ismet Dibra, Haxhi Ali Elbasani; personalitete të shquara në lëvizjen kombëtare, si Hoxha Kadri Prishtina, Haxhi Vebi Dibra, Ismail Ndroqi etj; shkrimtarë dhe publicistë, si Hfz Ali Korça, Sadik Bega; orientalistë të shquar, si Vexhi Buharaja; udhëheqës shpirtërorë e ushtarakë, si Mulla Idriz Gjilani; mistikë dhe filozofë, si Ferit Vokopola, Baba Ali Tomorri; hoxhallarë novatorë, si Mulla Hasan Masurica etj. Në radhët e këtyre personalitetëve pati të atillë që, me pendën e tyre të fuqishme, paralajmëruan rrezikun komunist treçerek shekulli më parë. Janë të njohura pamfletet e Hfz. Ali Tarjes, Hfz. Ali Korçës etj.

Mes këtyre figurave, kemi trajtuar edhe figurat e femrave, siç është ajo e Hoxha Hanmit. Gjithsej kemi trajtuar në këtë kre dyzetë e gjashtë figura, aktiviteti i të cileve rroket në kufijtë e shekullit XX e që vjen deri në ditët tona. Duke pasur parasysh botimin e këtij materiali, kemi gjetur edhe portretet e shumicës prej tyre.

Studimi është i paisur me referenca nga literatura e shfrytëzuar në biblioteka e arkiva të ndryshme.

Në përfundim të kësaj parashtrese e ndiej për detyrë të shpreh mirënjohjen time, në radhë të parë, për Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, për ndihmën e dhënë, duke më vënë në dispozicion materialet arkivore të tij. Gjithashtu e ndiej për detyrë të falënderoj Drejtorinë e Arkivave të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht arkivat e Meshihateve të Prishtinës, Shkupit, Podgoricës dhe të medresesë së Shkodrës, të cilët më kanë vënë në dispozicion dokumente të rëndësishme lidhur me temën e mësipërme.

Shpreh mirënjohjen time ndaj drejtorit të Institutit të Historisë As.Prof. Kasem Biçokut si dhe stafit të departamentit të shek. XX pranë këtij instituti për konsultimet e vyera që kam bërë me ta. Njëkohësisht i jam mirënjohës edhe udhëheqësit shkencor Prof.Dr. Shefik Osmanit i cili më ka ndenjtur afër gjatë tërës kohës që kam bërë këtë punim.

Pa pretenduar për një shterim të kësaj teme, shpresojmë se kemi bërë diçka të mirë për atdheun dhe kulturën tonë kombëtare.

*Autori*

## **KREU I**

### **POLITIKA ANTIFETARE DHE PASOJAT E SAJ MBI KULTURËN ISLAME GJATË SHEK. XX**

Shekulli XX, për kulturën shqiptare në përgjithësi e atë islame në veçanti, shënon një kthesë cilësore në të gjitha drejtimet. Duke qenë trashëgimtare prej pesë shekujsh të një veprimtarie kulturi dhe mbartëse e

kulturës orientale, ajo tani ndodhet para problemesh e zhvillimesh të tjera. Ishte kjo kohë që bëri edhe një herë aktuale idetë e Hasan Tahsinut, Ymer Prizrenit, Abdyl e Sami Frashërit, Rexhep Demit etj. për shikimin e interesave të kombit në një prizëm tjetër.

Heqja e Halifatit dhe pushimi i këtij institucioni islamik pas 13 shekujsh, e la pa udhëheqje qendrore shpirtërore edhe popullatën shqiptare. Kështu që me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me krijimin e shtetit shqiptar, sadoqë të cunguar, organizmat fetare si dhe institucionet e kultit dhe ato arsimore islamike u ndodhën para detyrash shumë urgjente dhe shumë të rëndësishme lidhur me të mbijetuarit e doktrinës së tyre dhe ruajtjen e identitetit shqiptar. Kështu Bektashinjtë më 1922 u bënë të pavarur nga Turqia. Ndërsa bashkësia sunite e cila kishte ndërprerë lidhjet me Stambollin që me 1921, organizoi kongresin e saj të parë me 1923 dhe zgjodhi muftiun e vet me seli në Tiranë, dhe Këshillin e Lartë të Sheriatit. Në statutin e këtij këshilli që u botua me 1925 thuhet: "Kryetari i Këshillit të Naltë të Sheriatit përfaqëson trupin Mysliman në Shqipëri me titullin "Myfti i Përgjithshëm".

Në këtë kohë në Shqipëri u zhvillua një veprimtari islame shumë e madhe..., për herë të parë edhe Kur'ani përkthehet në gjuhën shqipe...Në gusht të vitit 1929 "Xhema-ati Mysliman Shqipëtar" mbajti kongresin e dytë në Tiranë. Atëherë në Shqipëri ishin 1048 xhami aktive, në të cilat punonin 1315 nëpunës. Një numër i rinisë shqiptare u dërgua që të mësojnë Islamin jashtë vendit, sidomos në Egjipt. U themelua Këshilli i Lartë i Bashkësisë në krye të të cilit ishin edhe katër myftini të tjera ( Shkodrës, Tiranës, Korçës dhe Gjirokastrës). Në vitin 1929 bektashinjtë në Korçë mbajtën kongresin e tretë në të cilin shpallën pavarësinë e tyre shpirtërore dhe autonominë në suaza të Bashkësisë Islame të Shqipërisë.

Nga kjo del qartë se islamizmi në Shqipëri trashëgonte forca të kualifikuara në fushën teologjike si dhe në atë të administratës (myftilerë, kadilerë, guvernatorë, politikanë), që ishin të lidhur ngushtë me idenë e pavarësisë dhe çlirimit kombëtar.

Në Shqipëri edukimi fetar, megjithëse kultivohej, nuk qe i organizuar në një shkallë të merituar. Shkollat e mesme, medresetë, qenë të kufizuara. Në fillim të shekullit XX në Shqipëri filloi të organizohej arsimi i mesëm islamik. Po ashtu filloi të organizohej në këtë shkallë edhe në disa qendra të Kosovës dhe në Shkup, ndërsa në Çamëri u pengua plotësisht, siç do ta shohim më poshtë. Megjithatë, populli ruajti me xhelozni besimin dhe ushtroi rregullisht ritet fetare. Bindjet, konceptet, shartet u trashëguan në brezat e fundit edhe në heshtje. Në heshtje po zhvillohej një luftë me ateizmin, që filloi të përhapej në Shqipëri, sidomos në kuadrin e përhapjes së ideve komuniste.

## **QËNDRIMI I POLITIKAVE TË HUAJA NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE**

Në fillim të shek. XX, ndërsa Perandoria Osmane numëronte ditët e fundit në territoret e Gadishullit Ballkanik të sunduara prej saj, vetëdija kombëtare te shqiptarët ishte ngritur në shkallën më të lartë. Situata e re kërkonte që forcat islame të nxirrnin në pah edhe një herë ato nene kuranore dhe ato hadithe, që evokonin dashurinë për atdheun, si barrikadë kundër pretendimeve territoriale të grekëve në jug dhe të sllavëve në veri, kundër pretendimeve italiane për zaptimin e një pjese të bregdetit shqiptar. Politika e shteteve fqinje rrezikonte në të dy krahët popullsinë shqiptare, në mënyrë të veçantë atë myslimane që ishte më e madhja në numër duke filluar nga Kosova, në Preshevë, Bujanovc, Medvegjë, deri në Mal të Zi (Ulqin, Tivar, etj.), dhe në ish-republikën jugosllave të Maqenonisë (në Dibër, Tetovë, Kërçovë, Gostivar, Kumanovë etj.) dhe në viset e Çamërisë, deri në Prevezë.

Kjo popullsi shqiptare myslimane, nën lakminë dhe intereset e këtyre forcave, rrezikohej të humbte teritoret, kombësinë dhe bashkë me te besimin e vet.

Diplomacia evropiane, në mënyrë krejtësisht të padrejtë, popullsinë myslimane të këtyre trojeve, e konsideronte si popullsi turke dhe trojet e saj si plaçkë për të kënaqur fqinjët. Kështu në tryezat e kësaj diplomacie të drejtat e popullatës shqiptare, pas çdo lufte të humbur nga Turqia mbeteshin nëpër këmbë. Kjo bëri që shqiptarët të ngrihen në këmbë për të mbrojtë trojet e tyre, si trashëgimtarë legjitim të tyre, çka bëri që në ballin e luftës të radhiteshin bri njëri-tjetrit myslimanë e të krishterë..."Shqiptarët, goftë të besimit musliman apo të besimit katolik (kristian R. Z.), nuk mund (dhe nuk duhet) t'i nënshtrohen sundimit të ndonjë shteti sllav (...)"

## **KONVERTIMI I DETYRUAR ME DHUNË**

Masakrat e ushtruara në mënyrë masive kundër banorëve ulqinakë, tivaras, kosovarë, dibranë, çamë etj., i afruan myslimanët shqiptarë me bashkatdhetarët e tyre vëllezër katolikë e ortodoksë, me të cilët i bashkonin interesa të përbashkëta e kryesisht: gjuha, gjaku e toka.

Qëndrimi antishqiptar i qeverisë serbe, ndonëse përpiqej të kamuflohej, shprehej qartë edhe në udhëzimet e ministrisë së jashtme dërguar konsujve serbë, në të cilat theksohej veçanërisht domosdoshmëria e ndërhyrjes së misionerëve serbë tek autoritetet turke lidhur me çarmatimin e plotë të shqiptarëve.

Vendosja e administratës ushtarake kishte për qëllim, nga njëra anë, sigurimin e shtetit serbomalazez, kurse nga ana tjetër, dëbimin në masë të shqiptarëve prej trojeve të tyre autoktone me anë të shtypjes së vazhdueshme dhe të zbatimit të masakrave të përgjakshme mbi popullsinë e pafajshme.

Prej shtypit të kohës bëhej e ditur se në Ponoshec të Rekës së Gjakovës, malazetët kanë mbytur e vrarë 165 veta, në mes të cilëve gjendeshin edhe gra e fëmijë. Malazetët, pasi e kanë mbaruar këtë vandalizëm, "familjet që kanë mbetur të shkreta i kanë përzënë jashtë kufirit".

Me anë të ndërrimit të detyruar të emrave të njerëzve, të vendbanimeve të tyre e të përkatësisë fetare dhe, duke përdorur për këtë qëllim mjetet më të egra, pushtuesit serbo-malazet u përpoqën që të krijonin një gjendje të padurueshme për popullsinë shqiptare. Në radhët e këtyre pushtuesve përfshiheshin, përveç ushtarëve, edhe nëpunës civilë, çetnikë, popë ortodoksë e të tjerë. Të gjithë së bashku u vunë në lëvizje dhe duke përdorur terrorin "e detyronin popullsinë shqiptare të rrethit të Pejës e të Gjakovës të kalojnë në fenë ortodokse, përkatësisht të sllavizohej".

Sipas të dhënave nga burimet arkivore, me 10 mars 1913, në Lugun e Baranit, 68 familje shqiptare të konfesionit mysliman u kthyen në fenë ortodokse. Ndërkaq, në fshatrat e rrethit të Pejës: Brestë, Novosellë, Treboviç, Dubovë, Drenoc, Lloqan, Carrabreg, Leshan, Dredhëz, Petriç, Zajmovë, Prelep, Jabllanicë, Krushevë, Isniç, Strellc, Raushiq, Glllogjan e Kriticë u konvertua në fenë ortodokse tërë popullsia shqiptare e konfesionit mysliman.

Familjeve shqiptare, në radhë të parë meshkujve, u ndërroheshin emrat me ceremoni nga priftërinjtë ortodoksë apo nga "kumbarët e caktuar prej ushtrisë malazeze". Ky pagëzim i përgjithshëm i popullsisë shqiptare u bë kryesisht në Plavë, Guci e vise tjera... Në këtë proces konvertimi Ukshini u bë Vukashin,

Rama-Rade, Selimi-Sime, Tahiri-Tihomir, Ramadani-Radivoj, Sadiku-Dika, Bajrami-Bllagoj, Shefqeti-Shqepan, Milaimi-Millorad etj. Ky akt u ruajt edhe në këngët e podgorit.

Popullata shqiptare myslimane e mbetur nën pushtimin serbomalazez ose atë grek, pas Luftës Ballkanike, u privua nga organizimi i mëtejshëm arsimor i besimit në gjuhën shqipe dhe institucionet arsimore-kulturore të tij. Personalitete të shquara të kulturës islame shqiptare, hoxhallarë të përmendur, ylema të ditur, çamë, kosovarë e dibranë etj., u detyruan të marrin rrugën e mërgimit ose t'i nënshtrohen ndjekjeve antinjerëzore: vrasjeve, burgimeve, bastisjeve, diskriminimeve, grabitjeve etj. Një pjesë tjetër u detyrua të konvertojë.

Terrori malazez mbi popullatën shqiptare në Dukagjin e sidomos akti i dhunës, që u ushtrua mbi popullatën e Lugut të Baranit për ndërrimin e fesë, s'ishte tjetër veç një përpjekje për realizimin e programit serb sipas Naçertanijës së Grashaninit për shkombëtarizimin e shqiptarëve, përkatësisht për kolonizimin e Kosovës. Ky akt si dhe krimet e papara të Sav Batares në rajonin e Dukagjinit, bënë bujë të madhe në qarqet ndërkombëtare. Shtypi austro-hungarez, ai italian dhe turk i kushtuan vëmendje të madhe akteve malazeze në Dukagjin, si dhe rezistencës së shqiptarëve për të mos e ndërruar fenë. Ndërrimi i fesë nga ajo myslimane në ortodokse sllave nënkuptonte sllavizimin e plotë të shqiptarëve.

I ballafaquar me presionin ndërkombëtar, mbreti i Malit të Zi, Nikolla Petroviq, më në fund, u detyrua ta pranonte se tërë arsenali i dhunës për konvertimin e detyrueshëm të shqiptarëve në fenë ortodokse ishte inicuar nga vet ai me qëllim të shpërnguljes së përgjithshme të shqiptarëve nga tokat e okupuara dhe premtoi se do të jepte urdhër që aksioni i "konvertimit të shqiptarëve në fenë ortodokse të ndërpritet" dhe se "atryre që tashmë janë pagëzuar ortodoksë do t'u lejohet të kthehen në fenë e mëparshme".

Lidhur me këtë, vicekonsulli austriak në Prizren, Pecel, do të shkruajë se "u ndal një aventurë e shëmtuar e sllavëve për shkombëtarizimin fetar të shqiptarëve dhe për asgjësimin e tyre me anë të shpërnguljes nga trojet e tyre stërgjyshore, që ishte edhe pikësynimi i sllavëve.

Rezultat i këtij procesi është rasti i dy fshatrave në anën e majtë të rrugës, që lidh Pejën me Rozhajën (Ciga dhe Brestoviku) popullsia e të cilave ndonëse janë me origjinë shqiptare, i mbajnë për ortodoks serbë.

Mirëpo, edhe këto veprime apo skena trishtuese të shoqëruara me krime, që ranë mbi shqiptarët e të gjitha moshave e gjinive gjatë fundit të shekullit XIX e fillim të shekullit XX, nuk arritën të thyejnë qëndresën e tyre për të mbajtur kombësinë e fenë e tyre.

Këngëtari popullor e përshkruan kështu këtë qëndresë:

*Krisi pushka e dajaku,*

*rrugët e shebrit i mbuloj gjaku.*

*Sali Bajraktari u bërtet,*

*Ou, bini vllazën n'shabadet,*

*edhe një gisht çone përçjetë*

*Në çdo fshat burrat janë besatue*

*Me u gri e me u copëtue,*

*E kurrë fenë mos me ndërrue.*

Në analet serbe e malazeze thuhet se: "Kishte nga shqiptarët muslimanë që, posa kryqëzoheshin, vraponin në ndonjë lumë dhe i fërkonin ato pjesë të trupit, të cilat ua kishte prekë Popi, dhe i fërkonin aq shumë me rërë gjersa t'u dilte gjaku."

## **SHPRONËSIMI I TOKAVE TË SHQIPTARËVE**

Fillimi i shekullit XX i gjeti shqiptarët në një prapambetje të theksuar në të gjitha aspektet. Epilogu i traktatit të fshehtë të Londrës më 1913 dhe i traktatit të paqës të Versajës më 1919 i thelloj pasojat për kombin shqiptar. "Ushtritë pushtuese serbe, malazeze, bullgare dhe greke në viset shqiptare të pushtuara gjatë luftërave ballkanike (1912-13) dhe gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-18) rrënuan në themel më se 800 lokalitete shqiptare, vranë ose i zhdukën përgjithmonë rreth 350.000 shqiptarë dhe ndoqën nga vatrata etnike mbi 500.000 të tjerë.

Një genocid i paparë edhe në mesjetë është ushtruar mbi popullsinë shqiptare, në mënyrë të veçantë nga kisha ortodokse sllave e greke për konvertimin e detyruar të tyre në ortodoksë. Për këtë dëshmon edhe studjuesja Edit Durham: "Kisha ortodokse (shkruan ajo) me programet kundër çifutëve në Rusi dhe me bëmat e saj në Ballkan, mban tani rekord për mizoritë fetare". Me dhjetëra janë ndërtesat e kultit mysliman që janë shkatëruar në trojet shqiptare të myslimanëve të Greqisë dhe të Jugosllavisë.

Një segment tjetër i politikës antishqiptare e antiislame i ndjekur nga qarqet jugosllave dhe greke është dhe likuidimi i troje-pasurive të vakëfeve islame. Me forma të ndryshme, të maskuara e të drejtpërdrejta, me ligje gjoja për zbatimin e reformës agrare, u shpronësuan sipërfaqe të tëra toke, që i përkisnin

vakëfeve islame. Shpronësimi i tyre filloi qysh në vitin 1919. Disponohen të dhëna mbi konfiskimin e tokave të disa xhamive në rrethin e Shkupit, të tokave të teqesë së Tetovës, të myftnisë së Prizrenit, "të varrezave myslimane të Shkupit, të Tetovës...", të Kaçanikut, Kumanovës, Preshevës...".

Këto toka, në të cilat u vendosën kolonë serbë e malazezë, përbënin sipërfaqe të konsiderueshme. Gjithashtu pas vitit 1918 u shpronësuan dhe kaluan në duart e shtetit jugosllav edhe toka të popullsisë islame që arritën në dhjetëra mijëra ha, baras me 3/4 e tokës së shpronësuar në të ashtuquajturat "vise të jugut".

"Nga sipërfaqja e sipërpërmendur, mbi 192000 ha u shpronësuan vetëm në Kosovë, ku "reforma goditi mbi 62000 familje, toka të cilat kaluan në duart e elementit ortodoks sllav, vendas ose kolonë...". Njëlloj si qeveria e Beogradit, ajo e Athinës, në bashkëpunim të ngushtë me kishën greke-ortodokse, organizoi shpërnguljet e detyruara të popullsisë myslimane shqiptare çame dhe konfiskoi të tëra pasuritë e tyre. "Ushtria (greke) rrëmbente gjithçka gjente të shqiptarëve muslimanë. Shtëpitë e këtyre kudo që ishin, i plaçkiti dhe i dogji...Faltoret e muslimanëve dhe varret e shqiptarëve...i prishën. Çamërit dhe tërë banorët e tjerë islamë të krahinave shqiptare që patën fatin e zi të binin nën sundimin robërues të kryqtarëve athino-fanaritë, u cilësuan si popullatë e dorës së dytë (ulët); si të tillë ata u zhveshën krejtësisht nga çdo e drejtë njerëzore dhe kombëtare..."

Në këtë mënyrë, qendra të tëra të banuara, që ishin të pastra etnikisht dhe nga pikëpamja e besimit, u shndërruan në qendra ku mbizotëronte popullsia sllave dhe ajo greke. Meqë Shqipëria e kufijve të 1913-ës kufizohej në të tëra anët me shqiptarë, Beogradi dhe Athina u treguan mjaft aktive në pastrimin etnik të zonave kufitare me Shqipërinë, si dhe në rrugë-kalimet kryesore hekurudhore dhe automobilistike. Vetëm në zonën e Rrafshit të Dukagjinit, të Fushë-Kosovës dhe të rajonit të Shkupit u vendosën me qindra kolonë serbë në mbi 120000 ha tokë. Deri "në nëntor të viti 1937 në viset e quajtura "Juzhna

Srbija" u sollën 46 000 familje koloniste (serbe) me 5-7 antarë të cilëve iu ndanë tokat shqiptare". Kësaj dukurie i parapriu dokumenti pragmatik i Dr. Vaso Çubrilloviqit, paraqitur më 7 mars 1937 në Klubin Serb të Kulturës në Beograd, mbi Shpërnguljen e Arnautëve, ku në mënyrë analitike zbërthen këto synime: kolonizimi i krahinave jugore, mënyra e shpërnguljes, organizimi i shpërnguljeve në rrethinat e Dibrës, Pollogut të Poshtëm e të Sipërm, malit të Sharrit, Drenicës, Pejës, Istogut, Vuçiternit, Stavicës, Llapit, Graçanicës, Nerodmjes, Gjakovës, Podgorit, Gorës, Podrimjes, Gjilanit, Kaçanikut.

<b>Rrethi</b>	<b>vrau</b>	<b>burgosi</b>	<b>rrahu</b>	<b>dogji</b>	<b>plaçkiti</b>
Prishtina dhe Llapi	4600	3650	350	1340	2490
Vuçiterna	2179	2940	215	1463	2431
Ferizaj	1690	3400	190	720	960
Peja	1560	3800	240	714	1970
Prizreni dhe Luma	836	2700	120	770	1562

Gjilani	680	2400	220	450	630
Presheva	260	970	85	180	240
Mitrovica	133	1700	30	42	104
Gjakova	68	200	25	56	78
<b>Gjithsej</b>	<b>12346</b>	<b>22160</b>	<b>1635</b>	<b>6125</b>	<b>10515</b>

*Tabelë që pasqyron represionin serb mbi popullatën e Kosovës*

Duke e trajtuar këtë problem Dr. Vaso Çubrilloviqi (ish Ministër i Qeverisë Federative, anëtar i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve dhe, që nga viti 1970 drejtor i Institutit Ballkanologjik të Beogradit dhe anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave të ish BS), theksonte: Nga rrethet e mësipërm "ato që përbëjnë pykën shqiptare, për ne, aktualisht (ishte viti 1937, shënimi im R.Z.) më të rëndësishme janë: Peja, Gjakova, Podrimja, Gora (Dragashi), Sharri, Podgora, Istogu dhe Drenica, në veri të Malit të Sharrit. Këto janë rrethe kufitare dhe duhen shpërngulur me çdo kusht. Rrethet në thëllësi të Kaçanikut, Gjilanit, Graçanicës, Llapit, Vuçiternit etj, mundësisht duhen dobësuar, sidomos ai i Kaçanikut dhe i Llapit, ndërsa të tjerat duhen kolonizuar gradualisht e sistematikisht dhe kjo duhet të realizohet gjatë dhjetëvjeçarit."

Ai vazhdon me shtjellime se si duhet bërë "Popullimi i krahinave të shpërngulura", cila do të jetë "Teknika e kolonizimit", "Mjetet financiare". Shpenzimet për shpërngulje Dr. Vaso Çubrilloviq i llogarit deri në 800 milionë dinarë. "Shqiptarët e shpërngulur, (thekson fundamentalisti sllav Çubrilloviq), do të lënë jo vetëm tokën, por edhe shtëpinë e veglat e punës... Gjatë krijimit të kolonive të reja, atje ku ta lypë nevoja, duhet të përdoret forca ushtarake..." Të gjitha këto ai i quan "Detyra strategjike-ushtarake dhe ekonomike".

Strategjia e Çubrilloviqit dhe e atyre që e mbështetën nuk ka nevojë për koment, mbasi ajo paraqet fare qartë synimet asimiluese (në mënyrën më barbare) ndaj shqiptarëve.

Problemi i shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë nga Jugosllavia mbeti një synim konstant për qeverinë jugosllave. Në vazhdim të kësaj politike më 1938 u hartua Konventa Turko-Jugosllave, për shpërnguljen e shqiptarëve, në bazë të së cilës "Shtetasi jugosllavë me fe, kulturë dhe përkatësi myslimane..."(Neni 1) gjithsej 40000 familje (neni 3), detyroheshin të linin trojet e tyre të rajonit të Banovinës së Vardarit, Banovinës së Zetës, banovinës së Moravës dhe të emigronin detyrimisht në Turqi. Brenda gjashtë vjetësh duke filluar nga muaji korrik 1939, do të realizohej periodikisht çdo vit, nga 1 maji deri më 15 tetor, emigrimi si më poshtë: Gjatë vitit 1939 - 4.000 familje, 1940 - 6.000 familje, 1941 - 7.000 familje, 1942 - 7.000 familje, 1943 - 8.000 familje, 1944 - 8.000 familje.

Në nenin 6 të kësaj konvente thuhet shprehimisht: "e gjithë pasuria e patundshme në fshat, e cila u takon shpërngulësve, do të mbetet pronë e Qeverisë Jugosllave..." Për ironi, në nenin 12, përcaktohet se këta nënshtetas "heqin dorë nga shtetësia jugosllave me dëshirë". Në nenin pasardhës ligjërohej që "Qeveria Jugosllave merr përsipër që ata t'i transportojë gratis deri në limanin e barkimit të tyre në Selanik" (Neni 12).

Kjo qe një politikë diskriminuese ndaj shqiptarëve myslimanë, që shoqërohej me një demagogji makiavelike. Për realizimin e saj, Jugosllavia vuri tërë arsenalin e saj propagandistik që kishte në dispozicion, të shoqëruar me një fond prej 800 milionë dinarësh, që përfaqësonte një shumë të madhe për Jugosllavinë.

"Me qëllim të shpopullimit të Çamërisë nga shqiptarët, qeveria Greke e asaj kohe, në kuadrin e këmbimit masiv të popullsisë respektive me qeverinë turke, në vitin 1923 përfshiu edhe elementin shqiptar mysliman. Pjesa e mbetur e popullsisë shqiptare myslimane u trajtua si element destruktiv. Madje në kohën e diktaturës famëkeqe të Mataksait ajo iu nënshtrua një genocidi të hapur. Kryqëzatën e egër antishqiptare në Çamëri e ndërmorri së fundi gjenerali Zerva. Bilanci i krimeve është tragjedi: 2300 të vrarë, prej të cilëve 350 ishin gra. U dëbuan 18150 veta, u dogjën dhe u shkatërruan 5350 shtëpi etj. Kështu u zhduk prania e shqiptarëve myslimanë në Çamëri, gjë që përbën një krim historik."

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, në nëntor 1944, Dr. Vaso Çubrilloviqi paraqiti përsëri para udhëheqjes më të lartë të LANÇ të Jugosllavisë platformën e re mbi "Problemin e pakicave në Jugosllavinë e re". Ai nisej nga parimi se "Jugosllavia Federative Demokratike mund të ketë paqë dhe një zhvillim të sigurt vetëm në qoftë se do të jetë e pastër etnikisht". Ai, duke iu referu metodave naziste të shpërnguljes me dhunë të masave të popullit, deklaronte: "Vetë Rajhu i Tretë ka ndjekur një politikë brutale kolonizuese duke shpërngulur miliona vetë nga njëri skaj i Evropës në tjetrin". Në vijim shtonte: "Edhe ne do të kemi të drejtë të kërkojmë nga aleatët tanë që dhe çështja e pakicave tona të zgjidhet në këtë mënyrë, me anën e shpërnguljes së detyruar". "...ne, - deklaronte Çubrilloviqi, - duhet që me çdo çmim të marrim etnikisht Baçkën, Kosovën dhe Metohinë, duke dëbuar me këtë rast qindra mijëra hungarezë dhe shqiptarë nga shteti ynë...". "Ndërsa në Kosovë dhe Metohi duhet të ndryshohet me themel përbërja e tyre etnike" duke linçuar thirrjen që "Ushtria gjatë operacioneve të luftës duhet t'i

spastrojë në mënyrë të planifikuar e pa mëshirë pakicat kombëtare". Këtu e kanë burimin tërë ato masakra masive që u bënë mbi popullsinë shqiptare, kryesisht myslimane.

Në pamundësi për ta realizuar plotësisht këtë plan djallëzor e antihuman për arsye të qëndresës së masave shqiptare, ata, në mënyra të ndryshme, u vunë kufizime shqiptarëve, duke mos i lënë të zhvillojnë kulturën e tyre, ekonominë e tyre, institutet e tyre etj. Elementi fshatar mysliman nuk kishte asnjë përkrahje. Ai gjendej i vetëm përballë furisë serbe.

## **PERSEKUTIMET E KLERIT DHE SHKATËRRIMI I INSTITUCIONEVE TË KULTIT ISLAM**

Një fenomen i tillë i ngjashëm kishte ndodhur edhe në zonën e Çamërisë, me çamërit myslimanë. Kisha greke dhe ajo sllave, pasi dështuan në ndërmarrjet e tyre për t'i konvertuar myslimanët në të krishterë ortodoksë, si etapë e parë, dhe pastaj për t'i shkombëtarizuar ata, si etapë e dytë, filluan përpjekjet për të komprometuar disa kategori sociale si: klerikët, çifligarët, shtresat e pasura në përgjithësi. Kështu qarqet serbe, sidomos gjatë viteve 1919 - 1921, kishin ndërmarrë një aksion barbar, që në popull u quajt me emrin i fëmija ta thithë 24 orë, dhe kur ka ardhur patrulla e dytë të njëjtin fëmijë e kanë dërrmuar për tokë, e kanë mbytur dhe e kanë hedhur në zjarr".

Si rezultat i mllëfit ortodoks grek edhe zëri i çamëve myslimanë në Çamëri u shua. Pothuajse asnjë faltore islame (xhami) nuk mbeti në këmbë në Çamëri. Asnjë klerik çam nuk pipëtin. Grekët i zgjidhnin

vetë klerikët myslimanë. Çamërit myslimanë u shpërndanë në Shqipëri, Turqi, SHBA, Egjipt e në disa vende islamike.

Duke bërë fjalë për vuajtjet dhe mjerimet e bashkatdhetarëve të vet, një dëshmitar i kohës, ndër të tjera shkruante: "Çamëria... po lëngon nën një sundim të huaj, i cili popullsinë e atjeshme po e mundon tiranisht". Genocidin që pësuan çamërit e përshkruan në mënyrë dramatike Edit Durhami. Kështu në Çamëri feja dhe kultura islamike filloi të venitej, sepse qarqet zyrtare greke me anë aktesh e dekretesh të ndryshme penguan çdo gjë që kishte lidhje me kulturën islame dhe ndërgjegjien kombëtare shqiptare. Në këtë mënyrë islamizmi shqiptar u gjet para disa armiqve njëkohësisht: në Shqipëri para komunizmit, në Jugosllavi para komunizmit dhe kishës ortodokse sllave dhe në Greqi (Çamëri) para kishës ortodokse greke, armike tradicionale e shqiptarëve, si dhe politikës vorio-epirote.

Në Jugosllavi u përpoqën t'u mbyllin gojën hoxhallarëve. Në mënyrë të veçantë ata u përpoqën të depërtonin në medresetë. Historia dëshmon për veprime të kësaj natyre. Me metoda nga më të ndryshmet ata u përpoqën t'i lënë myslimanët në prapambetje, duke u mohuar arsimimin, të drejtën e punës, duke i lënë kështu larg kulturës dhe, duke iu shmangur vetëdijes kombëtare. Ata bënë çmos që duke shfrytëzuar një rrethanë si pasojë e klerit të papërgatitur, ta kthejnë popullsinë myslimane në një popullsi thjesht fanatike, që mund të nënshtrohej sa më lehtë.

Xhamia FET'HIJE në Prizren, e njohur në popull si Xhuma Xhamia (e ndërtuar më 1445), i është rrëzuar minareja më 5.6.1923 dhe në vendë të sajë i është ngritë këmbanara. Sot funksionon si kishë ortodokse sllave.

## SINJALET E PARA NDAJ RREZIKUT KOMUNIST

Përveç shovinizmit ortodoks fqinj feja e kultura islame u përballën edhe me ideologjinë e regjimit komunist. Propaganda e komunizmit, fillimisht, përveç bolshevizmit të partisë komuniste synonte edhe goditjet ndaj fesë. Kjo propagandë antifetare u intensifikua sidomos në vitet '20 dhe '30 të shekullit tonë. Ajo u përhap edhe në Shqipëri, kryesisht nëpërmjet përhapjes së ideve komuniste e përkthimit të literaturës komuniste.

Kleri mysliman shqiptar me H. Vehbi Dibrën në krye e kuptoi këtë sfidë dhe u shpejtua të marrë masa. Ai reformoi medresetë, miratoi pjesëmarrjen e gruas myslimane në jetën shoqërore, duke dekretuar heqjen e perçes, lejoi përdorimin e kapeles, organizoi shtypin fetar e të tjera dhe iu kundërvua ideologjisë komuniste. Ai kuptoi rolin e kulturës islame si ndërlihdhëse të Shqipërisë me perëndimin dhe lindjen, madje me kulturën mbarë botërore. Ai e kuptoi pozitën gjeografike, që zinte Shqipëria në këtë pjesë të Evropës dhe rolin që duhej të lozte. Ai nuk e pa progresin perëndimor si diçka të huaj, por pa në të edhe atë pjesë që ishte negative, mohuese, depresive për shoqërinë në përgjithësi.

Me Kryemyftiun e parë të shqiptarëve u solidarizuan shumë përfaqësues të inetligjencies Islame, siç qe Hafiz Ibrahim Dalliu etj. Këta fetarë atdhetarë të flaktë e mësuan popullin se si duhet të flijohet për kombin. "Patriotizma (thoshte Hafiz Dalliu) asht një fjalë e shenjtë që përfshin shpirtin e të gjithë virtuteve njerëzore dhe kombëtare. Prandaj ai fatbardhë që cilësohet me fjalën patriot, asht tepër i lavdërueshëm, kudo dhe prej kujdohit, rrëfëhet me gisht". Por, duhet thënë gjithashtu se një pjesë e mirë e klerikëve, të pakompletuar nga pikëpamja filozofike e teologjike, të prapambetur në mendime, nuk arritën t'i bëjnë ballë ofensivës komuniste.

Materialet që botuan Hfz. Ali Korça dhe Hfz. Ali Tarja kundër komunizmit, ndonëse janë me interes, nuk u ngritën në nivelet e një lufte të paepur, të argumentuar, shkencore. Në "Zani i Naltë", gjithnjë e më pak botoheshin artikuj të kësaj natyre teorike. Lidhjet që u krijuan me vende islamike si me Egjiptin, Pakistanin, Sirinë etj, nuk u ngritën në atë nivel që kërkonte koha. Por e rëndësishme është se veprat e Hfz. Ibrahim Dalliut, si: "Tefsiri i Kur'anit" e të tjera, luajtën një rol të rëndësishëm në ushtrimin e gjuhës amëtare për rrjedhojë të zhvillimit të kulturës islame në mënyrë të veçantë në trevat e Kosovës.

Në vitin 1934 Hfz. Ali Kraja kishte botuar monografinë e tij "A duhet feja". Në kapitullin "Islamizmi e ateizmi" të këtij materiali, autori, i nisur nga pozita teologjike teorike, debaton me ateizmin e propaganduar nga komunistët. Ndër të tjera shkruan: "Çdo mysliman më parë se çdo gjë beson se Krozullimi është vepra e një Krijuesi.

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste u dha shkas komunistëve që propagandën e tyre ta intensifikonin në kuadrin e Luftës kundër pushtuesve nazifashistë. Premtimet joshëse, nga njëra anë, skamja dhe padija, nga ana tjetër, dhe në mënyrë të veçantë qënia në krye të Luftës e P.K.SH., i dha një goditje të rëndë fesë në përgjithësi dhe në veçanti islamizmit si besim i pjesës më të madhe të shqiptarëve. Në Kosovë çështja mbeti më ndryshe. Kosovarët i mbajtën të palëkundura lidhjet me fenë.

Komunizmi filloi të depërtojë në Shqipëri nëpërmjet një propagande të organizuar mirë, nëpërmjet literaturës që vinte kryesisht nga jashtë, e cila mohonte fenë, mohonte Zotin, nëpërmjet idesë së bashkimit të të gjithë njerëzve në një pushtet të vetëm. Një literaturë e pasur vinte nga Kominterni, natyrisht e kontrolluar dhe e përpunuar në BRSS. Parullat që përmbanin këto materiale, ishin kaq tërheqëse sa filluan të bëjnë për vete mjaft të rinj të shtresave të varfra të popullsisë. Premtimet që u bëheshin për të ardhmen, për botën e re pa klasa e pa shfrytëzues, për mirëqënie të të gjithëve joshën

masa të tëra të rinjsh, sidomos nxënës, shëgertë, punëtorë dhe disa intelektualë. Nga ana tjetër, përhapja e komunizmit gjeti terren të përshtatshëm, sepse mungonin botime të ndryshme me karakter fetar dhe format e propagandës fetare kishin mbetur prapa.

Në institucionet arsimore, siç qenë mejtepet që funksiononin pranë xhamive, vërtet jepeshin mësimë feje dhe parimet e moralit islam, por në ato nuk zhvillohej ose nuk përgatiteshin nxënësit në atë shkallë për t'iu kundërvënë me debat propagandës komuniste. Komunistët filluan të përhapnin sllogane sikur feja pengon qytetërimin, se feja është një opium për popujt, se ajo e pengon bashkimin kombëtar etj. Në këtë mënyrë para udhëheqësve të Bashkësisë Islame Shqiptare doli problemi i madh i konsolidimit të mendimit islamik, të kulturës islame, të debatimit për probleme teorike, si dhe për kundërvënie ndaj arsenalit të fuqishëm të propagandës që po bëhej në Shqipëri.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me pushtimin e Shqipërisë, myslimanët në përgjithësi u radhitën kundër pushtuesit. Pushtuesit italianë bënë një politikë demagogjike për t'i tërhequr ata ndaj politikës së tyre, ftuan shumë klerikë në Romë, përdorën simbole të ndryshme (shpata e islamit), shpërndanë ndihmë ekonomike, futën mësimin e besimit në shkollë për t'i joshur ata ndaj politikës së tyre.

Muslimanët shqiptarë përfituan me zgjuarësi nga kushtet e reja të krijuara nga zhvillimi i luftës, sidomos me ndryshimet e kufijve. Ata foruan lidhjet e tyre me myslimanët shqiptarë të Kosovës, të trojeve shqiptare të Malit të Zi dhe të trojeve shqiptare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë si dhe me popullatën çame. Vajtje-ardhjet, bashkëpunimi i tyre, forcoi më tepër lidhjet dhe ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në këto zona. Një pjesë e literaturës në gjuhën shqipe, e panjohur më parë nga popullata e zonave të pushtuara nga Jugosllavia dhe Greqia, filloi të hyjë në këto zona dhe të lozë një rol të rëndësishëm në pikëpamje kombëtare.

## PËRBALLJA ME KOMUNIZMIN

Në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore, me ndikimet e fuqishme sllavo-komuniste edhe në shtetin amë, u zhvillua një luftë e gjithanshme kundër fesë në përgjithësi, duke e kufizuar veprimtarinë fetare në mënyrë graduale. Partia Komuniste Shqiptare ndërmoi një sërë masash radikale që synonin vendosjen e sistemit socialist totalitar. Në kushtet e vendosjes e konsolidimit të këtij sistemi, feja islame ashtu sikurse i gjithë sistemi i fesë në përgjithësi, pësoi goditje të njëpasnjëshme të cilat fillimisht e dobësuan ndikimin dhe më pas e ndaluan ushtrimin legal të saj.

Në luftën kundër fesë u përdoren metoda e forma të cilat evoluan sipas kushteve historike dhe etapave të ndërtimit të sistemit politik monist. Në vitet e para pas çlirimit udhëheqja shqiptare nuk u ngrit të ndalonte në mënyrë kategorike fenë e institucionet e saj. Një hap i tillë i nxituar do të shkaktonte pakënaqësi në radhët e besimtarëve, mbi 75% e të cilëve ishin islam, do të shtonte radhët e kundërshtarëve ndaj regjimit madje do të kompromentonte gjithë punën për arritjen e objektivave programore të PKSHE ndërtimin e sistemit socialist totalitar. Në këtë mënyrë ajo u ruajt nga "tendosja e harkut" dhe ndoqi një politikë të moderuar ndaj këtij problemi, që mbështetej në parimin se në lidhje me shtetin feja do të ishte çështje private, gjë që do të thoshte se as feja nuk do të përzihej në punët e shtetit dhe as shteti nuk do të përzihej në punët e brendshme të fesë.

Duke iu përmbajtur kësaj strategjie e taktike PKSHE ruajti statusin që feja kishte fituar në periudhën e mbretërisë (1929) sipas të cilit feja qe e ndarë nga shteti. Ky i fundit ligjërisht mbajti prerogativat e aprovimit të statuteve të komuniteteve fetare dhe angazhimin për subvencion financiar të tyre.

Në këto rrethana komuniteti islam që në vitin e parë të pas luftës bëri përpjekje për shërimin e plagëve (dëmeve) që kishin pësuar ndërtesat e kultit dhe sistemi i fesë në përgjithësi si dhe për organizimin e

veprimtarisë fetare. Fillimisht u ngrit një këshill i përkohshëm për përgatitjen e statutit të ri i cili u aprovua në kongresin III të besimtarëve islam në maj të vitit 1945.

Statuti konfirmonte bazën sociale të komunitetit që përbëhej nga gjithë muslimanët e Shqipërisë si dhe sanksiononte organe drejtuese të tij. Organi më i lartë ishte Këshilli i Përgjithshëm i përbërë nga kryetari, 4 kryemyftinj të zonave dhe nga një përfaqësues për çdo prefekturë. Njëkohësisht u morën masa për vënien në funksion të xhamive dhe për të mundur ushtrimin e ceremonive fetare. Ndonëse në kushte të vështira materiale, me ndihmën e pakursyer të besimtarëve, u bë e mundur që brenda një kohe të shkurtër të riparoheshin ndërtesat e kultit.

Ndërsa komuniteti musliman dhe besimtarët bënë përpjekje për ushtrimin e fesë, shteti i ri që po institucionalizohej, duke lejuar të drejtën dhe lirinë e veprimtarisë fetare, në të njëjtën kohë garantoi edhe të drejtën e propagandës ateiste antifetare. Çdo shtetas në përshtatje me botëkuptimin e tij dhe çdo organizatë shoqërore, në përshtatje me programin e vet, mund të zhvillonte lirisht propagandën ateiste. Krahas ndarjes së fesë nga shteti u bë edhe ndarja e shkollës nga feja.

Në këtë mënyrë fillimisht feja lejohej të ushtrohej, por ajo ndalohej të vepronte në kundërshtim me ligjet e shtetit. Këto parime u mishëruan në kushtetutën e parë të RPSH (Statuti) në nenin 18 të së cilës thuhej se "të gjithë shtetasve u garantohej liria e ndërgjegjës dhe e besimit". Njëkohësisht Kushtetuta ndalonte përdorimin e fesë për qëllime politike dhe formimin e organizatave politike mbi baza fetare. Si komunitetet e tjera fetare edhe ai musliman u la i lirë në çështjet e ushtrimit të ceremonive fetare, por vetëm brenda kufijve të caktuar me ligj.

Duke i konsideruar të pamjaftueshme aktet legjislativë udhëheqja komuniste shqiptare ndërmori një sërë masash të tjera që e kufizuan më tej fenë. Në këtë drejtim një goditje të veçantë përbënin masat në

rrafshin ekonomik për dobësimin e pozitive ekonomike e të bazës materiale të fesë. Në kuadrin e shndërrimeve në fushën ekonomike në përgjithësi, e të mjeteve të prodhimit në veçanti iu bë fesë me anën e Reformës Agrare.

Me anë të kësaj Reforme shteti i shpronësoi entet fetare të proveniences islame nga 3,163 hektarë toke dhe 61 000 rrënjë ullinj.

Kjo reformë dhe një sërë masash të tjera në fushën fiskale e të shtetëzimeve e kufizuan tepër bazën ekonomike të fesë. Gjithnjë në rrafshin ekonomik një goditje tjetër i dha institucioneve fetare proçesi i kooperimit të mjeteve të punës e të prodhimit në bujqësi që filloi në fund të vitit 1946. Gjatë këtij proçesi në emër të unifikimeve e sistemeve të tokave institucioneve fetare iu morën sipërfaqe të tëra toke pa shpërblim ose në këmbim me toka improduktive.

Masat shtetërore, për dobësimin e fesë, me kalimin e kohës po shkonin në kahje të kundërt me statutin ekzistues të saj. Me 26 nëntor 1949 doli ligji i ri për komunitetet fetare. Ai ndonëse i mbështetur në dispozitat kushtetuese mundësonte ndërhyrjen dhe vënien e fesë nën kontrollin e shtetit. Ky synim konstatohet lehtë në përmbajtjen e raportit justifikues të miratimit të tij, ku ndër të tjera thuhet se "...parimi i mosndërhyrjes në punët e fesë duhet interpretuar se feja qendron jashtë shtetit... ose si shtet brenda shtetit".

Ndërhyrja e shtetit ndaj fesë duket edhe nga përmbajtja e disa neneve të këtij ligji. Kështu neni 12 u diktonte institucioneve fetare jo edukimin fetar e besimtarëve me dashurinë ndaj partisë shtet, kurse letërsinë e propagandën fetare e vinte nën kontrollin e shtetit. Përveç kësaj në emër të krijimit të një feje mbi baza kombëtare ligji ndalonte marrëdhëniet e drejtëpërdrejta të fesë me institucionet homologe jashtë shtetit. Ato mund të realizoheshin me ndërmjetësinë e qeverisë. Në Shqipëri u ndalua ngritja e

degëve, shoqatave e urdhërave fetare e tjera, qendra drejtuese e të cilave nuk ndodhej brenda vendit. Ligji i jepte të drejtë absolute qeverisë të vendoste për titullarët e komuniteteve fetare. Në qoftë se ndonjëri prej tyre nuk plotësonte kriteret politike ajo mund ta pezullonte. Ndryshe nga ligji i mëparshëm ky ligj e linte evazive çështjen e subvencionit financiar të fesë. Në të thuhej vetëm "shteti mund të ndihmonte fenë".

Ky ligj shënonte një fazë të re në marrëdhëniet e fesë me shtetin. Kompetencat e zbatimit të tij i mori në dorë një i ashtuquajtur "Komitetet për çështjet klerikale" i ngritur pranë qeverisë.

Ky komitet nga një organ në cilësinë e koordinatorit gradualisht u shndërrua në një organ diktati mbi fenë, duke përcaktuar edhe objektin e veprimtarive fetare. Përmbajtjen e ligjit qeveria shpejtoi ta bëjë menjëherë të njohur. Ajo u kërkoi komuniteteve fetare të rishikonin statutin e buxhetin e tyre duke linçuar diktatin "në ligj shprehet vija e drejtë e pushtetit popullor ndaj komuniteteve fetare, prandaj pritet respektimi rigoroz i tij".

Një kujdes të veçantë bëri qeveria shqiptare (kuptohet nën udhëzimet e udhëheqjes komuniste -R.Z.) për përzgjedhjen e kuadrit fetar sipas kriterëve politike. Kjo konstatohet në dokumentacionin zyrtar, ku shpesh ndeshen udhëzime të sakta mbi mënyrat e depertimit në organet drejtuese të fesë të elementeve "të besuar". Për arritjen e këtij qëllimi nëpunës të shtetit e të aparateve partiake merrnin pjesë aktive në fushatat e zgjedhjeve të organeve drejtuese fetare.

Një drejtim tjetër i politikës së PPSH ishte ngushtimi i sferës së veprimtarive fetare, shkurtimi i personelit dhe i institucioneve fetare. Në një qarkore të qeverisë të vitit 1951, thuhej hapur se zgjerimi i veprimtarive fetare binte ndesh me politiken e partisë e të pushtetit, sepse rrit influencën e dogmës fetare në popull dhe zbeh autoritetin e partisë.

Ky legjislacion në hapat e para të instalimit të sistemit socialist totalitar shënonte një dobësim të pozitës së fesë, përbënte një goditje tronditëse për gjithë "ndërtesën" fetare duke e lehtësuar luftën e mëtejshme.

Përpos legjislacionit e masave të tjera në rrafsh politik dhe ekonomik për kufizimin dhe dobësimin e ndikimit të fesë në jetën shoqërore, nga partia shtet u organizua një fushatë e gjithanshme dhe e vazhdueshme ateiste në planin ideologjik.

Megjithatë ndonjë orientim për prurësi ndaj besimtarëve, sidomos atyre muslimanë që ishin më të shumtë, e gjithë masmedia, shkolla, institucionet e tjera shtetërore, organizatat sociale hynë në një konfrontim pa precedent me ideologjinë fetare, që synonte dobësimin e fesë, ndalimin e letërsisë e kulturës fetare në përgjithësi, ku vendin kryesor kuptohet e zinte ajo islame. Është për këtë arsye që udhëheqja komuniste në qershor të vitit 1956, në një letër drejtuar gjithë komiteteve qarkore të PKS, pasi vinte në dukje faktin se në vend gjallnonin ende shumë rite e festa fetare, të cilat "pengonin ecjen përpara" udhëzonte që gjatë punës për pengimin e festave fetare të mos kalohej në masa administrative. Kjo gjë theksonte ajo do të arrihej në sajë të një pune të madhe bindëse.

Në kushtet kur institucionet fetare e vazhdonin veprimtarinë e tyre për të rritur ndikimin e fesë tek njerëzit, një vëmendje e veçantë iu kushtua edukimit me ideologjinë komuniste të brezit të ri. Në këtë drejtim një rol të madh luajti shkolla. Për këtë qëllim u morën masa për përshtatjen e programeve e të teksteve mësimore në mënyrë që në to të mos i bëhej asnjë lëshim botëkuptimit fetar. Po kështu u udhëzuan të gjitha institucionet kulturore e arsimore që propagandën ateiste ta lidhnin me jetën e përditshme. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë iu kushtua punës me leksionet e bisedat, të filmit shkencor e të eksperimentimit me të dhënat e shkencës në përgjithësi. Terreni kryesor i kësaj pune u bë

fshati, ku përgjithësisht ndikimi i fesë qe më i madh e besimtarët ishin më të shumtë. Veprimtarët e punonjësve të kulturës nga qyteti u bënë propagandistë të botëkuptimit ateist në fshat.

Në etapën e mësipërme (vitet '50) në kuadrin e gjithë luftës kundër fesë një vëmendje e veçantë iu kushtua masave të ndërmarra nga shteti komunist si ndalimi i krijimit të organizatave politike me baza fetare, ndalimi i botimit të letërsisë fetare, kufizimit e më pas heqja e mundësive për pregatitjen e kuadrit fetar.

Udhëheqja komuniste pasi analizoi hapat e shënuara deri në këtë periudhë, në përpjekjet për kufizimin e fesë, hodhi parullën e luftës në front të gjerë kundër saj.

Në fund të vitit 1965 dhe gjatë vitit 1966 mjaft të rinj të nxitur nga organizatat e PPSH mbi bazë krahine, qyteti e fshati ishin hedhur në luftë kundër ndërtesave të kultit. Me dt. 14 maj 1966 ishte mbyllur nga organizata e rinisë xhamia e katundit Xibrake të lokalitetit të Belshit (Elbasan). Një ditë më pas ishte mbyllur nga organizata e rinisë xhamia e fshatit Mynqan të lokalitetit të Cërrikut. Populli i lagjes "Kongresi i Përmetit" të qytetit të Shkodrës në mbledhjen e tij, të inicuar nga komunistët, me datë 5 qershor 1966 ishte shprehur për mbylljen e xhamisë dhe kthimin e territorit përreth në terren sportiv për familjet. Më 17 gusht disa komunistë anëtarë të kooperativës bujqësore së Shënkollit në emër të fshtrave lajmëronin famullitarin e zyrës famullitare të Breg Mates, në rrethin e Lezhës, se populli nuk i donte krezmimet "prandaj të lajmërohej ipeshkvi që të mos vinte për të kryer ceremonitë e zakonshme". Gjatë vitit 1966 ishin mbyllur faltore edhe në shumë rrethe të tjera të vendit nga të rinjtë.

Nën presionet e manipulimet e partisë shtet Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Bektashian me vendim të posaçëm të 16 Tetorit 1966 mbyllte, me motivacion mosfrekuentimi nga ana e besimtarëve, një sërë teqesh në rrethet Kolonjë, Elbasan, Berat, Gjirokastër .

Nga ana tjetër organet e pushtetit vendor duke u konformuar për qëllime karrieriste u bënë një sërë propozimesh organeve të larta të pushtetit për të ndërmarrë një sërë masash në drejtim të legjislacionit përkatës të institucioneve e organizatave fetare. Të gjitha këto propozime argumentoheshin me "kushtet e reja të krijuara me arritjet në fushën e ekonomisë, në fushën ideologjike e nivelin kulturor të masave".

Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit të Shkodrës "në emër të kërkesave të popullit të këtij rrethi" i propozonte Këshillit të Ministrave nevojën e një sërë ndryshimesh në statusin e kishës katolike të Shqipërisë. Njëkohësisht propozohej që institucionet fetare të merrnin aprovimin e t'i nënshtroheshin kontrollit të "komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve", për një sërë çështjesh të rëndësishme të veprimtarisë së tyre.

Gjithashtu mbështetur në orientimet e udhëheqjes komuniste duke u mbështetur në ndryshimet e bëra në sferën e ideologjisë i propozohej Këshillit të Ministrave që të bëheshin disa ndryshime në ligjin nr. 743 datë 16.2.1949 "Mbi komunitetet fetare", të miratuar dhe nga Kuvendi Popullor në ligjin nr. 773 datë 16.1.1950 meqenëse në dekretet e sipërme përmbaheshin nene të tilla që u kishte kaluar koha u duheshin ndryshuar.

Gjatë gjysmës së parë të viteve gjashtëdhjetë ishin marrë një sërë masash të tjera, ndonëse të pjeshme, që e kufizonin fenë si shkurtimi i organikave të komuniteteve fetare në qender dhe i zyrave të tyre vartëse nëpër rrethe.

Me vendim të posaçëm ishte mbyllur medreseja dhe ishin grumbulluar mjaft libra fetare. Njëkohësisht ishte pakësuar buxheti i komuniteteve fetare. Buxheti i komunitetit musliman u pakësua nga 12 milion lekë të vjetra në 2 milion e 800 mijë.

Të gjitha masat kufizuese ndaj fesë në përgjithësi e kulturës islame në veçanti deri në mesin e viteve 60 si dhe veprimet e rinisë kundër fesë gjatë vitit 1966 inkurajuan udhëheqjen shqiptare për kalimin në një fazë të re, më të lartë, në një luftë frontale kundër fesë me përmasa të papara. Një luftë e tillë në një shkallë tejet tendencioze, ishte pjesë përbërëse e orientimit që kishte dhënë PPSH për politizimin dhe ideologjizimin e skajshëm të jetës së vendit si dhe produkt i revolucionit kulturor kinez.

Xhamia e Biçakçizades (Xhamia e Agait) ndërtuar me 1660/70 Elbasan. U shkatërrua nga regjimi komunist në vitet 1970

## **PUSHTETI DHE LUFTA E TIJ KUNDËR FESË**

Kongresi V i PPSH që u mbajt në nëntor të vitit 1966 e cilësoi luftën kundër ideologjisë fetare si një aspekt me rëndësi në zhvillimin e luftës së klasave. Sipas udhëheqjes komuniste "ndërtimi i socializmit dhe fitorja e tij e plotë nuk mund të garantohej duke pasur akoma njerëzim bartës të botëkuptimit idealist fetar dhe të zakoneve prapanike". Ishin këto kushte objektive e subjektive të krijuara dhe kjo "domosdoshmëri" që PPSH hodhi parullën për një luftë klasore të thellë " midis dy botëkuptimeve, jo vetëm midis nesh dhe armiqve, por edhe në gjirin e popullit", qëllimi i së cilës përveç të tjerave ishte çrrënjësia e botëkuptimit fetar.

Angazhimi në luftën kundër fesë sikurse thamë më sipër kishte filluar në shtresat e popullit, veçanërisht të rinisë, duke përfshirë një front të gjerë, qytetin e fshatit.

Ajo u shoqërua me aksione goditëse direkte. Ndonëse nuk disponohet ndonjë dokument që udhëheqja komuniste të ketë dhënë orjentim për fillimin e veprimeve kundër institucioneve fetare. Lidhur me këtë dëshmojnë dokumentet e Kongresit të V të PPSH, që u mbajt në nëntor të vitit 1966 si dhe një letër e PPSH e shkruar me 27 shkurt të vitit 1967 drejtuar komiteteve të partisë të rretheve "Mbi luftën kundër fesë, paragjytimeve e zakoneve fetare". Në këto dokumente jepeshin orientime për zhvillimin e "sa më drejt, pa gabime dhe me sukses të luftës kundër fesë, paragjytimeve dhe zakoneve prapanike".

Lufta frontale kundër fesë për rrjedhojë edhe kulturës islame u zhvillua në disa drejtime kryesore. Ajo u drejtua kundër ndërtesave të kultit dhe bazës materiale të fesë. Objekt i saj ishte likuidimi i funksionit zyrtar të klerit profesionist dhe neutralizimi i tij ndër masa. Një tjetër orientim i lëvizjes kundër fesë në këto vite ishte sidomos lufta kundër dogmave, riteve e ceremonive fetare, që përbënin thelbin e herezisë kundër fesë dhe një dimension i kulturës islame.

Lufta kundër fesë që shpërtheu në këtë periudhë u drejtua në fillim kundër faltoreve e bazës materiale të tyre. Në fillim u mbyllën disa xhami e kisha kryesore dhe pastaj të rinjtë e manipuluar shkuan më tej, për t'i mbyllur të gjitha ato.

## **XHAMIA E DURRËSIT PARA PRISHJES**

Dalja e rinis në ballë të kësaj lufte e ka shpjegimin e vet. Brezi i ri në përgjithësi dhe rinia shkollore në veçanti ishte më pak e ndikuar nga ideologjia fetare për vetë kushtet e reja në të cilat ajo kishte lindur e ishte rritur. Njohuritë ateiste të marra nëpërmjet shkollës dhe puna e vazhdueshme propagandistike

antifetare kishin bërë që brezi i ri të ishte indiferent ndaj fesë. Të gjitha këtyre u duhen shtuar edhe veçoritë e moshës së rinisë, lehtësia për t'u manipuluar, shpirti i iniciativës, energjia etj.

Në kuadrin e lëvizjes heretike u shquan të rinjtë e Durrësit të cilët u hodhën në një veprim të organizuar ndaj bazës materiale të fesë. Pas aksioneve të të rinjëve të këti qyteti në të gjithë rajonet e vendit të rinjtë filluan një luftë të gjerë ndaj institucioneve fetare në përgjithësi e në rastin konkret ndaj fesë e kulturës islame në veçanti. Nëpërmjet fletërrufëve të vendosura në ambientet e shkollave apo ndërmarrjeve kritikoheshin nxënësit besimtarë, kritikohej në të gjitha drejtimet feja. Një formë e tillë pune gjeti përhapje në lagje e fshatra.

Këto aksione të të rinjve u nxitën fuqimisht nga organizatat bazë të partisë, komitetet si dhe nga organizatat sociale. Komitetet e partisë praktikuan gjerësisht dërgimin e të rinjëve të qendrave të punës e të shkollave në fshatra dhe lagje. U kombinua puna në mënyrë të tillë që të rinjtë punëtorë dhe të zonave fushore që punonin në kooperativat e zonave malore të merreshin edhe me propagandën e gjerë ateiste në përgjithësi dhe të ndihmonin rininë e fshatit në këto zona në luftën kundër vatrave të fesë.

Të nxitur nga veprimet e para, komitetet e partisë të rretheve dhe organizatat bazë të Partisë e ridimensionuan punën e tyre për likuidimin fesë. Krahas mbylljes së faltoreve ato orientuan për një sërë aksionesh të tjera për zhdukjen e gjithë bazës materiale të fesë si: Dorëshkrimet e vjetra islame, kryqet, ikonat, kur'anet, letërsinë fetare në përgjithësi etj. të vendosura në vendet e shenjta, në ambiente të ndryshme dhe brenda ndërtesave të banimit.

Si rezultat i këtyre veprimeve në një kohë të shkurtër prej disa muajsh iu dha tronditja e parë institucioneve fetare. Me përjashtim të ndonjë xhamie apo kishe me vlera arkitektonike apo historike,

në të gjithë vendin u mbyllën të gjitha xhamitë, kishat, teqetë, tyrbet, vakëfet etj. Ky numër arrinte gjithsej në 2035, nga të cilat 740 xhami.

Me mbylljen e faktoreve lindën edhe disa probleme. Pothuajse të gjitha ato, megjithëse u përdorën për qëllime ekonomike apo social kulturore, ruanin pamjen e mëparshme. Kjo, përveç të tjerash, në heshtje, u kujtonin besimtarëve ndërtesën e shenjtë qoftë kjo xhami apo kishë. Duke u nisur nga këto efekte të padëshirueshme për udhëheqjen komuniste që mund të ushtronte ruajtja e pamjes së jashtme e ndërtesave të kultit u udhëzua që të ndërmerreshin një seri masash. Në emër të planeve rregulluese të qyteteve apo fshatrave ndërtesat e mësipërme të prisheshin fare e në vend të tyre të bëheshin ndërtime të reja. Shumë të tjera do të prisheshin nën pretekstin e rrezikut të shembjes e të mungesës së vlerave arkitektonike. Të tjerave që u vunë në përdorim për nevoja të ndryshme si: kinema, shtëpi e vatra kulturore e palestra etj. iu ndryshua pamja e jashtme në sajë të rindërtimeve të pjesshme.

Në këtë aspekt nën "vullnetin" e bazës u kërkua që "Ministria e Arsim Kulturës (Instituti i ruajtjes së monumenteve të kulturës) të rishikonte kriteret që ruajnë një numër të madh kishash e xhamish pa ndonjë vlerë historike".

## **SHTETËZIMI I PRONAVE FETARE**

Bashkë me institucionet fetare u vu dorë mbi pasurinë e tyre. Me dekret të Presidiumit e Kuvendit Popullor nr. 4263 të 11 prillit 1967 pasuritë e patundshme të komuniteteve fetare kaluan në dispozicion

të komiteteve ekzekutive të kishave popullore të rretheve përkatëse ose iu dorëzuan kooperativave bujqësore pa shpërblim.

Gjendja e arkivave dhe e llogarive rrjedhëse të të gjitha institucioneve fetare që deri në fund të muajit mars të atij viti arrinte shumën 1929307 lekë të reja, kalonte në dispozicion të komiteteve ekzekutive të rretheve për nevoja social kulturore ose për nevojat kooperative bujqësore. Në dispozicion të këtyre të fundit kalonin edhe një sasi e madhe bagëtish, vreshtash, ullinjsh, kopshtesh etj. që posedonin institucionet fetare.

Një pasuri tjetër e patundshme që kaloi në pronësi të shtetit ishin mullinjët e magazinat me paisjet e tyre të brendshme pronë e ndërtesave të kultit. Njëkohësisht shteti hiqte dorë nga subvencionimi që bënte çdo vit për pagesat e rrogave e të pensioneve të një pjese të mirë të klerikëve.

Krahas likuidimit të faltoreve e bazës materiale lufta u drejtua edhe kundër normave kur'anore, ceremonive, riteve e praktikave fetare. Kjo ishte herezia më e mprehtë, më e gjerë e më e thellë që u shtri edhe brenda në familje. Ajo preku direkt ritet fetare si botëkuptim, festat e zakonet që ishin futur e shkrirë në jetën e përditshme të njerëzve. Kjo dëshmonte për atë që partia shtet ishte e vendosur për të shkullur nga rrënjët të gjitha ato fije që i mbanin njerëzit të lidhura me botëkuptimin fetar.

Në radikalizimin e kësaj lufte udhëheqja komuniste llogariti faktin që feja e kultura islame në Shqipëri nuk kishin mundur të zhvilloheshin në formë të qendrueshme e sistematike për arsyet e mungesës së një baze klerikale me kulturë. Duke llogaritur këto rrethana KQ i PPSH në letrën që u drejtonte komiteteve të partisë të rretheve "Mbi luftën kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare" orientonte që lufta "duhet të bëhet me këmbëngulje kundër zakoneve, traditave, mënyrës së jetesës e të interpretimit të fenomeneve.

Shtrohej një detyrë e tillë sepse ishte pikërisht kjo sferë që klerikët kishin mundur të futnin besimin fetar duke e përzier me gëzimet, hidhërimet, me ngjarjet e përditshme të jetës së njerëzve.

Lëvizja heretike me kalimin e kohës u bë më e organizuar. Organizatat bazë të partisë në fshat krijuan instrumente të tilla siç ishin "aktivet e luftës kundër fesë dhe zakoneve prapanike". Pjesëmarrësit e këtyre aktiveve ishin kryesisht të rinj e arsimtarë. Ata fillimisht u morën me studimin e karakterit të riteve fetare në zonën apo fshatin e tyre, shkallën e influencës së këtyre riteve dhe të klerit në përgjithësi.

Udhëheqja e PPSH kishte orientuar për forma më të zgjedhura duke vënë në lëvizje levat e saj, organizatat sociale. Ato u kthyen në tribuna ku demaskoheshin institucionet dhe botëkuptimi fetar. Nën presionin e manipuluesve shumë njerëz u mblodhën në tubime ku merreshin vendime për të likuiduar bazën materiale e ritet fetare.

Po të shikojmë përmbajtjen e vendimeve të disa tubimeve, rezulton se lufta likuiduese drejtohej kundër festave fetare si bajrami, ramazani, pashkët etj. Me anë të tyre dënoheshin ritet e ceremonitë fetare që përdoreshin në rast lindjeje dhe vënie emri të familjeve apo në vdekje. Edhe gjeografia e lëvizjes antifetare që e gjerë, ajo kishte përfshirë gati të gjitha krahinat e vendit, fshatin e qytetin.

Në këtë luftë pa precedent PPSH duke llogaritur rezistencën dhe rritjen e numrit të kundërshtarëve të regjimit, sepse kjo ishte një luftë që zhvillohej brenda gjirit të popullit, bëri thirrje për prurë. Në këto momente ajo porosiste: "Me gjithë propagandën tonë të organizuar kundër fesë, riteve, dogmave, institucioneve fetare dhe klerikëve profesionistë të kemi vazhdimisht parasysh që të mos futemi në luftë të hapët me njerëzit që besojnë në fenë, sepse në popull do të ketë edhe njerëz të ndershëm të lidhur

me partinë e patriotë të flaktë, që do të ruajnë në ndërgjegjen e tyre edhe për shumë dhe mundet edhe deri sa të vdesin besimet e tyre".

Shumë shpejt festat e ceremonitë fetare u kufizuan. Nga disa vëzhgime sociale rezultonte se një festë e tillë si bajrami i vogël, në marsin e vitit 1967, u festua shumë më pak se çdo vit tjetër. Në këto ditë në përgjithësi nuk pati mungesa në punë dhe të nxënësve në shkolla, sikurse ndodhte në vitet e tjera.

Një dimension tjetër i luftës kundër fesë në këto vite ishte edhe likuidimi i funksionit zyrtar të klerit profesionist dhe neutralizimi i ulemasë, proces ky që u zhvillua nëpërmjet një lufte të ashpër klasore. Në vitin 1967 në gjithë vendin vepronin një numër i madh hoxhallarësh, priftërinjsh, dervishësh, shehlerësh etj. Veç këtyre një pjesë e xhamive dhe kishave kishin dhe këshilltarët e tyre, numri i të cilëve arrinte në disa mijëra vetë.

Në gjithë këtë herezi kundër fesë qëndrimi i klerikëve që i ndryshëm. Një pjesë e klerit, e lidhur në forma të ndryshme me regjimin apo e joshur me premtime, mbështeti e përkrahu lëvizjen antifetare. Një pjesë tjetër megjithëse e pabindur për drejtësinë e domosdoshmërinë e mbylljes së institucioneve fetare e frikësuar nga diktatura mbajti qëndrim të heshtur. Këtë e dëshmon akti i kryesisë së klerit bektashian dhe atij musliman të cilët linçuan një qarkore ku u bënë thirrje të gjithë klerikëve të vendit të këtyre komuniteteve që të gjithë hoxhallarët e dervishët të hiqnin çallmat e taçet, njëkohësisht të dorëzonin teqetë e xhamitë. Sipas qarkores në rast se me iniciativën e vetë klerikëve ose me kërkesë të masave mbyllej një teqe, atëherë automatikisht personeli klerik i kësaj zhishej nga funksioni dhe ndërpriste çdo marrëdhënie administrative me komunitetin e vet. Klerikëve do u jepej një sasi të hollash për të përballuar përkohësisht nevojat e tyre, derisa të stabilizoheshin në punë. Klerikëve të kaluar nga mosha dhe me pamundësi që të punonin u rekomandohej që të kalonin në azilin e pleqve, kurse të tjerët vullnetarisht bëheshin anëtarë të kooperativave bujqësore.

Sigurisht në këto momente pati njerëz që nuk i miratuan veprimet e këtyre klerikëve. Në këto kushte PKSHP porosiste që të mos qendrohej indiferent ndaj këtyre "iniciativave pozitive" të klerit, por "të mbroheshin qëllimet e tyre të mira sepse shumica e popullit në radhë të parë të rinjtë e të rejtat, do t'i aprovinin ato".

Në shtator të vitit 1967 përfaqësuesit e të gjitha besimeve fetare duke parë se çdo gjë kishte marrë fund i propozonin Këshillit të Ministrave një varg masash për të thjeshtuar organikat e buxhetin e tyre.

## **REAGIMET E KLERIT**

Krahas qendrimeve të mësipërme një pjesë e klerikëve i rezistoi me të gjitha format lëvizjes destruktive antifetare e antikulturë. Në mjaft raste kjo kategori në bashkëpunim me elemente kundërshtarë të regjimit u munduan të dëmtonin këtë të fundit me të gjitha mënyrat. Klerikët të tillë u përpoqën të ngrenë besimtarët kundër zhvillimit të kësaj lëvizjeje. Veprimtaria e tyre synonte që me anë të parullave e veprimeve të ndryshme të prekte pothuajse të gjitha sferat e politikës dhe të ideologjisë së PPSH. Në bashkëpunim me klerin mbeturina të kulakëve në mjaft raste nuk i zbatuan vendimet e tubimeve për luftën kundër fesë dhe kulturës islame. Ata krahas kundërvënies së hapur u përpoqën të ndikojnë edhe në besimtarë të tjerë. Madje pati elemente kundërshtarë të regjimit që dolën hapur në mbrojtje të institucioneve fetare e klerit. Ata u bënë mbështetës e ruajtës të bazës materiale fetare, të cilën e shpërndanë ku mundën.

Reagimi i klerit ndaj veprimeve të rinisë dhe të organizatave të tjera socialiste që kërkonin mbylljen e kishave dhe të xhamive u shpreh fillimisht në paraqitjen e ankesave pranë qeverisë ose Presidentit të Kuvendit Popullor duke i atribuar pushtetit në bazë veprimet që kryente rinia për likuidimin e institucioneve të kultit.

Forma më e përhapur e luftës që elementi kundërshtar i regjimit së bashku me klerin përdorën kundër udhëheqjes e shtetit komunist ishte hedhja e parullave të ndryshme si: "kjo qeveri nuk i ka punët mirë me prishjen e fesë", "këto janë vetëm fillimi ndërsa fundi i tyre do të çojë në zhdukjen e familjes". Parullën fetare "Të kthejmë Shqipërinë në vakëf" e propaganduan ish dervishët në Tropojë. Për të sensibilizuar besimtarët ata u përpoqën të lidhnin veprimet kundër fesë me kolektivizimin që po kryhej në zonat malore dhe shkurtimin e oborreve personale të kooperativistëve, për t'i penguar këto reforma. "Komunistët, thoshin ata, po i shkatërrojnë kishat e xhamitë, tokat na i morën dhe fenë na e hoqën". Ose "duke prishur teqet e kopshtet këta i hapën punë vetes". Gjithashtu u orvatën të krijonin përshtypjen se në regjimin komunist ka dallim fesh, krahinash etj. Në Pogradec e Fier prishja (shkatërrimi) apo mbyllja më parë e kishave nga xhamitë ose ruajtja si monumente kulture e ndonjë ndërtese kulturi u komentua si përkrahje e një besimi dhe luftimi me ashpërsi i tjetrit.

Duke qenë se prishja e mbyllja e faltoreve nuk qe një veprim i menjëhershëm, u dha mundësi disa klerikëve të fshihnin një pjesë të letërsisë fetare. Ata shpërndanë tek disa besimtarë një pjesë të literaturës fetare. Elemente, klerikë në bashkëpunim me kundërshtarë të regjimit u orvatën të bëjnë për vete njerëzit e shtresave të ndryshme dhe të propagandonin dogmat fetare, bile në ndonjë rast të kryenin fshehurazi edhe ceremoni fetare. Mjaft klerikë u munduan t'u mësonin besimtarëve disa shërbime që mund t'i kryenin vetë në shtëpi duke sugjeruar që ata t'ua mësonin fëmijëve të tyre. Këto veprime shoqëroheshin me predikime të tilla se " të besosh nuk është e domosdoshme të vish në

xhami, sepse ato janë vende thjesht grumbullimi. Njeriu mund të falet edhe në shtëpinë e tij mjafton që me zemër të jetë me fenë".

Organizatat e partisë dhe ato sociale u hodhën në veprimtari për të demaskuar "rolin reaksionar të fesë" në terrenin politik. Organizatat e frontit bënë tubime për të demaskuar në mbledhjet e tyre një sërë klerikësh. Organizatat e Frontit e qytetit të Shkodrës kishte denoncuar publikisht veprimtarinë e hoxhës së Gumenicës i cili sipas saj shkonte nëpër shtëpitë e fshatarëve, agjitonte në radhët e tyre kundër pushtetit.

Anëtarët e organizatës së Frontit të lagjes "Tre heronjtë" kritikuan dhe cilësuan armiqësore veprimtarinë e ish-klerikut të kësaj lagjeje, i cili meqenëse nuk kishte mundësi të vepronte në lagjen e tij e kishte spostuar veprimtarinë në lagjet periferike të qytetit ku takohej me fshatarë. Një akuzë publike e rreptë iu bë edhe klerikëve të tjerë të cilët kryenin rite fetare në shtëpitë e tyre.

Krahas formave të mësipërme pjesa më e vendosur e klerit e cila edhe më përpara kishte kryer aktivitet kundër regjimit në bashkëpunim me elemente të prekur nga reformat komuniste arriti të kryejë vepra dëmtuese të organizuara.

Një sërë grupesh aktive, të kryesuar e të frymëzuar nga kleri, u kapën dhe u dënuan penalisht nga organet e diktaturës së proletariatit për agjitacion e propagandë kundër shtetit komunist.

Pas këtyre publikimeve e akuzave ndaj fesë të shoqëruara me veprime destruktive në asnjë mënyrë nuk mund të pritej që njerëzit të ishin plotësisht e të gjithë ateistë, që botëkuptimi fetar të zhdukej menjëherë. Duke e kuotuar kështu këtë problem dilte nevoja e vazhdimit të mëtejshëm të luftës ndaj tendencës për të konsideruar të përfunduar luftën kundër fesë.

Pas aksioneve të para kundër bazës materiale u vërejtën koncepte të tilla si "...ne e bëmë punën tonë, kishat e xhamitë i mbyllëm priftin e hoxhën e dëbuam". Po aq i dëmshëm u konsiderua nga organizatat partiake edhe koncepti tjetër sipas të cilit feja do të zhdukej me kalimin e kohës, se koha do të bënte punën e saj. Ose "jemi mirë, tashti për tashti nuk po manifestohen shfaqje të ideologjisë fetare në rast se do të konstatohen të tilla do të zhvillojmë përsëri biseda e leksione siç bëmë në fillim".

## **VAZHDON LUFTA KUNDËR FESË**

Këto koncepte e të tjera si këto në mendjet e kuadrove e punëtorëve të partisë, u panë si të rrezikshme nga udhëheqja komuniste. Sipas saj po të mos luftoheshin këto mendësi mund të lindnin rreziqet e rënies së propagandës ateiste shkencore, rreziqet e punës me fushatë për t'ia lënë atë spontanitetit dhe për ta shndërruar lëvizjen antifetare në flakë kashte. E, po të veprohej kështu, atëherë feja paragjykimet dhe mbeturinat e saj, gjithnjë sipas udhëheqjes komuniste, jo vetëm nuk do të zhdukeshin bile kishte mundësi që ato të forcoheshin përsëri. Në fakt në këtë shqetësim ka diçka reale sepse ideologjia e vjetër në përgjithësi e botëkuptimi fetar në veçanti, nuk mund të zhduken menjëherë ato kanë rrënjë të thella dhe rezistojnë gjatë.

Me gjithë sukseset e arritura kundër fesë, rezultonte se mbeturinat fetare sidomos ato që lidheshin me praktikat jetësore, vazhdonin të rezistonin, të përhapeshin aty-këtu duke marrë shpesh herë edhe forma të reja. Shfaqje të tilla ishin përshëndetjet, urimet, ngushëllimet, mallkimet dhe frikësimet që lidheshin me emrin e krijuesit të botës-Zotit dhe shprehjet apo leksiku teologjik në përgjithësi. Shpesh herë nga të moshuarit përhapej tek fëmijët letërsi gojore me përmbajtje fetare me anë të përrallave, tregimeve,

thirrjeve, proverbave etj. Viheshin re përpjekje për të trashëguar në brezat e rinj praktikat fetare në lindjet, vdekjet, shenjat në varreza, në sëmundjet e njerëzve të kafshëve e bimëve, në fenomenet e natyrës në vënien e festimit e emrave etj. Pati tentativa për t'u mësuar fëmijëve përmendësh norma kur'anore e hadithe.

Shpesh herë këto praktika fetare kamuflloheshin me të renë. Një fenomen i tillë vihej re shpeshherë kur nën pretekstin e festimit të ditëlindjeve festohej dita e shenjtit etj.

Një formë e rezistencës pasive ishte edhe shfrytëzimi i disa ndërtesave fetare që u ruajtën për vlera historike apo përdorimi. Në disa raste ato u përdorën për procesion me karakter fetar. Në mjaft fshatra madje edhe në ndonjë qytet u vunë re mjaft shenja të ruajtjes, nga një pjesë e njerëzve, të besimeve festave e riteve fetare. Në mjaft fshatra të rrethit të Beratit, Pogradecit, Peshkopisë gjatë ditëve të bajramit dyqanet shitën shumë më shumë sheqer nga ditë e tjera. Në këto ditë u vërejtën edhe shumë mungesa në punë.

Forma të përhapura ishin ato që u vërejtën në drejtim të ruajtjes së bazës materiale të fesë ose të ruajtjes së respektit për vendet e shenjta. Në zonën Vërzhezhës (Skrapar) kishte kohë që ishte prishur mekani, por përsëri u gjetën brenda 40 kg qirinj. Qirinj e lekë ishin gjetur edhe në vende të tjera të shenjta pas mbylljes së tyre.

Duke vlerësuar drejt këtë "rrezik" PPSH orientoi në këto momente që lufta kundër fesë të mbahej e ngritur dhe se epiqendra e luftës kundër besimeve dhe praktikave fetare tashmë duhej të kalonte në familje, pa lënë mënjane, kur të ishte e nevojshme, edhe diskutimet në popull. Forcat që do ta bënin këtë punë do të ishin komunistët, rinia punëtore, nxënësit e shkollave. Dhe për ta kryer këtë mision sa më mirë PPSH shtronte nevojën e "përgatitjes më mirë ideologjike të këtyre forcave".

Një kujdes i veçantë në këtë fazë iu kushtua punës për zëvendësimin e festave e ceremonive fetare me festa e zakone të reja sepse ndërsa ishte mohuar e vjetra vinte momenti i pohimit "i afirmimit të së resë". Sepse në jetën shpirtërore të njerëzve nuk mund të kishte boshllëqe. Ky boshllëk i krijuar duhej mbushur sa më shpejt me festa e zakone të reja, ndryshe ekzistonte rreziku i kthimit tek e vjetra.

Një vend i veçantë iu kushtua punës me të moshuarit. Kuvendet dhe mbledhjet e veçanta, këshillimi e marrja e mendimit të pleqve, puna sqaruese me ta, ishin disa forma që ishin përdorur e do të përdreshin përsëri në të ardhmen, sipas problemeve të ndryshme. Kjo për faktin se ata ishin më shumë se kushdo tjetër fanatikë e besimtarë. Në radhët e tyre vëreheshin më shumë shqetësime nga lufta radikale që iu bë fesë në këtë fushë. Prandaj nën drejtimin e organizatave bazë të partisë, organizatat sociale e sidomos ajo e frontit, tashmë u udhëzuan ta konsideronin si një aksion me rëndësi punën e veçantë me këtë shtresë të popullsisë duke e trajtuar problemin me kujdes të madh

Në një studim që është bërë në dy universitetet e Tiranës, në vitin 1994, rezultoi se më shumë se tre të katërtat e studentëve besonin në fenë, ndërsa atëherë, deklaroheshin vetëm një e katërta e intelektualëve që besonin në fe, nga që ishin edukuar e rritur në periudhën, kur shteti deklarohet si ateist. Që në vitin 1994 pedagogu Adem Tamo shkruante: "Jemi në vitin 1994, d.m.th. katër vjet mbas ringjalljes së institucionit të besimit. Ndryshimet e ndodhura kanë qenë të vrullshme, por këto ende nuk po studiohen as në rrafshin sociologjik as psikologjik. Po të përjashtojmë disa studime me karakter historik, mund të thuhet se studimet në përgjithësi mungojnë, ndërsa ato me karakter empirik mungojnë tërësisht... Studimi i ringjalljes së institucionit të besimit dhe i qëndrimeve ndaj tij ka vështirësitë e veta: ringjallja e besimit po bëhet në kushtet e një krize komplekse të kalimit nga totalitarizmi në demokraci. Kjo krizë është politike, ekonomike e morale. Në po këtë studim thuhet se studentët janë më kompaktë e më homogjenë se intelektualët në pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre

religjioze. Kjo do të thotë se lejimi i besimit të lirë, pas gjithë asaj periudhe të gjatë ndalimi, e ka çorganizuar më tepër sistemin e vlerave shpirtërore të atij brezi, i cili është formuar në periudhën kur institucioni i besimit ishte i ndaluar.

Me lëvizjet demokratike që u zhvilluan në vend, u fituan të drejtat e besimit nga të gjithë njerëzit, sipas bindjeve të tyre e besimeve që kanë. Dëshmitare historike e paharruar dhe e përhershme mbeti për shqiptarët data 16 nëntor 1990, kur të rinjtë dhe populli i Shkodrës rihapën pas 25 vjetësh xhaminë e Plumbit, e cila u bë prijëse për rihapjen e ngritjen e të gjitha faltoreve në mbarë Shqipërinë. Gjatë këtyre viteve të demokratizimit të vendit popullata islame është kthyer plotësisht në besimin islam. Materiale të shumta që kanë të bëjnë me konceptin e besimit, mirësinë, devotshmërinë, jetën, lirinë, barazinë, moralin, etj, gjithnjë e më shumë po bëjnë pjesë në jetën aktive të Islamit.

Por studijuesve, sidomos atyre në fushën e historisë u mbetet që të zbulojnë të gjitha ato relike të lëna trashëgim nga të parët tanë, që i kanë shërbyer kulturës islame në të gjitha trojet shqiptare, dhe ato nuk na detyrojnë të kthehemi largë në lashtësi ngase i gjejmë ato të regjistruara në burime të ndryshme dokumentare e arkivore të dekadave të shekullit të fundit, siç është identifikimi i faltoreve dhe të figurave të shquara, i ngjarjeve dhe i dukurive sociale të karakterit fetar, në mënyrë të veçantë të atyre që historia i la në hije ose nuk i ceku fare.

## **KREU II**

# **ARSIMI ISLAMIK SHQIP NË TREVAT SHQIPTARE**

### **ARSIMI FILLOR**

Me islamizimin e trevave shqiptare krahas të tjerave, u morën masa për organizimin e arsimit islam. U ngritën shkollat e arsimit fillor (Mejtepet) dhe, mbi këtë bazë, filluan të ngrihen edhe shkollat e mesme (Medresetë).

Mejtepet nuk kanë pasur kurdoherë të njëjtën fizionomi, qoftë nga struktura, qoftë edhe nga programi, por gjithmonë ato kanë ruajtur përmbajtjen fetare, kanë synuar edukimin fetar dhe formimin fillestar teologjik islam të brezit të ri. Mejtepe u përhapën në të gjitha trevat shqiptare: Në Shqipërinë Veriore - Lindore (Kosovë), në të gjitha territoret shqiptare të Maqedonisë, në zonën Jugore (Çamëri) etj. Ato kryesisht funksiononin pranë xhamive dhe drejtoheshin nga imami. Në mjaft raste, punën e mësuesit në këto mejtepe e bënte një klerik i veçantë. Përbërja e nxënësve të mejtepeve, nga pikëpamja e gjinisë, zakonisht ishte e përzier (djem edhe vajza). Moshja e pranimi të nxënësve nuk ka qenë e fiksuar, por zakonisht ata pranoheshin nga mosha 6-7 vjeçare deri në moshën 14-16 vjeçare.

Lëndët që zhvilloheshin në mejtepe ishin të karakterit teologjik islam, duke përdorë terminologji të konsiderueshme edhe në gjuhën arabe, ndërsa shpjegimet bëheshin në gjuhën amtare shqipe. Pjesën më të madhe të kohës së mësimi në këto shkolla e zinte mësimi i Kur'anit dhe komentimi i tij që bëhej në gjuhën shqipe. Paralelisht me këto, nxënësve u mësoheshin edhe elementet e para të aritmetikës. Sipas rastit, në disa mejtepe zhvilloheshin edhe lëndë të tjera. Ky cikël i ulët i arsimit islamik normalisht

zgjaste 3 vjet dhe ndryshe quheshin edhe "Ruzhdie", kurse ato të karakterit të shkollës fillore quheshin "Ibtidaije".

"Më 1915, kur Turqia bëri reformën shkollore, ibtidaijet dhe ruzhdijet humbën karakterin e mëparshëm dhe kaluan në "sibjan mejtepe", e më parë këto të fundit ishin klasë përgatitore për ibtidaijet dhe ruzhdijet..."

Pas shpalljes së Pavarësisë, në mejtepet e trojeve shqiptare, që mbetën në kufijtë e Jugosllavisë nuk u lejua mësimi i gjuhës shqipe. Edhe mejtepet që funksiononin pranë xhamive në zonat e Çamërisë, si në Margëlliç, Paramithinjë, Konicë, Janinë etj. u mbyllën dhe pas Luftës Ballkanike nuk funksionuan më. Me të dhënat e tërthorta që kemi për këto zona që nga ajo kohë e deri më tani mejtepet kanë funksionuar me ndërprerje deri sa u mbyllën përfundimisht.

Pas luftës Ballkanike në Shqipërinë e kufijve të 1913-tës, me zgjerimin e rrjetit arsimor shtetëror, u shtrua edhe çështja e përfshirjes së mësimin të fesë si lëndë e veçantë në shkolla. Kjo bëri që rëndësia e mejtepeve të binte.

Në trevat shqiptare që ngelën nën Jugosllavi, në Kosovë, në Mal të Zi, Maqedoni dhe treva të tjera, shqiptarët muslimanë u organizuan në Meshihate (Bashkësi Islame), organ ky që u interesua për mësimin e fesë brezit të ri e, për pasojë, edhe ngritjen e mejtepeve. Nën ndikimin e mësimin të fesë në gjuhën shqipe në Shqipëri, edhe në mejtepet e Kosovës filloi t'i jepet një vend edhe më i gjerë gjuhës amtare. Në këtë vështrim ato luajtën një rol patriotik në edukimin e të rinjve shqiptarë muslimanë. Kjo është e theksuar sidomos për disa zona, ku midis dy luftërave botërore, kur u hapën medrese e shkolla shqipe, këto mejtepe dhe drejtuesit e tyre ishin të vetmet institucione fetare dhe shkencore. Mjaft prej tyre luajtën rolin e një shkolle të vërtetë shqipe.

Institucionet arsimore fetare në këtë kohë zhvilluan një aktivitet pothuajse privat, por i udhëhequr dhe i drejtuar nga Komuniteti Musliman.

Në çerekun e parë të shekullit XX në Shqipëri kanë qenë të njohura mejtepet e Shkodrës, siç janë ato të Mulla Medos dhe të Mulla Faslisë. Në shtypin e kohës për to thuhet: "Pas shpalljes së Hyrietit - të konstitucionit turk -, aty nga viti 1909-1910, në disa nga këto mejtepe, si në mejtepin e Mulla Medos e në atë të Mulla Faslisë (Shkodër), qenë bërë "reforma" duke përfshirë në to edhe nga një mësues laik, të cilët u mësonin nxënësve më të zgjuar e më të aftë, përveç turqishtes (këndim, diktim, gramatikë, bukurshkrim), edhe njohuritë elementare të lëndëve të tjera si aritmetikë, histori, gjeografi etj. Mësuesit laikë ishin nga intelektualët vendas të kohës, me kulturë të gjerë (me 4-5 klasë gjimnaz ushtarak apo civil)

Lëndët e historisë, gjeografisë, aritmetikës etj, mësuesit i shpjegonin shqip, në mënyrë të qartë e të kuptueshme. Në mbarim të vitit shkollor 1911-1912 në mejtepin e Mulla Medos si edhe në atë të Mulla Faslisë qenë bërë, për herë të parë, provimet zyrtarisht me komision provues, me anëtarë nga personeli i shkollës qytetare ushtarake. Nxënësit që fitonin në këto provime pajiseshin me një dokument shkollor të vulosur nga personeli mësimor i mejtepit dhe komisioni provues. Me këtë dokument shkollor nxënësit fitonin e gëzonin të drejtat e pranimit pa provim në shkollën qytetëse ushtarake apo edhe në gjimnazin civil.

Në qytetin e Shkodrës këto mejtepe vazhduan edhe pas vitit 1912. Për mbarëvajtjen e mejtepit të Mulla Medos u interesua dhe kryetari i Komisionit Ndërkombëtar për Shkodrën, koloneli anglez Filipi. Ky autoritet ndërkombëtar i dha drejtorit të mejtepit një ndërtesë të madhe.

Në bazë të salnameve turke që qarkulluan deri në vitin 1912, mejtepet në territoret shqiptare qenë mjaft të përhapura. Ato gjendeshin në Gegëri, Toskëri, Çamëri, Kosovë, Dibër, kudo ku kishte myslimanë shqiptarë.

Edhe "Hfz. Ymer Shemsedini në të dy mejtepet që mbajti mësim në Kosovë, përdori dy sisteme të shkrimit për shqipen, shkrimin arab dhe shkrimin latin, i pari për lëndët mësimore fetare, kurse i dyti për lëndët shoqërore dhe ekzakte..."

Për gjendjen e mejtepeve të trojeve shqiptare të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi hedh dritë dokumentacioni i hulumtuar në arkivat e Jugosllavisë. Konkretisht në arkivat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtëme, të Ministrisë së Drejtësisë etj.

Në një raport të Ministrisë së Fesë, ku bëhet fjalë për shkollat fetare të quajtura sibirian mejtepe, theksohet: "Çdo fëmijë musliman duhet të dijë të lexojë Kur'anin, pra të mësojë shkrim leximin arab, si dhe të dijë përmendësh të gjitha elementet e besimit të drejtë ndaj Zotit, Islamizmit".

Në një dokument tjetër të kohës theksohet: "Te muslimanët (shqiptarët) ka qenë zakon që fëmijët në moshën e hershme rinore t'i dërgojnë në sibirian mejtepe, ku mësonin ritet fetare dhe leximin e Kur'anit. Fëmija pasi ta kryente me sukses këtë, mund të rregjistrohej në shkollë filllore shtetërore".

Mejtepe të shumta ka pasur edhe në trevat shqiptare të aneksuara nga Mali i Zi. Pothuajse çdo fshat i madh kishte një shkollë të tillë. Me përfundimin e mejtepeve, nxënësit arrinin të mësonin shkrim e lexim (nuk ishin më analfabetë).

Me Luftën e Parë Ballkanike u ndërpre funksionimi i këtyre shkollave në territoret e pushtuara. Disa prej mejtepeve i përdornin përkohësisht për strehimin e kuajve, për magazinat dhe për strehimin e familjeve të migruara, siç ishte rasti në Pejë.

Ndërsa në kronikën e kapiten Krsto Pekiqit më 31. VIII. 1913 thuhej: "Nga Shkodra hoxhallarëve u jepej para për të hapur mejtepe në Krajë, të cilat sipas mendimit të kapedanit të fisit bëheshin për të çuar në kryengritje popullatën e atjeshme"

Në një dokument tjetër të ministrit të fesë, dërguar Këshillit Kryesor të Ministrisë së Arsimit në Beograd të datës 7 shtator 1923, në mes të tjerash, thuhet: "Në Kosovë çështja e arsimit fetar të muslimanëve (shqiptarëve - R.Z.) është shumë e komplikuar ... Në këto vise ka afro 50 myftinj dhe 600 imamë, prej të cilëve asnjëri nuk e njih si duhet gjuhën serbe, të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit tonë.. Pastaj nuk ka qytet ose qytezë ku nuk ka medrese, të cilat i mban vetë populli me shpenzimet e veta... Në to nuk mësohet gjë tjetër pos si të urrehen sa më tepër ata që nuk janë muslimanë (serbë R.Z.)

Si organet e pushtetit të Serbisë dhe ata të Knjaz Nikollës në Mal të Zi nuk i shihnin me sy të mirë këto lloje shkollash, ngaqë fryma patriotike dhe atdhedashëse e hoxhallarëve dhe mësuesve të këtyre mejtepeve reflektohej te nxënësit dhe te masa e popullit.

Ishte ky shkaku që Mali i Zi mbajti qëndrim zyrtar, duke urdhëruar për mbylljen e këtyre mejtepeve "me qëllim që të ndalohej propaganda e huaj, posaçërisht ajo e ardhur nga Shqipëria". Por popullata shqiptare muslimane ishte e vetëdijshme për rëndësinë e kësaj çështjeje. Dhe mexhllisit të ulemave në Shkup për çdo ditë i vinin kërkesa nga të gjitha anët e banuara (me shqiptarë) për t'u hapur sibian-mejtepet...

Megjithatë hapja e këtyre shkollave ndeshi në pengesa të vazhdueshme. Kështu "posa u hapën 25 siban-mejtepe (në Shkup R.Z.) erdhi vendimi i dytë i ministrisë së arsimit, sipas të cilit hapja e siban-mejtepeve vinte në kundërshtim me ligjet dhe shkollat popullore. Me këtë ministria i kundërvihet 18 ligjeve që i përkisnin bashkësisë fetare dhe mori të drejtën që vetëm ajo të ketë të drejtë të hapte siban-mejtepet dhe të caktonte mësuesit në to edhe pse në ligjin e cituar këtë të drejtë e kishte ulema-mexhlisi. Me të njëjtin vendim kërkohet dhe ndryshimi i planit mësimor në siban-mejtepe".

"Edhe përkundër presionit qeveritar dhe vështirësive materiale, një numër i madh i këtyre siban-mejtepeve arritën të funksiononin më tej. Në Kosovë në vitin 1933 vepronin mjaft prej tyre. Vetëm në Prishtinë me rrethinë deri më 1936 kishte 33 siban-mejtepe me rreth 1413 nxënës. Kjo shihet edhe nga dokumentat e kohës që i përkasin shkollave të tilla"

"Në rrethet e tjera të Kosovës në këtë kohë kishte edhe mjaft shkolla fetare. Gjatë vitit 1936 në Mitrovicë ekzistonte siban-mejtepi i quajtur Birçanin, i cili kishte katër paralele, nga të cilat dy të femrave e dy të meshkujve me gjithsej 216 nxënës. Mualimët (mësuesit) e saj ishin Muhamed Murati, Sherif Saiti, Osman Hyseni, Mulla Sulejmani dhe Sali Et'hem. Këtë mejtep në tërësi e financonte Xhemati, ndërsa i tërë rrethi i Mitrovicës kishte afër 13 shkolla. Po aq përafërsisht kishte dhe rrethi i Vuçiternës".

"Që nga viti 1932 e deri në vitin 1938 edhe në rrethin e Gjakovës u hapën mjaft mejtepe. Vetëm në vitin 1932 u hapën dy të tilla... Sipas disa të dhënash planifikohej që në vitin 1938 në Kosovë të hapeshin edhe 80 siban-mejtepe".

Por realizimi i këtij plani kishte mjaft vështirësi, për shumë arsye: Qeveritë e asaj kohe shihnin te mësuesit e këtyre shkollave kuadro që kishin ndikim në masat e gjëra dhe nuk thyheshin para ligjeve të

pushtetmbajtësve dhe se në to mësohej në gjuhën shqipe, kultivohej atdhedashuria dhe urrejtja ndaj pushtuesve serbë, maqedonas, bullgarë e malazezë.

Pas Luftës së Dytë Botërore harta politike e Ballkanit, megjithëse nuk pësoi ndryshime, për sa i përket institucioneve arsimore fetare ka një larmi të madhe. Në Shqipëri mejtepet e edhe mësimi i besimit për një kohë të shkurtër funksionoi, por vendimet që u muarën më vonë në bazë të kushtetutës të Republikës së Shqipërisë rrjeti i tyre erdhi gjithnjë duke u ngushtuar, derisa ato u mbyllën krejtësisht. Dhe për disa dekada nuk funksionuan ma.

Për shqiptarët e Kosovës si dhe të atyre të Maqedonisë dhe të Malit të Zi ndryshon çështja. Ato, edhe pse atje nuk u favorizuan, të pakten nuk u ndaluan. Shumica prej tyre punuan edhe për hirë të këmbënguljes së disa hoxhallarëve, të cilët i drejtuan këto mejtepe pa ndonjë shpërblim. Dihet që në këto mejtepe përveç mësimit të fesë që bëhej, aty ushqeheshin edhe ndjenja kombëtare kundër pushtuesit serb. Kjo është edhe arsyeja që më vonë, shumë prej tyre u mbyllën dhe mjaft nga drejtuesit e tyre u ndoqën.

Në hulumtimin tonë kemi hasur në të dhëna të shumta rreth mejtepeve, dhe nga statistikat dokumentohet se ato kishin një shtrirje të gjerë në mbarë trojet shqiptare. Kemi të dhëna për numrin e nxënësve (talebeve), emrat e mësuesve të tyre dhe lokalet pranë të cilave zhvilloheshin mësimet. Ky problem përbën një objekt të veçantë studimi jo vetëm nga ana e arsimit fetar por edhe nga ana e pedagogjike, si metodat e punës, tekstet e përdorura, planprogramet, veçoritë që fituan mejtepet në kohë të ndryshme dhe në krahina të ndryshme.

## ARSIMI I MESËM ISLAMIK

Në piramidën e arsimit fetar islamik medresetë i korrespondojnë arsimit të mesëm. Ato ngrihen mbi bazën e mejtepeve. Disa medrese kanë pasur edhe elemente të arsimit të lartë teologjik, disa kanë qenë më të kufizuara. Mbi ato që janë në statusin e arsimit të mesëm ngrihen fakultetet e studimeve islame ose universitetet.

Programi mësimor i medreseve përfshinte lëndët fetare dhe grupin e lëndëve humane e shkencore. Medresetë, si institucione fetare, arsimore, kulturore dhe edukative, që në vitet e para të islamizmit, shërbyen si vatra të kualifikuara të përfitimit e të përhapjes së ideologjisë islame, dhe, njëkohësisht, përhapëse të diturisë dhe të idealeve të larta njerëzore e qytetare.

Si kudo, edhe në trevat shqiptare, me përhapjen e islamizmit, filluan të ngrihen mejtepe dhe medrese, në të cilat jepnin mësim mësues, specialistë të fesë islame e të gjuhëve të huaja (arabe, turke, persishte).

Programi i tyre përfshinte lëndë të ndryshme si: mësimin e Kur'anit, zotërimin e tij përmendësh, tefsirin, hadithet, sheriatin, gjuhën arabe, persishten, gramatikën, matematikën, gjeometrinë, retorikën, filozofinë etj.

Shqiptarët, të etur për dije, e pritën hapjen e këtyre shkollave pa kundërshtim. Ata në to panë mundësinë për t'u arsimuar. Medresetë u ngritën nga bamirës myslimanë shqiptarë, çifligarë, ushtarakë, guvernatorë, që donin përparimin e vëllezërve të tyre. Ato patën jetë të gjatë. Ngritja e këtyre institucioneve në qendra të ndryshme, siç ishin Shkupi, Prizreni, Shkodra, Elbasani, Berati, Vlora, Ulqini, Janina, Gjakova, Tetova etj. faktehet nga të dhëna të shumta.

Gjatë udhëtimit të tij në trevat shqiptare, historiani Evlija Çelebiu përshkruan lulëzimin e tyre në shekullin XVII. Në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë rrjeti i medreseve në trevat shqiptare u zgjerua shumë. Grupi i pedagogëve të medreseve bënte elitën intelektuale dhe ushtronte një ndikim të fuqishëm mbi opinionin e masës së besimtarëve. Shumë prej tyre luajtën një rol parësor në përhapjen e kulturës dhe në edukimin patriotik të nxënësve të tyre si edhe në formimin intelektual islam.

## **MEDRESETË NË MAQEDONI BARIERË KUNDËR SHKOMBËTARIZIMIT**

Në Maqedoni si të gjithë shkollat fetare edhe medresetë filluan punën pranë xhamive, ku mësimdhënës ishin hoxhallarët, mual-limët dhe muderrizët që kishin kryer mësim të larta si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Medrese që nuk kishin ndonjë formim të lartë filluan të punonin në: "Prilep 1, Ohër 1, Tetovë 5, Gostivar 51 dhe Shkup 3". Një pjesë e tyre tashmë ishin bërë të njohura dhe gëzonin respekt nga populli. Kështu ishte p.sh. ajo e "Medahut" në Shkup, e themeluar më 1925 nga fetari dhe patrioti i shquar "muderrizi i gjithanshëm" siç i thonin populli, Atullah ef. Kurtishi, të cilën e udhëhoqi vet deri në vitin 1937. Kjo medrese ishte çerdhe e intelektualëve dhe patriotvë shqiptarë të besimit islam, ku diplomuan: Fetah efendia nga Shkupi, Mehmed ef. Grushina, Hafiz Nexhati e Hafiz Abdurrahimi nga Presheva, Qemal ef. Vrapçishta, Haki ef. Gjilani dhe Xhemal efendia nga Kumanova, e të tjerë. Në Shkup ishte e njohur edhe medreseja e "Naxhi Ismail Agës". Në Tetovë: Qupri Medreseja e Çarshisë, e Sinanit, e Tearcës etj. Medresetë e Tetovës kanë përgatitur kuadër mualimësh për rrethin e Tetovës,

Kërçovës, Strugës dhe Ohrit. Në rrethin e Prilepit ka funksionuar medreseja "Esat Osman Bej", në Ohër - "Sherif Bej", në Kumanovë - Medreseja e Kumanovës, në Gostivar "Sa'at Medresja" etj.

Këto medrese në të cilat edukoheshin fëmijë të shtresave të ndryshme të popullatës muslimane, kryesisht shqiptare, kishin për qëllim t'i kundërvihen politikës serbo-sllave e cila përpiqej që të hapë shkolla nëpër fshatra të mëdha dhe qytete në gjuhën serbe e maqedonase, duke propaganduar se gjoja "Zoti na folka serbisht" dhe se gjuha shqipe na qenka e varfër për të shprehë mendime të holla dhe me kuptim të ndërlikuar. Dhe, duke qenë se këto medrese ishin private që mbaheshin nga vet populli, ato arritën të përcaktojnë një politikë origjinale atdhetare në fushën e edukimit të rinisë shqiptare. Këto njëherit u bënë edhe shkëndija të luftës së më vonshme që do të zhvillohet nga forcat e përparuara shqiptare për zhdukjen e shkollave të huaja, që po rrezikonin seriozisht të ardhmen e vendit. Kjo ishte e lidhur me zhvillimin e idesë së rilindësve për pavarsinë e mbarë tokave shqiptare. Nxjerrja nga gjiri i popullit e hoxhallarëve të ri, të përgatitur nga ana profesionale dhe me shpirt të lartë patriotik, në mënyrë të drejtpërdrejt i kundërvihet politikës serbe e cila synonte që në shumë vende dhe xhami, xhemati të mbesë pa hoxhë. Ose edhe nëse do të ketë ata të jenë të pashkolluar në mënyrë që sa më lehtë t'i nënshtrojnë dhe indoktrinojnë.

Nr	Rrethi	Medrese	Konvikt	Mesues	Nxenes
1	Kumanove	1	1	1	48
2	Prilep	1	-	1	22
3	Oher	1	-	1	7
4	Tetove	5	2	6	161
5	Gostivar	1	-	2	40
6	Shkup	3	2	4	388
	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>15</b>	<b>666</b>

Një vlerë e këtyre medreseve ishte edhe ajo se ato mbështeteshin në procesin e pranimit të nxënësve mbi nevojat që kishin fshatra dhe zona të caktuara për kuadro fetare, kështu p.sh. i jepej përparësi më tëpër një familje a vendi, ku nuk kishte kuadro, ku xhamia e ndërtuar nuk kishte imam, ose që imami vinte nga ndonjë fshat ose zonë tjetër. "Kohëzgjatja në këto shkolla nuk ka qenë e kufizuar, prandaj

edhe mësimi zgjaste derisa merrej diploma (ixhazet nameja). Një numër nxënësish bënëin mësimet autodidakte me ndihmën e hoxhës së fshatit e më vonë u nënshtroheshin provimeve pranë këtyre medreseve".

## **MEDRESEJA E "ISA BEUT" SHKUP**

Një nga shkollat më të vjetra dhe më me traditë në Ballkan është Medreseja e "ISA BEUT" në Shkup. Ajo është themeluar pesë shekuj e gjysmë më parë, në vitin 1440. Historia e arsimit e njeh me emrin e Isa Beut, themeluesit të saj. Këtë emër ajo e mban edhe sot. Në rrugën e saj qindra vjeçare ajo pësoi disa rrëime. Ajo u shkatërrua deri në themel në vitin 1689, kur qytetin e Shkupit e dogji Pikolomini, komandant i ushtrisë Austro-Hungareze. Gërmadhat e saj janë ruajtur deri para Luftës së Parë Botërore.

Luftërat që u zhvilluan në këtë periudhë dhe shndërrimi i trojeve shqiptare e më gjerë në sheshe lufte, siç qe ajo Ballkanike dhe ajo e Luftës së Parë Botërore, por në mënyrë të veçantë pushtimi serb, e penguan seriozisht zhvillimin normal të punës në këtë medrese. Dëshmohet gojarisht nga shumë ish-nxënës të saj që mësimet (natyrisht në mënyrë të reduktuar) i bënëin privatisht në shtëpitë e mësuesve të tyre. Kjo praktikë ndikoi shumë në ruajtjen e besimit, si edhe në mosasimilimin e shqiptarëve.

Në fillim të viteve tridhjetë presioni i popullit qe i madh për ta zgjeruar dhe për ta forcuar këtë institucion. Një gjë të tillë qeveria jugosllave nuk e shihte me sy të mirë.

Në një qarkore zyrtare serbe të vitit 1933, shpaloset qartë politika sllave. Në të urdhërohen organet e arsimit të Mbretërisë Jugosllave që "Nxënësit e shkollave fillore të marrin njohuri elementare, por vend të posaçëm duhet t'i jepet mesimit të fesë në frymën e jugosllavizmit, "besimit të mbretit dhe të kishës."

Politika e Mbretërisë Jugosllave ishte antishqiptare dhe antiislame në mënyrë konseguente. Në vazhdim të traditave të lëna nga kisha ortodokse-sllave, e cila synoi në shkombëtarizimin dhe pastaj sllavizimin e shqiptarëve, organet e Mbretërisë Jugosllave ndoqën një plan diabolik, duke shfrytëzuar të gjitha rastet e mundshme për t'i lënë shqiptarët myslimanë në errësirë, të paarsimuar. Pas rikonstruktimit në vitin 1932, kësaj medreseje më 2 tetor 1936 iu bë edhe inaugurimi. Por jeta e saj që e shkurtër, ajo veproi vetëm pesë vite (1936-1941). Në prag të Luftës së Dytë Botërore numëronte tridhjetë e dy nxënës.

Në një dokument tjetër zyrtar të Ministrisë së Arsimit të Jugosllavisë të nënshkruar nga Andrea Grazhdanoviq, ministër arsimit i Mbretërisë Jugosllave të asaj kohe, thuhet: "...i nënshkruari mendon (ministri) se nxënësit myslimanë me gjuhë turke apo shqipe nuk duhen të shkollohen të gjithë, por vetëm një pjesë"

Me aktivizimin e partisë komuniste dhe me ardhjen e saj në pushtet, aktiviteti i kësaj medreseje vazhdoi të jetë i ndërprerë, për gati katër dhjetëvjeçarë.

Por, ajo arriti të krijojë tradita të forta, përgatiti breza të tërë besimtarësh, kështu që populli i Shkupit priste rastin e përshtatshëm për ta ringjallur atë.

Përpjekjet e para u bënë më 1978, duke shfrytëzuar konjunkturën politike. Megjithatë, për rrethana të ndryshme, ajo mundi të rifillojë punën e saj normalisht vetëm më 15.10.1984. Kontributi i popullit, dëshira e besimtarëve ishte që ajo të trashëgonte denjësisht atributet e paraardhësve të saj dhe

njëkohësisht t'i përgjigjet kërkesave bashkëkohore, duke u administruar, drejtuar e funksionuar nga kadro të kualifikuar me arsim të lartë teologjik dhe shkencor, duke u pajisur me një plan e program mësimor në bazë të arritjeve të fundit.

E gjithë veprimtaria e këtij institucioni zhvillohej në bazë të statutit, ku përcaktohen synimet, siç janë përgatitja e kadrove fetare-edukative-mesimore, formimi i tyre dhe perpunimi i kategorive etike e fetare. Në bazë të planit mësimor, në këtë medrese zhvilloheshin 26 lëndë gjatë 4 viteve.

Lëndët ndahen në tre grupe:

a) *Lëndët profesionale* që synojnë formimin fetar: Drejtshqiptimi i Kur'anit (kiraet), Mësimi i besimit (akaid), Drejtësia islame (fikhu), Historia islame, Etika ose edukata islame, Komentimi i Kur'anit (tefsiri), Tradita e Muhammedit a.s. (hadithi), Filozofia islame, Bukurshkrimi arabisht.

b) *Lëndët e kulturës së përgjithshme*. Filozofi e përgjithshme, Kultura dhe civilizimi islam, Pedagogji, Psikologji, Sociologji, Histori, Gjeografi, Biologji.

c) *Grupi i lëndëve të gjuhëve* si: të gjuhës shqipe, maqedonase dhe turqishte (që konsideroheshin si gjuhë amtare), arabe (gjuhë profesionale) dhe angleze (gjuhë e huaj). Në shkollë zhvillohej edhe edukata fizike.

Sikurse shihet në këtë shkollë mbizotërojnë lëndët me përmbajtje fetare, por jo pak vend zinin lëndët e tjera të shkencave humane e natyrore si dhe gjuhët e huaja. Kjo dëshmon për përgatitjen e shëndoshë e të kompletuar të kadrove që mbaronin këtë shkollë. Në këtë medrese shumica dërmuese e nxënësve janë shqiptarë.

Gjatë viteve 1984-1993 kanë mbaruar gjithsej në këtë medrese 157 maturantë. Nga këta të diplomuar, më se 40 kanë vazhduar studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Sarajevës, 20 në Universitetin Al-Az'har të Kajros, të tjerë në universitete të tjera jashtë vendit.

Duke filluar nga viti shkollor 1990-91 pranë këtij institucioni është organizuar edhe mësimi me korrespondencë për vajza, numri i të cilave arriti në 108, nëntë prej të cilave janë diplomuar. Në bazë të librit të amzës, deri në vitin shkollor 1991-92 janë regjistruar 867 nxënës, nga të cilët 529 janë nxënës të rregullt.

Realizimi i të gjitha këtyre kërkesave diktonte zgjerimin e këtij institucioni. Kështu grupi i caktuar i inxhinierëve për këtë çështje zgjodhi në periferi të qytetit të Shkupit fshatin Kondovë, ku filloi ndërtimi i kompleksit të medresesë, me tre objekte madhështore, që zënë një sipërfaqe prej 7000 m2.

Ndërtesa e shkollës ka, përveç nëntë klasave mësimore të mobiluara më së miri, bibliotekën, sallën e leximit, ku mbahen dhe konferencat, librarinë, një mesxhid, dy kabinete gjuhe, fonolaboratorin, një kabinet biologjie, sallën e mësuesve dhe anekse të tjera funksionale së bashku me konviktin dhe kompleksin sportiv. Medreseja e Isa Beut ndiqet dhe nga nxënës të nacionaliteteve të tjera, si nga muslimanët bullgarë, turqë etj.

## **MEDRESETË E KOSOVËS VATRA TË EDUKIMIT FETAR E KOMBËTAR**

Në trevat shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia pas vitit 1913 dhe konkretisht në trojet me popullsi myslimane të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi vazhduan të funksionojnë disa institucione arsimore, ndër to edhe medrese, që ishin themeluar shumë kohë më parë.

Ato ishin të vendosura kryesisht nëpër ndërtesa të vjetra të vakëfeve, ndërsa një pjesë e tyre zhvilloinin mësimet edhe nëpër xhami. Në territorin e Kosovës gjendeshin dhjetë medrese: në Prizren dhe në Prishtinë nga dy medrese, dhe nga një në Vuçiternë, Pejë, Gjiilan, Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj.

Më aktive nga këto qe ajo e Prishtinës e quajtur "MEDRESEJA PIRANAZ". Kjo u mbyll në vitin 1927, por, me kërkesën e drejtorit të saj, u rihap shumë shpejt me seli në Podujevë. Në të mësonin 35 nxënës të rregullt. Për punën e kësaj medreseje, një qeveritar serb i rrethit të Llapit, me 1929, propozonte se do të ishte mirë të mbyllet, duke dhënë edhe arsytet të cilat ishin të karakterit politik. Sipas tij: "Te mesimdhënësit e medresesë, të cilët nuk janë nëpunës shtetërorë, si edhe te nxënësit e saj, është e mundur të zgjohet vetëdija nacionale e mund të ngjajë që në të ardhmen të bëhen pionierë të levizjes kombëtare shqiptare për këto vise. Kjo gjë do të paraqiste rrezik të madh për interesat shtetërore dhe nacionale për këtë pjesë të Serbisë." Së dyti "lejimi i shkollave të tilla private, të cilat janë në fakt shkolla të pastra nacionale (siç dihet në to mësojnë vetëm fëmijët shqiptarë), edhe pse kanë karakter fetar, mund të ndikojnë në formimin e idesë së mbrojtjes së pakicave, si dhe mund të lindin dëshira dhe kërkesa dhe për hapjen e shkollave të tjera të pakicave shqiptare." Së fundi "kontrollimi i punës së këtyre shkollave është i pamundur, ngase është pikëpyetja se për çka flitet tjetër, pos mësimi fetar gjatë orëve të mësimi."

Më tej, shtonte ky titullar, "...organet policore kanë shënime të posaçme për shkolla të tilla dhe teqe dhe se në të kaluarën në to janë formuar kuadrot e Komitetit të Kosovës, për këtë arsye në vitin 1927 ishte mbyllur dhe medreseja e Prishtinës".

Në tubimet e shumta të Ulema Mexhllisit gjatë vitit 1939 propozohej që në territorin e tij të formoheshin vetëm 5 medrese të reformuara, kurse në Kosovë vetëm ajo e Prishtinës, ku do të perfshiheshin Podujeva, Vuçiterna, Mitrovica, Gjilani, Ferizaj, Serbica dhe Prishtina dhe ajo e Prizrenit ku do të perfshihej Rahoveci, Gjakova, Peja dhe Prizreni. Për rrethin e Kaçanikut parashikohej të shërbente medreseja "Gazi Isa Beg" e Shkupit. Ky plan mbeti pa u realizuar deri në vitin 1941.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, për nevoja të përgatitjes së kuadrove shqiptare që do të shërbenin në institucionet e kultit islamik në gjuhën e vendit, lindi si domosdoshmëri themelimi i një medreseje për nxënësit shqiptarë. Ky institucion fillimisht do të ishte në nivelin e një shkolle tetëvjeçare e më pas të një shkolle të mesme, programi i së cilës, përveç lëndëve profesionale fetare, do të përfshinte dhe grupin tjetër që do ta bënin këtë medrese të barasvlershme me shkollat e tjera të mesme.

Këshilli Ekzekutiv i Këshillit Krahinor për Kosovën e Metohinë me vendimin Nr. 29503, të datës 26.06.1949, dha pëlqimin e hapjes së medresesë së ulët në Prishtinë. Megjithatë, për shkak të mungesës së lokalit, medreseja nuk ia filloi punës deri në vitin shkollor 1951-52. Ndërtesa e saj që vendosur në lokalet e një ish- mejtepi, që gjendej në oborrin e një xhamie, buzë lumit të Vellushes së Epërme në lagjen "Alaud-din" të Prishtinës.

## **MEDRESEJA E ULËT "ALAUD-DIN" PRISHTINË**

Medreseja e ulët e Prishtinës "Alaud-din" filloi punën mbi bazën e plan-programit të miratuar nga KBI (Kryesia e Bashkësisë Islame). Në këtë medrese do të mësonin nxënës nga republikat e Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi.

Kjo ishte medreseja e parë që do të funksiononte, duke pasur si gjuhë mësimi shqipen. Pranë medresesë ishte ndërtuar dhe konvikti.

Ndërsa mësimet zhvilloheshin mbi bazën e plan-programit mësimor, administrimi dhe jeta organizative në këtë medrese përcaktohej mbi bazën e një rregulloreje të posaçme që përfshinte 147 nene. Në bazë të këtij dokumenti përcaktoheshin të gjitha normat e mbarëvajtjes së medresesë. Aty përcaktoheshin kompetencat e drejtorit, të edukatorëve, të kujdestarit të klasës, të mesimdhënësve etj.

Kohëzgjatja e shkollës ishte katër vjet dhe vertikalisht ajo kishte katër klasë. Gjuha e mëimit ishte shqipja. Medreseja kishte si objekt edukimin e nxënësve me frymën islame, si edhe arsimin e përgjithshëm të tyre. Viti mësimor i kësaj medreseje ishte nga 10 shtatori deri në 10 qershor. Brenda këtij harku kohor kishte pushime dimrore. Sistemi i vlerësimit të nxënësve mbështetej në shkallëzimin e pesë shifrave, 1 deri në 5, të barazvlefshme si më poshtë:

1= dobët, 2=mjaftueshëm, 3=mirë,

4=shumë mirë, 5=shkëlqyeshëm.

Numri i nxënësve ishte lënë në kompetencë të drejtorisë së medresesë në marrëveshje me KBI (Këshillin e Bashkësisë Islame). Në rregullore përfshiheshin edhe dënimet në rastet e shkeljes së rregullores nga nxënësit.

Në rregullore përcaktoheshin kriteret e pranimit të nxënësve, të mësuesve, si edhe të personelit tjetër. Si rregull, këtu pranoheshin nxënës që kishin mbaruar 4 klasë të shkollës fillore. Me mbarimin e saj, u njihej e drejta të ushtronin detyrën e imamit, hatibit etj. Në dokumentet e kësaj shkolle kjo njihej si "medreseja e ulët shqiptare".

Medreseja kishte bibliotekën dhe shoqatën e saj. Nga një vështrim i planit mësimor dhe kontigjentit të nxënësve të kësaj shkolle në vitet 50-60 rezultonte se në medresenë e ulët gjatë vitit shkollor 1951-1952 u përfshinë këto lëndë: Kur'ani, Gjuha shqipe, Gjuha serbe, Matematika, Akaidi, Fikhu, Ahlaku, Histori islame, Histori, Gjeografi, Botanikë, Vizatim, Bukurshkrim, Gramatikë arabe, Fiskulturë.

Ky kontigjent nxënësish, në fund të vitit mësimor 1951-52, arriti nga të 47 nxënësit e regjistruar të përfundojnë me sukses shkollën 15 nxënës. Në klasën e fundit të medresesë së ulët jepeshin 18 lëndë, që ishin: Kur'ani, Gjuha shqipe, Gjuha serbe, Gjuha turke, Gjuha arabe, Matematika, Fizika, Kimia, Higjiena, Akaidi, Fikhu, Ahlaku, Histori islame, Histori, Gjeografi, Bukurshkrim, Imamat, Përgatitje parashtarake.

"Duke filluar nga viti shkollor 1955-56 plani mësimor pësoi disa ndryshime, por lëndët profesionale dhe gjuha shqipe, si gjuhë mësimi, mbeten po ato. Medreseja e ulët deri në vitin shkollor 1962-63 përgatiti pesë gjenerata nxënësish".

"Pas kryerjes së medresesë së ulët, nxënësit e kësaj shkolle vazhdonin mësimet e shkollës së mesme, ose inkuadroheshin në punë në organizatat e fesë islame apo gjetiu. Ata që dëshironin të vazhdonin, duhej

të shkonin në Sarajevë, në medresenë GHB (Gazi Husrev Beg). Një numër tjetër vazhdonin nëpër shkolla të tjera të mesme, si në gjimnaz, shkollë normale, shkollë ekonomike etj. Shumica e nxënësve nga dy brezat e fundit i vazhduan mësimet e mesme në Prishtinë, pranë medresesë së mesme "Alauddin", e cila filloi punën më 1962."

Në bazë të të dhënave që reflekton shtypi i kohës, semimaturantët e kësaj shkolle dilnin nga ajo me një formim të shëndoshë fetar dhe njëkohësisht me një përgatitje gjuhësore dhe një formim patriotik të kënaqshëm. Kjo për arsye se gjatë kursit 4-vjeçar në atë shkollë zhvilloheshin 28 lëndë, që përfaqësonin grupin e lëndëve fetare (Kur'an, fikh, akaid, ahlak, histori islame), grupin e lëndëve të kulturës së përgjithshme (shqip, serbisht, arabisht, turqisht, histori, gjeografi etj), grupin e lëndëve shkencore (matematikë, fizikë, zoologji, kimi, etj.), grupin e lëndëve të edukimit estetik (vizatim, bukurshkrim) dhe grupin e lëndëve të edukimit fizik.

Shumë prej nxënësve, që mbaronin këtë shkollë, ndiqnin studimet, me shumë sukses, si në medresenë "Gazi Husrev Beg" të Sarajevës, ashtu edhe në shkollat e tjera shtetërore.

## **MEDRESEJA E MESME "ALAUD-DIN" PRISHTINË**

Me formimin e një baze të shëndoshë kontigjenti nxënësish, si dhe me krijimin e disa kushteve rrethore, në vitin shkollor 1962-63 hapi dyert e saj "Medreseja e Mesme "Alauddin" në Prishtinë. Ajo

u hap në bazë të aktit Nr.759-65 të Kryesisë Supreme Islame për RSF të Jugosllavisë në Sarajevë, i cili zyrtarisht iu komunikua me vonesë (qershor 1965).

Medreseja e mesme "Alauddin", si edhe medreseja e ulët, funksionon në bazë të rregulloreve. Regullorja për medresenë e mesme është miratuar nga KBI Prishtinë më 22 prill 1965. Ajo përbëhet nga 94 nene, ku përcaktohen objektivat kryesore të saj si: puna mësimore edukative, kualifikimi i kuadrove, të drejtat dhe detyrat e nxënësve dhe të krejt kolektivit punonjës, afati pesëvjeçar i mësimëve, pranimi i nxënësve në medrese mbi bazën e dëftesës së mbarimit të shkollës tetëvjeçare. Përfundimi i medresesë nga nxënësit kushtëzohet me dhënien në fund të klasës së pestë të 10 provimeve në lëndët: Kur'an, akaid, imamat, histori islame, hadith, tefsir, fikh, gjuhë shqipe (me shkrim e me gojë), arabisht e serbisht (me shkrim e me gojë).

Të dhëna lidhur me lëndët e ngarkesën e tyre sipas klasave po i japim nepermjet tabelës që vijon:

*Plan - programi i medresesë së mesme "Alaud-din" për vitet 1962 - 1969*

<b>Nr</b>	<b>Lëndët</b>	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>V</b>
1	Kur'an	5	5	4	3	2
2	Tefsir	-	-	-	3	3
3	Hadith	-	-	-	3	3
4	Akaid	3	2	2	-	-

5	Fikh	3	2	2	-	-
6	Ahlak	3	2	2	-	-
7	Usuli fikh	-	-	-	2	3
8	Histori Islame	2	2	2	2	2
9	Arabisht	6	6	6	6	6
10	Serbokroatisht	3	3	3	3	3
11	Gjuhë shqipe	3	3	3	3	3
12	Histori	-	2	2	2	2
13	Gjeografi	-	2	2	-	-
14	Rreg. Ligj. FI dhe vazi.	-	-	-	4	3
15	Biologji	-	-	-	3	2

16	Pedagogji	-	-	-	-	2
17	Retorike	-	-	-	-	1
18	Husni-hat	2	-	-	-	-
19	P.paraushtarake	-	-	-	2	2
20	Higjenë	-	1	-	-	-
21	Orë kujdestarie	1	1	1	1	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>31</b>	<b>29</b>	<b>37</b>	<b>38</b>

Numri i maturantëve të medresesë "Alauddin" ka ardhur në rritje graduale. Kontigjenti i maturantëve të parë, i vitit shkollor 1966-67, përbëhej nga 19 vetë, kurse kontigjenti i maturantëve të vitit 1993-94 ishte 43. Pranë medresesë gjendet dhe konvikti i përbërë nga 72 dhoma, i pajisur me të gjitha mjediset e nevojshme për zhvillimin e mësimin në nivelin bashkëkohor. Aty ka xhami, salla leximi, bibliotekë, kuzhinë dhe sallë ngrënie, palestër etj.

Që nga viti 1966 pranë kësaj medreseje funksionon "Shoqata e Nxënësve të Medresesë së Mesme Alauddin", e cila, në bazë të rregullores, synon "...me punue në thellimin dhe përforcimin e dashurisë së

nxënësve ndaj islamizmit, ndaj popullit dhe atdheut...". Kjo shoqatë ka seksionin letrar, ligjërues, dramatik dhe sportiv. Shoqata merret me organizimin e kohës së lirë të nxënësve.

Me nismën e saj, pranë kësaj medreseje organizohen çdo vit garat e shahut, të basketbollit, tenis-pingpongut, karatesë etj. Ajo gëzon një emër të mirë në mes shkollave tjera të Prishtinës dhe trajtohet si shkollë e mesme profesionale me tretman të barabartë me simotrat e tjera shkolla profesionale të Kosovës në gjuhën shqipe.

Medreseja mban lidhje bashkëpunimi me institucionet arsimore si me Universitetin e Kosovës, Fakultetin e Bujqësisë, Shoqatën e Kartës së Kosovës, Këshillin e Solidaritetit pranë LDK-së etj. Shoqata e Nxënësve të Medresesë "Alauddin" në Prishtinë ka organin e vet "Drita e Kur'anit", një revistë në 32 faqe.

Nxënësit e dalë nga kjo shkollë kanë vazhduar studimet e larta në Universitetin e Prishtinës, në SHLP të Gjakovës, në SHLK të Pejës, në SHLP të Shkupit, në akademinë pedagogjike të Shkupit, si dhe në universitetet jashtë vendit. Të gjithë këta kadro të dalë nga kjo vatër i dhanë një shtytje përpara mendimit teologjik islam nëpërmjet studimesh dhe artikujsh origjinalë, si dhe përkthimeve nga literatura e vendeve islamike; çuan përpara kulturën islame, duke bërë të mundur botimin e revistave të ndryshme, siç janë "Dituria Islame", "Takvim (Kalendar)", "Edukata Islame" etj. e, mbi të gjitha, përkthimi i Kur'anit.

Numri i madh i kadrove që mbaruan këtë shkollë, lidhja e saj nëpërmjet tyre me të gjitha qendrat e trojeve shqiptare, kontributet e shumanshme e bënë të njohur atë si "Vatra e popullit" dhe e emëruan "Foleja e shqipeve"

Nga viti 1993 kjo medrese ka hapur paralelen e saj në Prizren, dhe një vit më vonë edhe atë në Gjiilan. Gjatë vitit shkollor 1995/96 Medreseja "Alaud-din" numëronte 288 nxënës në Prishtinë, në Prizren 132, (në tri vite) dhe në Gjiilan 80 nxënës në dy vite.

Duke u nisur nga ajo se Islami urdhëron për arsim pa dallim si meshkujt ashtu edhe femrat, Kryesia e BI, si organi më i lartë fetar në Republikën e Kosovës, vendosi që në vitin e ri shkollor 1997/98 në kuadër të medresesë "Alaud-din" të hapen edhe dy paralele për femra, njëra në Prishtinë ku u pranuan 38 nxënëse, dhe tjetra në Prizren ku u pranuan 25. Pos këtyre, në këtë medrese i vijojnë mësimet me korespondencë edhe më se 400 nxënës (meshkuj dhe femra).

*Tabelë mbi numrin e nxënësve të medresesë Alaud-din gjatë vitit shkollor 1997/1998*

<b>Qyteti</b>	<b>Numri i nxënësve (meshkuj)</b>	<b>Numri i nxënësve (femra)</b>	<b>Shuma</b>
Prishtina	270	38	<b>308</b>
Prizreni	145	25	<b>170</b>
Gjilani	100	-	<b>100</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>535</b>	<b>63</b>	<b>578</b>

Krahas medreseve të mësipërme, në Kosovë kanë funksionuar normalisht edhe medrese të tjera nëpër qytete të ndryshme. Medrese ka pasur edhe nëpër disa fshatra si në Dobërçan, Tërnoc etj. Këto ishin ngritur pranë xhamive ose në lokale të ndryshme dhe janë drejtuar nga personel privat, të cilët nuk kanë pasur të drejtën e lëshimit të diplomave. Këto i kanë dhënë rrugë sidomos mësimi autodidakt dhe kanë qenë të njohura pranë bashkësive islamike.

## **MEDRESETË BRENDA SHQIPTAR**

Edhe në trojet e shtetit Shqiptar, që doli pas shpalljes së Pavarsisë, pati një numër të madh medresesh, të cilat si edhe në Kosovë, përveç rolit edukativo-arsimor, dhanë kontributin e tyre të çmueshëm edhe në rrafshin fetar e kombëtar. Përsoneli i tyre bashkë me nxënësit e lidhën fatin e tyre me fatin e Shqipërisë. Firmat e Haxhi Vehbi Dibrës dhe Ferid Vokopolës ishin ndër të parat që u vendosën në Kuvendin e Vlorës. Prandaj me të drejtë Sali Vuçiterni, ish-senator në qeverinë shqiptare thotë në deklaratën e tij kur flet mbi reformat në arsim: "Çështja e medreseve është pika më me rëndësi për ne..."

Të dhëna të hollsishe për gjeografinë e shpërndarjes së medreseve në Shqipëri dhe numrin e nxënësve të tyre jep tabela e mëposhtme:

## RRJETI I MEDRESEVE NË TERRITORIN E MBRETËRISË SHQIPTARE NË VITET '30 TË

Nr	Qyteti	Nr. nxënësve
1	Shkodra	121
2	Vlora	4
3	Gjirokastra	6
4	Kavaja	36
5	Durresi	6
6	Tirana	66
7	Kruja	2
8	Shijaku	17

9	Peqini	13
10	Elbasani	20
11	Korça	12
12	Berati	21
	<b>Gjithsej</b>	

Lidhur me problemin e organizimit të medreseve në qarqet e klerit mysliman u shfaqën dy rryma kontradiktore. Njëra me pikëpamje reformatore, në krye të së cilës qëndronte senatori Sali Vuçiterni, kurse tjetra me prirje konservatore, që kryesohej nga disa klerikë të rretheve, kryesisht atyre të prefekturës së Shkodrës.

Grupi i parë që i mendimit të organizonte në kryeqytet nje shkollë fetare, me një konvikt, ku studentëve të medreseve të rretheve t'u krijoheshin kushte për të ndjekur normalisht shkollën e mesme. Ky grup propozonte që personeli mesimor të zgjidhej nga teologet më të kualifikuar, te cilët do të pergatisnin edhe tekstet mësimore. Në këtë mënyrë të gjitha forcat do të përqëndroheshin në kryeqytet. Studentët që do dilnin nga kjo medrese mund të vazhdonin shkollat e larta fetare jashtë vendit. Këta qenë të mendimit që të mbyllen medresetë e tjera, të cilat kishin provuar se ishin të pafuqishme dhe përdornin metoda të vjetëruara.

Drejtuesit e grupit të dytë protestuan ashpër ndaj këtij projekti, duke thënë që ekzistenca e medreseve në disa qendra mjaft të populluara dhe sidomos në ato qendra, ku medresetë kishin tradita shekullore, siç ishin: Shkodra, Gjirokastra, Kruja, Elbasani, Berati etj. të vazhdonin normalisht punën e tyre.

Natyrisht në këtë ndeshje pikëpamjesh u aktivizuan edhe shumë besimtarë, por problemi që i kushtëzuar dhe nga ana ekonomike, mundësitë organizative etj. Ishin këta faktorë që mposhtën grupin e dytë.

Shpreh mendimin që ekzistenca e medreseve në vendet e populluara, po që se do të ekzistonin mundësitë ekonomike dhe përballimi i tyre me kuadro dhe pajisje didaktike, do të krijonte mundësi më të mëdha për masivizimin e kësaj hallke të arsimit islamik duke u frekuentuar nga një numër më i madh njerëzish duke krijuar kushte për të rritur nivelin teologjik të besimtarëve e për rrjedhojë ato do të bëheshin një barrikadë e rëndësishme kundër përhapjes së ideve ateiste në popull.

Këtë e dëshmon më së miri shembulli i Medresës së Përgjithshme të Tiranës, e cila duke grumbulluar kuadro të forta me kontigjentet e nxënësve që nxori ajo, edhe në kushtet e vështira të diktaturës së proletariatit dhe të shtetit ateist, e mbajti gjallë në popull frymën dhe edukatën fetare.

Pas shpërbërjes së shtetit ateist në Shqipëri, prapë u krijuan kushte për t'u zhvilluar arsimi fetar, e në këtë edhe ai islamik. Natyrisht pas një periudhe 50-vjeçare vështirësitë për hapjen e këtyre shkollave ishin të mëdha. Mungonin lokalet, kuadrot, tekstet mësimore, pajisjet etj., por dëshira e zjarrtë e besimtarëve, vullneti i mirë i tyre bëri që të kapërceheshin këto vështirësi dhe brenda një periudhe trevjeçare 1991-1994 u hapën në qytetet kryesore të Shqipërisë 10 medrese. Ato ndiqen nga 1504 nxënës, nga të cilët 55 janë femra. Afërsisht një e pesta e këtyre nxënësve janë konviktore dhe pjesërisht gezojnë bursa

studimore. 38 kuadro të përhershëm punojnë në këto medrese, kurse 171 janë të jashtëm, të zgjedhur nga specialistët më të aftë.

Të dhëna më të hollësishme mbi numrin e medreseve e nxënësve që ndjekun ato e kuadrin fetar jep tabela e mëposhtme:

*Gjendja e shkollave fetare në Shqipëri  
në fillim të vitit 1993-1994*

Nr	Medrese	Nxenes		Konv	Mësues	
		Gjith.	Fem.		difinit.	Me orë
1	"H.Mahmud Dashi" Tiranë	310	-	-	8	25
2	"H.Sheh Shamia" Shkoder	152	40	-	6	30
3	"Mustafa Varoshi" Durrës	78	15	-	3	14
4	"H.Ali Korça"	340	-	150	6	35

	Kavajë					
5	"H.Ali Elbasani" Elbasan	206	-	85	3	12
6	"Vexhi Buharaja" Berat	46	-	-	2	11
7	Peshkopi	149	-	-	4	15
8	Kukës	127	-	-	3	9
9	Korçë	43	-	-	1	10
10	Gjirokastrë	53	-	42	2	10
	Gjithsej	1504	55	277	38	171

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme, për nga numri i nxënësve vendin e parë e zë medreseja "Hfz. Ali Korça" e Kavajës, vendin e dytë ajo e Tiranës, dhe e fundit ajo e Korçës me 43 nxënës. Ndërsa për nga numri i femrave vendin e parë e zë medreseja "H. Sheh Shamia" me 40 vajza. Nxënësit e këtyre medreseve rregullisht pranohen në moshën 12-13-vjeçare, pasi të kenë kryer me sukses arsimin fillor.

Nxënësit e medreseve sipas rregullores çdo ditë duhet të bënin një orë praktikë fetare jasht orëve të mësimit mbi mënyrën dhe rregullat e faljes së pesë kohëve të namazit. Gjatë muajit të Ramazanit të gjithë nxënësit e medreseve do të bënin një muaj (4 javë) praktikë profesionale, kurse nxënësit e vitit 11 e të 12 do të drejtonin shërbesat fetare si falje taravish, falje xhumash, xhenazesh etj. Kjo bëhej në ato xhamia që do të caktohen nga shkolla në konsultim me Komunitetin Musliman. Për të pasë një ide më të plotë për planin mësimor të këtyre shkollave shif tabelat në vazhdim:

NR	LENDET	KLASAT				Ore Vjetore	
		V	VI	VII	VIII	V	VI
A	Lendet Pergjithshme	23	25				
	Gjuhë Shqipe	3	3	3	3	105	105
	Lexim Letrar	3	3	3	3	105	105
	Gjuhë e Huaj e Dytë	3	3	3	2	105	105
	Histori	2	2	2	2	70	70
	Gjeografi	1	2	2	2	35	70

	Matematikë	5	5	5	5	175	175
	Fizikë	-	2	2	2	-	70
	Kimi	-	-	-	3	-	-
	Biologji	-	2	2	2	-	70
	Dituri Natyre	-	-	-	-	105	-
	Vizatim	1	1	1	1	35	35
	Këngë E Muzikë	1	1	1	1	35	35
	Edukim Fizik	1	1	1	1	35	35
	Letërsi	-	-	-	-	-	-
	Astronomi	-	-	-	-	-	-
	Vizatim Teknik	-	-	-	-	-	-

B	Kulture Fetare	9	8	8	8	-	-
	Arabisht	6/3	2	3	3	159	105
	Kur'an	0/3	2	2	2	51	70
	Besim (Akaid)	2	2	2	2	70	70
	Histori Islame	1	1	1	1	35	35
	Hadith	-	-	-	-	-	-
	Tefsir	-	-	-	-	-	-
	Fikh	-	-	-	-	-	-
	Usuli Fikh	-	-	-	-	-	-
	Usuli Hadith	-	-	-	-	-	-
	Shuma Orë Jave	32	33	-	-	-	-

NR	Lendet	KLASAT				Ore Vjetore	
		IX	X	XI	XII	IX	X
A	Lendet e Pergjithshme	24	24				
	Gjuhë Shqipe	-	-	-	-	-	-
	Lexim Letrar	-	-	-	-	-	-
	Gjuhë e Huaj e Dytë	2	2	2	2	70	70
	Histori	2	2	3	3	70	70
	Gjeografi	2	2	2	-	70	70
	Matematikë	5	4	3	3	175	140
	Fizikë	3	3	3	4	105	105

	Kimi	2	3	2	2	70	105
	Biologji	2	2	2	2	70	70
	Dituri Natyre	-	-	-	-	-	-
	Vizatim	-	-	-	-	-	-
	Këngë E Muzikë	-	-	-	-	-	-
	Edukim Fizik	1	1	1	1	35	35
	Letërsi	4	4	4	4	140	140
	Astronomi	-	-	-	2	-	-
	Vizatim Teknik	1	1	-	-	35	35
B	Kulture Fetare	9	9	10	11	-	-

	Arabisht	6/3	3	2	2	159	105
	Kur'an	0/3	3	1	1	51	105
	Besim (Akaid)	2	2	1	1	70	70
	Histori Islame	1	1	1	1	35	35
	Hadith	-	-	1	1	-	-
	Tefsir	-	-	2	2	-	-
	Fikh	-	-	2	1	-	-
	Usuli Fikh	-	-		2	-	-
	Usuli Hadith	-	-	-	-	-	-
	Shuma Orë Jave	33	33	-	-	-	-

## **MEDRESEJA E PËRGJITHSHME - TIRANË**

Më 1924 në nivelin e gjimnazit klasik e teologjik, me personel terësisht shqiptar u themelua "Medreseja e Përgjithshme e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë". U hap në bazë të vendimit Nr. 105/1 dhe Nr. 125/2 të Qeverisë Shqiptare dhe u organizua në përputhje me artikullin 60 të Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Hapat e parë të medresesë në Tiranë u bënë në disa rrethana te veçanta historike, që po kalonte shoqëria shqiptare në atë kohë. Më 1931 në gjirin e Komunitetit Mysliman ishte krijuar dega kulturore, e cila qe miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më 20.07.1931 dhe firmosur nga K/Ministri Pandeli Vangjeli dhe ministrat H. Mosi, M. Tutulani etj. Dega Kulturore, e cila ndikoi shumë në krejt ecurinë e medresesë, sanksiononte në rregulloren e saj një sërë kërkesash e parimesh, siç ishin: vëllazërimi në mes myslimanëve, vëllazërimi kombëtar, konfirmimi me qytetërimin modern, konfirmimi me zhvillimin njerëzor, përmirësimi i gjendjes shoqërore të myslimanëve, organizimi i konferencave, botimi i broshurave, hapja e shkollave foshnjore për djem e vajza, ndjekja e medresesë nga seksi femëror.

Në përparimin e medresesë patën rëndësi edhe vendimet e Kongresit i të Komunitetit Mysliman Shqiptar, e në mënyre të veçantë pikëpamjet përparimtare të kryetarit të këtij Komuniteti Haxhi Vehbi Dibra.

Më 1931 përfunduan punimet e ndërtesës së re të Medresesë së Përgjithshme në Tiranë. Ky qe një sihariq për tërë botën shqiptare. Mehdi Frashëri, një nga politikanët dhe sociologët e shquar shqiptarë, në fjalën e përshëndetjes tha: "Përparimi i vrullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës, se për të

mjeruarit në këtë botë s'ka mëshirë. Mëshira mund të jetë personale, por jo midis popujve, d.m.th. se s'është internacionale.

Ai popull që rrëzohet me këmbët e veta s'ka të drejtë të ankohet. Medresetë që do të jenë foleja e prijsave të fesë islame në Shqipëri duhet të konformohen me frymën e shekullit brenda të cilit jetojmë."

Medreseja e Përgjithshme e Tiranës brenda pak viteve e fitoi fizionominë e vet si një institucion serioz, ku merrej një formim i shëndoshe fetar dhe kombëtar. Kjo u arrit në sajë të trupit mësimor të pedagogeve që e drejtonin atë, të cilët ishin shquar në levizjen kombëtare për çlirimin e Shqipërisë dhe njëkohësisht mbeten të respektuar dhe në periudhën kur vendi hyri në rrugën e emancipimit shoqëror. H.V.Dibra, që drejtoi për shumë vjet medresenë, Qamil Bala, drejtori i saj i parë, Ismet Dibra, Haki Sharofi, Isa Domni, Esat Myftia e të tjerë që qenë në krye të saj, kishin një përgatitje të lartë teologjike, filozofike, etike e sociologjike. Shkrimet e tyre janë deshmi e kulturës së gjërë që zotëronin.

Medreseja punonte mbi bazën e një rregulloreje të përbërë prej 92 nenesh, ku percaktohej çdo gjë që kishte të bënte me këtë institut. Medreseja e Përgjithshme vazhdonte 10 vjet, 3 prej të cilëve i përkisnin arsimit fillor, kurse 7 të tjerët përbënin arsimin e mesëm, të ndarë në kursin e ulët (4-vjeçar) dhe kursin e lartë (3-vjeçar). Viti mësimor i medresesë fillonte më 1 tetor dhe mbaronte më 30 qershor (artikulli 24 i Rregullores). Nxënësit ishin kryesisht internatiste dhe të seksit mashkullor. Në fund të çdo viti mësimor, sidomos në fund të çdo cikli, nxënësit maturantë jepnin 4 provime me shkrim e me gojë: besim, arabisht, gjuhë shqipe dhe histori e shenjtë. Në lëndën e besimit maturantët bënin një provim praktik, si dhe një predikim në një xhami faqe popullit. Në fund nxënësit pajiseshin me diplomë. Sistemi i vlerësimit ishte ai me 10 nota.

## PLANI MËSIMOR PËR TRE VJETËT E ARSIMIT FILLOR

Nr	Lëndët	Orë javore		
		I	II	III
1	Kur'an	6	4	4
2	Gjuhë shqipe	10	9	8
3	Besim	5	4	2
4	Fjalë arabisht	-	-	1
5	Aritmetikë e gjeometri	3	3	3
6	Histori	-	2	2
7	Gjeografi	-	2	2
8	Mësim natyre	-	2	2

<b>9</b>	Mësim sendesh	-	-	2
<b>10</b>	Muzikë	1	1	1
<b>11</b>	Gjymnastikë	1	1	1
<b>12</b>	Mësime shtetërore	-	2	2
	<b>Shuma</b>	<b>26</b>	<b>30</b>	<b>30</b>

Medreseja e Përgjithshme që në themelimin e saj u pajis me plan dhe program mësimor të nivelit bashkëkohor, të miratuar nga sekretari i Keshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman. Plani mësimor nga gruplëndët profesionale fetare u gërshetua me gruplëndët që karakterizojnë shkollat e mesme shtetërore, licetë klasike. Këto lëndë, siç ishte gjuha dhe letërsia shqipe, që merrej gjatë tërë periudhës shkollore 10 vjeçare, siç vërehet dhe në planin mësimor të mësipërm, kishte përparësi nga lëndët e tjera, e zhvilluar në nivel të lartë dhe e stimuluar në diskutimet me tolerancë që jep besimi islam. Ajo nxori dijetarë dhe shkencëtarë të aftë si Vexhi Buharaja, Shaban Demiraj, Vehbi Ismaili e të tjerë, punimet e të cilëve kanë zënë vend në fondet e shkences sonë shqiptare.

Aty studioheshin gjuhët e huaja, si arabishtja, anglishtja, persishtja. Arabishtja, e cila zinte vendin kryesor, zhvillohej mbi bazen e metodës Berlitz dhe asaj Ahu, që ishin më në zë në atë kohë.

Sintaksa arabe zhvillohej gjatë pesë vjetëve të fundit të medresesë. Nxënësit zotëronin rregullat e Avamilit, ato të Idh'harit, si dhe te Kafijes paralel me aplikacion. Në dy klasat e fundit programi i kësaj lënde përfshinte tekstin e Telhisit, Hadithit dhe Tefsirit të Kur'anit. Këto dy të fundit zhvilloheshin në praktikë, mbi bazën e Usuli Fikhut. Formim të mirë nxënësit merrnin edhe nga Logjika (Mantik) dhe lëndë tjera të karakterit juridiko-teologjik.

Në formimin intelektual bashkëkohor të medresistëve ndikuan lëndët shkencore si Historia e Natyrës, Kimia, Fizika, Historia, Gjeografia etj. Në botanikë bëhej klasifikimi i bimëve sipas sistemit të Karl Lineut. Në zoologji bëhej klasifikimi i kafshëve. Në fizikë zhvillohej mekanika, hidrostatika, aerostatika etj. Mësimet e fizikës dhe të kimisë shoqëroheshin me eksperimente.

Medresistët, nëpërmjet lëndës Dituri Drejtësore, merrnin njohuri edhe mbi kushtetutën dhe kodin civil, çka i ndihmonte ata për të bërë krahasime me Sheriatin (ligjin islam). Në formimin estetik të nxënësve luajti rolin e vet edhe lënda e muzikës, që zhvillohej me një orë në javë, sidomos me mësimin e këngëve me karakter kombëtar.

Medresistët zhvillonin një veprimtari të gjërë jashtëshkollore, shkencore e artistike. Ata shfrytëzonin për këto qëllime festat fetare e ato kombëtare. Përgatisnin këndimin e Mevludit shqip, ilahive etj., të cilat i zhvillonin para publikut.

Në harkun kohor 1931-1941 trupi mësimor i medresesë i cili ishte mjaft i ngritur nga ana intelektuale, të cilët dinin mirë gjuhën arabe dhe të tjera, njëfnin mirë shkencat islame, filozofinë, teologjinë e historinë, shtruan problemet që kishin të bëjnë me ndërtimin e përgjithshëm të njerëzve. Këta u angazhuan të marrin përsipër hartimin e platformave të reja për edukimin e rinisë "tue lanë përjashta të gjitha ato që s'janë të përshtatshme me qarkun dhe konditat (e asaj kohe)" Ata ndër të tjera theksonin se: "Ndër

shkollat fillore dhe shtetnore le t'i u mësohet feja fëmijëvet mbi baza dhe vija të caktuëme, me tekste të përgatituna mirë, tue pasë kurdoherë kontrollin e duhur si për sa u përket tekstevet ashtu edhe për sa i përket mësuësve që i mësojnë. Mësuesit t'on të fesë duhet të jenë ndër ma të zgjedhunit e ndër ma t'edukuemit sepse atyne u ngarkohet shumë një barrë e randë, barra se si me e edukuë fëmijën dhe moshën e re në pikpamje shpirtnore." Kjo frymë buronte nga Medreseja e Tiranës, që për mendimin tim, gjatë këtyre viteve po kalonte zhvillimet më kulmore të saj, pasi që siq do të shofim, më vonë, ndërhyrjet që u bënë nga pushteti, në strukturat dhe programet e sajë, bënë që më vonë, ajo të humbë vlerat e sajë si institucion që synonte të kultivojë ndërgjegjen fetare e kombëtare.

Pas Luftës së Dytë Botërore mbijetesa e saj u bë shumë e vështirë. Pushteti komunist i imponoi me vendim të veçantë një plan-program mësimor, që prekte thellë fizionominë dhe përmbajtjen e saj. Në mes lëndëve që iu imponuan ishte edhe gjuha ruse. Jo shumë kohë më vonë, gjuhës ruse iu shtua lënda e darvinizmit. Ndaj këtyre masave personeli mësimor reagoi ashpër. Esat Myftia, ish-drejtor i Medresesë së Përgjithshme dha dorëheqjen.

Më 1967, kjo medrese, fole e mendimit islamik shqiptar u mbyll. Mësuesit dhe nxënësit e saj u shpërndanë, u morën me punë të tjera dhe një pjesë u internuan ose u futën nëpër burgje.

Me rikrijimin e Komunitetit Musliman dhe kërkesat e popullit për të vazhduar traditën e edukimit fetar përmes medresesë, kjo shkollë u rihap më 1991. Ajo mori emrin e dijetarit të njohur në fushën e drejtësisë islame "H.Mahmud Dashi".

## **ARSIMI I LARTË ISLAMIK SHQIPTAR (FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME - PRISHTINË)**

Me rënien e sistemeve socialiste totalitare, në bllokun lindor sidomos me shëmbjen e regjimeve komuniste që e kishin kufizuar apo mohuar fenë, popullsia islame u gjend përpara mundësish të reja për të ushtruar lirisht fenë e saj, dhe në të njëjtën kohë të ngrejë edhe institucionet e veta fetare dhe kulturore. Mbi bazën e traditave të trashëguara, si dhe mbi bazën e arritjeve të nxitimshme të kohëve të fundit, u pa e nevojshme që të fitohet koha e humbur. Bota shqiptare tani nuk ishte më ajo e dikurshmja. Ajo e tregoi forcën dhe gjallërinë e saj në vitet '80, me krijimin e shtypit të saj fetar në gjuhën shqipe në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Kuadrot e reja të formuara në gjirin e universiteteve të njohura islamike e që u doktoruan në dhjetëvjeçarin e fundit, duke hartuar disertacionet, patën edhe tema që kishin për subjekt botën islame në Shqipëri. Këto studime u bënë në vazhden e punimeve dhe të veprimtarive të ideologëve patriotë myslimanë shqiptarë si: Hoxha Tahsini, Haxhi Ymer Prizreni, Mulla Zeka, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Korça, Kadri Gjata etj.

Më 1981 Rexhep Boja paraqiti temën interesante "Shqiptarët dhe Islamizmi", me të cilën ai mori gradën shkencore Magjistër dhe katër vjet me vonë ai mbrojti doktoraturën me disertacionin "Myslimanët në Jugosllavi". Studime të kësaj natyre u bënë edhe nga punonjës të tjerë. Nëpërmjet punimeve të kësaj natyre, që panë dritën e botimit në periodikët si "Dituria Islame"(Prishtinë), "Hëna e re" (Shkup), "Elif" (Podgoricë), dëshmuar se zhvillimi i vetëdijes fetare te shqiptarët ka qenë i lidhur ngushtë me përparimet e shoqërisë shqiptare, të pavarësisë së tyre ekonomike, sociale dhe politike dhe se e tërë popullsia me kombësi shqiptare e këtyre trojeve ishte e lidhur ngushtësisht me interesat kombëtare.

Të gjithë faktorët e mësipërm si dhe zhvillimi i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë, shtruan terrenin, dhe njëherish shtruan nevojën e ngritjes së një shkolle të lartë islame në një nga vendet me të përshtatshme.

Mundësitë dhe kushtet për ngritjen e një fakulteti islamik gjithëshqiptar i kishte Kosova dhe konkretisht Prishtina. Këtu ekzistonte Meshihati i cili zhvillonte një aktivitet të gjerë fetar, kulturor dhe kombëtar të pavarur, kishte kuadro të përgatitura teorikisht dhe organizativisht, kishte mundësi ekonomike për të ngritur një shkollë të lartë fetare islame. Prishtina, e cila që më 1951 kishte ngritur Medresenë e ulët dhe më 1962 Medresenë e mesme me filialet medrese, në qytetet e tjera (Prizren, Gjilan) dhe kuadrot efektive që kishte, u bë bazë për ngritjen e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Në mbledhjen e 7 qershorit 1992 të Kuvendit të Bashkësisë Islamike të Kosovës, Dr. Rexhep Boja, në emër të Komisionit Amë të formuar nga Dr.Pajazit Nushi, Mr.Ismail Ahmeti, Mr.Qemal Morina, Isa Bajqinca, Jashar Jashari, Miftar Hajdini dhe Naim Tërnavë, paraqiti synimet lidhur me ngritjen e Fakultetit të Studimeve Islame. Njëkohësisht ishin hartuar statuti dhe plan-programet e tij. Në bazë të plan-programit përfshiheshin 23 disiplina, nga të cilat 2/3 e zinin lëndët fetare, kurse pjesa tjetër përbëhej nga lëndët e kulturës së përgjithshme. Ky Fakultet gjeti miratimin edhe të rektorit të Universitetit të Prishtinës, Dr.Ejup Statovcit.

Mbi këtë bazë, me 7 dhjetor 1992 Fakulteti i Studimeve Islame hapi dyert e tij. Dekani i këtij Fakulteti u zgjodh nga Meshihati i Kosovës Dr.Rexhep Boja, ndërsa zëvendesdekan u zgjodh Mr.Qemal Morina.

Ky Fakultet, në vitin e parë, u ndoq nga 40 studentë të regullt dhe me korrespondencë.

Hapjes së këtij fakulteti i parapriu një platformë e thelluar dhe me baza shkencore e Dr.Pajazit Nushit, që u botua në faqet e "Diturisë Islame" me titullin "Themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame në

Prishtinë dhe parimet kryesore të organizimit të punës së tij" Autori, pasi bën një vështrim sintetik të veçorive etnopsikologjike dhe etnokulturore, analizon gjendjen dhe nivelin e shqiptarëve në Jugosllavinë e shpërbërë, përqindja e të cilëve arrinte në 97%. Ai vë në dukje se shqiptarët bëjnë një jete të organizuar fetare, kanë institucionet dhe organizatat e tyre të posaçme fetare. Vetëm "në Kosovë ka 484 xhami dhe 52 teqe, ku shqiptaret ushtrojnë të drejtën dhe lirinë e tyre të besimit. Që prej 29 vjetëve funksionon medreseja "Alaud-din" e Prishtinës, nga kanë dalë 25 gjenerata maturanësh, dhe se një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vijuar e vijnë studimet me sukses në Medinë, Tripoli, Damask, Kajro, etj., se në Tiranë, Prishtinë e Shkup janë botuar disa vepra origjinale islame" etj.

Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe, njërit prej teksteve më të vështira dhe më të rënda për përkthim, dëshmuar se kemi njohës të mirë të arabishtes, të kësaj gjuhe klasike të Lindjes, si edhe të shqipes.

"Kështu gjuha shqipe, thekson autori, u vërtetua dhe si gjuhë e veprave të larta dhe të ndërlukuara Islame". Në këtë platformë, autori dëshmon se Prishtina është edhe qendër e disa kuadrove me vokacion shkencor nga fusha e shkencave islame.

Dr.P.Nushi, duke shpalosur idetë e tij mbi programin e këtij Fakulteti, nënvizon se ky Fakultet është ndër të rrallët ku duhet të mësohen disa gjuhë të huaja, përveç shqipes-gjuhë mësimi dhe lëndë mësimi. Ai shtron nevojën e përvetësimit nga ana e studentëve të gjuhës arabe, turke, osmane, perse dhe angleze, duke e ngritur këtë Fakultet në nivelet e studimeve filozofike-orientalistike.

Në vazhdim të ekspozimit të tezave të tij mbi funksionet e fakultetit të Studimeve Islame, ai thekson se Islamizmi krahas me religjionet e tjera do të studiohet si formë e ekzistencës së jetës dhe e kuptimit të saj dhe si mënyrë e ngritjes së kulturës së përgjithshme të individit. Arti islamik, sidomos ai në fushën e

arkitekturës "ka gjetur një shtrirje të madhe në vendet arabe, në Spanjë, në vendet ballkanike, e deri në Alaskë".

Formimit të kuadrove me orientim arsimor, shkencor dhe edukativ të nivelit universitar dhe pasuniversitar i kontribuon, në radhë të parë, përmbajtja e punës arsimore, edukative dhe shkencore që po bën dhe do të bëjë Fakulteti i Studimeve Islame. Fakulteti u ofrohet në, radhë të parë, shqiptarëve, duke u bërë një vatrë e formimit të kuadrove teologjike shqiptare për studime islame.

Parimi i ndërlidhshmërisë së nevojave bashkëkohore kombëtare me ato fetare, kërkon zgjedhjen e atyre lëndëve të mësimi, të cilat i kontribuojnë qëllimit të përbashkët të zhvillimit të kombit tonë, mëvetësisë së plotë të tij, duke përfshirë këtu dhe lirinë shpirtërore individuale e kolektive të shqiptarëve. Mbi këtë parim gjejnë vend lëndët e kulturës së përgjithshme dhe të kulturës kombëtare përkrah lëndëve profesionale. Në kuadrin e lëndëve të kulturës së përgjithshme vend të veçantë zënë: lënda e filozofisë, e filozofisë islame dhe lënda e sociologjisë së kulturës me theksim të veçantë të sociologjisë së kulturës kombëtare. Po në këtë grup, të kulturës së përgjithshme, vend të veçantë gjejnë lëndët e gjuhës shqipe (fonetikë, morfologji dhe sintaksë e gjuhës shqipe), si dhe letërsia shqipe, edhe lëndët e gjuhëve të huaja.

Zotërimi i mësimave islame nga ana e studentëve të këtij Fakulteti do të lindë nevojën e studimit të trashëgimisë së besimit islam bashkëkohor, të zhvillimit të shqiptarëve dhe të mendimit shqiptar posaçërisht. Raporti ndërmjet lëndëve kombëtare duhet t'i motivojë studentët të hyjnë në përvijime mendimesh të tilla, të cilat më vonë do t'i thellojnë në studime të posaçme.

Feja Islame e shqiptarëve është një realitet. Pavarësisht nga qendrimet dhe pikëpamjet e cilitdo ndaj këtij realiteti, ky realitet duhet të studiohet, së paku të kapen anët kryesore të tij. Ai ka përmasa shtrirjeje

shumë të mëdha. Përmasat e shtrirjes gjeografike të shqiptarëve islame janë aq të mëdha, sa janë edhe përmasat e shtrirjes së diasporës shqiptare në vendet e ndryshme të të gjitha kontinenteve. Në këto kushte do të ishte e nevojshme të përpilohet atlas i shtrirjes së tyre. Aq më tepër kur dihet se lidhja shpirtërore ndërmjet tyre i kontribuon lidhjes kombëtare dhe zhvillimit të përbashkët kombëtar e fetar të tyre.

Vëzhgimi e studimi i trashëgimisë islame pozitive, ai i disiplinave moderne të shkencave bashkëkohore, sikurse edhe ai i shqiptarëve dhe i mendimit të tyre, do të shprehet pozitivisht dhe në ritmin e kapërcimit me të shpejtë të nivelit të zhvillimit ekonomik e social relativisht të ulët të shqiptarëve. Gjithashtu, vëzhgimet e studimet i këtilla do të shpjenë edhe në sinteza të rëndësishme për avancime të kufijve të horizontit të dijeve tona.

Për këtë arsye, misioni arsimor, edukativ dhe shkencor i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë ka rëndësi të veçantë dhe aktualisht me punën e gjithëmbarshme të tij do t'i kontribuojë zgjerimit të horizontit të dijeve, zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare dhe inkuadrimit të shqiptarëve në rrjedhat e përgjithshme të Evropës së integruar.

Më 3 korrik 1997 u diplomua studenti i parë i këtij fakulteti, i vetmi në të gjitha trojet shqiptare që përgatit kuadro në rrafshin e studimeve islame. Sadik (Sami) Mehmeti që ai që mbrojti me sukses temën e diplomës në lëndën e DA'WES me titull: "THIRRJA ISLAME - roli dhe mjetet e saj".

## **NDËRTESTAT E KULTIT ISLAM DHE ROLI I T YRE NË EDUKIMIN FETAR, ETIK DHE KUTUROR TË SHQIPTARËVE**

Islami i kushton rëndësi të veçantë, mësimi, edukimit dhe shkencës. Kjo theksohet fuqishëm qysh në ajetin e parë të zbritur nga ana e Zotit, duke i porositë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie a moshe "Lexoni, studjoni dhe edukohuni me emrin e Zotit tuaj..". Ky është edhe thesari më i çmuar që u ka lënë trashëgim Pejgamberi a.s. pasuesve të fesë islame. Islamizmi i shpallur tashmë para botës, i sillte asaj një raport të ri ndaj jetës, i ofronte një filozofi të re të bashkimit të njerëzve dhe të marrëdhënieve njerëzore midis tyre. Ai thërriste të gjithë njerëzit të afrohen me njëri tjetrin, i ftonte ata në lutje të përbashkëta, dukuri e cila u realizua edhe nëpërmes vazeve ose predikimeve që mbaheshin në ndërtesat e kultit islam, xhamitë, mesxhidet, medresetë, teqetë etj.

Vendi i parë në të cilin është lutur Zoti ose xhamia e parë mbi sipërfaqen e dheut në të cilën është kryer ritual fetar konsiderohet xhamia e Qabes në Mekë. Në të është lutur babai i gjithë njerëzimit Ademi a.s. me bashkëshorten e tij të nderuar Hazreti Havan. Por me ardhjen e islamit institucioni i xhamisë mori dimensiene të reja. Dhe xhamia e Pejgamberit a.s. në Medinë u bë shembull e të gjithë xhamive që u ndërtuan më pas në metropolet e botës islame. Më të rëndësishme prej tyre janë: 1) Xhamia e Basras, të cilën e ndërtoi Utbe Bin Gazvan në vitin 635. 2) Xhamia e Kufes, të cilën e ndërtoi Sa'd Ibnu Ebi Vekkas në vitin 638. 3) Xhamia e Amr Ibn Asit në Fustat, e ndërtuar në vitin 642. Kjo xhami është zgjeruar dhe rindërtuar mbi 16 herë. 4) Xhamia e Ukbe Bin Nafiut në Kajrevan, e ndërtuar rreth viteve 670 dhe 675. 5) Xhamia e Aksas në Kuds, që u ndërtua në kohën e Omer Bin Hattabit (Halifit të dytë

musliman). Këtë xhami e rindërtoi Melik Bin Mervani në vitin 658, dhe pastaj Velid Bin Abdul Meliku në vitin 706.

Të njohura janë edhe Xhamia e Emevive në Damask, të cilën e ndërtoi Velid Bin Abdul-Meliku në shekullin e parë sipas Hixhretit. Pastaj Xhamia e Al-Az'harit, që e ndërtoi Xhevher Es-Sakiliu në shek. e katërt sipas Hixhretit. Për te u kujdes edhe Slahud-din El-Ejjubi. Ndërsa në Andaluzi (Spanjë) xhamia më e madhe dhe më e bukur ishte Xhamia e Kordovës, të cilën filloj ta ndërtoi Abdurrahmani i i në shek. e dytë sipas Hixhretit. Ndërtimi i kësaj xhamie ka zgjatur plotë tre shekuj.

Këto objekte vitale për shoqërinë, sikurse në mbarë qytetet islame, ishin (dhe në disa vazhdojnë të jenë) edhe këtu karakteristikë e qyteteve tona, si: Ulqini, Shkodra, Prizreni, Peja, Shkupi, Berati, Elbasani, Korça, Janina etj. Këto njëherit përbëjnë elementin bazë të të gjitha vendbanimeve qytetare shqiptare të banuara me popullatë islame, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që banorët e këtyre qendrave të realizojnë në mënyrë të përbashkët detyrat që prej tyre i kërkon feja, besimi i tyre dhe atdheu.

Padyshim që vendin qëndror në këtë misjon e zë xhamia e cila është edhe objekti qëndror i të gjitha qyteteve dhe shoqërive islame. Dimensioni i saj shpirtëror dhe dimensionin social-shoqërorë e vejnë atë edhe në qendër të Ummetit musliman.

Por para se të ndalemi më tepër rreth këtyre dy elementeve bazë, që ia vlen të ndalemi më tepër në trajtimin tonë, le të mësojmë fillimisht etimologjinë dhe domethënien e fjalës xhami.

Xhami quhet fjalorja ku besimtarët muslimanë kryejnë ritet e tyre, dhe tregojnë besnikërinë ndaj Allahut e Profetit. Fjala xhami rrjedh nga arabishtja "xhami'ë", që do të thotë vend tubimi. Kjo shprehje te ne ka mbetur nga turqit, sepse arabët më tepër përdorin flalën "Mesxhid". Dallimi ndërmjet tyre qëndron në madhësinë. Mesxhidet janë më të vogla dhe ndërtohen me materiale më të varfra. Janë të mbuluara

zakonisht me çati me strukturë druri dhe tjegulla. Ndërsa fjala "xhami'ë" zakonisht përdoret për faltoret qendrore të një qyteti me përmasa të mëdha. Në Kur'an, në shumë vende përmendet fjala, mesxhid - mesaxhid, mesxhidul-haram, bejtull-llahetj. Atë e gjejmë në shumë raste edhe në librat e hadithit si te Buhariu, Muslimi, Termidhiu, Musnedi i Imam Ahmedit etj.

## **XHAMITË E PARA NË TROJET TONA:**

Kontaktet e para të shqiptarëve me Islamin dhe gjurmë të islamizimit të tyre dëshmohen relativisht herët. Në shekujt e mesjetës paraosmane tokat shqiptare, për hirë të pozitës së tyre gjeografike, janë frekuentuar dëndur prej misionarëve (thirrësave islam R.Z.) të botës islame arabo-turke, qoftë për qëllime tregtare, qoftë për qëllime fetare apo ushtarake.

Në literaturën e mëparshme kur flitet për historinë e objekteve të kultit musliman zakonisht përmenden vetëm xhamitë e ndërtuara pas vitit 1417, kur Berati ose qytetet shqiptare gjenden zyrtarisht nën juridiksionin e Perandorisë Osmane duke mohuar kështu një prezencë shumë më të hershme të elementit islam që gjindet në veprat me vlerë arkitektonike si në Prizren që nga viti 1380 ose 1389 në Berat, të ndërtuara këto në stilin e Selxhukëve. Në një kohë kur osmanët nuk kishin akoma stilin e tyre dallues. Xhamitë osmane para pushtimit të Kostandinopojës ishin hipostil me shumë kupola dhe shumë kollona, nuk kishin një sallë unike. Por pas kësaj kohe Osmanët i dhanë xhamisë një rëndësi të veçantë duke i bërë ato me hapësira të mëdha, me një dekor të veçantë.

Kontributi i mjeshtërive shqiptarë në ndërtimin e xhamive është evident si në veprat e ndërtuara prej tyre në vendlindje por edhe në viset e tjera të Perandorisë ku ato luajtën një rol të shquar për formimin e stilit klasik të xhamisë osmane.

"Dokumentat tregojnë se në fund të shek. XV shumë shqiptarë kishin zënë vend në zyrat më të larta të shtetit osman, gjithashtu ishte i madh e numri i mjeshtërive të artit, arkitekturës, pikturës në ateljet qendrore të Stambollit. Xhamitë e Stambollit formuan në këtë kohë stilin klasik të xhamive duke iu shmangur stilit të ndërtimeve bizantine me ndryshime në strukturë".

"Prej gjysmës së dytë të shekullit XV deri në fund të shekullit XVI shteti osman nëpërmes zyrës perandorake të arkitekturës shpërndau modelin e arkitekturës klasike në të gjitha qendrat e perandorisë si në Lindje dhe në vendet Jug-lindore. Si kudo xhamitë u ndërtuan në dy tipe: Stili monumental me tri volume të dallueshme mirë dhe në balancë harmonike ndaj njëri tjetrit; në këtë rast ato kishin një portik arkadash përpara hyrjes, sallën kuadratike të kurorëzuar me kupolë dhe një minare të hollë dhe të gjatë që ndërtohej te hyrja. Paralelisht ndërtohej edhe modeli me çati që siguronte hapësirë më të madhe funksionale. Në zgjedhjen e modelit duket se ndikonte preferenca e dekorimit të brendshëm, ku arti i pikturës gjente vend më shumë në xhamitë me kupola, kurse ai i gdhendjes së drurit në tavanet, mafilet dhe mimeret".

Xhamitë përfaqësuese fillimisht ishin dhuratë e vetë Sulltanit (Pajazit Veliut apo Pajazitit) që njihen me emrin "Xhamia Mbret" siç është në vendin tonë Xhamia Mbret në Elbasan.

Një etap tjetër në ndërtimin e xhamive fillon nga fundi i shek. XVII dhe mbyllet në fund të shek. XIX. Ajo karakterizohet nga përhapja e fesë islame në pjesën më të madhe të popullsisë vendase, dhe formimit të ndërgjegjes kombëtare në popujt e ndryshëm përbërës të Perandorisë. Këtu do të

theksonim se shumë orientalistë kanë vërejtur se në periudhën e krizës së rendit feudal ushtarak osman dhe shthurjes së pushtetit të tij të centralizuar fillon dhe forcimi i ndjenjes kombëtare tek popujt e ndryshëm, dhe të parët që ndien këtë ndjenjë duket të jenë arabët që kishin pushtetin e ulemas në kryeqytet dhe që ishin si njohës të përgatitur dhe tradicional të librit të shenjtë Kur'anit.

Pas tyre u diferencuan shqiptarët që zotëronin ushtrinë dhe pastaj turqit që trashgëgonin dinastinë e fronit. Proçesi i decentralizimit shfaqet edhe në sferën e ndërtimitarisë duke u ngritur tashmë zyra projektimi ta pavarura në shumë qendra e qytete të perandorisë. Projektet nuk vinin më nga Stambolli. Të tilla zyra vërehen edhe në Shqipëri. Kështuqë projektet hartohen në vend dhe ndërtimi kryhet nga esnafët, të cilat kishin marrë formë të plotë dhe kryenin vetë detyrat me karakter publik siç ishin: ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, urave, xhamive, ujësjellsave, hamameve, etj.

"Në këtë periudhë kemi ndërtimin e një numri të madh xhamish nëpër qytete dhe nëpër fshatra që dallohen nga të parat për prezencën e elementeve arkitekturore e artistik të shijes vendase por edhe për një origjinalitet në siluetat dhe në kompozicionet. Në grupin e këtyre xhamive bëjnë pjesë: Xhamia Mbret në Shkodër, xhamia e Mirahorit në Korçë, xhamia Muradie e Vlorës, xhamia e Plumbit në Berat etj. Të gjitha këto xhami u ndërtuan nga zyrtarë shqiptarë të lartë që punonin në administratën e Perandorisë, si Arkitekt Sinani, Sadeqar Mehmeti, Kasem Aliu etj. Këtë e dëshmojnë mbishkrimet e vendosura në to".

Në xhamitë e ndërtuara në qendrat e qyteteve të vjetra shqiptare spikatnin hapësirat monumentale nën kube, karakteristik këto të arkitekturës islamiko-osmane. "Hapësira e xhamisë në të gjitha arkitekturat islame është detyra më e rëndësishme e arkitektit. Tipi më i vjetër i xhamisë, e ashtëquajtura xhamia arabe, në të vërtetë është holli (tremi), i çelur më tërë gjerësinë kah oborri i brendshëm. Hapësira e xhamisë arabe është fushë e mbuluar këndëdrejtëshe me katër shtylla të lidhura për harqe,

shumëfishë e shumëzuar, pa diferencim lartësie, pa theksimin e cilësdo pjesë. Të gjitha pjesët e hapësirës janë barabar të vlefshme.

Është e qartë se tipi i këtillë i çelur i xhamisë, pa tërë një murë, ka mund të lind vetëm në viset me klimë të ngrohtë. Në viset me klimë më të ashpër, ai është përshtatur kushteve të reja, me atë që mbyllet ana e çelur kah oborri, e vetë oborri i brendshëm pakësohet, ose krejtësisht humbet..."

Për lajmërimin e xhamisë njëhapësinore, çfarë më së shpeshti janë ndërtuar edhe te ne, me rëndësi më të madhe është tipi selxhuk i xhamisë njëhapësinore, me kube me hajat në anën hyrëse, me kube të vogla të mbuluara tip i cili lajmërohet pas rënies së mbretërisë selxhuke..." Zhvillimi i xhamisë nga sistemi arab i ndërtimit me lokale të ndërthurura deri te lokali i vetëm unik, është bërë në kërkim të kompozicionit sa më të shprehur arkitektonik.

Xhamitë e ndërtuara ndër ne në shekullin e fundit, përveç imagjinatës, motiveve dhe formave arabe, perse, e turke, paraqet më së qarti edhe elementin autokton. Kështu ndër ne, ajo zakonisht përbëhet nga salla e lutjeve, portiku dhe minareja. Ndërtuesit e tyre pak nga pak filluan t'i afrohen arkitekturës së banesës popullore vendase. Kjo vihet re në arkadat, strehët e gjëra, dekoret, ngjyrat e jashtme etj. Në faltoret islame të Tiranës, por edhe gjetkë, vihej re një pasuri e madhe strukturore që mishërohej në dekoracionin me motive floreale, me pejsazhe të pikturuara dhe në gdhendjet në kolonat, arkadat, kapitelet, tavanet, mafilet e kornizat. Të gjitha këto zbukurime janë shumë të përafërta me motive të arkitekturës popullore.

Mjeshtërit vendas e të huaj që morën pjesë në ndërtimin e tyre, shfrytëzuan edhe formën dhe teknikën e përdorur gjatë shekujve të mëparshëm në monumentet e vendit tonë. Gjithashtu, këta zgjodhën tipin e xhamisë me sallë unike, jo vetëm nga përmasat e godinës, por edhe nga ndikimi i traditës vendase që,

me sa duket, nuk parapëlqente zgjidhjet e tjera. Larmia e teknikave dhe formave të tyre flasin qartë për shkallën e zhvillimit të arkitekturës, dëshmojnë nivelin e lartë të mjeshtërisë së mjeshtrove shqiptarë të ndërtimit. Shumë xhami të trojeve shqiptare janë monumente me vlera arkitektonike, të artit dhe kulturës islame.

Në Shqipërinë e kufijve të sotëm deri në vitin 1967 qenë ndërtuar mbi 1050 xhami, nga të cilat u ruajtën vetëm nga një ose dy nëpër qytete si Tirana, Berati, Gjirokastra, Vlora etj. Tiranë p.sh. nga 24 xhami që kishte të gjitha u rrëzuan përveq asaj të Et'hem Beut që u ruajt si monument kulture. Sot Tiranë ka 5 xhami, ndërsa Komuniteti Musliman Shqiptar në tërë vendin administron rreth 425 xhami, pjesa më e madhe e të cilave u ndërtuan ose rindërtuan vetëm pas vitit 1991.

## **ROLI I XHAMISË NË ASPEKTIN SHPIRTËROR:**

Xhamia është vendi më i nderuar dhe më i shenjtë mbi sipërfaqën e tokës, ngase në të adhurohet Krijuesi i gjithë botërave, në të gjejnë prehjen të gjithë krijesat, engjujt, njerëzit dhe xhinët. Ajo është vendi ku njeriu i parë Ademi (Adami) a.s. i është lutur Zotit që ta mëshirojë. Në Kur'an thuhet: "Me të vërtetë xhamitë janë për Allahun" (El Xhin, 18) "Kush hyn në të është i sigurtë" (Ali Imran, 97). Ndërsa një dietar islam me të drejtë i krahasonte xhamitë me yjë duke thënë "...Sikurse yjë zbukurojnë qiellin gjatë natës, ashtu edhe xhamitë zbukurojnë tokën gjatë ditës". Kjo e bëri edhe Pejgamberin a.s. që pas

migrimit në Medinë ndërmarrja e tij e parë të jetë ndërtimi i xhamisë. Nga aty pastaj thirrja e muezinit "ejani në namaz...ejani në shpëtim", mori botën.

Xhamitë janë vende ku në mënyrë të vazhdueshme përmendet Zoti, për çka në Kur'an thuhet: "Nëpër shtëpitë që janë ngritur me lejen e Allahut, aty përmendet edhe emri i Tij, aty e lavdërojnë Atë në mëngjes dhe në mbrëmje...", dhe vetë fjala "bejtull-llah" do të thotë "Shtëpi e Allahut", vend ky, ku besimtari në mënyrë imediate ballafaqohet me mëshirën e Krijuesit të tij, dhe pas kësaj fiton të drejtën e vazhdueshmërisë në jetën e përsosur dhe të pastër shpirtërore. Xhamia, gjithashtu, është ajo që lidh besimtarin me botën tjetër, bën lidhjen e botës së tij fizike me atë shpirtërore. Xhamia është një dritë udhërrëfyese drejt qiellit "miraxhit", drejt botës së lumtur dhe të amshuar. "Sot, në botën e oshëtimës dhe zhurmës së madhe shurdhuese, xhamitë janë bërë oazë e paqës e qetësisë. Në një atmosfer të tillë besimtarët... zhyten në devotshmëri, dhikër dhe mendime".Skemat me dritë hëne në kopësht, si dhe vizatimet me motive nga natyra janë një shembull i përkryer për të larguar nga frekuentuesi i xhamisë tërë stresin që i sjellë jeta dhe peripecitë e saj. "..Mjeshtrat e Lindjes, të cilëve nuk u lejohej të pasqyronin qenie njerëzore, i lanë udhë të lirë imagjinatës së tyre për të luajtur me motivet dhe format. Ata krijuan atë ornament shumë të hollë me qëndisje, që u njoh me emrin arabeskë. Atë çka provon njeriu kur shëtit nëpër oborret dhe sallat e Al-Hamras dhe admiron larminë pafund të këtyre motiveve dekorative, mbetet e pashlyeshme".

## ROLI SOCIAL DHE SHOQËROR I XHAMISË

Në shikim të parë për shumicën nga ne, xhamia shifet vetëm si një vend tubimi për popullsinë islame, ku lexohet Kur'ani, besimtari i lutet Zotit, siguron qetësinë e tij shpirtërore dhe pajiset me kulturë islame. Por harron se ajo lidhet ngushtë me tërë sferat e jetës shoqërore të myslimanëve.

Xhamia ka qenë gjithnjë vatër uniteti e shoqërisë islame. Aty takohen njerëzit, bisedojnë, vllazërohen, këshillohen njeri me tjetrin e marrin këshilla kolektive, për sjellje të veçantë sociale, fetare e kulturore, aty dëgjojnë ligjëratat të ndryshme etj.

Pastaj, xhamia lidhet me jetën ekonomike të myslimanëve. Ajo, meqenëse në bazë të vakufit ka qenë ekonomikisht e siguar dhe autonome, ka pasur mundësi të luajë një rol të dukshëm në sistemin e përgjithshëm të doktrinës ekonomike të shoqërisë islame. Institucioni i zeqatit që është njëri ndër shtyllat e islamit shpesh herë organizohej në masë nëpërmes xhamive, dhe në këtë mënyrë ai kalonte nga një bamirësi individuale ose mëshire, në një "institucion shumë të rëndësishëm social, të cilin e kontrollon shoqëria dhe të cilin e udhëheqë mekanizmi i caktuar administrativ".

Gjithashtu edhe si institucion arsimor, xhamia është më e vjetër se të gjithë shkollat tjera, sepse shkencat islame dhe ato botërore fillimisht u përpunuan në të. Ajo ka luajtur një rol të tillë shumë më parë se mejtepet, medresetë dhe institucionet e tjera arsimore që u themeluan me vonë.

Xhamia ka qenë dhe është vend i dijes, vend i diskutimit të normave morale e shpirtërore, mbi të cilat mbështetet shoqëria dhe e ardhmja e një populli. Edhe sot në Kosovë, ku arsimi shqip është i ndaluar nga pushtuesit serbë, shumë i kanë kthyer mjediset e tyre në shkolla për fëmijët.

Xhamia, si faktore islame, nxori nga gjiri i shkollave të saj mjaft nxënës që më vonë u bënë patriotë të dëgjuar si Hasan Tahsini, Ymer Prizreni, Vellezërit Frashëri, Haxhi Zeka, Hasan Prishtina e shumë rilindës të tjerë të besimit islam.

Bibliotekat e tyre në përgjithësi ishin të pasura. Dr.J.Rexhepagiq shkruan:"... në bibliotekat që kanë ekzistuar pranë xhamive mund të gjendej një numër veprash në dorëshkrim... Biblioteka e madhe orientale në tokat tona është themeluar në shekullin XV në Shkup. Kjo është biblioteka e Gazi Isa-bej... Në të ka pasur atëherë mbi 230 libra me 320 blej, autorët e të cilave janë shkencëtarët më të shquar islam e tjerë... Ka qenë shumë e pasur edhe biblioteka në Gjakovë... Bibliotekat u kanë shërbyer nxënësve të medreseve dhe qytetarëve të shkolluar e sidomos personaliteteve të shquara në lëmin shkencor, arsimor e kulturor..."

Xhamia luante rolin e parlamentit. Aty rriheshin mendime, zhvilloheshin debate e diskutime, merreshin vendime që ishin për të mirën e popullit dhe të atdheut. Kështu, ajo u bë shpesh herë pikënisje e ekspeditave ushtarake dhe vatër e kushtrimeve për liri dhe pavarësi të trojeve tona. E njëjta gjë ndodh shpesh edhe sot në Kosovën e pushtuar nga serbët. Në xhamitë dhe anekset e tyre bëhen mbledhjet e krerëve të Kosovës, që punojnë për pavarësinë e saj.

Shumë prej xhamive kanë qenë të lidhura organikisht me objekte të tjera, si medrese ose mejtepe, biblioteka, internate, sahatkulla, hamame dhe çezme, hane, dyqane etj. Objekte këto të rëndësishme për jetën normale të një populli.

Edhe sahatkullat si përmendore të kulturës islame, kanë qenë pjesë të pandara të kompleksit të xhamive kryesore të qyteteve, ngritur në viset ballkanike që në kohën e pushtimit osman. Ato karakterizoheshin si objekte publike, por nuk mund të mohohet dhe karakteri i tyre fetar. Ora në kullë ka paralajmëruar

kohën e lutjeve ditore (namazit). Ato me pozitën e dalluar në lokacionet ku janë ngritur, paraqesin përmendore të rëndësishmë nga trashëgimia kulturore e islamit ne trevat tona.

Prania e sahat kullave pranë xhamive është një fenomen i vendeve Ballkanike si Shqipëria, Bosnja dhe Maqedonia. E para kullë e sahatit që ngrihet është ajo e Shkupit, pastaj sahatkulla ka Prizreni, Berati dhe gjithë qytetet shqiptare me rradhë, duke llogaritur që kulla e sahatit me minaren bëhen pjesë e të njëjtës ndërtesë, fenomen arkitektonik ky që nuk shfaqet në asnjë nga vendet islame. Pra në xhaminë e Peqinit me origjinë nga ajo e Tiranës dhe e Kavajës kemi modelin origjinal shqiptar në arkitekturën e xhamive që nuk njihet në mbarë botën islame.

"Ka pasë diskutime se çfarë kërkon sahati pranë xhamisë por këtë problem e zgjidh Sahati i Elbasanit i cili i ndërtuar nga Aqif Pasha - me porosinë e tij në vitin 1899 thuhet se ky sahat i bukur e sakt u ndërtua nga vetë populli i Elbasanit për të matur pesë vaktet e shenja (pesë kohët e faljes) dhe ju prin gjithë muezinëve. Kështu tek kulla e sahatit nuk kemi një këmbanë kishe siq pretendojnë disa njerëz sepse minare të tilla kuadratike ka edhe në Spanjë, Marok, por që në fakt kjo nuk ka hyrë nga Spanja por ka hyrë nga Evropa dhe është një dukuri Evropiane në stilin e xhamisë që nuk ka origjinë orientale, por ky model arkitektonik në fakt është shqiptar dhe nuk gjindet gjëkund. Dhe përderisa sahat kullat u ndërtuan në prani të xhamisë atëherë ato duhet konceptuar në një të vetme. Me këto u bë edhe kristalizimi i traditës shqiptare në fushën e ndërtimit të xhamive".

Edhe Hamamet bëjnë pjesë në arkitekturën islame, dhe që zakonisht gjindeshin në afërsi të kompleksit të xhamive dhe medreseve. Ato kishin rëndësi të madhe për jetën e përditshme të myslimanëve, pasi pastërtinë trupore e kanë kërkesë të domosdoshme të fesë së tyre. "Funksionet e ndryshme në hamam kërkojnë lokale të formave, madhësive dhe lartësive të ndryshme. Për këtë arsye plani i brendshëm i tyre është bërë në mënyrë të kujdesshme, kurse formës së jashtme karakteristikën i'a kanë dhënë

kupolat dhe harqet me lartësi dhe madhësi të ndryshme. Hamamet edhe pse bëjnë pjesë në grupin e njëjtë me bezistanet me kupolë, për arsye se edhe tek hamamet plani përbëhet prej shumë fushave në formë të katrorëve, me madhësi të ndryshme, sipas vlerës së kompozimit lokal (hamamet) vijjnë menjëherë pas xhamive."

"Sipas arkitekturës më me rëndësi është hyrja në mesin ku gjendet shatërvani. Më tutje vazhdon edhe një lokal tjetër i mbuluar me qemer në trajtë të fuqisë, i cili shërben për zhveshje dhe pushim pas larjes (pastrimit). Lokalet për pastrim janë në formë të katrorëve të mbuluara me kupola të ulëta ashtu sikurse lokalet për zhveshje. Rezervuari i ujit dhe furna janë të ndërtuara në lokalet e skajshme të mbuluar me qemer. Kompozicioni zgjatet kah kupola e vestibulit. Çdo hamam ka pasur shadërvan (garderobë) kapalëk halvati (vend për larje), hazna (rezervoar për ujë), kulhan (vend për ndezjen e zjarrit - furrë)". "Në shek.16 tek ne në çdo qytet ka pasur një ose më shumë hamame. Sipas Evlija Çelebiut vetëm Shkupi kishte mbi 120 xhami dhe 15 hamame".

Ndërsa tyrbet si ajo e Sulltan Muratit në afërsi të Prishtinës, dhe teqetë si ajo e Tetovës, ato të Beratit, Krujës etj. paraqesin një nga realizimet më të mira të arkitekturës islame në Ballkan.

## **XHAMITË MË TË PËRMENDURA NË TERRITORET SHQIPTARE TË TRASHËGUARA NGA E KALUARA DHE ATO TË NDËRTUARA NË SHEK. XX**

Ndër xhamitë më të rëndësishme të ndërtuara në trevat shqiptare, përmenden:

- Xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut (Prishtinë, 1461. Stili dhe arkitektura e saj të habisin me bukurinë e tyre),
- Xhamia e Gazi Isa Beut (Shkup, 1475),
- Xhamia e Mustafa Pashës (Shkup, 1492),
- Xhamia e Mbret (Elbasan, 1492),
- Xhamia e Mbretit (Berat, 1492),
- Xhamia e Mbret (Përmet, 1494/95),
- Xhamia e Imaretit (Ohër, 1493)
- Xhamia Mbret (Shkodër, fundi i shek. XV),
- Xhamia e Tetovës (1495),
- Xhamia e Mirahorit (Korçë, 1494-1504),
- Xhamia e Fetije (Durrës, 1502/1503),

- Xhamia e Jahja Pashës (Shkup, 1504. Një nga më të bukurat e Ballkanit dhe me minarenë më të lartë në këtë gadishull, 55.5 m),
- Xhamia e Is'hak Beut ose Is'hak Çelebisë (Manastir, 1508/1509, një nga më imponantet në Ballkan, me ornamentikën e brendshme të pasur dhe shumë të vlefshme në pikëpamje artistike),
- Xhamia e Varoshit ose e Pazarit (Krujë, 1533/34),
- Xhamia e Muradijes (Vlorë, 1536/38),
- Xhamia e Vjetër ose e Pashallarëve (Vlorë, 1540),
- Xhamia e Plumbit (Berat, 1533-1554)
- Xhamia e Allajbegisë (fshati Burim-Dibër, mesi i shek. XVI),
- Xhamia e Re (Manastir, 1558/59),
- Xhamia e Hajdar Kadisë (Manastir, 1561),
- Xhamia e Gazi Mehmet Pashës (Prizren, 1561),
- Xhamia e Sinan Pashës (Kaçanik, 1594/95),
- Xhamia e Hadunit (Gjakovë, 1595),
- Xhamia e Nazareshës (Rugovë),
- Xhamia e Gjini Aleksit (fshati Rrusanaj, afër Delvinës, fundi ishek. XVII),
- Xhamia e Pirinasit (Prishtinë),

- Xhamia e Mazhiqit (Mitrovicë),
- Xhamia e Ballias (Elbasan, 1605/606)
- Xhamia e Sinan Pashës (Prizren, rreth vitit 1610),
- Xhamia e Sulejman Pashës (Tiranë, 1614),
- Xhamia e Plumbit (Pejë, para vitit 1624),
- Xhamia e Kavajës (1735/36),
- Xhamia e Pazarit (Gjirokastër, 1757),
- Xhamia e Velabishtit (afër Beratit, 1760),
- Xhamia e Plumbit (Shkodër, 1773/74. Ndërtuar nga Mehmet Pashë Bushati),
- Xhamia e Haxhi Ethem Beut (Tiranë, 1794-1821. Një ndër monumentet më të bukura të arkitekturës isalme në Shqipëri),
- Xhamia e Peqinit (1822/23)
- Xhamia e Beqarëve (Berat, 1827) etj.

## **KREU III**

# **SHTYPI PERIODIK FETAR ISLAM SHQIP I SHEKULLIT XX NË TROJET SHQIPTARE DHE NË DIASPORË**

Hulumtimet e bëra për temën në përgjithësi sjellin të dhëna për tërë arsenalin e shtypit mysliman shqiptar.

Meqë ky problem trajtohet për herë të parë, për të dhënë një vizion më të gjerë të shtypit periodik, po hedhim një vështrim panoramik përtej kufijve kohorë të caktuar në studimin tonë.

Nga të 700 gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe të botuara gjatë këtyre dy shekujve, duke nisur që nga "L'Albanese d'Italia" ("Shqiptari i Italisë"-1848) e deri më 1995, një numër i madh i tyre ka qenë tërësisht fetar. Në këtë studim do të trajtojmë edhe ato organe periodike shqiptare që, në një masë të konsiderueshme, në përmbajtjen e tyre kanë trajtuar probleme të mirëfillta fetare.

Shtypi periodik islam shqiptar fillon rregullisht në shekullin XX. Ai zë fill me pavarësinë e Shqipërisë, me krijimin e shtetit të parë shqiptar dhe merr fizionominë e plotë me formimin e Komunitetit Musliman Shqiptar, si institucion vetadministruar me formulimin e statusit të tij.

Komuniteti Musliman, si një organ juridik dhe fetar, kishte rrjetin e tij të shërbimeve fetare dhe të institucioneve fetare në tërë Republikën e Shqipërisë dhe, më vonë në Mbretërinë Shqiptare. Duke pasur nën vartësinë e tij institucione të shumta arsimore fetare, si dhe duke u ndodhur para kërkesave të grupeve intelektuale myslimane, u gjet para domosdoshmërisë së botimit të një organi të mirëfilltë fetar, i cili do t'u bënte tribuna e mendimit islamik shqiptar dhe epiqendra e shtypit mysliman në Shqipëri.

## SHTYPI ISLAM SHQIP NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XX

Gazeta "*Sedai Milet*" ("Zëri i Kombit"), që kishte dalë në Shkodër në vitin 1913, në gjuhën shqipe dhe pjesërisht turqisht, si botim javor, ishte tashmë e kapërcyer. Gjatë dhjetëvjeçarit 1913-1923 ishin rritur shumë kërkesat në drejtim të përmbajtjes së shtypit, të përjashtimit të gjuhëve të huaja, si dhe të një kuptimi të mëtejshëm ndërkonfesional. Ishin këto arsye që kjo gazetë javore ndonse përmbante pjesë nga Kur'ani, nga morali fetar islamik etj., me daljen e organeve të tjera të shtypit, me ngritjen e rrjetit arsimor në vend, niveli i saj ishte kapërcyer. Ajo pushoi së qeni më 1914.

Në vitin 1918 shqiptarët myslimanë të Vaterbarysë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nxorën nëpërmjet shoqërisë fetare muhamedane të kësaj qendre revistën "*Shqipëria*". Ky organ, që qarkulloi në mars të vitit 1918, tregon se shqiptarët ruanin të pacënuar si ndjenjat fetare, ashtu edhe ato kombëtare. Në këtë revistë ne gjejmë artikuj lidhur me vlerat e Kur'anit dhe rolin e këtij libri të shenjtë. Por, fatkeqësisht, revista "*Shqipëria*" doli vetëm në një numër dhe nuk vijoi më.

Një nga gazetat fetare myslimane në gjuhë shqipe, që fitoi autoritet në këto momente, ishte titulluar "*Reforma*". Kjo gazetë doli në Gjirokastrë në tetor të vitit 1921 dhe vazhdoi të botohej deri në vitin 1923. Ajo shtypej në shtypshkronjën shtetërore të Gjirokastrës dhe drejtohej nga personel fetar shqiptar.

Gazeta "*Reforma*" ishte organ dyjavor, por nuk pati jetë të gjatë. Në harkun kohor 1921-23 u botuan vetëm 8 numra të saj. Përveç lëndës fetare, në të pati edhe artikuj me karakter letrar, shoqëror dhe politik, duke tërhequr kështu një numër të konsiderueshëm intelektualësh. Ajo që të bie në sy në përmbajtjen e kësaj gazete është se, përveç temave me karakter fetar, si dhe temave që trajtonin tarikatet, me tolerancë të madhe trajtoi problemin e konsolidimit të shoqërisë shqiptare.

Viti 1923 shënon disa ngjarje me rëndësi në veprimtarinë e Komunitetit Musliman Shqiptar. Në mënyrë të veçantë bëhen përpjekje për hartimin e dokumenteve bazë, të statuteve dhe regulloreve; bëhen përgatitje për të themeluar Medresenë e Përgjithshme me qendër në Tiranë.

Në këtë vit dalin dy të përkohshme: në tetor del në Shkodër e përkohëshmjia "*Udha e s'vërtetës*", që pati për kryeredaktor personalitetin e shquar, juristin dhe burrin e shtetit Hoxha Kadri Prishtinën, kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, dhe revista "*Zani i Naltë*" si organ i Komunitetit Musliman Shqiptar.

E përkohshmjia "*Udha e s'vërtetës*" doli në tetor të vitit 1923. Që në numrin e parë kryeredaktori i saj paraqiti në mënyrë koncize programin e kësaj reviste. Aty përmbledheshin synimet kryesore, të këtij organi si: mësimi i parimeve të thjeshta të fesë, për t'i shpëtuar njerzit prej shkatërrimit të plotë; për të ngjallë në zemrat e tyre ndjenjat e bashkimit për të jetuar tok në shoqërinë bashkëkohore. Aktivizimi i gjithë dijetarëve shqiptarë për t'iu bërë gjymtyrë të dobishme të jetës kombëtare e shoqërore, ishte një nga preokupimet kryesore të programit. Kështu, nënvizohej atje, do t'i japim një impuls zhvillimit mendor të gjithë popullit. Kryeredaktori i saj theksonte se problemet do të shtriheshin dhe në fushë të filozofisë, sociologjisë e të politikës.

Në këtë revistë bashkëpunuan mjaft intelektualë e teologë. Revista botohej nga një komision i posaçëm që quhej "Komisioni i shariatit". Ajo doli vetëm tre numra. Siç dihet, kryeredaktori i saj, i cili luajti një rol të madh në mbrojtjen e të drejtave të Kosovës dhe në demaskimin e politikës jugosllave, vdiq në rrethana të paqarta, por "*Udha e s'vërtetës*" që drejtoi ai la një jehonë të mirë për problemet që shtroi, për qëndrimet që mbajti dhe nivelin e paraqitjes së artikujve.

Revista "*Zani i Naltë*" doli paralelisht me "Udhën e s'vërtetës", në tetor të vitit 1923, por ndërsa "Udha e s'vërtetës" dilte në Shkodër, "Zani i Naltë", organ i Komunitetit Musliman Shqiptar, botohej në Tiranë, ku ishte dhe qendra e këtij komuniteti. Ajo që e përkohshme mujore dhe vazhdoi të qarkullojë nga tetori i vitit 1923 deri në vitin 1938. Gjatë kësaj kohe ajo u drejtua nga personalitete të shquara, me përgatitje të lartë të kulturës dhe shkencave islame, siç qenë: Ismail Maçi, Isa Domni, Haki Sharofi etj.

Destinacioni i revistës ishte fetar, por në përmbajtjen e saj nuk mungonin dhe problemet e filozofisë, të moralit, të literaturës kombëtare dhe të sociologjisë. Gjatë 15 vjetëve të jetës së saj, ajo botoi seri të tëra artikujsh që dëshmojnë një pasuri të tërë kulturore, nëpërmjet së cilës pasqyrohet edhe niveli i mendimit teologjik shqiptar gjatë periudhës së pavarësisë.

Revista "Zani i Naltë" nëpërmjet kryeartikujve të saj, nën titullin e përbashkët "Ç'urdhëron Kur'ani", botoi pjesë nga vazet që mbante Haxhi Vehbi Dibra, personalitet i shquar në fushën e teologjisë dhe komentatori më i mirë i Kur'anit në gjuhën shqipe për kohën e tij. Këto vaze u mbledhën dhe u botuan më vonë në libra të veçantë, duke dhënë kështu një kontribut të shquar, në aspektin didaktik, për imamët e rinj. Autoriteti dhe erudicioni i këtij autori, si njohës i mirë i mendimit teorik islam, e ngriti nivelin e kësaj reviste. Tezat e ndryshme, siç ishin ato "Mbi trupin dhe shpirtin", ai gjen rrugë për t'i interpretuar ato nga ana etike dhe filozofike në kuadrin e besimit islam. Duke folur për trupin, ai thekson se trupi nuk mund të ndahet nga disa qendra nxitëse shpirtërore nëpërmjet të cilave shpërthejnë rrezet e dritës morale. Këto qendra në realitet janë një, por ato shkallëzohen në gjashtë gradë, të cilat përcaktojnë statusin etik të njeriut dhe diferencat e distancave morale midis njeriut dhe Krijuesit. Këto gjashtë qendra autori i shkallëzon: 1. Qendra epshore, 2. e zemrës, 3. shpirtërore, 4. e sekretit, 5. e misterit, 6. e mbimisterit.

Paralelisht me trajtime të kësaj natyre në këtë revistë filluan të botohen edhe tema të fushave me karakter laik, por gjithmonë brenda kuadrit të botëkuptimit islamik. Kështu, për shembull, në faqet e kësaj reviste gjejmë të shtjelluar tema si: "Njeriu dhe feja", "Danteja dhe Islamizma", "Teori të reja", "Kozmografia tej kaosit", "Idealizmi e Materializmi", "Teoria e planetizmit", "Pavdekësia e njeriut", "Njeriu dhe gjithësia", "Edukata moderne" etj .

Artikujt e kësaj natyre me të dhënat që shtronin dhe arsyetimet që bënin, duke u mbështetur në versetet Kur'anore dhe hadithet, synonin të formonin një botëkuptim islamik bashkëkohor rreth kategorive kryesore të moralit islam, të filozofisë islame, të edukatës islame, të qytetërimit islam dhe të bindjeve islame në përgjithësi, duke krijuar kështu barrikadën kundër ideologjisë komuniste, që po depërtonte dita ditës në Shqipëri.

Në revistë përfshiheshin edhe rubrika me të dhëna rreth historisë së kaluar dhe gjendjes së atëhershme të islamizmit nëpër botë. Me këto revista synohej mbajtja gjallë e lidhjeve shpirtërore të muslimanëve me vëllezërit e mbi një miliard idhtarësh të botës islame. Duke u shoqëruar dhe me shifra, e ngandonjëherë edhe me ilustrime, duke botuar herë pas here përkthime nga shtypi islamik botëror, synohej që brezi i ri të njihet me qytetërimin islam, me ndihmesat që ky i ka dhënë qytetërimit botëror e sidomos me njohjen e të rinjve me arritjet bashkëkohore të islamizmit nëpër botë.

Revista, në kuadrin e rubrikave që hapi gjatë jetës së saj, përfshiu edhe tribunen e diskutimeve dhe të polemikave. Kjo imponohej nga rrethanat historike në përgjithësi dhe gjendja sociale që kalonte Shqipëria dhe, në mënyrë të veçantë, nga problemet emergjente që i dilnin përpara shoqërisë shqiptare të cilat kryesisht ishin: problemi i arsimit dhe i edukimit laik e fetar, i mësimin të fesë në shkollat shtetërore, i statusit të gruas shqiptare në shoqëri dhe familje etj.

Një nga këto polemika, në të cilën morën pjesë edhe mjaft klerikë, që ajo e zhvilluar lidhur me problemet e organizimit të rrjetit arsimor fetar, veçanërisht medreseve në Shqipëri. Personaliteti i njohur në fushën e kulturës fetare, ish senatori shqiptar dhe poliglot i gjuhëve të Lindjes e të Perëndimit, Sali Vuçiterni, duke dashur të sillte një formë të re organizimi në medrese, ishte i pikëpamjes së konsolidimit të Medresesë së Përgjithshme të Tiranës. Në këtë pikëpamje, të cilën ai e bëri të njohur botërisht, u ndesh me përfaqësuesit e klerit mysliman shqiptar në rrethe, që kishin mbetur prapa si nga mendësia ashtu edhe nga kultura.

Sali Vuçiterni shtroi mendimin e ngritjes së sistemit arsimor fetar shqiptar mbi bazën e dy medreseve të konsoliduara, dhe jo mbi bazën e një numri të pakufizuar medresesh, që s'kishin mundësi as të ndihmoheshin e as të kontrolloheshin. Ai që për ngritjen e një medreseje në Veri të Shqipërisë me qendër në Shkodër dhe të një medreseje të përgjithshme me qendër në Tiranë, me nivel mbi arsimin e mesëm. i parë në këtë optikë, problemi i medreseve donte të thoshte heqje dorë nga mësonjëtoret gjysmëprivate, që punonin pa programe, pa plane mësimore dhe që drejtoheshin nga hoxhallarë mësimdhënës pa përgatitjen që kërkonte koha. Drejtuesit e këtyre medreseve (në shumicën e rasteve me një mësues të vetëm), të lidhur ngushtë me interesat e tyre ekonomike vetjake, që nuk azhornoheshin me përparimet dhe arritjet e arsimit në përgjithësi, iu kundërvunë pa parim, duke zhvilluar një polemikë të ashpër të paargumentuar dhe kryeneçe, gjë që vinte në pah prapambetjen e tyre. Më vonë revista zhvilloi polemika edhe me organe të tjera të shtypit, që denigronin botëkuptimin islamik.

Në revistën "Zani i Naltë" bashkëpunuan personalitete të shquara, siç qenë H.Vehbi Dibra, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Korça, Sali Vuçiterni, Haki Sharofi, Mehdi Frashëri, Mit'hat Frashëri (Lumo Skëndo), Ismet Dibra, Ferid Vokopola etj.

Duke përshkruar kontributin e kësaj reviste gjatë 15 vjetëve të jetës së saj, Magjistër Sherafedin Hoxha afirmon se ajo pati një rëndësi shumë të madhe në edukimin fetar musliman të popullatës shqiptare, kultivoi ndjenjat e patriotizmit dhe të ngritjes kulturore arsimore, perkrahu ecurinë e përparimit të përgjithshëm kombëtar, kultivoi ndjenjat e zhvillimit arsimor dhe nxiti procese të tjera civilizuese. Ai organ shtypi kultivoi tolerancën ndërmjet besimeve fetare të shqiptarëve, duke insistuar që kombi shqiptar është një, në harmoni me besimet fetare. "Për këtë shkak, shkruan ai, mund të themi se kjo revistë është nga më të përparuarat organe fetare që dolën në gjuhën shqipe... Ajo me të vërtetë zë vend të merituar jo vetëm në historinë e gazetarisë shqiptare, por edhe në historinë kulturore të popullit shqiptar në përgjithësi".

Gati 13 vjet pas "Zani i Naltë", një revistë tjetër myslimane me titull "*Drita*" u botua në kontinentin aziatik, në Lahorë të Indisë. Kjo revistë u përgatit dhe u botua nga studentët shqiptarë, që studionin në universitetin teologjik të Lahores. Në krye të grupit redaktues të këtij organi, numri i parë i së cilës doli në janar 1936, qëndronte studenti Sherif Putra.

Sherif Putra, i cili kishte kryer studimet në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës, ishte shquar që atëherë për shkrimet e tij e sidomos për përkthimet e bëra nga gjuha angleze dhe arabe. Revista, në 32 faqe, vazhdoi në 8 numra dhe pati jehonë jo vetëm në mjediset studentore shqiptare të Lahores së asaj kohe, por edhe më tutje.

Në fillim të Luftës së Dytë Botërore gjendja dhe harta politike e Shqipërisë, si edhe e shumë shteteve të tjera, ndryshoi. Me situatat e reja lindën edhe interesa të reja. Në këto kushte, mosdalja më e "Zanit të Naltë" krijoi një boshllëk të madh. Një organ i ri fetar, do të plotësonte nevojat e kohës për edukimin fetar dhe patriotik njëkohësisht. Por mbi të gjitha kjo revistë e re duhej të plotësonte nevojat imediate

që kishin lindur me ndryshimin e kufijve dhe lirinë më të madhe që kishte fituar popullsia shqiptare e zonave të Kosovës.

Në këto kushte, më 1940, doli revista "*Kultura Islame*", e përmuajshme, fetare, letrare, diturore, artistike, organ i Komunitetit Musliman Shqiptar. Revista në fjalë kishte në krye të saj dy nga përfaqësuesit më të rinj të kulturës islame, që kishin kryer studimet e larta teologjike në Egjipt (El Az'har) dhe në Lahorë të Indisë, përkatësisht Sadik Bega, drejtor përgjegjës dhe Sherif Putra, redaktor.

Stafi drejtues i kësaj reviste u përpoq të sigurojë një numër bashkëpunëtorësh, sidomos të rinj universitarë me prirje islamike dhe të talentuar në fusha të ndryshme. Kështu, krahas firmave të vjetra, si Hafiz Ali Korça, Dr.Bexhet Shapati, Haki Sharofi etj, në faqet e kësaj reviste filluan të duken firma të reja, si Sadik Bega, Vexhi Buharaja, Sherif Putra, Asim Lohja, Jup Kastrati, Shefik Osmani, Muhamed Bala, Besim Levonja e të tjerë. Në mes tyre shquhen edhe shkrimtaret e reja si J.Kodra, Postribsja etj. Një numër i madh intelektualësh, bashkëpunëtorë të kësaj reviste, për motive të ndryshme shkruajtën me pseudonime. Revista "*Kultura islame*" vazhdoi të dalë deri në vitin 1944.

E parë në kuadrin e përmbajtjes, "*Kultura Islame*" ishte vazhdim i "*Zanit të Naltë*", por me një vizion më të gjerë se i pari. Ndonëse i bëri vend gjuhës italiane në ndonjë faqe të saj, si dhe ndonjë artikulli "*flirtues*" me fashizmin, ajo u përpoq të ruaje fizionominë patriotike pararendëse të saj. Gjuha që përdori ajo dhe problemet që shtroi në tryezën e diskutimit krijuan mjedise joshëse për intelektualët myslimanë.

Në faqet e saj u trajtuan edhe probleme me karakter teorik e studimor si: "*Hyrje në filozofinë islame*", një studim ky i gjerë që vazhdoi në disa numra. Edhe studimi tjetër me karakter monografik "*Përhapja e islamizmit*", u botua në disa numra. Në aspektin moral teologjik e filozofik u trajtuan tema, siç qe p.sh.

"Problemi i së mirës dhe i së keqes", kategori filozofiko-morale këto, që kanë qenë objekt diskutimi për shumë doktrina. Shtjellimi i kësaj teme u bë mbi bazën e tezave të: "Masës së ligjit të evolucionit", "Moralit dhe epsheve në mase", "Para vendimit ose fatit". Po ashtu, në këtë revistë u botuan edhe studime nga fusha e arteve dhe e historisë, siç qenë "Kuptimi i artit dhe kufijtë e tij", "Shkrimtarët fetaro-letrarë muslimanë të Shqipërisë", "Historia e bibliotekave" etj.

Në korrik të vitit 1942 në Tiranë filloi publikimi i një të perkohshmëje të re me orientim fetar, që mbante titullin "*Njeriu*". Që në faqen e parë kjo revistë percaktonte orientimin e saj si e përmuajshme shpirtërore, kulturore.

Revista "*Njeriu*" ishte organ i organizatës "Drita Hyjnore". Në përmbajtjen e këtij organi bashkohet trajtimi teorik me atë praktik, ana filozofike me atë divulgative. Në qendër të tij është misticizmi. Redaksia e kësaj reviste e përcakton kështu thelbin teorik të saj: "Misticizmi, që ka caq karakteristika të ngjashme, është udha e përbashkët prej se cilës kanë lindur pohimet e mëdha të së vërtetës dhe është pikëmbështetja që duhet të përmbledhë të gjithë ata që dëshirojnë me ba vepra bamirëse, mirëkuptimi, dashurie dhe durimi. Vetëm me pastërtinë e vetëmohimin e një mistiku të përsosur mund të sigurohet shumë shpejt naltësimi i njeriut, duke përshkruar rrugët e gjithë idealeve që pajtohen me qëllimin suprem të jetës njerëzore".

Njeriu, që ka për titull kjo revistë, quhet misteri i mistereve, krijesë e zgjedhur në mes krijesave të Perëndisë, krijesë e vogël, por dhe viganë, e vetmja ndër të tjera që natyra t'i ketë lejuar të depërtojnë në ligjet e saj të fshehta, qenie që përmbledh në vetvete të mbaruarën e të pambaruarën.

Që në numrin e parë të kësaj reviste u shfaqën firma të njohura të potencialit intelektual shqiptar, si: poeti e filozofi Ferid Vokopola, shkrimtari Haki Stërmilli, avokati e poeti Kristo Floqi, studjuesi Vasfi

Sami Visoka, prof. V. Demiraj, Filip Ndocaj, Beqir Haçi, Prof L. Eftimiadhi, Vexhi Buharaja etj. Në faqet e saj u botuan dhe shkrime të Fan Nolit, Faik Konicës, Lasgush Poradecit, Lumo Skëndos etj. "Njeriu" u bëri vend edhe firmave të reja si: Suat Haxhit, Mustafa Greblleshit, Shefik Osmanit, Jup Kastratit etj.

Kjo revistë vazhdoi botimin e saj deri në vitin 1944 me gjithsej 27 numra.

Në vitin 1942 qarkulloi edhe një revistë tjetër me titull "*Drita Hyjnore*", por ajo pati jetë të shkurtër.

## **SHTYPI ISLAM NË GJUHËN SHQIPE PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Qëndrimi i heshtur, mospërfillës dhe mohues ndaj shtypit fetar islam, që mbajtën për gati 50 vjet disa studiues të historisë dhe letërsisë shqipe është i papërligjshëm, për disa arsye: Së pari, se ai përfaqësohej me një numër të konsiderueshëm periodikësh. Së dyti, se ai fliste në emër të më se 88 % të popullsisë. Së treti, ai shtronte, krahas problemeve fetare, edhe ato sociale, kulturore dhe arsimore.

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, ku jetonin rreth tre milionë shqiptarë, si dhe në Greqi, ku kishte një numër të madh shqiptarësh myslimanë, që banonin kryesisht në troje të veta në Çameri, problemi i ushtrimit të fesë, i mbajtjes së faltoreve, i organizimit të edukatës fetare dhe i botimit të shtypit me

karakter fetar, ka pasur format dhe përmbajtjet e veta, sipas kushteve të varura plotësisht nga zhvillimet politike të ngjarjeve.

Në vendet ku u vendos pushteti komunist, siç qenë: Republika Popullore e Shqipërisë dhe RFSJ lufta antifetare kaloi në sistem. Në RFSJ tehu i politikës ndaj shqiptarëve u drejtua më tepër ndaj formave për shkombëtarizimin e tyre. Ateizmi i propaganduar nga ata synonte pikërisht këtë qëllim. Edhe ndonjë lëshim që u bë në problemet e ushtrimit të fesë synonte lënien në errësi të shqiptarëve.

Megjithatë, përsa i përket çështjes së fesë, shtrëngimet më të mëdha qenë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila luftën kundër fesë e zhvilloi në kundërshtim me kushtetutën e vitit 1946 dhe më 1977 e përfshiu edhe në kushtetutë. Në Shqipëri filloi një luftë e organizuar antifetare deri në goditje shumë të fuqishme. Në truallin amë të shqiptarëve në menyrë të organizuar, në emër të nismave të rinisë, u sheshuan me qindra faltore, institucione kulti, një pjesë e të cilave ishin dhe monumente kulture. Me këtë rast u shkatërruan xhami, teqe, tyrbe etj., duke humbur kështu dokumente, dorëshkrime e vepra të tjera me rëndësi të madhe historike, nën etiketën se ishin fetare e shkruar me alfabetin arab. Këto akte u kurorëzuan me hapjen e muzeut ateist. Anarkizmi dhe injoranca e këtij veprimi vinte nga mendësia komuniste se çdo gjë fetare duhej zhdukur, për t'u zëvendësuar me ideologjinë komuniste.

Po kështu edhe në territorin e Çamërisë, që përfshihet brenda kufijve të shtetit grek, megjithëqë Greqia është një shtet teokratik, ku feja ortodokse respektohet, çdo gjë fetare në gjuhën shqipe ishte e pamundur të botohej. Motivet e këtyre pengesave njihen. Gjuha shqipe dhe besimi islam do të nxisnin gjallërimin e elementit mysliman, bashkimin e tyre në një komunitet të organizuar, si dhe ngjalljen e ndjenjave patriotike. E tërë popullata çame mbeti e privuar në këtë drejtim.

Shtypi periodik me përmbajtje fetare pati mundësi zhvillimi vetëm në diasporë dhe në RFSJ, ku jetojnë rreth tre milionë shqiptarë, në shumicën dërrmuese myslimane dhe me tradita fetare islamike, të cilët, duke shfrytëzuar disa hapësira kushtetuese, arritën të bëjnë disa botime, që e mbajten gjallë bashkësinë islame në atë vend.

Fillimisht menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore botimi i shtypit fetar periodik i përket diasporës. Në SHBA filloi të botohej revista fetare-kulturore "*Jeta muslimane shqiptare*", numri i parë i së cilës doli më 1950 në Detroit. Revista ishte organ i shoqërisë muslimane që drejtohej nga Imam Vehbi Ismaili, publicist i njohur i literatures me karakter fetar; dhe dy nëndrejtorët: R.Xh. Gurazezin dhe Ahmet Ramon.

Revista dilte tri herë në vit. Paraqitja e saj teknikisht ishte e nivelit të lartë. Gjithashtu përmbajtja ishte mjaft e larmishme. Kjo revistë botohej në dy gjuhë, paraprihej nga artikuj në gjuhën shqipe dhe pasohej nga artikuj të tjerë në gjuhën angleze.

Përfshirja në revistë e temave me karakter studimor dhe historik i dhanë asaj një fizionomi shkencore këtij organi. Revista "*Jeta muslimane shqiptare*" luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e unitetit të shqiptarëve të SHBA-së dhe, në të njëjtën kohë, dëshmonte se bashkësia islame shqiptare përfaqësonte një bërthamë të shëndoshë.

Diaspora islamike shqiptare e SHBA-së u aktivizua në botimin e fletoreve dhe të revistave në gjuhën shqipe me qëllim që të konsolidonte të bashkatdhetarët shqiptarë besimin islam në kushtet e shoqërisë amerikane, pra të një shoqërie shumë të përparuar.

Duke filluar që nga viti 1971, shqiptarët e Amerikës filluan botimin e një reviste tjetër me titull "*Perpjekja jonë*" (e cila vazhdon të qarkullojë) me një paraqitje elegante në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe me

vëllim mbi 200 faqe. Revista është e pajisur me ilustrime. Ajo është pronë e Këshillit të Qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane. Ne na ka rënë në dorë një pjesë e tirazhit të kësaj reviste. Kemi konsultuar vetëm vëllimet X-XIV të viteve 1981-1989. "Përpyekja jonë" botohet në New York, New Jersey (ShBA). Ajo ka për editor Qamil Mujën.

Në vitet '60 Shoqata e Ulemave në Prishtinë botoi për herë të parë "*Buletinin informativ*" në dy gjuhë: serbokroatisht dhe shqip. Megjithëse përmbajtja e këtij buletini është e varfër, ai përmban vlera, sepse i priu edicioneve të mëvonshme, siç janë "Takvim - kalendari" (1968), "Edukata Islame" (1971), "Nuru-l-Kur'an" (1975), "Ditura Islame"(1986), "El Hilal" (1987), "Hu" dhe "Dervish" (1897), pa përmendur këtu revistat që filluan të dalin në periudhën pas komuniste, kur feja u la e lirë në Shqipëri, në Republikën ish -Jugosllave të Maqedonisë, në Mal të Zi, në Republikën e Kosovës etj.

Buletini "*Takvim - kalendar*" doli pothuajse njëkohësisht në Shkup (1967) dhe në Prishtinë (1970). Takvimi i Shkupit u botua nga Shoqata "Ilmije" e Bashkësisë së fesë Islame në Shkup, në të dy gjuhët: turqisht dhe shqip, kurse Takvimi i Prishtinës u botua në gjuhën shqipe nga Shoqata e Ulemave të Prishtinës. Të dy këto takvime patën të përbashkët pjesën kalendarike, ndërsa pjesa tjetër kishte diferenca. Në këtë pjesë përfshihen tema të ndryshme me karakter edukativ-fetar dhe historiko-kulturor.

Kalendari "Takvim" i Prishtinës drejtohej nga Hajrullah Hoxha, i cili i dha atij, me kalimin e kohës, formën e një kalendari kombëtar të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare, por natyrisht me drejtim kulturor islam. Në përmbajtjen e këtij buletini u botuan dhe mjaft artikuj me interesa më të gjëra.

Në vitet '70 me fitoren e statusit të krahinës Autonome botimet në gjuhën shqipe në Kosovë kishin arritur suksese të medha. Arsimi laik në gjuhën shqipe kishte ecur shumë përpara, në fushën e letërsisë

kishin filluar të lëvroheshin gjini të ndryshme. Vetëm përkundër zhvillimeve të mësipërme shtypi fetar kishte mbetur prapa, megjithëqë pjesa dërrmuese e popullatës ishte myslimane dhe besimtarë, për të mos thënë fanatikë. Në këto rrethana shtrohej si domosdoshmëri krijimi i shtypit fetar islamik i nivelit bashkëkohor.

Një vit më pas (1971) doli në qarkullim edhe revista "*Edukata Islame*", organ i Këshillit të Ulemave të Prishtinës e drejtuar nga Hajrullah Hoxha. Në këtë mënyrë, shtypit në gjuhën shqipe iu shtuan dy organe fetare: njëri njëvjetor dhe tjetri tremujor.

Shtimi i radhëve të intelektualëve kosovarë, dibranë etj., që mbaronin shkollat e larta dhe që kishin bindje islamike, rritën mundësitë për përhapjen e fjalës së shkruar islame, duke mbushur zbrastësinë ekzistuese. Në këto momente, kalendari "*Takvim*" dhe "*Edukata Islame*" e pasuruan përmbajtjen e tyre duke trajtuar një larmi temash, të cilat ngritën vetëdijen islame në nivele të reja. "*Edukata Islame*" trajton tema nga fusha e islamistikës, historisë, kulturës dhe e informatikës. Në të kanë shkruar pena të nohura si: Sherif Ahmeti, Nexhat Ibrahim, Bajrush Ahmeti, Hajrulla Hoxha etj.

Megjithatë ato ishin të pamjaftueshme për të përballuar ndikimin ateist që vinte nga Shqipëria dhe propagandën sllave që denigronte vazhdimisht fenë islame. Në këto rrethana, medresesë "*Alaudin*" të Prishtinës i dilte një detyrë e madhe për t'u çelur shteg diskutimeve dhe për t'u hapur horizont studentëve me anën e fjalës së shkruar në gjuhën shqipe. Viti 1975 shënon daljen e numrit të revistës "*Nur-ul-Kur'an*", organ i shoqatës së nxënësve të kësaj medreseje. Më vonë ky organ merr emrin "*Drita e Kur'anit*". Këtu trajtohen tema në lëmin e shariatit, historisë islame, kulturës, letërsisë dhe informatikës.

Dalja e këtyre organeve përgatiti terrenin për botimin e një reviste fetare, kulturore e shkencore me përmasa më të mëdha - "*Dituria Islame*". Dalja e kësaj reviste, numri i parë i së cilës doli në qershor 1986,

u bë e mundur dhe nga fakti se shumë veta që kishin kryer studimet e larta teologjike në Kajro, Bagdad, Sarajevë, tashmë kishin kërkesa të reja. Revista ishte e përmuajshme. Ajo e nisi jetën e vet me trajtimin e disiplinave fetare islame, të studimeve me karakter filozofik dhe shkencor. në faqet e saj gjetën vend përthime nga literatura klasike islame, dhe rubrika polemizuese. Në të shpalosen fakte, dukuri dhe dokumente të reja me rëndësi historike për fatet e islamit në Kosovë e gjetkë. Revistën e boton Meshihati i Bashkësise Islame në Prishtinë.

Me interes është botimi në faqet e kësaj reviste i veprës madhore të Sami Frasherit "Kamus Al-a'lam" (Enciklopedia e historisë dhe e gjeografisë). Me kohë, tematika e materialeve që kishte karakter informativ profesional e teologjik të specializuar, filloi të ndikojë ndjeshëm në kultivimin e traditës në fushën e moralit e të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Kështu artikujt e: H.Ibrahim Dalliu "Injoranca nuk zhduket me top", të Ibrahim Hasnajt, Edith Durham "Brenja e Ballkanit" dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët", të Dr.Hakif Bajramit "Krimet dhe kriminelët në peshojën e ndërgjegjës njerëzore", të Mr. Hamdi Thaçit "Shqiptarët në Libi", S. Frashëri "Për rolin dhe pozitën e femrës në familje e në shoqëri" etj, nxjerrin në pah dëshirën e popullit të mençur shqiptar për bashkimin e viseve shqiptare. Edukimi fetar e patriotik i tyre do të bëhet themel i Shqipërisë etnike e demokratike.

Rreth kësaj reviste u tubuan personalitete të shquara si të kulturës shqiptare, ashtu edhe asaj islamike si: Përktihyesi i Kur'anit Sherif Ahmeti, Nexhat Ibrahim, Dr.Muhamet Pirraku, Vehbi Ismaili, Prof.Dr.Gazmend Shpuza, Dr.Skëndër Riza, Mentor Çoku, Hysen Gjozo, Dr.Kristaq Prifti, Dr.Ali Iljazi, Mehmet Halimi, Idriz Vuçiterma, Dr.Hakif Bajrami, Prof.Iljaz Rexha, Mr.Qemajl Morina etj.

Në Republikën e Maqedonisë, duke filluar nga viti 1987 filloi të qarkullojë gazeta "*El-Hilal*", në tri gjuhë: serbokroatisht - shqip dhe turqisht. Kjo gazetë ishte dymujore dhe botohej në Shkup. Ajo trajtonte tema shkencore, kulturore, filozofike dhe historike me përmbajtje islame. Botimi i kësaj gazete

sensibilizoi publikun shqiptar autokton të Maqedonisë, i cili duke i shtuar interesat e tij për problemet e trajtuara në këtë organ, krijoi kushtet e një botimi krejtësisht në gjuhën shqipe. Kjo gazetë u zëvendësua nga gazeta kulturore - informative islame "*Hëna e re*". Ajo ka një vëllim prej 32 faqesh, për çdo numër.

Në Kosovë gjeti dritën e botimit edhe një revistë tjetër, organ i bashkësise së dervishëve të Kosovës, "*HU*", e cila për dhjetë vjet me radhë dha një kontribut të ndjeshëm në fushën e studimeve të islamistikës. Në korrik të vitit 1987 doli organi tjetër periodik i kësaj bashkësie me titullin "*Dervish*", që botohej si organ i shoqatës së Meshajihëve të Kosovës në Prizren. Kryeredaktori i saj qe Haxhi Sheh Xhemali.

Në periudhën post-komuniste, bashkë me reformat demokratizuese dhe me hartimin e kushtetutave të reja u krijuan kushte për botimin e organeve fetare si në Shqipëri, ashtu edhe në Mal të Zi, Maqedoni dhe në Kosovë.

Në Shqipëri u riorganizua, pas një gjysmë shekulli, bashkësia islame ose Komuniteti Musliman Shqiptar, me një organikë të veçantë, në përbërjen e së cilës përfshihej edhe redaksia e gazetës "*Drita Islame*". Ky organ dyjavor i këtij Komuniteti, filloi të qarkullojë nga viti 1992, nën maksimën "Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr". Organi "*Drita Islame*" ka për kryeredaktor Ismail Muçën. Në rubrikat e saj gazeta trajton probleme që kanë të bëjnë me njohjen e islamit në tërësi, si dhe artikuj të tjerë me karakter historik për figurat e shquara shqiptare islame, kronika nga ngjarjet e vendit etj. Në kuadër të zgjerimit të horizontit kulturor, kohë pas kohe, botohen në këtë organ edhe aspekte nga veprimtaria e dietarëve islam të kohës së kaluar dhe bashkëkohore.

Nën mbikqyrjen e Organizatës së Bashkimit të Rinisë Islame Shqiptare dhe të bibliotekës "Mbarësia", në Shqipëri dolën edhe disa organe, të cilat i dhanë mundësi të rinjve dhe të rejave për të shprehur dëshirën e tyre të zjarrtë dhe dashurinë për fenë, gjë që u ndalua për dekada me radhë.

Kështu më 19.12.1991 botohet numri i parë i organit të Bashkimit të Rinisë Islame Shqiptare "*Shkëlqimi Islam*" i cili mori moto të veten thënie: "Dashuria për Atdheun rrjedh nga besimi". Nga kjo organizatë rinore u inicuan dhe dy organe të tjera: në Shkodër "*Triumfi Islam*" dhe në Pogradec "*Morali Islam*". "Shoqata Rinia dhe Kultura Islame" nxori dy numra të një reviste me titull: "*Logjika Islame*", ndërsa një organ i pavarur "*Ura e Siratit*", deri në fund të 1994, arriti të nxjerrë 6 numra me karakter fetar, kulturor dhe social.

Duke filluar nga dhjetori i vitit 1995 Komuniteti Bektashian Shqiptar filloi botimin e një reviste me titull "*Urtësia*"- revistë fetare shoqërore artistike. Revista ka siguruar një numër të konsiderueshëm bashkëpunëtorësh. Në rubrikat e kësaj reviste ka artikuj me interes për historinë e bektashizmit, i cili thuhet se është përhapur apo ka hyrë në Shqipëri në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Me interes paraqitet rubrika "Fjalori enciklopedik" i botuar në faqet e saj.

Gjatë periudhës 1991-93 qarkulluan edhe disa fletushka, në përmbajtjen e të cilave kishte artikuj propagandistikë të karakterit gazetaresk dhe në disa raste të nxitjes së polemikave pa vend.

Problemet islamike gjatë kësaj periudhe ishin shumë të mprehta, kryesisht ato kishin të bënin me problemin e konsolidimit të fesë islame në Shqipëri, me problemet e përbashkëta fetare dhe kombëtare, të lidhura me mbrojtjen nga konvertimet e organizuara antishqiptare, me problemin e arsimimit të gruas islame shqiptare, kulturimin e saj, pjesëmarrjen në jetën aktive të vendit, në bazë të parimeve islame, etj.

Përkundër këtyre kërkesave imperative, disa nga këto fletushka shtronin problemin e kthimit prapa të gruas shqiptare, e veçimin e saj nga jeta aktive, shtronin "probleme" të luftës ndërintelektuale ose të ofendimeve jashtë gjuhës intelektuale, gjëra këto që shkaktojnë ndeshje dhe trazira artificiale.

Është e kuptueshme që islamizmi nuk ka asgjë të përbashkët me këto pikëpamje, mendime dhe qëndrimejashtë çdo etike njerzore. Shtypi periodik islamik shqiptar, duke iu përmbajtur frymës së humanizmit, trashëgon traditat më të mira të lëna nga paraardhësit e tij, siç ishin revistat "Zani i Naltë" dhe "Kultura Islame". Ai synon ta farkëtojë bashkimin kombëtar në frymën e mësimave të Kur'anit, duke mos lejuar që institucionet e huaja fetare joislamike të luftojnë për eliminimin e islamizmit në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, duke iu përmbajtur mendimit të shëndoshë, synon të luftojë kundër rrymave ekstremiste që, në emër të Islamit, kërkojnë t'i fryjnë zjarrit për ndasi fetare e kombëtare.

Publikime në formën e fletushkave janë bërë edhe në gjuhë të huaja, siç është p.sh. *"Islam in Albania"*, e botuar në gjuhën angleze (mars 1994).

Shtypi islam në gjuhën shqipe njohu zhvillime të reja edhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë dhe në Mal të Zi. Në Shkup, duke filluar nga maji i vitit 1987, filloi të botohej gazeta *"El-Hilal"*, "Revistë për çështje islame dhe informative" në 18 faqe. Gazeta botohej si organ i Bashkësisë Islame të Shkupit, në tri gjuhë: maqedonisht,shqip dhe turqisht.

Në faqet e saj gazeta ekspozoi tema kryesisht të karakterit fetar, me një diapazon të gjerë,duke përkthyer edhe autorë bashkëkohorë. Por në të nuk munguan edhe artikuj të tjerë me përmbajtje nga historia e kulturës islame, e monumenteve të kulturës së saj, e institucioneve islamike në Maqedoni, si dhe genocidi jugosllav kundër elementit shqiptar islam dhe monumenteve etnike të tyre.

Me vonë (1987) kjo gazetë u zëvendësua nga gazeta "*Hëna e Re*" në gjuhën shqipe. Gazeta fillimisht kishte 24 faqe dhe dilte me një tirazh prej 6000 kopjesh, ndërsa aktualisht ajo ka një vëllim prej 32 faqesh. Perveç artikujve dhe informacioneve me karakter fetar, në këtë gazetë botohen kohë pas kohe edhe artikuj me karakter shkencor, që përmbajnë elemente të reja dhe fakte të panjohura nga historiografia e mëparshme, qoftë monarkike, qoftë edhe komuniste. Artikuj të tilla janë "Shkupi në tregimet udhëpershkuese të shekullit XVII" të autorit B.Shehapi, "Monedhat e Ilirisë Jugore" të autorit H.Osmani, "Botimet islame shqiptare" të autorit Dr.Feti Mehdiu, "Shkolla më e vjetër në Ballkan" e N.Ahmetit," Rexhep Voka dhe rilindësit" e V.Bexhetit, "Islami fe universale" e N.Ibrahimit, "Veprimtaria kulturore e Said Najdenit" e Mr.Nexhat Abazit. Në këtë gazetë bashkëpunuan dhe autorë nga Kosova, Shqipëria, nga Bosnje-Hercegovina, si edhe nga bota islame.

Me artikujt e saj kjo gazetë ndikoi në sensibilizimin e masës islame shqiptare të Maqedonisë për të shtuar njohuritë e tyre mbi islamin dhe botën islame në përgjithësi. Ajo luajti një rol të veçantë në formimin e ndërgjegjes kombëtare, në mënyrë të veçantë lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe, në shtypin islamik.

Krahas gazetës "*Hëna e Re*", filloi të botohej edhe një organ i Shoqatës së nxënësve të Shkollës së Mesme Islamike "*Medreseja Isa Beu*" me titullin "*Ikere*", në 30 faqe, në gjuhët shqip,turqisht dhe maqedonisht. Përmbajtja e revistës është krejtësisht fetare. Gati 2/3 e revistës janë në gjuhën shqipe.

Duke filluar nga janari 1993 filloi të botohej revista kulturore islame "*Nuri*" në gjuhën shqipe në 80 faqe. Kjo revistë ka për drejtor Gh.Vefai. Sipas programit të saj revista synon perhapjen e kulturës, kontaktin dhe këmbimin e mendimeve kulturore, të civilizimit dhe të mendimit islam, paraqitjen e kulturës së lashtë iraniane, paraqitjen e së vertetës historike dhe shkoqitjen historike të mendimit

filozofik, njohjen e vlerave shpirtërore të religjioneve dhe të mendimit njerëzor, si dhe kontaktin me intelektualë dhe shkencëtarë. Deri në qershor 1994 kanë dalë gjithsej katër numra.

Në Republikën e Pavarur të Kosovës, pas Shpalljes së saj, përveç revistave "Dituria Islame", "Edukata Islame" dhe "Takvimi", filloi të botohej dhe revista "*Bashkimi paqësor*", organ i shoqatës "Bashkimi", me seli në Prishtinë. Revista ka 16 faqe dhe si synim të saj ka trajtimin e problemeve edukative - arsimore, kulturore dhe mirëbërëse. Revista i shtjellon temat e saj në aspektin bashkëkohor duke i bërë jehonë, në mënyrë të veçantë, problemeve aktuale, duke sensibilizuar kështu opinionin masiv. Në faqet e kësaj reviste kanë gjetur trajtim tema të tilla si "Sulmet ndaj arsimit shqip në Kosovë", "Gjendja e hapësirës gjuhësore e kulturore të Kosovës", "Shqiptaret dhe pluralizmi" etj.

Gjithashtu në Prishtinë filloi të qarkullojë edhe një revistë e re "*Drita e Kur'anit*", organi i nxënësve të Medresesë së Mesme "Alauddin".

Në janar të vitit 1993 qarkulloi edhe një gazetë në 8 faqe me titull "*Kompaktësia-Ittifik*", organ i Shoqatës Edukativo-arsimore-kulturore "Bashkimi" me qendër në Prishtinë. Gazeta doli në tri gjuhë: shqip, turqisht dhe serbisht. Ajo ka karakter kryesisht informativ.

Era e demokracisë, që nga viti 1990 përshkoi tërë vendet e Lindjes, u ndje edhe në territorin e Malit të Zi, ku banojnë disa dhjetëra mijë shqiptarë. Prej gati më se një shekulli shqiptarët e atyshëm nuk kishin pasur të drejtë të ushtronin gjuhën e tyre shqipe në shkolla dhe as ta shkruanin atë në libra fetare. Hfz. Ali Ulqinaku nga Ulqini, i cili kishte shkruar mevludin shqip, u detyrua ta botojë atë në Shqipëri. Institucionet e kultit u penguan në çdo rast që të mirëmbaheshin, kështu p.sh. xhamia e Osmanagës, në Stari Varosh, e njohur nga autoritetet malazeze si xhamia e Osmanagiqve, u shkatërrua dhe fondet e mbledhura nga populli për ristrukturimin e saj u përvetësuan nga Banka Jugosllave.

Xhamia e Osman Agës në Podgoricë, Mal të Zi

Duke filluar nga viti 1990 e deri më 1992 u bë i mundur qarkullimi, në Mal të Zi, i të parës gazetë dymujore në gjuhën serbe dhe shqipe me titull "*Elij*" ("Fjala"). Gazeta u botua në Podgoricë dhe pati si kryeredaktor Idriz Demirin. Gjithsej nga kjo gazetë kanë dalë 16 numra. Ky organ, ka synuar edukimin fetar islamik të masave muslimane të Malit të Zi (shqiptare, sllavofone dhe turkofone) si dhe evidentimin e traditës kulturore të banorëve muslimanë të këtyre trojeve, gërshtuar me problemet aktuale fetare e social - kulturore. Në kuadrin e lidhjeve që ka bashkësia islame me Komunitete të tjera, ky organ ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijes, sidomos të të rinjve, për njohjen e islamit në gjuhën e tyre amtare.

Në mjediset intelektuale një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe artikujt redaksionalë në aperturë të këtij organi dhe të nënshkruara nga kryeredaktori i saj I.Demiri. Të tillë janë artikujt social-teologjik të mjedisit që përfshin shteti malazez, siç janë p.sh. "Opinione mbi paqen", "Opinione mbi kohën", mbi kategoritë e ndryshme të doktrinës islame etj.

Me kalimin e kohës, kjo gazetë filloi të kristalizojë fizionominë e vet, duke përcaktuar rubrika të veçanta, në mes të të cilave që edhe ajo rreth ndihmesave që kanë dhënë shqiptarët e këtyre anëve në fushën e traditës islame dhe të kulturës kombëtare.

Fatkeqësisht gazeta u ndërpre. Mundësitë për ta vazhduar veprimtarinë fetare kulturore në Mal të Zi u veshtrësuan edhe më tepër se më parë. Politika e shtetit serbo-malazez ndrydhi çdo veprimtari që kishte të bënte me materiale në gjuhën amtare shqipe. Për popullatën shqiptare, parimet demokratike u shkelën dhe, si pasojë, u kufizuan veprimet e tyre në gjuhën amtare.

Me 1994 filloi botimin revista tremujore fetare, kulturore e shkencore "*Thirja Islame*", organ i Komunitetit Musliman Shqiptar në SHBA dhe Kanada. Kjo revistë del në gjuhën shqipe dhe angleze. Kryeredaktori i saj është Rexhep Morina.

Gjithashtu nga shkurti i 1994-ës një tjetër revistë "*Vepra*" bëhet e kërkuar për shumë lexues, burim i përhershëm informacioni shkencor. Deri në nëntor 1994 dolën 9 numra të kësaj reviste. Kurse shoqata kulturore "Drita" e Gjilanit në Kosovë, deri në korrik 1995 nxori tre numra të revistes mujore "*Drita*", me përmbajtje: kulturë, art dhe teologji. Kryeredaktor i saj ishte Zekerija Abdullahu.

## **BOTIME TË NDRYSHME ME KARAKTER FETAR ISLAM NË GJUHËN SHQIPE**

Botimet me karakter fetar në gjuhën shqipe kanë filluar të dalin në dritë që herët, por ne do të ndalemi te botimet e shekullit XX. Fondi i librit islam në gjuhën shqipe, si të gjithë përbërësit e tjerë të veprimtarisë fetare, ka zigzaket e veta, baticat e zbaticat e tij. Këto zigzake janë rrjedhojë e motiveve dhe e synimeve ideologjike, politike dhe antishqiptare prej nga u nisën armiqtë e islamizmit e të Shqipërisë.

Ai ka pasur gjithashtu funksionet e veta në varësi të kohës kur është botuar dhe në varësi të mjedisit ku është adresuar. Natyrisht, ai ka edhe fizionominë e vet në varësi të temës që trajton. Megjithatë, këtu nuk jemi para një konglomerati, por para një larmie botimesh, që shtypen në kohë dhe vende të

ndryshme dhe që në të gjitha rastet i përmbahen një boshti: edukimit islam, moralit islam, filozofisë islame.

Vizioni i rrugës së vështirë që kanë përshkuar këto botime, nga njëra anë, dhe vlera historike dhe aktuale që ato kanë nga ana tjetër, mund të evidentohen më mirë mbi bazën e kronologjisë e të tematikës që ato shtjellojnë.

*Kronologjikisht botimet* me karakter fetar islam gjatë shekullit XX, mund të paraqiten në mënyrë simbolike me një kurbë. Ajo përvijohet në agim të shekullit me veprën e Said Najdenit "Fe-Rëfenjëseja e Myslimanëve", e shkruar me alfabetin latin. Është kuptimplotë fakti që kjo vepër u shkrua me alfabetin e perbashkët. Ajo ka përmbajtjen e një programi jo vetëm fetar por edhe kombëtar. Në themelet e tij është kushtrimi drejtuar gjithë bashkatdhetarëve se "Zotit... i pëlqen liria kombëtare, puna, çiltërsia, burrëria, aspak grindjet, por leverdia e ndërsjellë".

Pra shtypi mysliman shqiptar i këtij shekulli e fillon startin e tij me një libër shkollor, udhërrëfyes, programatik në kuadrin e përpjekjeve për formimin e shtetit të ardhshëm të pavarur shqiptar, si dhe në atë të mirëkuptimit ndërkonfesional. Gjashtë vjet pas botimit të kësaj vepre, kurba fillon të ngjitet. Botohet një vepër tjetër: "Mendime" e Rexhep Vokë-Tetovës.

Për t'u shënuar është se kjo vepër dëshmon një nivel më të lartë të mendimit filozofik dhe atdhetarizmit, gjë që tregon se kontributi i personaliteteve fetare islame për bashkimin e kombit bëhej gjithnjë e më i ndjeshëm dhe më i vetëdijshëm për popullin. Figura e vepra e tij u vesh me paragjykime, duke e errësuar krejtësisht kontributin e këtij autori. Ishin ndjenjat e qëndrimet patriotike arsyet që ai u ndëshkua. U hoq nga posti i Myftiut të Manastirit dhe nga detyra e pedagogut në fakultetin teologjik e

në medrese dhe përfundoi në një shitës lulesh e perimesh në tregun e Stambollit, ku dikur kishte mbaruar shkollën e lartë.

Pas vitit 1906 nuk ka ndonjë gjë për t'u shënuar në botimet fetare islame në gjuhë shqipe. Por pas shpalljes së Pavarësisë fillojnë e aktivizohen shumë hoxhallarë e teologë dhe fillon botimi i teksteve mësimore për mësimin e besimit. Në vitin 1923 bëhet fjalë për botime madhore dhe fillon përgatitja për përkthimin e Kur'anit. Në vitin 1929 shtypshkronja "Ora e Shkodrës" boton librin "Një përshkrim i shkurtër i jetës së Profetit të Islamizms", përkthyer nga Omer M. Sharra.

Në fund të viteve '20 Komuniteti Musliman Shqiptar filloi të botojë në formë broshurash "Ajka e kuptimeve të Kurani Qerimit", që në vitin 1931 kishin arritur në faqen 1156. Vitet '30 shënojnë një ngjitime të re në botimin e veprave madhore. Kështu botohet në dy vëllime "Tefsiri shqip i Kur'anit" të autorit të mirënjohur Hfz. Ibrahim Dalliu si edhe librat "Mësimet feje", "Profeti ynë", "Profeti islam", "Islamizmi" etj.

Në gjysmën e parë të viteve '40, me botimin e disa librave me karakter problemor, kurba fillon të bjerë, për të arritur në nivelin zero me vendosjen e pushtetit komunist si në Shqipëri, ashtu edhe në trojet e tjera shqiptare. Disa "llambushka" ndizen gjatë periudhës 1945-1991 në diasporën shqiptare. Veçanërisht në këtë hark kohor janë botimet e Bibliotekës Muslimane Shqiptare të "Albanian Islamic Center" Harper Woods, Mich. USA, të bëra nën kujdesin e Imam Vehbi Ismailit dhe të Albanian American Islamic Center, Inc. New York-New Jersey, nën kujdesin e Isa Hoxhës. Këto publikime dhe të tjera si këto të shtypur nga qendra të tjera i patën portat e shtetit amë të mbyllura deri në vitin 1991. Ndërsa shqiptarët e Kosovës, të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, këta libra u njohën më parë.

Dekada e fundit e shekullit tonë ka filluar me një ngjytje të re të kurbës me botime të shumta të gjinive të ndryshme, që i kanë vatrat e tyre në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Podgoricë, Tetovë etj. Paralelisht me botimet që bëhen në vendet e mësipërme, botime të shumta janë duke u bërë edhe nga diaspora shqiptare, sidomos ajo e SHBA-së me qendër në New York, New Jersey, Miçigan, si dhe në Belgjikë (Bruksel).

Përsa i përket karakterit, fondi i botimeve fetare të shekullit XX në gjuhën shqipe është mjaft i larmishëm. Në vija të trasha, mund të bëjme këtë klasifikim: Kur'ani në gjuhën shqipe. Hadithet në gjuhën shqipe. Letërsia dokumentare shqipe për personalitetin e profetit të islamit.

## KUR'ANI

Kur'ani ka marrë këtë emër ngase vetë Zoti e ka quajtur në këtë mënyrë (In-na enzelnahu Kur'anen arabij-jen leal-lekun ta'kilun). "Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht (në një gjuhë të njohur) ashtu që ta kuptoni". Kur'ani është libri me të cilin Allahu xh.sh. i mbylli të gjitha shpalljet hyjnore.

"Kur'ani është relevata (relevacio-shpallje) e Zotit që iu dërgua Muhammedit a.s. nëpërmjet melekut Xhebrail e që u shkrua nga shokët e tij për t'u ruajtur si tekst autentik deri në ditët e sotme. Ai paraqet formulimin përfundimtar të së vërtetës mbi Zotin, njeriun, jetën dhe botën".

Në aspektin gjuhësor e ka burimin nga fjala arabe EL KUR'U, që do të thotë tubim ose përmbledhje. Kurse në traditën e myslimanëve me Kur'an nënkuptohen fjalët që i zbritën Pejgamberit a.s. nëpërmjet melekut Xhebrail, në shpellën Hira, në afërsi të Mekkës në vitin 610 të erës sonë. Ajeti i parë që zbriti ishte: "ikre bismi rab-bike" (Lexo, në emrin e Zotit tënd).

Por zbritja e Kur'anit vazhdoi për 23 vjet me radhë, në mënyrë që përfundimisht të gjente vendin e tij në zemrat dhe traditën e Sahabëve dhe vetë Resulullahit. Llogaritet që në Mekë zbritën 85 sure-kaptina, kurse në Medinë 29 sure.

Kur'ani nuk është vetëm kod feje, por është fjalë e Zotit, burim i parë i teologjisë dhe i drejtësisë islame, këshilltar në jetën praktike; është mrekulli ("Muxhizë"), që i përket Muhamedit a.s..

Mrekullia e tij është e përjetshme dhe absolute, gjuha dhe stili i tij dëshmojnë qartë se kemi të bëjmë me një shpallje qiellore, e cila çdo ditë e më tepër vjen duke siguruar themelet e shëndosha të fesë, të moralit, përparimit, edukimit dhe të kuptimit të gjithëmbarshëm të jetës sonë.

Kur'ani ka përmbajtje origjinale burimore. Ai është porosia e fundit hyjnore që i vjen qenies njerëzore. Në realitet ai i kaloi hapësirat e asaj që mund të arrijë mendja jonë. Ai vërteton konceptet e përgjithshme, parimet dhe direktivat (Kul-lij-jat) themelore.

Parimet dhe konceptet që shpalosen në Kur'an paraqesin rregulla hyjnore, paraqesin atë që është e mbinatyrshe, e përgjithmonshme dhe e pandryshueshme. Në këtë mënyrë këto qëndrojnë mbi kohën dhe vendin.

Mbinatyrshtëria e Kur'anit shihet edhe në të vërtetën shkencore që përmban, çka vërteton se Kur'ani është mrekulli e përherëshme e Profetit Muhammed, që i përgjigjet çdo shkallë të zhvillimit intelektual. Ai përmban argumente të mjaftueshme për të gjitha nivelet.

## KUR'ANI NË GJUHËN SHQIPE

Besimtarët myslimanë shqiptarë, që e përdornin Kur'anin në jetën e tyre të përditshme gjatë ushtrimit të riteve, e ndjenë që herët nevojën e përkthimit të tij, në mënyrë që të kuptonin përmbajtjen sa më gjerë, për t'u bërë të vetëdijshëm në ushtrimin e fesë së tyre. Njohës të gjuhës arabe kishte mjaft në Shqipëri, por vështirsia qëndronte gjetiu. Duke qenë ende e palëvruar gjuha shqipe, ndesheshin vështirësi të mëdha për të bërë një përkthim të një libri të shenjtë, e të pasur nga ana leksikore e linguistike në përgjithësi siç është Kur'ani. Gjuha arabe, në të cilën është shkruar Kur'ani, është një gjuhë shumë e lashtë, e pasur dhe ka një terminologji filozofike, që në shumë raste paraqet vështirësi të mëdha në përkthim, nëse do t'i nënshtrohemi besnikërisë së përmbajtjes. Vetëm për ilustrim do t'i referohem fjalës "Zot" e cila ka 99 sinonime. Secili prej këtyre sinonimeve ka nuancën e vet, gjë e cila paraqet një vështirësi të madhe për përkthyesin shqiptar. Ishin këto arsytet që teologët shqiptarë i druheshin pasaktësive që mund t'u shpëtonin.

Fragmente të Kur'anit në gjuhën shqipe i hasim qysh herët në letërsinë e bejtexhinjve, pra nga shekulli XVII për të vazhduar më vonë në shekullin XVIII e sidomos në atë XX, ku në përgjithësi mbizotëronte përkthimi i verseteve të caktuara për nga tematika. i tillë është, p.sh., "Libri i të falmës" i autorit të njohur Hfz. I.Dalliu.

Nuk ka dyshim që periudha e Rilindjes, e sidomos gjysma e parë e shekullit XX, konsiderohet faza e parë ku bëhen përpjekje serioze për përkthimin e tekstit të plotë të Kur'anit.

Me 1921 I.M.Qafëzezi bën botimin e parë të përkthimit të tekstit të Kur'anit në shqip, ku përfshihet afërsisht 1/3 e tij. Edhe pse pa komentim, ky përkthim ka vlera të veçanta nga ana historike. Botimi u bë në Ploesht të Rumanisë.

Një hap më tej në fushën e përkthimit të Kur'anit e bën Hfz.I.Dalliu. Ai në vitin 1929 boton "Ajka e kuptimeve të Kur'ani Qerimit", që është një përkthim me kompetencë nga ana teologjike. Dalliu e pajisi botimin e tij me një koment të konsiderueshëm, çka lehtësonte të kuptuarit e përmbajtjes dhe të porosive të Kur'anit.

Kemi të dhëna që janë ndërmarrë veprime për përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe disa herë. Gjatë viteve 30 pranë Komunitetit Musliman Shqiptar në Tiranë është formuar një komision pune i përbërë nga 12 teologë të njohur për të përkthyer Kur'anin në gjuhën shqipe. Pas një pune disa vjeçare komisioni arriti të bëjë një përkthim shumë serioz si nga pikëpamja e besnikërisë së përmbajtjes së tij, ashtu edhe nga pikëpamja gjuhësore. Ky material në dorëshkrim sot gjendet në arkivin e K. M. Shqiptar në Tiranë.

Një përkthim tjetër ka ndërmarrë edhe Hfz.Ali Korça, pjesë të të cilit janë botuar edhe në shtypin shqiptar.

Botimi i plotë i Kur'anit të përkthyer në gjuhën shqipe për shumë arsye arriti të bëhet vetëm në mesin e viteve 80.

Me 1981 në Prishtinë u formua një grup pune i kryesuar prej Sherif Ahmetit dhe tetë anëtarëve: I. Ahmeti, B. Ahmeti, Q. Qazimi, R. Rexhepi, H. Hoxha dhe A. Aliu, ky ekip i organizuar nën drejtimin e Kryesisë së Shoqatës së Ulemave të Kosovës, pati si qëllim përkthimin e tekstit të plotë të Kur'anit në gjuhën shqipe. Edhe pse me 6 qershor 1984 materialet u dorëzuan nga të gjithë anëtarët e grupit, ky përkthim i Kur'anit nuk u botua për shkaqe të caktuara.

Botimi i parë i plotë i Kur'anit në gjuhën shqipe u bë në vitin 1985 në Prishtinë, nga Feti Mehdiu. Shqipëruesi është njohës e studjues i islamistikës dhe i arabologjisë pranë Fakultetit Filologjik të

Prishtinës. Ky përkthim për vlerat e veta të veçanta në aspektin gjuhësor pati jehonë të madhe në publicistikën kosovare dhe më gjerë.

Përkthimi dhe botimi i dytë i plotë i Kur'anit u bë në vitin 1988 nga Prof.Hasan Nahi, po nga Kosova. Përkthyesi ka kryer studimet e shkencave islame në Egjipt. Gjatë përkthimit, ky teolog i formuar, rëndësine më të madhe ia kushtoi anës kuptimore dhe besnikërisë së përmbytjes nëpërmjet një gjuhe të qartë. Prof.Nahi vendos bri tekstit original përkthimin në gjuhën shqipe.

Përkthimi i tretë i plotë i Kur'anit është bërë nga H.Sherif Ahmeti po me 1988, nën kujdesin e Kryesisë së Bashkësise Islame të Prishtinës. Ky mund të quhet ndër përkthimet më të kompletuara të Kur'anit. Përkthimit të ajeteve i bashkangjitet edhe një koment i konsiderueshëm, me një vështrim rreth Kur'anit, që lehtëson kuptimin më mirë dhe më të plotë të tij. Për këtë arsye, ky përkthim me koment është ribotuar disa herë.

Përkthimi i katërt i Kur'anit në gjuhën shqipe është ai i Muhammed Zekeria Khanit, i cili u shtyp nga "Islam Internacional Publications" (TD, Islamabad, 1990). Ky përkthim qe, padyshim, një mesazh i ri në përkthimin e civateve Kur'anore. M.Z.Khan përpiket të bëjë shpjegime të civateve, por, nga ana e përmbytjes, ai lë shumë për të dëshiruar.

Përkthimi i mësipërm ka edhe gabime gjuhësore e kuptimore, të cilat, në raste të veçanta, e bëjnë të mangët dhe të paqartë kuptimin e tekstit.

## **PËRKTHIME TË PJESSHME TË KUR'ANIT BOTUAR NË LIBRA TË NDRYSHËM**

Përveç përkthimeve të plota ekzistojnë edhe përkthime të pjesshme të Kur'anit botuar në libra të ndryshëm, ku gjenden pjesë të përkthyer nga Kur'ani. Shquhet në këtë aspekt përkthimi i sures së "Jasinit". Duke qenë se në përmbajtjen e saj përfshihen udhëzime, këshillime dhe shpjegime të kuptimeve të larta, versionet e përkthimeve të saj në gjuhën shqipe janë të shumta.

Botimet e saj të para në gjuhën shqipe u bënë në vitet '30, Mjafton të përmendet këtu "Libri i së falmes" i Hfz.I.Dalliut, botuar në Tiranë më 1937. Libër ky që ka disa ribotime, dhe i cili është i shoqëruar me shtyllat themelore që duhet të zotërojë çdo besimtar mysliman për të formuar botëkuptimin e tij dhe për të vepruar. Në hyrje të këtij botimi ka dhe disa udhëzime fonetike mbi drejtshqiptimin e saj.

Këtë përkthim e ndoqen edhe variante të tjera si më poshtë:

- "Islamizmi dhe lutjet" i Imam Vehbi Ismailit, Detroit, 1957.

- "Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini Sherif" i Hfz. Sulejman Kemurës, botuar në Prishtinë më 1959. Në gjuhën shqipe e kanë përkthyer Bajram Agani dhe Mehmet Gjevori. Libri është ribotuar disa herë.

- "Rregulla dhe lutje" i Hfz S. Kemures, Prishtinë, 1972, Jasini me komentim, përkthim i Sherif Ahmetit.

- "Ajete të Kur'anit me shpjegime të tjera" i Beqir Malokit, botuar në Romë më 1982.

- "Jasini dhe 20 sure të tjera". Përktheu Dr.Feti Mehdiu. Prishtinë,1992.

- Në vitin 1993 në Prishtinë, Qazim Qazimi boton një tekst për klasat e larta të medresesë me titull "Hyrje në shkencat Kur'anore."

- "Kaptina Jasin". Përkthim dhe koment i M.Mustafës, Shkup, 1994.

- "Jasini" Përkthim dhe koment i Prof.S.Kutubit, Shkup, 1994.

- "Kaptina Jasin". Përkthyer nga N.Ibrahimi. Ribotimi i fundit më 1994.

Përveç këtyre librave që radhitëm të cilat kryesisht patën për bazë përkthimin e sures "Jasin", ka edhe mjaft libra të tjerë të përkthyer me tematikë nga Kur'ani, që janë botuar kohët e fundit. Është për t'u vënë në dukje libri i Dr. Feti Mehdiut "Nga tematika e Kur'anit". Ky libër ka karakter didaktik, strukturë të shëndoshë dhe lidhje logjike. Tematika e tij i nënshtrohet kriterëve teologjike shkencore. Fillimisht trajtohet qëndrimi i Kur'anit ndaj shkencave të përpikta dhe besimit, vijohet me: Kur'ani për besimin, për meshkujt, femrat, familjen, fëmijet, për çështje ekonomike -sociale etj. Autori i punimit e bën të qartë qëllimin e botimit të këtij vëllimi. Botime me tematikë nga Kur'ani pati edhe në shumë qendra tjera të Kosovës, si "Kur'ani dhe të drejtat e njeriut," Gjilan, Njohuri rreth Kur'anit, Prizren, Kur'ani libër për të gjallët apo..." Mitrovicë etj.

Një pritse të mirë në publikun shqiptar pati edhe broshura e Dr.Maurice Bucaille, anëtar i Akademisë Franceze të Mjekësisë, që shtjellon ndërlidhjet e Kur'anit me shkencat bashkëkohore. Dr.M.Bucaille, që është kirurg i shquar, e zhvilloi fillimisht në formë leksioni temën e mësipërme, duke e ilustruar me fragmente Kur'anore para auditorit të Commonelthit të Londrës. Me titullin "Të dhëna fiziologjike dhe embrionologjike në Kur'an", kjo temë është mbajtur edhe në Akademinë Franceze të Mjekësisë më

9 nëntor 1976. Broshura e lartëpërmendur u publikua në Tiranë më 1992. Në këtë broshurë autori shtron nevojën e një kulture enciklopedike për të kuptuar Kur'anin. Ai flet për Universin dhe krijimin e tij, për astronominë, tokën, krijimin e njeriut etj.

Më 1986 u botua libri i Ahmed Deedat "Kur'ani, mrekullia më e përsosur" në gjuhën shqipe, më 1986. Në këtë libër gjejmë vlerësime për Muhammedin (a.s.) nga personalitete të shkencës, kulturës e filozofisë përendimore, si të Thomas Carlylit, të Gibbonit, të R. Bosworth - Smith, të La Martinit, të Jules Mesermanit etj. Në librin e A.Deedat gjendet dhe kreu "Mbi të vigjëlon nëntëmbëdhjetësi".

Në vazhdim të botimeve të pjesshme të Kur'anit, më 1994 u botua "Nën hijen e Kur'anit-12 suret e fundit", vepër e Halil Idrizit. Po më 1994 është botuar edhe një fragment i Kur'anit me titull "Kur'ani i Madhnueshëm", përkthim dhe komente. Fatkeqësisht këtij botimi i mungon parathënia dhe emri i përkthyesit.

## **PËRKTHIME TË PJESSHME TË KUR'ANIT BOTUAR NË PERIODIKË TË KOHËS**

Përkthimet e pjesshme të Kur'anit në gjuhën tonë janë të shumta. ato i gjejmë edhe në periodikë të kohës. Kjo për faktin se shpjegimet që kanë bërë teologët myslimanë mbi islamin dhe porositë e tij, gjithmonë i kanë mbështetur në Kur'an, çka i ka detyruar ata që të përkthejnë pjesë prej tij, të mbledhura në tematikë të caktuar ose në tematika të ndryshme.

Në revistën "Zani i Naltë" gjejmë përkthime të tilla që në vitin 1924. Hfz. Ali Korça fillon me përkthimin dhe komentimin e sures En-Nas nga dhjetori i vitit 1926, dhe vazhdon me sure të tjera, deri në vitin 1929, kur gjejmë përkthime nga ana e tij të sures Zilzal (surja e Termetit). Në po këtë revistë, Hfz.A.Korça na jep përkthime me komente të gjëra për profetësinë e Hazreti Muhammedit (a.s), duke u mbështetur edhe mbi doktrinat e një shumice dijetarësh evropianë. Gjithashtu në "Zanin e Naltë" Hfz.Ismet Dibra, duke shpjeguar "Tregimin e qiellës e të tokës" në pikëpamje fetare, fillon një varg përkthimesh të citateve të Kur'anit.

Në këtë vazhdë vlen të theksohet edhe dersi (ligjërata) i Hfz.M.Dashit më 8.II.1931, që është një përkthim e komentim i disa ajeteve të Kur'anit, mbajtur në xhaminë e vjetër të Tiranës e që u botua po në këtë revistë. Po ky autor, në numrin 3 të po kësaj reviste, boton artikullin "Ç'urdhëron Kur'ani", ku merr përsipër përkthimin e disa ajeteve të sures "Isra". Me të njëjtin titull, po në këtë revistë (Nr. 6, 1932) paraqitet edhe studenti Medresesë së Pergjithshme të Tiranës, Vexhi Demiraj, i cili sjell një përkthim të dy fragmenteve kuranore. Nën këtë titull bën komentimin dhe përkthimin e Ajetit 350 të Sures El-Mu'mininun edhe Haki Sharofi.

Përkthime të pjesshme tematike të Kur'anit janë botuar edhe në revistën "Kultura Islame", të bëra nga Sherif Putra, Haki Sharofi, Sadik Bega, Ferid Vokopola etj.

Përkthime të pjesshme të Kur'anit, që u botuan në organet e shtypit shqiptar, hasim më vonë në të gjitha organet e shtypit islam të trevave të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të diasporës. Kështu në "takvimet" e Prishtinës vazhdimisht botohen përkthime të pjesëve të Kur'anit nga teologë të mirënjohur si Hajrullah Hoxha e H.Sherif Ahmeti. Pastaj nga komisioni i përkthimit të Kur'anit kemi disa vazhdime të sures Ali Imran, Bekares.

Shqipërimet e Kur'anit hasim edhe në revistën "Dituria Islame", (Kosovë), gazetën "Hilal", "Hëna e Re" (Maqedoni), "Elif" (Mali i Zi), "Jeta muslimane shqiptare" (Detroit, SHBA), "Përpjekja Jonë", New York-New Jersey etj. Në to shquhen emra të rinj që merren me përkthimin dhe komentimin e Kur'anit si: Idriz Demiri, Shaqir Fetahu etj.

Perveç besimtarëve të besimit islam, kanë bërë përpjekje ta përkthejnë e ta kuptojnë Kur'anin qoftë të plotë ose të pjesshëm edhe besimtarët e feve të tjera. Kështu, qysh me 1530, Kur'ani u shtyp në Venedik, më 1543. Kur'anin e gjejmë të përkthyer edhe në gjuhën latine. Në disa gjuhë Kur'anin e kemi të përkthyer disa herë nga përkthyes të ndryshëm, dhe deri në gjashtëdhjetë herë, si p.sh. në gjuhën angleze.

Sipas një studimi të bërë nga Ismet Binark dhe Halit Oren, rezulton se Kur'ani është përkthyer në pjesën dërmuese të gjuhëve të botës, si të Perëndimit, ashtu edhe të Lindjes, si klasike ashtu edhe atyre moderne.

Duke u mbështetur në burimet bibliografike deri tani, llogariten afërsisht 2672 përkthime të Kur'anit.

## **LEXUESIT E KUR'ANIT NË TREVAT SHQIPTARE (KURRAT - HAFIZËT)**

Njëra nga disiplinat shkencore që pati shtrirje të gjërë, qysh nga çasti kur popullata shqiptare pranoi fenë islame, është edhe ajo mbi leximin e Kur'anit, e cila në terminologjinë arabe është njohur me emrin

"Texhvid". Texhvidi u mësohej nxënësve nëpër të gjitha medresetë, qofshin ato iptidaije, ruzhdie, medrese të ulëta apo të larta.

Pranë medresesë së "Gazi Mehmet Pashës" në Prizren, e cila kishte një traditë mbi 400- vjeçare për përgatitjen e kuadrove në fusha të ndryshme të fesë dhe të shkencës, ekzistonte edhe seksioni i veçantë për mësimin e librit (Kur'anit përmendësh).

Të rralla kanë qenë rastet që nxënësi, i cili ka kryer medresetë e Tiranës, të Prizrenit, e të tjera, të mos ketë kryer edhe hifzin. Vetëm gjatë shekullit XX në Prizren kishte mbi 70 hafizë, si Hafiz Qemal Kajseriu, i cili hifzin e kreu në moshën 11- vjeçare te Mualimi i tij Hafez Shevqeti. Qemali ka qenë njohës i përpikte i të tri gjuhëve orientale (arabe, persiane dhe turke). Hafiz Safet Basha ka qenë myftiu i fundit i Prizrenit. Hifzin e kreu në moshën 12- vjeçe nën përkujdesjen e Hafiz Qamilit. të njohur janë edhe Hafiz Ismailhaki Ustaibo, Hafiz Maksut Spahiu, Hafiz Abdullah Sagdani, Hafize Asije etj. Hafize Asije ka qenë e vetmja Hafize femër nga Prizreni. Dita e kryerjes së hatmës së saj ka qenë një një manifestim popullor për Prizrenin.

Nga kurratë (recituesit) më të njohur të Kur'anit në trevat shqiptare gjatë shek.XX përmenden:

1.Hfz.Ali Korça-Korçë. 2.Hfz.Maliq Gjakova-(prof.i kurrave të Shkodrës, më vonë myfti në Shijak). 3.Hfz.Ymer Temali-Shkodër. 4.Hfz.Sabri Beg Bushati-Shkodër. 5.Hfz. Xhemal Dibra-Tiranë. 6.Hfz.Muhamed Gashi-Pejë (Imam i Xhamisë së Kuqe). 7.Hfz. Emin Behrami-Vuçiternë, prof i medresesë "Alauddin" (Prishtinë). 8.Hfz.Jashari -Dobërçan, rreth i Gjilanit. 9. Hfz.Nexhati Ahmeti-myderiz nga Presheva. 10.Hfz.Idriz Dermaku-hoxhë atdhetar nga Shipashnica e Kamenicës. 11.Hfz.Muhamed ef.Asllani-Tetovë (mualim i Xhamisë së Pashës). 12.Hfz.Ismail H.Hasani-mualim i

Sibian Mektebit të Prilepit. 13.Hfz.Abdulhaki Kasami-Tetovë. 14.Hfz.Abaz Jahjai-Tetovë. 15. Hfz. Hasan Lunji-Ulqin. 16. Hfz. Hasan Mavriq- Podgoricë etj.

Gjenerata e re e kurrave është në formim e siper. Përgatitja e tyre realizohet, veç të tjerave dhe me anë të tekstit shkollor "Mbi të kënduarit e Kur'anit" të autorit Emin Behrami, pedagog në Medresen "Allauddin" të Prishtinës, i lindur në Vuçitern të Kosovës. Teksti i mësipërm fillimisht është shfrytëzuar si tekst mësimor në "Medresenë Alaud-din" të Prishtinës, por, për cilësite praktike që ka, ky tekst ka fituar popullaritet dhe aktualisht po përdoret nga lexuesit (recituesit) e Kur'anit që përgatiten trevat shqiptare të Kosovës.

Në vitin 1992 për kurratë shqiptarë u botua broshura "Rregulla mbi të lexuarit e Kur'anit", e cila për shkak të thjeshtësisë dhe përgatitjes praktike që ka është caktuar edhe si tekst shkollor në mbarë medresetë e Shqipërisë. Më 1996 në Prizren u botua një metodë (speciale) mbi të mësuarit e Kur'anit përmendësh, të përgatitur nga Hfz.Hajredin Hoxha, njëri ndër hafizët e parë që ka kryer fakultetin e Studimeve të Kur'anit në Medine (Arabia Saudite). Në broshurën e tij Hfz.Hajredini rekomandon mbi njëmbëdhjetë metoda që duhet t'i njohë ai që dëshiron të mësojë Kur'anin përmendësh .

Përkthimet e plota apo të pjesshme të Kur'anit, përgatitja e lexuesve të tij, luajtën një rol të madh në njohjen e vet kësaj vepre si dhe për zgjerimin e horizontit teologjik të besimtarëve.

Duhet të pranojmë se ndikimi i Kur'anit nga koha e ardhjes së islamit në trevat shqiptare ishte i patjetërsueshëm, ngaqë ai është "kushtetutë" mbi të cilën mbështetet i tërë civilizimi islam.

Kur'ani, kryevepër e letërsisë arabe, ndikoi në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë te krijuesit shqiptarë. Kështu, p.sh., në veprën "Jusufi me Zelihanë" të Hfz. A.Korçës tema e Kur'anit përbën

boshtin themelor të saj.E përbashkëta vihet re te: morali i lartë, dinjiteti njerëzor,durimi islam, ftesa për të pranuar fenë monoteiste islame etj.

Kur'ani i dha mundësi zhvillimit të traditave dhe të kulturës sonë kombëtare. Ai ndikoi fuqishëm që trojet tona të përjashtojnë depërtimet sllave dhe helene. Po sjellim vetëm një shembull: Plisi ose qelesha, që ishte simboli i rrobave tona kombëtare, u favorizua nga porosia e Kur'anit dhe mësimet islame për mbulimin e kokës, çka bëri që të ruhet një traditë e tillë deri në ditët e sotme. Shembuj të ngjashëm kemi edhe në organizimin e tregtisë, të familjes, ushtrisë, festave fetare, therjes së kurbanit, vizitës në varreza etj.

E tërë lufta për pavarësi kombëtare, padyshim që ishte e ndikuar edhe nga oqeani i pasur i Kur'anit. i ndikuar nga ky libër i shenjtë, populli shqiptar nxori nga gjiri i vet tribunë popullore dhe udhëheqës të lëvizjes çlirimtare.

Diktatura komuniste gati gjysmëshekullore mbi Shqipërinë, nuk arriti ta shuajë dashurinë e shqiptarëve ndaj Kur'anit. Ai u ruajt në sirtarët e fshehta të familjeve shqiptare, u lexua fshehtas nga besimtarët, u mësua në tre breza fshehtas dhe vetëm tani ai po del i lirë, duke provuar se sa të lidhur janë shqiptarët myslimanë me të.

## **HADITHET NË GJUHËN SHQIPE**

Përveç Kur'anit myslimanët, për t'u formuar nga ana fetare dhe botëkuptimore, mbështeten dhe te Hadithet. Madje teoricienët shqiptarë të islamit pikërisht këtu e kanë përqendruar vëmendjen dhe janë

përpjekur t'u bëjnë të njohur ithtarëve (besimtarëve) të tyre përmbajtjen e Kur'anit dhe të Haditheve në rrugë të ndryshme në gjuhën amtare. Këto rrugë janë vazet ose predikimet e ditëve të premte, përkthimet dhe botimet në gjuhën shqipe, mevludet e ilahitë etj. Kjo ka bërë që pranë xhamive të kishte biblioteka të këtij profili . Po ashtu edhe pranë medreseve . Në këto rrugë është ruajtur edhe gjuha amtare në mes të besimtarëve myslimanë. Nga ana tjetër, këto kanë ndihmuar edhe për mosshkombëtarizimin e shqiptareve nga ana e sllavëve dhe e grekëve.

Kur'ani është kod themelor dhe thelbësor i fesë islame. Në të janë përfshire të tëra dispozitat fetare me karakter universal. Shpjegimin dhe sqarimin e këtyre dispozitave e bën Hadithi, pra Muhammedi (a. s.). Po të mos i shpjegonte ato kjo shkencë, shumë dispozita Kur'anore do të mbeteshin të paqarta, sepse Kur'ani duke u marrë me bazat dhe parimet themelore të fesë, rrallë zgjatet në hollësi. Në përgjithësi, hollësitë jepen nga vetë Profeti (a.s.) ose nëpërmjet veprimeve të tij praktike, ose duke i shpjeguar me fjalë.

Hadithi si disiplinë shkencore teologjike është një ndër burimet më të vlefshme islame dhe konsiderohet i dyti në jurisprudencën islame.

Shokët e Muhammedit (a. s.) e kuptuan sa e vlefshme ishte shkenca e Hadithit, prandaj dhe u perpoqën e u sakrifikuan për ta ruajtur atë dhe për të transmetuar me besnikëri te pasardhësit e tyre çdo gjë që dëgjuan nga Profeti(a. s.), të cilën e kishin mësuar përmendësh.

Shkrimi i kësaj shkence në formën e një përmbledhjeje dhe në mënyrë zyrtare u bë në mbarim të shekullit i dhe në fillim të shekullit II të erës islame, pra rreth viteve 90-101H. ose 622-633M.

Me hadithet shqiptarët janë njohur qysh herët, d.m.th. menjëherë pas përqaimit nga ana e tyre të besimit mysliman. Përmbajtja e haditheve (maksimave, fjalëve, porosive të Muhammedit (a. s.) ka

ndikuar fuqishëm në moralin dhe ndërgjegjien e tyre. Këtu duhet parë edhe ajo frymë mirëkuptimi me besimtarët e feve të tjera, ajo atmosferë vëllazërimi që këshillonte Muhammedi (a. s.) lidhur me marrëdhëniet në mes të njerëzve.

Duke iu përmbajtur kufijve që rrok ky punim, do të trajtojmë vetëm Hadithet që filluan të botohen në gjuhën shqipe në fillim të shekullit tonë e prapa.

Botimi i parë i "Haditheve" shqip në një tekst të veçantë u bë në vitin 1940. Hafiz Ibrahim Dalliu i paraqiti publikut "Hadithi-Errbeain" ku përmbledhen 42 Hadithe të autoriteteve të kësaj fushe, siç janë autorët Buhariu, Myslimi, Termidhiu, Ebu Davudi etj. Autori ynë është mbështetur te I. Neveviu. Në parathënie nënvizohen vlerat shoqërore të këtyre maksimave, të cilat, për përmbajtjen e lartë që kanë, mbeten gjithmonë aktuale. "Shoqëria njerëzore në çfarëdo kallëpi të hyjë, prapë për ato baza është nevojtare".

Duke qenë ky libër "antologjia" e parë e Haditheve në gjuhën shqipe, fiton disa vlera:

*Së pari*, pas botimeve fragmentare të Kur'anit, botimi i kësaj antologjie plotëson literaturën fetare të boshtit tjetër kryesor të formimit të besimtar islam. Letërsia jonë e Haditheve e pasuron letërsinë tonë filozofike, atë teologjike, e ngre në një shkallë të re etikën shqiptare.

*Së dyti*, hap rrugën e një zhanri të ri të literaturës dokumentare, duke e pasuruar literaturën historike shqiptare.

*Së treti*, jep një material të pasur rreth fjalorit fetar. P.sh. shpjegon termat: hadith, ahiret, haram, hallall, hytbe, dynja, imam, kader, kiamet, razi, rivajet, exhel, xhennet, xhehenem etj.

*Së katërti*, përmban referenca të shumta, një pjesë e të cilave na njeh me hadithologët më të mëdhenj të botës.

Botimet lidhur me hadithet u intensifikuan në mënyrë të veçantë në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit tonë, të cilët kapin një vëllim prej 1584 faqesh (me sa na kanë rënë në dorë deri tani - R.Z.).

Hadithet e konsiderojnë njeriun si formën më të persosur të të gjitha qenieve, të cilin Zoti e ka pajisur me çdo gjë të nevojshme për mbarëvajtjen dhe zhvillimin. Çdo gjë përreth, d.m.th. i tërë universi është në funksion të njeriut. Por, gjithnjë në bazë të këtij mesazhi të Profetit, duke qenë njeriu i përbërë nga trupi dhe shpirti, ai ka detyrë për trajtimin maksimal të këtyre dy anëve.

Në bazë të logjikës së Haditheve të botuar në shqip, njeriu, si qenie, është i privilegjuar nga qeniet e tjera se ka aftësinë për të mësuar, aftësinë e të menduarit, di të dallojë të mirën nga e keqja dhe të drejtën nga e shtrembra. Njeriu është i pajisur me intelekt dhe ndonse inteligjent, në shumë raste mund të anojë nga e keqja, nga e shtrembra, nga e liga, duke u nisur nga interesat e ngushta vetjake. Burim konfliktesh në mes dy individësh mund të bëhet e njëjta gjë, në se interesat janë të kundërta, por në dy të kundërtat e një gjëje, vetëm njëra është e vërtetë.

Hadithet ose mesazhet e shprehura nga Profeti i japin rrugë atyre: "Qëllimi kryesor i mesazheve hyjnore, -shkruan Imam Vehbi Ismaili, i cili i është kushtuar një kohë të gjatë përmbajtjes dhe përkthimit të haditheve-, ka qenë gjithmonë që ta largojë njeriun nga e liga dhe ta udhëheqë në të mbarën e të mirën, për të siguruar lumturinë në të dy jetët". Mesazhet e Muhammedit (a.s.) në përmbajtjen e tyre prekin tërë sferen e botës materiale dhe asaj shpirtërore, i kundërvihen sfidave të kohës së sotme, veseve të ulëta të imoralitetit, korrupsionit, prostitucionit, pornografisë, drogës, kriminalitetit, shfrytëzimit,

alkoolit, ekstravagancave etj. Ato i kundërvihen robotizimit të jetës së njeriut, ato janë për një jetë e marrëdhënie të drejta, për pasurimin e mendjes e të zemrës me besimin në Zotin, në Allahun (xh.sh.).

"Disa nga këto mesazhe të Muhammedit (a.s.) janë si rrebesh dallgësh ose vërshim rrekeje, ndërsa të tjerët janë të buta dhe qetësuese, por të gjitha janë të pajisua me një stil madhështor letrar e kuptime të shkëlqyeshme frytdhënëse dhe të paimitueshme" ( I. V. Ismaili-150 Hadithe f.VII ).

Hadithet janë maksima të Muhammedit (a.s.). Muhammedi, i cili qe bari dhensh, tregtar, qytetar, ushtar dhe komandant, burrë shteti dhe administrator, jurist dhe reformator, u bë autor i një kushtetute humane e federale, në të cilën ai i skaliti mesazhet e tij. Në një verset Kur'anor thuhet: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut..."

Moralistët shqiptarë, teoricientët e islamizmit në trevat shqiptare, e vlerësuan me të drejtë rolin e haditheve në planin formues etik, social, filozofik dhe botëkuptimor në përgjithësi. Duke evokuar periudhën e lavdishme të jetës dhe të veprimtarisë së Muhammedit (a.s.), ata theksonin bindshëm se "fjalët e praktikat e Profetit duhen mësuar, zbatuar dhe pasur nga të gjitha bashkësitë myslimane" edhe në kohën e sotme. Ato janë shumë aktuale në ditët tona. Roli i tyre është i pallogaritshëm në normalizimin e jetës së përditshme.

Duhet të kemi të qartë dhe gjithnjë parasysh se Kur'ani është fjala e Zotit, kurse Hadithet janë mesazhet, porosinë, shpjegimet e Kur'anit që bënte Muhammedi (a.s.). Ato dallohen edhe nga stili. Hadithet janë shkruar nga bashkëpunëtorët e Muhammedit (a.s.), të cilët rrinin me të, faleshin me të, asistonin në bisedat e tij, në këshillat e tij. Ata i shkruanin që në të gjallë të tij.

Siç tregojnë hadithologët shqiptarë, në një rast, kur një qytetar u ankua se nuk mund të mbante mend të gjitha sa dëgjoi nga Ai, Muhammedi (a.s.) e këshilloi me këto fjalë: "Duhet të kërkosh ndihmën e dorës së djathtë", çka d.m.th., sipas Tirmidhiut (39:12), "të shkruante".

Muhammedi (a.s.), në të gjallë të tij, ka dhënë vetë urdhër që të shkruheshin "Letra" dhe "traktate", të cilat u ruajtën. Por duhet ditur që, në mënyrë të rregullt, të shkruarit e Haditheve filloi vetëm pasi u njohën mirë veçoritë e stilit të Kur'anit. Hadithet diskutoheshin, komentoheshin dhe futeshin në veprim në jetën e përditshme.

Muhammedi (a.s.), siç thuhet nga biografët e tij, i vlerësonte shumë dijet, të mësuarit, kulturën, shkencën. Ai që rrethuar me njerëz të ditur. Nga njerëzit e afërt të tij kishte asish që "nuk bëjshin tjetër gjë veç merreshin me studime." Dhjetë vjetë pas vdekjes së tij, islamizmi u përqaftua nga popuj të ndryshëm, të cilët treguan interesa për jetën dhe veprimtarinë e Muhammedit (a.s.) dhe, si rrjedhojë, aspekte të qëndrimeve dhe të veprimeve të tij u bënë pasuri të miliona njerëzve.

Fjalët e Muhammedit (a.s.), pra Hadithet, u bënë udhërrëfyese në jetën e pasardhësve të tij. Shumë nga ata sakrifikuan me vetëmohim gjithçka për idealin e tyre: pasurinë, familjen, vetë jetën. Kjo ndodhi dhe me pasardhësit islamë në trevat shqiptare. Të gjithë ata përqipeshin të ndiqnin shembullin e tyre.

Në letërsinë shqipe të haditheve përsëritet shpesh roli i transmetuesit të Haditheve. Vetë Profeti kishte porositur që mësimit e tij t'ua kumtonin atyre që nuk i kishin dëgjuar; kështuqë, çdo njeri që kishte dëgjuar një mesazh, kur kishte qenë i pranishëm ku fliste Muhammedi (a.s.), e ndiente për detyrë t'ua thonte atë të tjerëve.

Në letërsinë tonë thuhet se Ebu Hurejreja, që ishte një ndër ata që kishte ndejtur me shumë afër Muhammedit (a.s.), kishte afër 800 studentë, ndërsa "shtëpitë e shokëve të Profetit", që kishin dëgjuar

më shumë fjalët dhe që kishin parë veprimet e tij, pas vdekjes së Profetit Muhammed (a.s.) u bënë shkolla që frekuentoheshin nga myslimanë të ardhur nga të gjitha anët e botës islame për të mësuar Hadithet. Dhe kur të ktheheshin në vendet e tyre do të bëheshin mësues të Hadithit".

Shkrimi i Haditheve, komentimi dhe shfrytëzimi i tyre si bazë për trajtimin e problemeve sociale, grupimi dhe klasifikimi i tyre etj., krijoi një disiplinë më vete, e cila sherbeu si lëndë mësimore në shkollat e botës islame dhe si bazë e drejtësisë.

Letërsia jonë e Haditheve e përshkruan me ngjyra tërheqese jetën e tij. Natyra e kishte pajisur atë me një kujtesë fenomenale. Bashkënxënësit që kishin marrë me shkrim hadithet, i korigjonin në bazë të kujtesës së shokut të tyre. Në moshën 16- vjeçare Buhariu u bë mësues i lëndës së Hadithit. Në moshën 18- vjeçare ai hartoi një tekst të tij. Për të hartuar librin e Haditheve, Buhariu qarkulloi në tërë botën islame të kohës së tij, çka i kushtoi 40 vjet. Ai kishte studiuar 600 mijë hadithe, por në librin e vet ai rreshtoi 7.257 të tilla të grupuara sipas temave. Nëse do të zbriten përsëritjet, libri i Buhariut përmban 2.762 Hadithe.

Libri i Buhariut është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Përkthimi me më autoritet është ai në gjuhën angleze, në nënte vëllime, me nga 450 faqe secili. Pjesë të Buhariut qysh herët janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Një grup pune i përbërë prej shtatë vetëve, mori përsipër përkthimin komplet të Sahihul-Buhariut në gjuhën shqipe. Ky përkthim ka 8 vëllime dhe, krahas tekstit origjinal në gjuhën arabe ka edhe përkthimin në shqip. Ky grup është i përbërë prej: Mehdi Polisit, Abdullah Hamidit, Feti Mehdiut, Ismail Ahmetit, Ruzhdi Latës, Isa Memishit dhe Bahri Aliut.

Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe do të ndihmojë dukshëm në njohjen më të thellë të mjaft çështjeve e problemeve të normave islame, siç do të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të kërkimeve në fushën e shkencës së Hadithit ndër shqiptarët.

Është e rëndësishme të bëhet e ditur se një nga kushtet strikte që kërkohet nga transmetuesit e haditheve ishte ndersmeria e njohur botërisht si dhe të mos kishte asnjë njollë: pra "të ishte njeri i mësuar, nuk duhet të kishte bërë ndonjë krim, nuk duhet të kishte shpifur ndonjë rrenë, nuk duhet të kishte falsifikuar ndonjë dëshmi... duhej të ishte fetar i devotshëm dhe i paanshëm në çështje politike"

Hadithologu shqiptar I.V. Ismaili thekson se Profeti (a.s.) ka thënë: "Unë nuk jam më tepër se njeri. Kur t'ju jap urdhër për një gjë që ka të bëjë me fe, ju duhet të gjykonit dhe vetë, sepse unë nuk jam me tepër se njeri"

Në Shqipëri Hadithet kanë pasur një përhapje të konsiderueshme. Me zhvillimin e shtypit fetar e sidomos me njohjen e biografisë së Muhammedit (a.s.), ato filluan të përhapen në trevat dhe diasporën shqiptare, por jo në atë shkallë sa një student të doktorohet në këtë disiplinë. Por Hadithe të veçanta janë bërë pjesë e kulturës së shumë intelektualëve islamë. Jo vetëm kaqë por ata u bënë mbështetës e propagandues në organe e periodikë të kohës. Ndër hadithet e përhapura më shumë do të veçonim:

"Të diturit janë trashëgimtarët e profetëve, të cilët ua kanë lënë atyre diturinë si trashëgim". "Ai që ka zgjedhur rrugën e mësimit ka zgjedhur rrugën me të mirë. Për atë që përpiqet të gjejë rrugën e fitimit të diturisë, Zoti do ta hapë një rrugë deri në dyert e parajsës". "Le të jetë i pasuri dhe i varfri i barabartë para jush në fitimin e diturisë", si dhe një sërë hadithesh të tjera që kanë të bëjnë me domosdoshmërinë e dijes.

Në kuadrin e antologjive të Haditheve në gjuhën shqipe që përmendëm në fillim janë edhe dy të tjera me tematikë të caktuar, por pa të dhëna se kur janë botuar. Ndër to: "Fjala e bukur" ka gjithsej 195 Hadithe, ndërsa "Shkëndija nga udhëzimi profetik" ka 240 Hadithe. Hadithet e këtij të dytit kryesisht janë të marra nga Buhariu, Tirmidhiu e Muslimi. Nga ana didaktike shumë më praktik është "Kështu fliste Muhammedi (a.s.)", në dy vëllime. Por mbi të gjitha mbetet antologjia e Imam Vehbi Ismailit "150 Hadithe -Fjalë të Profetit Muhammed a.s.", i cili, përveç panoramës historike retrospektive të Haditheve, e pajisi librin e tij me të dhëna burimore. Këto të dhëna janë nga Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Davudi etj.

V. Ismaili na jep edhe tekstin origjinal, si dhe, në mjaft raste, shenimet me kuptimin që ka Hadithi, rastin kur ai duhet pasur parasysh, si edhe analogjitë me fondin folklorik të fjalëve tona të urta (fq.12). V. Ismaili zgjatet në komentet e Haditheve.

Shtrohet pyetja: A ka Hadithologë shqiptarë?

Në fushën e paraqitjes dhe të komentimit të Haditheve shqiptarët paraqiten me disa figura të mëdha në lëmin ndërkombëtar islamik, që njihen botërisht Ata janë: Nasrud-din El Albani (Shqiptari), Abdulkadër Arnauti, Shuajb Arnauti, Imam Vehbi Ismaili etj. Ndërsa në atë kombëtar, vëmendjen e tërheq Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, ku sektori i shkencës së hadithit udhëhiqet nga hadithologu i ri Sylejman Osmani i cili kohë më parë u lauria në Universitetin Islamik të Medinës në Arabinë Saudite. Në veprën e tij "Sunneti bazë e Sheriatit" ai shprehet: "Bota islame ka pasur muhadithinë të njohur nga të gjitha anët e saj. Edhe në kohën e Pejgamberit a.s. sahabët vinin nga vendet e ndryshme dhe mësonin prej tij pastaj ato mësimet ua transmetonin mesit ku jetonin. Në mesin e tyre kishte romakë, persianë, etiopianë dhe të gjithë njiheshin sipas etnitetit të tyre...

Imam Buhariu dhe shumë të tjerë nuk ishin arabë, por kontributi i tyre u bë i pazëvendësueshëm. Pastaj gjatë shekujve pati dijetarë të mëdhenj dhe secilit shekull i printe njëri prej tyre".

Zoti deshi që shkencës së hadithit në këtë shekull t'i prijnë dijetarët shqiptarë që i njeh tërë bota islame, i respekton, nderon dhe me veprat e tyre kanë lënë histori që dëshmon për ta. Në realitet ka edhe shqiptarë të tjerë të rangut të tillë por këta të Hadithit janë të nivelit më të lartë, ngase sipas vlerësimeve Nasirudin Albani është dijetari numër një i shkencës së hadithit në tërë botën islame, dhe në shumë çështje kontestuese profesionale, fjala e tij është përfundimtare".

## **LETËRSIA DOKUMENTARE SHQIPE PËR PERSONALITETIN E PROFETIT TË ISLAMIT**

Fondi i letërsisë sonë dokumentare është relativisht i pasur . Në të përfshihen jetëshkrime të njerëzve të shquar që nga kohët më të lashta e deri në ditët tona.

Në këtë fond përfshihen dhe veprat kushtuar Muhammedit a.s., Profetit të islamit. Ato janë përkthime nga gjuhët e huaja ose dhe vepra origjinale. Për natyrën që kanë, ato mund t'i ndajmë në dy grupe: Mevludet, dhe Jetëshkrimet mbi Muhamedin a.s. (biografi, studime, ese, etj).

MEVLUDI "Është ode heroike me elemente të poemës, që i kushtohet jetës së Muhammedit a.s., duke filluar nga lindja deri në vdekje... është ode a poemë për personalitetin e Profetit islam, Muhammedit a.s.; është një krijim poetik."

Ditëlindja e Muhammedit a.s. filloi të kremtohet në vendet islame gjatë periudhës së sundimit të Fatimidëve të Egjiptit (909-1171) dhe që andej u përhap në tërë popujt islamikë. Kremtimi organizohej zakonisht në krye të çdo viti islam dhe vazhdonte me ditë të tëra i shoqëruar me një tok rimesh, melodish që këndoheshin vetëm ose në kor e që pershkruanin jetën e Muhammedit. Në këtë muaj filluan të festohen edhe ditëlindjet e personaliteteve të shquara. Kjo i shtyu shumë poetë t'i vihen kompozimit të biografisë së profetit në vargje dhe të na japin vepra të bukura poetike. Nga krijimet më të zgjedhura të kësaj gjinie konsiderohet Mevludi "Vesilet-un-Nexhat"(1409) i poetit turk Sulejman Çelebiu (1351-1422) nga Bursa. Kjo vepër iu bë e njohur botës shqiptare dhe ka shërbyer si gurrë frymëzimi për poetët tanë anonimë që i kanë thurur vargje ditëlindjes së Muhammedit (a.s.). Por nderi i autorit të parë, që i prin karvanit të poetëve që kanë shkruar mevlude, i përket Muzafërudin Gurburit, në gjuhën arabe, në shekullin XIII.

Kjo gjini ndikoi thellë edhe te krijuesit shqiptarë. Në jetën e myslimanëve të vendit tonë ceremonia e mevludit në mënyrë të organizuar dëshmohej se ka filluar të kremtohet me tekst shqip nga fundi i shekullit XVIII. Autori i Mevludit të parë shqip është Hasan Zyko Kamberi. Në historinë e letërsisë shqipe, Osman Myderizi, studiues i letërsisë shqipe me alfabet arab, për rastin e dhënë shkruan: "Mevludi (i H.Z.Kamberit) shquhet për disa tipare origjinale të hartimit dhe për realizimin e thjeshtë që e kujton Varibobën".

Në botimet e mëvonshme të Historisë së Letërsisë Shqipe dhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1985), kur flitet për H.Z.Kamberin dhe krijimtarinë e tij, nuk përmendet më Mevludi i tij, ashtu siç nuk përmenden edhe vepra të tjera me karakter fetar të Naimit "Qerbelaja", etj.

Në fund të shekullit XIX libri që ka depertuar më tepër në shtëpitë myslimane dhe është bërë mbarëpopullor, në mënyrë të veçantë në periudhën e kremtimit të Mevludit, është libri i Hafiz Ali Riza

Ulqinakut (1853-1913). Ky libër është botuar në vitin 1879 (1295 H ) në gjuhën shqipe, me alfabetin osman, me titull "Terxhyme-i mevlud ala lisani arnaud".

Vepra "Mevludi Sherif-Lindja e Hazreti Muhammedit Alejhisselam" është një përkthim i mevludit të Sulejman Çelebisë, por në të përfshihen edhe mjaft pjesë origjinale, siç është parathënia etj. Ai është shkruar në të folmen e Ulqinit, prej nga ishte dhe autori.

Me vendim nr.139, dt.26.09.1933 të Këshillit të Përhershëm të Komunitetit Mysliman, kjo vepër u botua me alfabetin latin si vepër postume, nga Shtëpia Botuese "Kristo Luarasi". Ribotime të kësaj vepre u bënë edhe më vonë nga Meshihati i Podgoricës më 1970 dhe 1975, si dhe nga Komuniteti Musliman i Tiranës dhe nga Biblioteka Muslimane Shqiptare e Miçiganit, Brukselit etj.

Vepra përmban 27 tituj, në të përfshihet edhe parathënia, ku autori tregon qëllimin që ka duke e shkruar në gjuhën shqipe. Ai shpreh këtu keqardhjen për numrin e paktë të librave me karakter islam që shumë pakë janë shkruar në gjuhën shqipe. Ai e quan një gjë të madhe që po e shkruante veprën në gjuhën e popullit dhe kombit të vet:

*N'gjuhë të Shqipes kam qëllim un me i tregue*

*Që kështu vllaznit sa do pak me përfitue.*

Ky mevlud dihet përmendësh nga shumë besimtarë dhe këndohet në shumë vise të Shqipërisë, të Kosovës dhe në trojet shqiptare të Malit të Zi, sidomos në Ulqin, vendlindja e autorit. Mevludi i Hfz. R. A. Ulqinakut, përveç edukimit fetar, ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe në mbijetësen e gjuhës shqipe. Ai ka spostuar variantin turqisht të Çelebiut dhe ka futur në mënyrë masive gjuhën shqipe në ritet fetare, duke e bërë me të kuptueshme përmbajtjen dhe më të afërt për ithtarët e besimit islam.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të këtij shekulli, në harkun kohor në mes Mevludeve të H.Z.Kamberit dhe të Hfz.A. Ulqinakut, janë botuar dhe disa të tjerë. Në trevat e Kosovës ka qenë përhapur dhe vazhdon ende Mevludi i Tahir Efendi Popovës, i cili për herë të parë u botua në Stamboll në vitin 1905 me titull "Mendhumentul mevlud fi efdalil mevvhud bi lisanil arneud" (Poezi mbi lindjen e krijesës me të lavdishme, në gjuhën shqipe) MEVLUD. Përveç botimit të parë me alfabet osman, ky Mevlud pati disa ribotime me alfabetin e gjuhës së sotme shqipe në Ankara dhe në Prishtinë. Botimi i vitit 1984 paraprihet nga një parathënie ("Disa fjalë në fillim") të Sh.Ahmetit, si edhe të një fjalori në fund të çdo faqeje për të lehtësuar kuptimin e tij. Duke qenë shumë i ngarkuar me fjalë të huaja, ky tekst nuk lejon ta shijosh përmbajtjen e tij të bukur.

Kemi të dhëna se një "Mevlud" në gjuhën shqipe me shkronja të alfabetit turk është botuar në Ankara më 1944 me autor H.Zejnulla Ozjashar. Gjithashtu jemi në dijeni se në vitin 1970 në Damask të Sirisë është botuar një mevlud në dialektin e Kosovës dhe me alfabet arab nga i njëjti autor por me emrin e tij të vërtetë, Zejnulla Jashari, i cili me origjinë ishte nga fshati Durbesh i rrethit të Gjilanit në Kosovë. Kemi bindjen se "Mevludi" i Jasharit është ribotim, që pason "Mevludin" e tij të botuar në Ankara.

Në zonën e Çamërisë ka qenë shumë popullor "Mevludi" i Hafiz Abdullah Zemblakut. Ky shërbeu për të mbajtur gjallë tonet islame dhe ato kombëtare gjatë gjithë kohës së ndrydhjes që ushtronin grekët mbi popullsinë shqiptare. Hfz.A. Zemblaku ka qenë njeri me veprimtari të gjerë fetare. Janë të njohura botimet e tij si "Hyttbet", "Tefsiri i Jasinit" etj.

Në zonën e Shqipërisë JL i njohur ka qenë sidomos "Mevludi-Lindja e Pejgamberit" i Hafiz Ali Korçës (1934).

Mevludi i Hfz.A.Korçës shquhet për një gjuhë më bashkëkohore, për një konceptim të ri në thurjen poetike. Hfz. A. Korça njihet për kulturën e tij të gjerë, për njohjen e gjuhëve klasike të Orientit, për qëndrimin e tij ndaj ateizmit dhe komunizmit.

Në vitet '30 personaliteti tjetër i botës shqiptare islame H.I.Dalliu, i njohur si teoricien dhe njekohësisht si publicist, botoi veprën "E lemja dhe jeta e të madhit Muhammed", Mevludi. Kjo vepër e **Hfz.I.Dalliu**, me përmbajtjen e saj të gjerë me rreth 6000 vargje, bën që të shquhet mbi të tjerët.

Në diasporën shqiptare të Amerikës fitoi popullarizim "Mevludi" i Idriz Lamajt. Ky "Mevlud" paraprihet nga një parathënie e Imam Vehbi Ismailit dhe shoqërohet nga trajtesat "Poezia shpirtërore islame", "Zanafilla e Mevludit" dhe "Poezia shqiptare islame të poetët shqiptarë dhe Mevludi shqiptar". Ky botim me panoramën që sjell përfaqëson një kontribut të ri në formimin e lexuesve lidhur me kulturën fetare islame. Idriz Lamaj ka një gjuhë mjaft të zgjedhur.

Dy vjet me vonë, në vitin 1984, besimtarëve myslimanë shqiptarë të Maqedonisë iu paraqit një variant i ri i Mevludit, i punuar nga Imam Fahredin Osmani dhe i përgatitur për shtyp nga Qufli Osmani. Botimi i këtij Mevludi, i pastruar nga fjalët orientale, si dhe më i pasur në tematikë, plotësoi një nevojë të kohës. Në parathënie shpjegohet se "Në çfarëdo alfabeti të shkruhet apo gjuhë të këndohet Mevludi, ka të njëjtin shpërblim (thevap) nga Zoti xh.sh., këtë e cekim ngase ende ekziston bindja e gabuar te disa individë... se "Mevludi"... me alfabetin arab ka më tepër shpërblim".

Mevludet në gjuhën shqipe janë shtypur në Stamboll, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Podgoricë, Vaterbury, Miçigan (SHBA), Bruksel, Ankara, Toronto, Damask etj. Ekzistojnë edhe shumë "Mevlude" në dorëshkrim, si p.sh. ai i Ismail Floqit, Abdullah Sulejman Konispolit dhe i Haxhi Miçigickos, Tahir Efendi Llukës etj.

Për të formuar një ide lidhur me evoluimin e formulimit gjuhësor të Mevludeve, po japim fragmente nga Mevludet e disa autoreve:

Hasan Zyko Kamberi  
Lumeja ti në këtë dynja,  
Lumeja ti ç'paske thënë,  
që të dhanë këtë evlat,  
tjatër ëme s'i është dhënë.

Hafiz Ali Ulqinaku  
Amine e ama e Muhammed Mustafasë,  
Prej asaj erdh Ai Diell i gjith dynjas,  
Në hak t'Asaj shum nishane u bën beli,  
Prej sadesfje leu Ajo kokërr Inxhi.

Hafiz Ali Korça  
Si ay ta duam iman' e vatanë

Për udhë rrefenjës mjaft kemi Kur'anë.  
Po mbajtmë Kur'anë, mbajtmë lumtërinë,  
Me të munt ta mbajme din' e kombësinë.

Tahir Efendi Popova

Sa lutje që bajmë te Ti me na i pranu,  
Dhe dëshirat të gjithëve me nai plotsu.

Idriz Lamaj

E lumja Emine kush do t'th'rras -Nanë,  
Yt bir, Profeti që gëzon tokë, hanë.

Fahrudin Osmani

Mu afrua dhe me gjoks ai më shtrëngoi  
M'tha: Lexo me emër të Zotit që të krijoj.

Konkludojmë që "Mevludet përfaqësojnë një syth të veçantë në letërsinë tonë dokumentare për rëndësinë e disaaneshme të tyre".

## JETËSHKRIMET KUSHTUAR PERSONALITETIT TË PROFETIT

Përveç Mevludeve ekzistojnë edhe jetëshkrimet kushtuar personalitetit të Profetit islam. Kryesisht këtu grupohen shkrime biografike në prozë, studime biografike, ese etj. Siç e pamë më lart, Mevludet iu kanë paraprirë këtyre studimeve. Biografi të plota për Muhammedin a.s filluan të botohen në shekullin tonë. Me daljen më vete të Shqipërisë, si dhe me krijimin e gjeneratave të reja që po mbaronin shkollat e mesme dhe studimet e larta, u ndie nevoja dhe u bë e mundur njohja më e thellë e jetës dhe të veprave të Profetit islam. Mevludet që këndoheshin në kolektiva të ndryshme gjatë një muaji, nuk plotesonin të dhënat për të cilat kishin nevojë besimtarët, sidomos brezi i ri. Si rrjedhim, filluan të botohen të dhëna të shkurtra biografike, fragmente të shkurtra dhe ese.

Në faqet e shtypit shqiptar, kohë pas kohe u botuan edhe artikuj nga autorë të huaj. Por të gjitha këta nuk i plotësonin kërkësat në rritje të besimtarëve dhe të intelektualëve shqiptarë në përgjithësi. Në përgjigje të këtyre nevojave, në vitin 1929 doli botimi i parë biografik me titull "Muhammedi Profeti i islamizms", vepër e autorit të mirënjohur Muhammed Ali nga Pakistani. Kjo vepër u përkthye nga Omer M.Sharra dhe u botua me miratimin e Këshillit të Lartë të Sheriatit. Vepra e lartpërmendur është një nga veprat e para në literaturën dokumentare shqipe. Ajo u prit shumë mirë nga publiku. Në parathënien e këtij libri, përkthyesi shpreh opinionin e tij se ky libër është "Kryesisht me u dhanë një dritë atyre që janë në errësirë dhe nuk kanë dijeni të vërtetë në parimet islame si dhe prijësin e këtij besimi". Përkthyesi, duke qenë i ndërgjegjshëm për antagonizmat që ekzistonin, i nisur nga qëllimi se ky libër do të shërbejë edhe në aspektin e edukimit patriotik, shton se qëllimi i këtij libri është edhe hedhja e themeleve për një afrim me të ngushtë, dhe një bashkpunim më të sigurtë mes njerëzve. Duke parë

se shpeshherë në opinionin e disa shtresave kishte tendenca nënvlerësimi, përkthyesi e mbyll parathënien e tij me bindjen se libri i M.Aliut do të japë njohuri të tilla mbi figurën e madhe të Muhammedit a.s. si mirëbërës i njerëzimit, duke i dhënë atij atë vend nderi që edhe myslimanët u japin prijësve të feve të tjera.

Me kalimin e kohës, ky libër, megjithëqë pati ribotime, nuk i përmbushte plotësisht kërkesat e shoqërisë intelektuale shqiptare në rritje. Fluksi i ideve komuniste që po përhapeshin në Shqipëri e bëri të nevojshme nxjerrjen në pah të Muhammedit a.s. në tërë dimensionet e tij.

Pikërisht në këtë kohë, Beqir Çela, një nga intelektualët më të shquar shqiptarë dhe njohës i mirë i qytetërimit britanik, përktheu kryeveprën e personalitetit anglez të shekullit XIX, Thomas Carlylit (1795-1881) "Heroi si profet -Muhammedi dhe islamizma", me parathënie të Ismet Totos, një nga përfaqësuesit më të dëgjuar të neoshqiptarizmit për kohën. Kjo vepër e kishte bërë të dëgjuar Carlylin në publikun anglo-amerikan që në vitin 1840, kur kjo vepër u botua për herë të parë në Londër.

Intelektualët shqiptarë, duke lexuar këtë vepër, panë se mendimtari i shquar anglez e vlerësonte shumë lart Muhammedin dhe veprën e tij. Carlyli e dashuroi heroin e tij. Ai shkruan se Muhammedi ishte "Një karakter serioz dhe i sinqertë, por prapë i dhembës, i shoqërueshëm, bile dhe shakatar, një qeshje e mirë në buzët e tij". Njerëzit që e rrethonin kishin vënë re "se ai gjithmonë fliste diçka plotëkuptim, se ishte një njeri i parrëmbyer në fjalë, i heshtur kur nuk duhej me thanë gja, por i qëllimshëm, i mençur dhe i sinqertë, kur fliste, gjithmonë, duke i hedhur dritë çështjes".

Në këtë përkthim lexuesit gjetën edhe përkthimin fizik të profetit nga autori: "Fytyrën e tij të hijshme, mendjen e ndritur dhe të ndershme, në ngjyrë të përzieme kuq e kafërenje dhe sytë e zes të shkëlqyeshëm".

Në botën intelektuale, botimi i kësaj vepre në gjuhën shqipe pati jehonë të veçantë. Zbulimi i figurës së Muhammedit a.s. nëpërmjet kësaj kryevepre që dilte nga pena e Carlylit lëkundti shumë pikëpamje, rrëzoi shumë opinione të gabuara dhe detyroi mjaft njerëz që personalitetin e Muhammedit a.s. t'a shihnin në një optikë të re. Carlyli theksonte se "Ai nuk mundet të jetë ndryshe, veçse i singërt" dhe se "Feja e tij nuk ishte një fe e lehtë, por me agjërime të veshtira, lajme, formula të koklavitura e të rrepta, falje pesë herë në ditë dhe shmangie prej verës" (faqe 59). Lexuesit shqiptarë panë se Carlyli e vlerësonte veprën e Muhammedit a.s dhe fjalët e tij nga ana letrare shumë lart. "Une mendoj, - se as në ungjill as gjëkund gjetkë nuk është shkruar një gjë e tillë me vlere të barazueshme".

Jehona e përkthimit të Carlylit u përsërit në diasporën shqiptare të Amerikës në vitet '90. Ajo pati dy ribotime. Suksesi që korri tregoi edhe një herë vlerën që ka edhe vendin që zë Muhammedi a.s. në historinë botërore, aq më tepër kur një vlerësim i tillë nxirrej nga një mendimtar anglez, siç ishte Tommas Carlyli, kundërshtar i materializmit dhe i racionalizmit.

Një vepër e plotë mbi jetëshkrimin e Muhammedit a.s në këto vite u shkrua nga Hafiz Ibrahim Dalliu. Kjo vepër titullohej "E lemja dhe jeta e të madhit Muhammed a.s.". Kjo vepër u shkrua në poezi në bazë të modelit lindor të ilahive, që shoqërohen me muzikë. Ajo përmban 31 tema, duke formuar kështu në tërësi një poemë të gjatë, nga më të gjatat në gjuhën shqipe. Vepra në bazë të strukturës që ka paraqet karakter të dyfishtë: Ajo është në të njëjtën kohë mevlud, dhe po në të njëjtën kohë edhe një libër biografik.

Poema përmban një informacion të gjerë mbi jetën dhe veprimtarinë e Muhammedit (a.s.), shkruar me një gjuhë popullore, të thjeshtë dhe pa pretendime stilistike. Natyrisht që në këtë poemë ka plot figura letrare, përshkrime patetike që ngjallin emocione të forta, epitete, krahasime të bukura, por njëherazi vepra ka edhe mjaft fjalë të huaja.

Në arkivin e Peshkopit Fan.S.Noli, Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë është gjendur një ese me titull "Muhammedi". Ky punim i Nolit u përfshi në botimin e veprave të tij të plota, në vëllimin e katërt.

Afirmimi që i bën Noli personalitetit të Muhammedit (a.s.), i përforcon tezat e Th. Carlylit. "Islami-thekson Noli,- ishte një lëvizje shoqërore e klasave të ulëta". Noli, si historian bën konkluzionin rreth islamizmit me këto fjalë: "Një varg reformash, mund t'i atribohen drejtpërsëdrejti Muhammedit (a.s.). Këto janë: Monoteizmi, zhdukja e idhujtarisë, heqja e flijeve njerëzore, heqja e vrasjes së fëmijeve, heqja e feudeve fisnore, heqja e kastave shoqërore në gjirin e islamit, ndalimi i pijeve alkoolike, kufizimi dhe rregullimi i poligamisë, reforma në të mirë të grave dhe të klasave të ulëta, trajtimi njerëzor i skllëvërve joislamike, vëllazerimi i përgjithshëm brenda përbrenda islamit pa dallim race dhe ngjyre".

Interes të veçantë paraqet trajtimi që F.Noli i bën poligamisë, e cila është bërë objekt sulmi, duke iu dhënë ngjyrat më keqdashëse. Sipas peshkopit shqiptar: "Është fakt historik që çdo martesë e Muhammedit pas vdekjes së Hatixhesë mund të shpjegohet si një akt i nevojës politike, sepse të gjitha gratë e tij, me përjashtim të Aishes, ishin gra të veja, të shokëve të tij të vrarë në luftë, këto ishin të gjitha të një moshe mesatare, çka në Arabi ka kuptimin shumë të moshuara, sepse atje gratë janë të pjekura që në moshën 10-vjeçare. Prandaj, ai koleksion i mjerueshëm grash plaka ishte thjesht karikatura e një haremi, siç e kupton zakonisht Përendimi. Në të vërtetë ai qe një azil varfanjakësh për gra të veja e të moshuara".

Një numër botimesh fragmentare mbi jetën e Muhammedit (a.s.) vërshuan gjatë viteve '30 dhe në fillim të viteve '40. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me vendosjen eregjimit komunist në Shqipëri, aktiviteti fetar dhe botimet me karakter kulturor islamik sikurse kemi thënë u ndërprejnë. Kjo gjendje asfiksie për shtypin islamik vazhdoi për gati pesë dekada. Botimet e pakta që kishin mbetur

nëpër duart e besimtarëve ose të bibliofilëve u mbajtën nëpër qelitë e shtëpive për të bërë "gjumë" të imponuar nga diktatura komuniste.

Botimet fetare në gjuhën shqipe tani kaluan në duart e diasporës shqiptare. Më vonë rilindi iniciativa e shtypit dhe në trevat shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia.

Viti 1960 është një vit sihariqi për të gjithë besimtarët islamë shqiptarë. Imami i myslimanëve të Miçiganit të SHBA-së, shqiptari Vehbi Ismaili, pas një pune shumë- vjeçare të kujdesshme dhe plot pasion arriti të hartojë të parën vepër origjinale mbi jetën e Muhammedit (a.s) në prozë. Nga ana kronologjike kjo është e dyta në gjuhën shqipe(origjinale). Siç dihet në Miçigan të SHBA-së, ishte themeluar "Albanian Islamic Center Harper Woods", e cila në organikën e saj përfshin edhe bibliotekën myslimane shqiptare. Kjo bibliotekë ka një veprimtari të gjerë. Në këtë veprimtari përfshihet edhe botimi i kësaj vepre.

"Muhammedi Profeti Islam" vepër e I.V. Ismailit është ndërtuar mbi bazën e gjinisë së tregimit. Ajo është shkruar me pathos dhe ëshë paraqitur me një stil të thjeshtë dhe joshës. Ilustrimet e bëjnë atë edhe më të rrokshme. Pa mbushur ende 10 vjet, ky libër me biografinë e Profetit, pati jehonë të madhe dhe në shumë vende të tjera. Nuk kaloi shumë kohë dhe ai u përkthye në gjuhë të tjera si: në arabisht, anglisht, gjermanisht, persisht, polonisht, serbokroatisht dhe rusisht. Nëpërmjet këtij libri, literatura shqiptare dhe me sakte gjinia e tregimit të saj fitoi terren të ri njohjeje, sidomos në moshat e reja muslimane të këtyre vendeve. Edhe në gjuhën shqipe kjo vepër pati disa ribotime.

Gjatë viteve '80 - '90, me kujdesin e mecenëve të Vebi Ismailit dhe Isa Hoxhës, "Bibliotekat myslimane shqiptare" të qendrave islamike shqiptare të Miçiganit, New Yorkut, New Jerseyt dhe Torontos bënë një numër të konsiderueshëm botimesh me këtë subjekt. Ato janë kryesisht përkthime nga anglishtja

ose arabishtja, si dhe ribotime. Në mes këtyre botimeve të tërheq vëmendjen vepra e mendimtarit të shquar amerikan Robert L. Gulick, JR. "Muhammedi edukator", drama e shkrimtarit të njohur egjiptian, Teufik el Hakimit "Muhammedi profeti njeri", tregimet e Abdet-Tev-vab Jusuf "Muhammedi (në njëzet tregime)". Edhe diaspora shqiptare e Belgjikës ndoqi këtë shembull përsa i përket botimeve mbi këtë temë.

Kësaj serie i përket dhe vepra e Halit Muhamed Halit "Humaniteti i Muhammedit a.s.", (përkthyer nga Neshat Xheladini), i cili është autor i më se 40 monografive. M.F.Halidi në shkrimet e tij ka pasur si moto: "Lirinë, logjikën dhe përparimin". Mëshira, drejtësia, dashuria dhe përsosmëria morale janë objekt trajtimi në këtë libër. M.Halid qe pedagog i Universitetit të El Az'harit.

Me rrëzimin e regjimeve komuniste në vendet e Lindjes, botimet për këtë temë rifilluan në Shqipëri dhe u dendësuan në të gjitha trevat shqiptare dhe në diasporë, ku ka grupime myslimanësh shqiptarë.

Serinë e veprave të letërsisë dokumentare me subjekt biografik mbi Muhammedin (a.s.)e hapi Shtëpia Botuese "Dituria"-Tiranë, 1991, me ribotimin e veprës së Muhammed Aliut "Muhammedi - profeti ynë". Ky botim është nga botimet me tirazh me të madh të bëra në gjuhën shqipe - 25000 kopje. Fatkeqësisht nuk shënohet këtu përkthyesi dhe as origjina e autorit. Në parathënie ka vetëm të shënuar: Lahore, 25 gusht 1923 dhe emrin e autorit Muhamed Ali, si edhe dy redaktorët : Ali Musa Basha dhe Françesk Ziri.

Dy vjet më vonë, më 1993, pa dritën një vepër tjetër e vëllimshme me rreth 800 faqe me këtë subjekt. Vepra është origjinale, e treta e këtij lloji në gjuhën shqipe nga autori Prof.Vehbi Sulejman Gavoçi. Kjo vepër mban si titull "Jeta e Profetit Muhammed(A.S.S). Ajo përmban të dhëna të shumta mbi jetën dhe veprimtarinë e Profetit,por atë e vështirëson gjuha arkaike dhe dialektore si edhe gabimet e shumta

drejtshkrimore. Këto mungesa, që mund të mënjanoheshin me një redaktim të kujdesshëm, nuk lënë të shijosh përmbajtjen e pasur që autori ka shkruar me dashuri të thellë. Mjafton të lexosh parathënien e kësaj vepre për të kuptuar dashurinë e këtij autori dhe dëshirën për t'i shërbyer vëllezerve të tij në Shqipëri, në trevat shqiptare dhe në diasporë.

Në vitin 1994, Shtëpia Botuese e Shkupit "Logos-A" botoi biografinë "Jeta e të dërguarit Muhammed S.A.V.", të përkthyer nga anglishtja. Kësaj tematike i përkasin edhe disa botime të tjera që i kushtohen jetës dhe veprimtarisë së bashkëpunëtorëve të Muhammedit (a.s.), që kanë edhe ata rolin e tyre.

Botime fragmentare mbi vlerat e mendimit teorik të profetit, mbi qëndrimet ndaj shkencës dhe artit, ndaj problemeve sociale që i preokupojnë të gjithë, ndaj qëndrimit që duhet mbajtur ndaj fanatizmit dhe korrupsionit, si edhe qëndrimet e kolosëve të mendimit, qoftë lindorë, qoftë atyre përendimorë, nuk do t'i trajtojmë në këtë studim.

Të gjitha këto pershtypje janë të përmbledhura në poezinë e J.V.Gëtes "Kënga e Muhammedit", të përmbledhura në veprën "Poezi të ndryshme". Kjo poezi është përkthyer në shqip nga dy përkthyes të mirënjohur: Skënder Luarasi dhe Perikli Jorgoni.

## **TRAJTIMET E BESIMIT ISLAM, I PERSONALITETEVE DHE NDIKIMI I TYRE NË KULTURËN KOMBËTARE NËPËRMJET VEPRIMTARIVE LAIKE**

Një rol të veçantë në pasurimin e kulturës islame kanë luajtur edhe trajtimet e besimit islam, i personaliteteve dhe i ndikimit të tyre në kulturën kombëtare nëpërmjet veprimtarive laike. Trajtimi i besimit mysliman në botimet apo në veprimtaritë shkencore, artistike, etj. ashtu si edhe të besimeve të tjera, si pjesë e jetës shpirtërore të popullit, kanë qenë diçka normale në punën e studiuesve, të krijuesve, në tërë traditën shqiptare të këtyre fushave. Por, harmonizimi i kësaj pune me veprimtarinë laike nuk ka qenë gjithnjë i njëjtë. Ai ka pasur edhe luhatjet e veta, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, për arsyt që tashmë dihen, fillimisht duke u zbehur dhe pastaj në ndalimin kategorik e deri në dhënien e ngjyimeve ateiste edhe të këtyre veprimtarive studimore, e artistike e kulturore në tërësi.

Kjo fushë veprimtarie është shfaqur në këto drejtime kryesore:

Së pari: Duke ruajtur rigorozitetin e vet shkencor, veprimtaria studimore ka pasqyruar edhe idetë e pikëpamjet fetare të autorëve, të njerëzve të thjeshtë apo personalitete qofshin, bashkë me pikëpamjet apo ndjenjat e tjera.

Së dyti: Liria e forcave shkencore e krijuese për të zgjedhur tematikën e tyre, si objekt studimi apo krijimi, ka mundësuar ndriçimin sadopak edhe të elemente të besimit islam apo të besimeve të tjera në Zotin, të kulturës islame apo të kulturave të tjera, si pjesë e kulturës kombëtare shqiptare.

Së treti: veprimtaria letrare e publicistike me anë të shtypit të ditës apo atij periodik ka trajtuar edhe probleme të besimit islam, të afirmimit të veprimtarive me rrezatim në jetën shpirtërore të njerëzve tanë. Edhe bashkëpunimi me letrarë e publicistë për të trajtuar probleme të kësaj natyre në shtypin laik, nuk ka qenë pa rrjedhojë pozitive në kulturën islame.

Së katërti: Arti e kultura, si shprehje të botës shpirtërore të njerëzve, të njohura e të dashura për ta, krahas pasqyrimin tërësor të botës shpirtërore të njerëzve, ka pasqyruar edhe besimin në Zotin, në islamin apo në një besim tjetër.

Së pesti: veprimtaritë studimore e shkencore të organizuara për probleme sociale e fetare të besimit islam, por me një përqëndrim forcash shumë të kualifikuara, kanë ndikuar ndjeshëm edhe në pasqyrimin e aspekteve të ndryshme të kulturës shqiptare.

Dihet, p.sh., që veprat e Naimit, të Fishtës, apo të autorëve të tjerë, në mes të tjerave, krahas problematikës kombëtare të drejtpërdrejtë, kanë edhe dimensionet e tyre sociale e fetare. Konkretisht islamizmi i Naimit jo vetëm nëpërmjet vargjeve të veçanta, si "E po silli Zotit besë dhe kësaj fjalëzës sime..." por edhe në vepra të drejtpërdrejta si poema "Qerbelaja...". Njëanshmëria në trajtimin e këtyre kolosëve të kulturës shqiptare, duke u shmangur mendimin fetar, është një mungesë e vërtetë e trajtimit shkencor të tyre.

Vitet e fundit ka filluar një ridimensionim i kësaj trajtese. Madje, për Naimin, jo vetëm duke e studiuar në pikëpamje letrare, gjuhësore, stili etj., por ka përpjekje edhe për trajtesa në caqe disertacionesh për mendimin fetar të tij.

Para pak vitesh u ndërmorën disa studime edhe për njohjen më mirë të personalitetit të shquar islam e të kulturës shqiptare, Rexhep Voka. i lënë në hije nga synime të caktuara sllavokomuniste. Duke

përqendruar forcat më të kualifikuara të intelektualëve shqiptarë në ish-Republikën e Maqedonisë, u ndërmorën studime për probleme të gjuhës së Vokës, të stilit të tij, të mendimit pedagogjik e të veprimtarisë arsimore, si dhe të ideve e pikëpamjeve të tij filozofike e fetare etj. Mbi bazën e këtyre studimeve u mbajt një simpozium, i shoqëruar me veprimtari të tjera social-kulturore. Sigurisht nuk pretendohet se është shterruar studimi i këtij personaliteti, por nga një veprim i organizuar laik u evidentuan edhe disa nga dukuritë fetare të këtij personaliteti të shquar të besimit dhe të kulturës.

Akademiku Jashar Rexhepagiqi me botimin e tij: "Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të Kombësisë Shqiptare në territorin e Jugosllavesë së sotme, deri në vitin 1918", botuar në serbokroatisht dhe shqip, përkatësisht 1968 e 1970, evidenton edhe disa veprimtarë të shquar fetarë dhe arsimorë njëkohësisht. Puna e tyre shërbeu si nxitje e frymëzimit për hoxhallarët e klerikët e tjerë myslimanë, por edhe si material për studiuesit e fushave të edukimit shqiptar, ku kishte peshën e vetë të rëndësishme edhe edukimi me parimet e moralit islam. Këtij qëllimi i shërbyen, gjithashtu edhe studime të tjera të këtij autori, si "Shkollat shqipe veçanërisht në Kosovë në vitet 1908-1910" etj.

Studime komplekse janë ndërmarrë edhe nga disa institucione shoqërore, shoqata, me personalitete të tjera, siç është rasti për Haxhi Vehbi Dibren dhe Haki Sharofin, për të cilët u mbajtën sesione shkencore të organizuara nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" dhe Shoqata Intelektuale "Kultura Islame", gjatë vitit 1994.

Mandej botimet më të plota të veprave të Sami dhe Naim Frashërit, që panë dritën e publikimit dinjitoz në Kosovë, lanë shtigje për të kuptuar edhe pikëpamjet e tyre fetare islame, çka nuk u bë në shtetin amë.

Madhështia e Hasan Tahsinit në fushën e edukimit vërehet edhe në veprën "Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes", një vepër tërësisht laike, si dhe "Mësuesit për Kombin Shqiptar", të cilat për objekt kanë veprimtarinë arsimore e pedagogjike edhe të disa personaliteteve në radhët e hoxhollarëve të shquar. Kjo e fundit trajton për herë të parë dhjetëra mësues hoxhollarë e shehlerë, disa prej të cilëve, edhe pse trajtohen mbi kriterin problemor, zënë një kapitull të veçantë, siç janë: Rexhep Voka, Ibrahim Dalliu, Hafiz Shëmsedini, etj, përveç dhjetëra të tjerëve që edhe këta përfshihen për herë të parë në një studim shkencor laik.

Edhe në Revistën Pedagogjike, botuar në Tiranë, janë botuar, në mes tjerash, artikuj studimorë që trajtojnë probleme të mejtepeve e të alterimit të veprimtarisë fetare me atë arsimore, sidomos nga Sulë Dedei.

Botimi i monografisë "Gostivari dhe Abdylhaqim Dogani" trajton jo vetëm veprimtarinë arsimore të mësuesit të shquar Abdylhaqim Dogani prej Gostivari, në gjuhën amtare shqipe, por edhe veprimtarinë e tij tepër të veçantë në botimet shkollore e didaktike, me synime në përmërsimin e nivelit të mësimdhënies në shkollat shqipe islame. Përveç abetareve shqipe me alfabet arab, turk, por edhe latin, në vitin 1946, Dogani boton edhe "Sistemi i ri i mësimi fetar sipas parimeve të pedagogjisë, në alfabetin turk. Por, Dogani ishte njëkohësisht edhe një mësues shumë i afirmuar i lëndëve të edukatës fetare, që shquhej në radhët e mësuesve në shkollat laike, të cilët miratoheshin me vendime të rëndësishme e të posaçme nga Tirana (është fjala për Shqipërinë etnike).

Pas proceseve të demokratizimit dhe të vendosjes së pluralizmit në disa vende, të europës JL përfshirë edhe Shqipërinë dhe viset tjera ku jetojnë shqiptarët në trojet e tyre, në Kosovë, Mal të Zi e në ish Republikën jugosllave të Maqedonisë, botimet në fushën e besimit u bënë më të hapura e të lira. Këto përfshinë edhe veprimtarinë publicistike. Në organe të partive politike ose të pavarura pati studime për

probleme e shqetësime të besimtarëve të Komunitetit Islam, portrete personalitetesh fetare, pasqyrim të veprimtarisë së tyre etj. Veçanërisht artikujt e Abdi Baletës dhe të Hysen Çobanit kanë zënë një vend të veçantë për të argumentuar teorikisht e praktikisht pikëpamje të gabuara apo të qëllimshme kundër islamizmit në viset shqiptare. Këta autorë kanë botuar edhe vëllime më vete për synime të caktuara në dobi të kombit shqiptar e të besimit islam.

Edhe botimi i Ahmet Kondos kushtuar jetës dhe veprimtarisë së personalitetit të shquar të kulturës shqiptare, Vexhi Buharaja, ndriçon në mënyrë të tërthortë, por edhe të drejtpërdrejtë veprimtarinë e një orientalisti edhe në dobi të kulturës islame në Shqipëri. i kësaj natyre është edhe botimi i monografisë së Demir Behlulit "Arabeska origjinale, në xhami të Kosovës Lindore (1984-1994)" për të cilën H. Sulejman Rexhepi, kryetar i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, shkruan: "...Kjo vepër, e para e llojit të vet në librat shqip, dëshmon për një punë dhjetëvjeçare të Demir Behlulit, që e bëri në 17 xhami të ndryshme. Vlen të përhëndetet sidomos tendenca dhe guximi i tij, që krahas arabeskave origjinale, të "murosë" edhe arabeskat shqiptare, krahas shenjave fetare të përdorë edhe ato kombëtare, florës origjinale t'ia ndërlihdë edhe ato autoktone, krahas shtyllave të mermerta, të krijojë, përmes teknikës së vet, edhe ato shtylla origjinale me pamje të llojit të lisit që rritet nëpër trevat shqiptare...

Zoti i shpërbleftë të gjithë ata që kujdesen për shtëpinë e Tij!"- përfundon H. Sulejman Rexhepi.

Në atë punim njihet lexuesi me artin islam, me pikturën, skulpturën, arkitekturën, me dekorin, modelet dhe pastaj flitet për xhamitë e vjetra në Kosovë, për objektet arkitektonike të kultit, për tyrbet, sahatkullat, hamamet etj. Analizohen vlerat e shumë objekteve fetare në Kosovë. i një rëndësie të veçantë është edhe përkthimi i mbishkrimeve Kur'anore në gjuhën shqipe.

Në monografitë kushtuar qendrave, qyteteve apo fshatrave, sidomos në tre prej tyre shikojmë një pasqyrim me vërtetësi të institucioneve fetare islame, si pjesë e kulturës së qytetit apo të zonës a fshatit.

Tek monografia "Piroku ynë", e Daut Izairit, një botim njaft dinjitoz, rreth 300 faqesh, zë vendin e vet edhe xhamia, duke i lënë një kapitull të veçantë. "Dihet mirëfilli -thuhet në këtë kapitull- se inisiativën e ndërtimit të këtij tempulli e pati kryeplaku i atëhershëm Haxhi Beqir Rexhep Kurtishi, pjesëtar i familjes së Hasanollarëve. Për ndërtimin e xhamisë, kanë dhënë lëndë ndërtuese, të holla dhe kanë kryer punë vullnetare të gjithë fshatarët.

Pasi jepen imamët që kanë kryer procesione fetare islamike, në mes të tjerave, thuhet: "Përveç faljes së xhumasë në xhami, imamët ose muezinët kanë kryer edhe detyra të tjera si: vaize, nasihate, mësimin e fëmijëve në leximin e Kur'anit, ilmihallin, ahlakun, edukatën morale, hatmeve (lexim Kur'anin), leximin e mevludit si dhe punë tjera fetare të nevojshme për banorët e fshatit."

Në monografinë "Gradeci (Draudakum)" të Dr. Musa Krajës dhe Dr. Sejfedin Harunit, krahas trajtimit historik, ekonomik -shoqëror, arsimor e kulturor, një kapitull i veçantë zë "Xhamia dhe xhemati". Aty jepen specifikat e xhamisë madhështore të Gradecit, me të dhëna të sakta të saj, të funksionimit, të punës së imamëve, të këshillit të xhamisë, të besimtarëve dhe të rolit të këtij institucioni në jetën shpirtërore të fshatit prej 5 mijë banorësh, të shoqëruara edhe me disa fotografi.

Këtë kontribut sjell edhe monografia "Ulqini", si dhe albumi fotografik me pamje nga qyteti, që evidenton edhe objektet kulturore të kultit islam në atë qytet.

Tashti nuk tingëllon normale një praktikë pune studimore, pa e pasqyruar në optikën e vet edhe rolin e fesë në një fushë apo në një tjetër, jo formalisht, por për peshën e jashtëzakonshme që ka ajo në ndikimin e botës shpirtërore të besimtarëve të vet. Shembujt nuk janë të paktë. Në një botim

"Hakmarrja tek shqiptarët" jepet edhe një kapitull i veçantë, me titull: "Optika fetare për ndjenjën dhe veprimin hakmarrës".

Në leksionet e seminarët e Pedagogjisë që zhvillohen në Universitet tek pjesët mbi teorinë e edukimit, në pedagogji të përgjithshme, tashmë nënvizohet edhe roli i fuqishëm edukativ i fesë dhe i institucioneve të saj për edukimin e njerëzve. Kjo jo vetëm nuk e cënon karakterin laik të shkollës, por e forcon karakterin shkencor të saj. Kështu edhe në letërsi, psikologji, sociologji etj.

Ditët e fundit doli nga shtypi një punim shkencor i një grupi autorësh, personalitete të fushës së edukimit, me titull: "Reflektime social- pedagogjike", me autorë nga Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Universiteti i Tetovës, Akademia Pedagogjike e Shkupit, Universiteti i Prishtinës dhe nga Turqia. Në një botim të tillë laik, specialistësh të afirmuar, në mes të problemeve të tjera, janë trajtuar edhe probleme që ndriçojnë islamizmin në disa drejtime të caktuara të studiuara. Në mes tyre janë: "Idetë arsimore të Islamit", nga Kolë Tahiri, profesor në Universitetin e Tiranës, "Qëndrimi ndaj fesë dhe motivacioni religjioz i studentëve dhe i intelektualëve" nga Adem Tamo, po profesor i këtij universiteti.

Edhe në fakultetet e shkencave shoqërore, në institucionet e tjera, shoqatat kulturore e atdhetare, ashtu siç janë organizuar veprimtari studimore, e simpoziume për probleme të ndryshme. Me të drejtë është organizuar edhe ndonjë simpozium kushtuar ndikimit të ndërsjelltë të kulturave në mes popullit tonë e popujve të Lindjes së Afërme. Në këto aktivitete janë mbajtur kumtesa interesante, disa prej të cilave edhe për ndriçimin e çështjeve të veçanta, ku ndihet ndikimi i islamizmit, siç qe sesioni i organizuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Shoqata "Hasan Tahsini".

Në literaturën laike të botuar, me vlera të veçanta janë studimet e profesor Skëndër Rizajt, sidomos libri "Kosova, Shqiptarët dhe Turqit dje, sot dhe nesër", të cilat janë rrjedhojë e shfrytëzimit, si rrallë studiues shqiptarë, të arkivave të pasur të Turqisë, përfshirë edhe ata të ish- Perandorisë Osmane.

Edhe botimet e realizuara nga shoqata dhe komunitete fetare kanë ndikimin e tyre të ndjeshëm në tërë jetën kulturore, pse e pasurojnë dhe e thellojnë konceptimin bashkëkohor të çështjeve të veçanta. Në një seminar ndërkombëtar që organizoi Shoqata e Intelektualëve Shqiptarë "Kultura Islame", në dhjetor të vitit 1994, u mbajtën shumë kumtesa interesante, rrjedhojë e studimeve të kryera me theksime të veçanta aktuale dhe perspektive, në mes të cilave nënvizojmë: "Shqipëria sot dhe nesër, islami dhe identiteti i Shqipërisë sot në Evropë"; "Besimi mysliman është pjesë integrale e nacionalizmit shqiptar"; "Kontributi i klerit mysliman në pavarësinë dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptar" (1912-1939); "Vlera e objekteve të kultit mysliman të shkatërruara dhe mundësia e restaurimit të tyre"; "Personaliteti i Profetit të islamit në letërsinë dokumentare shqipe". Me shumë interes u pritën edhe dy kumtesa mbi fundamentalizmin fetar, si rrymë politike antifetare, si dhe një kumtim: "Islami në letërsinë shqipe dhe ndikimi në jetën shqiptare".

Ndërsa simpoziumi ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë në vitin 1992, me temë: "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët", i organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, trajton gjerësisht jo vetëm shumë probleme të drejtpërdrejta të besimit islam, por edhe shumë çështje të tjera, ose ndihmesa të studiuesve islamë apo të besimeve të tjera për arsimin, kulturën, shkencën etj. në të gjitha trevat shqiptare.

Nga kumtesat e mbajtura dhe ato që nuk mundën të lexoheshin, (ndonëse nuk u mblodhën të gjitha), u arrit të botohen 72 prej tyre, nga studiues prej të gjitha trevave shqiptare.

Interes të veçantë paraqesin kumtesat: "Bazat e fesë islame"; "E vërteta dhe paragjykimet për islamin në botë dhe ndër shqiptarët"; "Roli i islamit në integrimin e Shqipërisë etnike dhe të kombit shqiptar"; "Idetë edukative të Kur'anit"; "Fushat e veprimit filozofik në besimin islam"; "Momente të kalimit në islam të popullsisë shqiptare në shek. XV-XVII"; "Shkaqet e pranimit të popullsisë së krishtere në klasën e spahijve"; "Popullsia myslimane shqiptare në Ballkan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX"; "Disa elemente të besimit pagan në kulturën islame ndër shqiptarët"; "Prania e kulturës arabe-islame në mite, rite e besime popullore shqiptare"; "Toleranca fetare në mes myslimanëve dhe katolikëve në Kosovë"; "Toleranca në lëvizjet çlirimtare të popullit shqiptar (shek. XVII-XVIII)"; "Tëparë të bektashizmit të shqiptarët gjatë Rilindjes"; "Islami si dukuri sociolinguistike shqiptare në shembull të folmes së Shkodrës"; "Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare"; "Patriotizmi dhe besimi i Haxhi Ymer Prizrenit shikuar nga pikëpamja psikologjike dhe etike".

Tema të tjera shumë të rëndësishme ishin edhe ato me përqasje në fushën sociale, në publicistikë, gjuhësi, në historinë e arsimit e të mendimit pedagogjik shqiptar, në fushën e politikës kombëtare, në histori, etnografi, etnopsikikë, në diplomaci, arkivistikë etj, të cilat janë një bazë e mirë për thellimin e mëtejshëm, madje edhe me pretendime deri edhe në monografi të veçanta, që do pasurojnë bibliotekën islame e atë mbarë- kulturore shqiptare.

Edhe të tjera veprimtari laike i kanë shërbyer vitet e fundit besimit islam, ashtu si edhe besimeve të tjera, ndriçimit të shumë pamjeve me ndikime në botën shpirtërore të njerëzve tanë.

Botimet e shumë artikujve publicistikë e studimorë në organet e shtypit, si në "Rilindja", "Dardania", në "Kosova", e sidomos në revistën shkencore "Perla" e të tjera, kanë pasur dhe kanë vlera të ndjeshme studimore dhe afirmuese për çështje të veçanta të besimit islam, të personaliteteve të njohura apo të paevidentuara.

Gazetarë me interesa intelektuale e morale të caktuara i nxjerrin elementet që i përkasin së ardhmes, që i paraprijnë asaj, duke shkruar për to, për faktet e dukuritë e tyre, duke përfshirë edhe dukuritë fetare, veçanërisht islame. Duke i zbërthyer e përpunuar në optikën e publicistit bashkëkohor prirjet e drejtimit e tilla për të ardhmen, siç është rritja në mënyrë shumë të ndjeshme e numrit të të rinjve që besojnë, ato sigurojnë edhe bashkëpunëtorë të kualifikuar në këtë fushë, që së bashku të ndikojnë në përpunimin e opinionit, e në radhë të parë për atë të besimit islam.

## **KREU IV**

# **FIGURA TË SHQUARA ISLAME DHE KONTRIBUTI I TYRE NË EDUKIMIN KULTUROR DHE SHPIRTËROR TË SHQIPTARËVE**

Njerëzit e shquar, cilës do fushë t'i përkasin, i japin fizionominë kombit, e mbajnë gjallë atë. Ndaj çdo popull i përjetëson ata duke i nderuar me emrat e tyre qytetet, rrugët, institucionet, shkollat etj. Çdo emër i harruar është një faj, çdo emër i mohuar përbën një krim, historik. Një krim përbën edhe një shtrembërim me dashje.

Historia e shekullit XX, për popullin shqiptar, është plot kthesa, plot batica dhe zbatica, plot heronj të heshtur. Faqet e historisë të këtij shekulli regjistrojnë dy lufta botërore, një luftë ballkanike, disa ngritje flamuresh, një shpallje pavarësie, disa beteja, disa kongrese, disa kushtetuta laike, ateiste, disa deportime të dhunshme, një gjenocid antiklerikal, disa fushata për zhdukjen e faltoreve, klerikëve etj.

Në këtë vorbull të këtij shekulli, kanë jetuar, vepruar dhe janë përpjekur një mori mendimtarësh, predikuesish, luftëtarësh islamë. Disa prej tyre janë imponuar me gjakun, djersën dhe qëndrimin e tyre në kthesa historike, por disa i janë nënshtruar heshtjes së rëndë. Ishte pikërisht një thirrje nga brenda, një detyrë kombëtare, një ndjenjë drejtësie t'i nxjerrë në dritë, t'i vlerësoi, këto figura që e lartësuan fenë islame, kombin tonë, që na lanë një trashigim të pasur, që na bën të mbajmë ballin lart.

Shqipëtarët me të vërtetë u pushtuan nga osmanët dhe e humbën pavarësinë kombëtare, por ata edhe pse përqaftuan fenë islame, asnjëherë nuk u pajtuan me pushtuesin dhe as nuk u asimiluan prej tij.

Sigurisht që rrezatime kulturore, gjuhësore, etnografike etj. pati, por ato nuk arritën ta asfiksojnë as gjuhën, as doket, as zakonet tona etnike.

Një pjesë e shqiptarëve u angazhuan në detyra të larta shtetërore, ushtarake, fetare, deri edhe diplomatike e kulturore. Motivet e angazhimit ishin, aftësitë, trimëria, zgjuarsia, karakteri i fortë e besnikëria. Madje shumë prej tyre me shpresë për t'i shërbyer, nëpërmjet Perandorisë edhe Atdheut të vet. Pra kur ishte çështja për të mbrojtur interesat kombëtare të vendlindjes së tyre ata nuk iu përulën kërkesave të Portës së Lartë.

Ndonëse pushtuesi bënte presion që të identifikohesh feja me kombësitë, kjo nuk u arrit asnjëherë. Qëllimi kryesor i fesë është ta përgatitë njeriun për jetën e amëshueme, pa mohuar edhe këtë që ai bën. Në këtë aspekt, feja islame dhe kombi janë dy nocione që nuk i kundërvihen njëri-tjetrit. Ky koncept ka ndikuar në mënyrë thelbësore që shqiptarët, si një popull me tradita të lashta dhe me një krenari shekullore, të përqafojnë islamizmin edhe pse ajo ishte feja e pushtuesit.

Shembulli më i mirë për këtë është Skënderbeu, i cili, ndonëse i konvertuar në islamizëm, mori edukatë islame dhe u rrit me moral islam, nuk e harroi përkatësinë kombëtare. Për më tepër ai luftoi një çerek shekulli në mbrojtje të pavarësisë kombëtare.

Pas epokës së Skënderbeut dhe pushtimit të trojeve tona nga Turqia, ka qenë dhe kleri mysliman ai që ka dhënë kontributin e çmuar në ruajtjen e gjuhës amtare, ndonëse atë e ka shkruar me alfabetin arab. Klerikët myslimanë, mësimet që jepnin, këshillat që transmetonin, vazet që mbanin ditëve të premtë nëpër faltoret i bënë në gjuhën amtare shqipe. Edhe në mejtepet që drejtonin, ata flisnin në gjuhën amtare, duke i mësuar dhe edukuar nxënësit me moral kombëtar dhe me kërkesat e moralit islam njëkohësisht, por me alfabet arab, ose turko-arab. Duke përdorur këtë mjet të fuqishëm, ata ruajtën

dashurinë për gjuhën, me të cilën i thurën lavdi fesë islame, i kënduan mevlude Profetit të tyre, duke krijuar kështu plejada të tëra poetësh popullorë. E gjithë kjo përfaqëson një qëndrim patriotik të ulemave, myftilerëve, kadilerëve dhe hafizëve shqiptarë.

Ata asnjëherë nuk i nxitën besimtarët e tyre kundër bashkatdhetarëve të një besimi tjetër. Përkundrazi, ata iu prinë në luftë, duke luftuar krah për krah kundër armikut të përbashkët. Ata luftuan për të drejtat e vegjëlisë, për të drejtat e mbarë popullit, siç qe p.sh., H.Sheh Shamia. Por një cilësi e klerit musliman ka qenë modestia e theksuar e tyre dhe, për pasojë, mosvënia në dukje e veprimtarisë së tyre.

Me kalimin e kohëve filluan të shquhen nga kleri islam edhe një radhë shkrimtarësh, poetë e prozatorë, që historia e letërsisë shqipe i ka mbiemëruar "Bejtexhij". i tillë është p.sh. Nezim Frakulla i Beratit, autori i një "Divani"i shkruar sipas modeleve të poezisë klasike iraniane, Hasan Zyko Kamberi, një poet që u bë popullor, jo vetëm në vendlindjen e tij, në Starje, por në tërë jugun, e deri te Hfz. Ali Riza Ulqinaku, që u bë i njohur, që në shekullin e kaluar, me "Mevludin"e tij, por edhe me veprimtarinë shumë pasionante si mësues i fëmijëve. Këtu nuk duhen lënë pa përmendur edhe dy figurat e shquara shqiptare nga Dukagjini, dy poetë të shquar: Jahja Bej Dukagjini dhe Ahmed Bej Dukagjini, që na e kthejnë shikimin në thellësi të viteve të shekullit XV-XVI, të cilët në veprat e tyre mburren se janë shqiptarë.

Të gjitha këto tregojnë se personalitetet e shquara shqiptare që i përkasnin klerit islam kanë qenë të lidhur ngushtë me fenë e tyre islame, me kombin shqiptar dhe e kanë ruajtur atë, dhe për këtë qëndrim patriotik këta klerikë nuk kanë gëzuar ndonjë privilegj nga pushtuesi, por përkundrazi në mjaft raste janë vënë në shënjestër prej tij. Ka qenë edukata që kanë transmetuar ata, forca e fjalës së tyre, nëpër xhamitë me xhematin e tyre që kanë edukuar masat popullore, krahas frymës fetare, edhe me vetëdijen e dashurisë për atdheun në pjesën më të madhe të popullsisë.

Gjatë historisë plot zigzake, ka pasur raste kur vendi ka ndier nevojën e hoxhallarëve, më vonë të teoricienëve që kanë luftuar për mëmëdheun, të kadilerëve, më pas të poetëve dhe më pas ende të politikanëve e deri në shekullin tonë, kur një plejadë e tërë klerikësh islam kanë qendruar në krye të lëvizjes kombëtare kundër pushtimit sllav, atij grek e nazifashist me pushkë e me penë në dorë. Ata përkthyen Kur'anin, përkthyen Hadithet e Muhammedit (a.s), duke lënë kështu gjurmët e tyre në lëvizjen islame në trevat shqiptare të Shqipërisë, të Kosovës, të Çamërisë, të Maqedonisë e të Malit të Zi.

Duke pasur parasysh kontributin që kanë dhënë, do të përpiqemi të bëjmë një përmbledhje të veprimtarisë të tyre. Në këtë mënyrë do të mundohemi të plotësojmë atë zbrazëti që për gjysmë shekulli pushteti monist u përpoq ta errësojë. Duke qenë se tema jonë kufizohet brenda shekullit XX, në këtë rreshtim të figurave që do të bëjmë më poshtë, do t'i përmbahemi harkut kohor të shekullit XX, pa lënë jashtë edhe ato figura që kanë vepruar në kapërcim të shekujve XIX-XX.

Kriteri që është ndjekur në radhitjen e këtyre figurave është kronologjik, kriter që mbështetet në datën e vdekjes së tyre, duke pasur parasysh kontributin e tyre në shekullin XX. Këtu është pasur parasysh pasqyrimi i figurave të shquara fetare të të gjitha trevave shqiptare, pa pretenduar se me këtë punë ne kemi shtuar hulumtimet tona në këtë fushë.

Të gjithë mund të mos jenë të "shquar" në kuptimin klasik të fjalës, madje mund të jenë edhe të thjeshtë në pamje hierarkike, por ne do të ndalemi tek ata, që shquhen për madhësinë e veprës së tyre sa atdhetare aq edhe fetare.

# **PËRSONALITETE TË KULTURËS ISLAME QË KANË JETUAR E KONTRIBUAR NË FUND TË SHEK.XIX - GJYSMA E PARË E SHEK. XX.**

## **SAID NAJDENI HOXHË VOKA I DIBRËS**

Seid Najdeni është një nga veprimtarët e shquar të lëvizjes kombëtare shqiptare, që zhvilloi veprimtarinë e tij në kuadrin e Rilindjes, në drejtim të mësimit të gjuhës së shkruar shqipe në zonën e Dibrës.

Seid Najdeni lindi në Dibër më 1864, ku mori edhe arsimin fillor e atë plotor. Arsimin e lartë e bëri në medresenë "Hajdar" të Fatihut në Stamboll. Këtë shkollë e mbaroi në vitin 1888 dhe u kthye në atdhe i frymëzuar për idealin kombëtar nga kontaktet që kishte pasur me përfaqësues të shquar të lëvizjes kombëtare shqiptare në Stamboll. Mbresa te veçanta i la takimi me Naim Frashërin. Mori me vete një sasi të konsiderueshme abetaresh, të cilat fillimisht i shërbyen për hapjen e shkollës në Dibër, më 1888.

Kjo shkollë punoi vetëm një vit, sepse atë e mbyllën autoritetet pushtuese. Gjatë jetës së saj, sadoqë të shkurtër, kjo shkollë pati një jehonë të madhe në popull dhe ndikoi në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Në vitin 1893 S.Najdeni e hapi përsëri shkollën, në krye të së cilës ai vendosi Hoxhë Muglicën, që kishte mbaruar medresenë e Elbasanit. Për mbajtjen në këmbë të kësaj shkolle paraqiteshin pengesa dhe vështirësi të mëdha, por ato nuk e zbrapsën S. Najdenin. Një vit më pas edhe kjo shkollë u mbyll, por tani nevoja e shkollës shqipe kishte pushtuar tërë dibranët.

S. Najdeni, duke e ndier nevojën e kontakteve drejtpërdrejta me krerë të lëvizjes shqiptare, u nis, në vitin 1895, në Stamboll, por atje u arrestua dhe u burgos në burgun e Edrenesë, ku ndodheshin dhe patriotë të tjerë të shquar, si Haxhi Zeka, Hamdi Ohri, Ibrahim Mitrovica e të tjerë. Pas lirimit nga burgu përshkoi vilajetet shqiptare të Shkodrës, Manastirit, Kosovës dhe të Janinës, si edhe ngulimet shqiptare në Itali, Bullgari e Rumani.

Gjatë qëndrimit të tij në Shkup, ai u burgos përsëri, por me ndërhyrjen e miqve të tij u lirua. Më 1900 hapi për të tretën herë shkollën shqipe në Dibër. Kjo shkollë pati një rëndësi të veçantë për zonën e Dibrës.

S.Najdeni mori pjesë në shumë tubime, për çështjen kombëtare e sovranitetin e vendit siç qe Lidhja e Pejës ku ai tha fjalën e tij.

Veprat kryesore që S. Najdeni botoi me alfabetin latin janë dy. E para është "Fe rrëfenjësja e myslimanëve", botuar në Sofie më 1900, dhe e dyta "Abetare e gjuhës shqipe ndë të folë gegënisht", botuar po në Sofie më 1900, por pa emër të autorit, pra anonime. E para është një vepër fetare e mbështetur në parimet Kur'anore, që janë të detyrueshme për të gjithë besimtarët myslimanë. Ky përfaqëson një manual fetar, por me mjaft të dhëna patriotike dhe filozofike. Problemin e diturisë dhe të prapambetjes Najdeni e trajton gjerë. Ai pranon dy dituri: atë fetare dhe atë të mendjes, të cilat, duke u mbështetur në Kur'an, nuk i kundërvihen njëra-tjetrës. Dituria për të është një armë e fuqishme, që mëkon ndërgjegjen kombëtare, që e njeh njeriun me shumë të dhëna, i jep atij pavarësi dhe e bën të barabartë me të tjerët.

Në këtë botim ai përfshin edhe thirrje për të përvetësuar shkrim leximin shqip, për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Duke e shkruar këtë vepër me alfabetin e Stambollit, ai prononcohet krahas

atyre që mbronin alfabetin latin. Parulla e tij qe: "Që shqiptarët të shpëtojnë nga rreziku, ka vetëm një rrugë: me u zgjue kombi, me mësue gjuhën e tij, me i dalë zot vetes".

## **TAHIR EFENDI LLUKA PISHTARË I SHKOLLIMIT SHQIP NË KOSOVË**

Tahir Efendi Lluka me veprimtarinë e tij u përket dy shekujve. Ai ka një veprimtari të gjerë dhe origjinale, që lidhet me botimet e tij me karakter fetar e pedagogjik në gjuhën amtare shqipe, si dhe me punën e tij mësimore - mektebin, e ngritur nga ai vetë në prag të shekullit tonë, 1900/ 1318H, në Llukë. Me këto ai u fut në radhët e pishtarëve të shkollimit shqip në Kosovë, sepse Tahir Efendi Lluka nisej nga parimi që shkrim-leximi në gjuhën amtare shmang prapambetjen dhe e ngre kombin shqiptar në radhën e kombeve të tjerë të qytetëruar.

Tahir Efendi Lluka arsimin fillor e bëri në Shkup, kurse të mesmin e më tej i vazhdoi në Stamboll, ku u shqua për rrezultate të shkëlqyera. Për rrjedhim, ai u emërua myderis në shkollën e lartë fetare islame të Fatihut në Stamboll, ku shërbeu gati dhjetë vjet. Biografët e tij dëshmojnë se Tahir Efendi Lluka bashkëpunoi me Hasan Tahsinin dhe me veprimtarë të tjerë të lëvizjes kombëtare në Stamboll, si Jani Vreto etj. Pas vdekjes së Hasan Tahsinit (1881), Tahir Efendi Lluka u kthye në vendlindje, në fshatin Llukë e Epërme, ku ngriti një mejtep, që për gjuhë mësimi kishte gjuhën shqipe. Shkrimi i gjuhës shqipe në këtë mejtep bëhej mbi bazën e grafisë arabe.

Duke pasur parasysh edhe botimet e tij në gjuhën shqipe, siç qenë "Broshurë për moralin" ("Risale-i ahlak"), "Mevludi" dorëshkrimi "Urata e besimtarëve" etj., si edhe ndërtimin e mejtepit, mund të themi se ai luajti një rol të madh për të mbajtur gjallë gjuhën e shkruar shqipe. Ai shkruan se shkolla është një vend tubimi, një vend bashkimi. Në përbërjen e shkollës së tij kishte djem dhe vajza, të cilët lexonin në gjuhën shqipe.

Ai thekson vlerën e gjuhës amtare, sidomos shkrim-leximin në këtë gjuhë, e cila do ta shkëpusë nga prapambetja kombin tonë dhe do ta radhisë krahas kombeve të tjera të qytetëruara. "Gjithsa kavn me g(j)uh t'vet jon tuj knue hem tuj shkruie për dynja dit për dit kta tuej fitue e tuj madhnue veç kavmi yn pa fitue tuj voglue".

Tahir Efendi Lluka u njoh edhe me emrin "Tahiri i vogël", meqë me emrin "Tahiri i madh" njihej Tahir Efendi Gjakova-Boshnjaku, kishte bërë përpjekje që më parë që të përshtaste për gjuhën shqipe një alfabet arab dhe ia kishte arritur. Me punën që bëri, ai ishte i bindur se me alfabetin e saj gjuha shqipe do të mësohej shumë lehtë ("Fort shumë fajde ka me konë për Shqypnin", "Un i bona masus kto për Shqypnin", "Gjithkush t'jen ka nxon ma kollaj"). Këtij alfabeti i janë përmbajtur edhe shumë autorë të tjerë, në këtë mënyrë të veçantë në trevat e Kosovës. Veprimtaria e Tahir Efendi Llukës nuk u pa me sy të mirë nga organet e shtetit të kohës. Kur ai shkoi në Stamboll, mjediset qeveritare dhe ato fanatike e akuzuan për ndërmarrjen e tij.

Veprimtaria e tij botimore dhe ajo në fushën e praktikës pedagogjike kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, si të Dr. Muamed Pirakut, Mr. Abdullah Hamitit etj. Vdiq në prag të Kongresit të Manastirit.

## KADRI GJATA DËSHMORI I ÇËSHTJES KOMBËTARE

Kadri Gjata është një nga figurat e shquara të Rilindjes sonë kombatare. Arsimin fillor dhe atë plotor (Ruzhdijen) i bëri në Libohovë, vendlindja e tij. Arsimitin e mesëm fetar e bëri në Janinë, ku mbaroi medresenë e atyshme. Aty dhe u vendos.

Më 1908, kur u shpall Hyrjeti, Kadri Gjata ishte burrë i pjekur, 43 vjeçar. Ai mbulonte postin e myftiut të Janinës dhe gëzonte një autoritet të ndjeshëm në tërë popullatën shqiptare të Janinës. Në klimën e formuar pas ardhjes në fuqi të turqve të rinj në Janinë, u krijua klubi patriotik dhe filloi botimin gazeta "Zgjimi i Shqipërisë".

Për organizimin e klubit si dhe për nxjerrjen e gazetës në këtë nyjë të rëndësishme, shkoi atje patrioti Bajo Topulli, kryetar i Komitetit Revolucionar të Manastirit dhe organizues i çetave patriotike në Jug. Në mbledhjen që u organizua për krijimin e klubit, në praninë e 300 përfaqësuesve, Kadri Gjata u zgjodh anëtar i kryesisë dhe, pas njëzet muajsh veprimtarie, ai u zgjodh kryetar i atij klubi. Në këtë periudhë u lidh ngushtë me Nuçi Naçin, i cili qe drejtor i gazetës "Zgjimi i Shqipërisë", që nxirrte ky klub. Klubi, nën drejtimin e Kadri Gjatës, mori emrin "Bashkimi" dhe kishte një program shumë ambicioz. Ai synonte në sigurimin e të drejtave kombëtare, shtrirjen e arsimit shqip, botimin e librave dhe të materialeve të tjera etj.

Pranë klubit ngriti një shkollë shqipe dhe organizoi qarkun letrar "Toskëria"(1910). E rëndësishme është veprimtaria e këtij klubi në zonat e Çamërisë. Të gjitha këto veprimtari e bënë shumë popullor emrin e Kadri Gjatës, por, nga ana tjetër, shtuan edhe urrejtjen e xhonturqve dhe të shovinistëve grekë.

Këta të fundit, më 12 korrik 1912, organizuan vrasjen e tij nga një çetë e përbërë prej 22 vetash, që kryesohej nga kapedanët: Jani Puteci, Gogua dhe Farmaku. Shtypi shqiptar dhe tërë trevat shqiptare e qanë "Dëshmorin e Kombit", "Patriotin e pavdekshëm", "Shpirtin dhe zemrën e shqiptarizmes në Janinë", "Djalin e Shqipërisë", myftiun e nderuar të Janinës.

## **MULLA ISUF KRAJA (KRAJË, 1849 - SHKODËR, 1912)**

Isuf Kraja është një nga personalitetet e larta fetare dhe shoqërore me prejardhje nga zona e Krajës, një trevë etnikisht e pastër shqiptare, trevë e njohur si vatër albanologësh të shquar shqiptarë, si dhe për hoxhallarë me emër e personalitet të afirmuar me punë e studime.

Isuf Kraja, i biri i Aliut, nga fshati Kështenjë i Krajës, i lindur atje në vitin 1849, i nxitur nga kushëriri i tij i parë, Abdullah Begu, një krajan që kishte ecur e ngjitur lartë në hierarkinë shtetërore të Perandorisë Osmane, si Komandant i Gardës së Perandorisë, apo siç thuhej në një burim tjetër, si Ministër i thesarit i Perandorisë, me ndihmën e të cilit përfundoi me sukses studimet e larta për teologji.

Jeta e gjatë në Stamboll dhe rrethi miqësor e fisnor i krijoi mundësi të qendronte e të njihej thellë me personalitete të shquara shiptare që punonin në Stamboll, me burra të shquar të Rilindjes sonë, lidhjet me të cilët i ruajti edhe pas ardhjes së tij në Shqipëri. Pas kthimit nga Stambolli, duke sjellë me vetë një bibliotekë shumë të pasur, u shqua për ndihmë konkrete në ngritjen arsimore e sociale të bashkatdhetarëve, duke mësuar të vegjlit e të rriturit.

E ushtroi veprimtarinë e hoxhës e të mësuesit në Krajë, Postrisë, në Nenshatë dhe në Shkodër, duke marrë pjesë aktive në jetën politike, fetare e sociale të Shkodrës. Shkollat e hapura në zonën e Krajës, si shkolla e Ostrosit të Vogël, që ishte hapur që në vitin 1896, në Arbnesht që në vitin 1895, në Skie që në vitin 1892, mbanin lidhje të ngushta me intelektualë krajanë në Shkodër, ku Molla Isuf Kraja kishte një rol të veçantë. Ai ishte funksionar fetar në një repart të madh ushtarak dhe njëkohësisht kryente edhe detyrën e hoxhës në qytet. Veprimtarinë e tij fetare e harmonizoi natyrshëm me atë kombëtare, madje edhe duke bashkëpunuar ngushtë me klerikë të tjerë, përfshirë edhe të feve të tjera, siç kishte mik të ngushtë klerikun katolik të Nenshatit, etj, çka ndikonte dhe rrezatonte nga miqësi në mes dy teologëve, në miqësi e harmonizim në mes bashkëqytetarëve të besimeve të ndryshme. Isuf Kraja shërbeu nga viti 1900 edhe si mësues i historisë dhe i gjeografisë në shkollën Ruzhdië të qytetit.

Profesor doktor Hajrullah Koliqi, në monografinë "Kraja ndër mote". në mes tjerash shkruan: "Një shkodran tjetër me prejardhje krajanë, ishte edhe Isuf Kraja. Ai ishte një nga veprimtarët më të shquar të Rilindjes Kombëtare në Shkodër dhe i arsimit kombëtar shqiptar. Isuf Kraja, krahas Luigj Gurakuqit, Musa Boriçit, Anton Xanonit, Ali ulqinakut, Daut Boriçit, Ndre Mjedës, Gaspër Jakovës-Mërturit, Shtjefën Gjeçovit., etj ishte një nga burrat e atdhetarët më të shquar shkodranë e më gjërë".

Mungesa e një shteti të organizuar në viset shqiptare, i kishte lënë shumë shtigje vjedhjeve e grabitjeve jo vetëm të individëve, por edhe lagjeve e fshatrave, nga cubat, që kusarinë e kishin bërë mjet jetese. Në vaset që jepte, molla Isuf Kraja shtronte edhe problemet aktuale që e preokuponin xhematin e tij, sidomos në fshatrat ku shërbeu, duke u dalur hapur që të organizohen për vetëmbrojtje të shtëpive, pasurive e nderit të tyre, ndaj cubave, që dukeshin sa në një anë në një tjetër. Duke mos u pajtuar me qëndrimin pritës, hoxha që rrinte gjithnjë i armatosur, për të njëjtën arsye, organizoi një lloj vetëmbrojtjeje dhe nuk la këmbë cubi që të hynte në fshat. Të gjendur para një mase të tillë, cubat

vendosën të grabisin disa krerë bagëti pikërisht në fshatin ku punonte molla Isufi. Me të dëgjuar lehjet e qejve, hoxha vëzhgoi me kujdes dhe konstatoi se fshati ishte bërë pre e hajdutëve. Ndezi dritën e llambës së vajgurit, por menjëherë pushka qëlloi drejtë e në llambë, dmth, hajdutët kishin marrë masa për parandalimin e hoxhës në veprimtarinë mbrojtëse. Por, hoxha e dha alarmin me pushkë, sipas sinjaleve që kishin kombinuar me fshatin, duke u ngritur i madh e i vogël në këmbë në mbrojtje të fshtit, çka i bëri të iknin me të katra hajdutët, që nuk e parashikonin një organizim të tillë vetëmbrojtës kundër tyre.

Në atë trevë në Krajë, pas vdekjes së Isuf Krajës, në vitin 1912, në Shkodër, vazhduan dy nipa të tij veprimtarinë fetare dhe arsimore. Djali i motrës së Isufit, Tahir Kandaqi, për të cilin shkruhet: "Janë dhjetra e dhjetra banorë dhe intelektualë të krahinës, të cilët i janë mirënjohës që i mësoi dhe i edukoi. Njeri me kulturë të gjerë, ai ishte shpirt nxitës e frymëzues i rinisë. Biblioteka e tij e pasur në shtëpi kthehej shpesh në parlatore e vend mbledhjesh. Dinte përmendesh përmbrri dy mijë vargje të Naimit dhe ua lexonte të rinjve. U fliste atyre për mëmëdhenë, për lirinë, për gjuhën amtare dhe i nxiste si dijetar, si mësues dhe si atdhetar".

Është një tyrbe në Krajë, pikërisht varri i Tahir Kandaqit, i kthyer nga banorët në një tyrbe të rrethuar bukur me mermer e në mjete estetike të denja për një vend të shenjtë, një vend ku njerëzit venë..

Një tjetër nip i Isuf Krajës, djali i vëllaut, është molla Hysa nga Kështenja i njohur si hoxhë i devotshëm, edukator edhe me peshën e fjalës së tij dhe trim. Trimëria e tij është shfaqur në mbrojtje të njerëzve të persekutuar nga pushteti jugosllav, përfshirë edhe të vdekurin, nderimet e të cilit ia ka bërë në kundërshtim të hapët me urdhërat e prera të organeve për ta braktisur, etj.

Isuf Kraja la edhe djalin në Shkodër, vajzat...

Por, mungesa e aftësive intelektuale e bashkëshortes, për arsye që dihen për femrat tona të asaj periudhe, i la shteg të tjerëve të merrnin me thasë librat e rralla e shumë të vlerta, pasuria e vetme e molla Isufit, e të shpërndaheshin sa andej këndej nga individë, që i kishin apo jo mundësitë e shfrytëzimit e mbase edhe të ruajtjes së tyre, si një fond i rrallë kulture.

## **HAFIZ ALI RIZA ULQINAKU**

### **AUTORI I MEVLUDIT SHQIP**

Një ndër figurat e shquara të Rilindjes Kombëtare është edhe Hafiz Ali Riza Ulqinaku, veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Sipas L.Skëndos, Ali Ulqinaku i përkiste shkollës letrare dhe shkencore shqiptare të traditës islame, të njohur si bejtexhinj.

Lindi në Ulqin më 1853, ku mori dhe mësimet e para. Më vonë u shkollua në Shkodër dhe në Stamboll. Fillimisht ka punuar si imam dhe myfti në Ulqin. Që në moshë të re u mor me përkthime dhe përshtatje në gjuhën shqipe të veprave letrare moralizuese dhe mësimore.

Ka lënë vepra të botuara, dorëshkrime origjinale dhe përkthime. Ka botuar më 1884 një përmbledhje me tre vepra të veçanta: Përkthimin shqip të veprës turke "Huda Rabbim", Mevludin, të ndarë në katër kapituj, me 634 vargje gjithsej dhe Një Fe-rrëfenjë të përbërë nga 804 vargje. Ndërsa në dorëshkrim ka lënë një abetare shqip dhe tre fjalorë. i pari është hartuar në vargje, metodë kjo e suksesshme dhe praktike për mësimin e gjuhëve të huaja nga nxënësit e fillores. i dyti është shqip-turqisht, ndërsa fjalori i tretë është turqisht-shqip.

Veprën "Mevludi sherif" e shqipëroi më 1873. Kur u shpërngul në Shkodër më 1879, veprën e solli dorëshkrim. U botua në vitin 1885/86 sipas dëshmisë së vetë autorit. Ky Mevlud u përhap në mënyrë të rrufeshme në të gjitha trevat veriore shqiptare të besimit mysliman. Mevludi mësohej përmëndësh, kopjohej. Vepra mori karakter didaktik dhe patriotik, sepse Hfz. Ali Ulqinaku i bëri një parathënie në vjershë dhe i shtoi një pjesë origjinale. Në parathënie shkroi për domosdoshmërinë e lëvrimit të gjuhës së pastër shqipe.

Pikërisht për këtë pati pasoja nga pushtuesit. Kështu u detyrua të lërë Ulqinin dhe të vendoset në Shkodër e më vonë në Lezhë.

Hfz. A.Ulqinaku u mor me veprimtari letrare, filologjike e pedagogjike, jo i shtyrë vetëm nga feja, por dhe nga nevojat e popullit për dije e arsim, kulturë dhe shkencë. i shtyrë nga dashuria për gjuhën shqipe, për ruajtjen e saj dhe të kombësisë shqiptare.

Për veprimtarinë e tij dhe për nxënësit përshtati një alfabet të shqipes mbi bazë të grafisë arabe. Këtë e bëri për nevojat aktuale të kulturës e të shkrimit shqip, për përhapjen e saj legale në atdhe. Bëri që shqipja e folur të shkruhej, të ruhej e të kultivohej.

Vepra letrare e Hfz.Ali Ulqinakut ndikoi fuqishëm në krijuesit letrarë me alfabet që erdhen pas tij. Ndikimi i tij haset dhe në një plejadë shkrimtarësh të shkolluar nëpër medrese të ndryshme, midis dy luftërave botërore. Vdiq më 1913.

## **HAZIZ LILA. MËSUESI I GOSTIVARIT DHE I STRUGËS**

Në agim të shekullit XX një Hafiz i ri nga Strebleva e Gollobordës, i porsaardhur nga studimet që kishte bërë në Stamboll, u emërua mësues i frëngjishtes në Gostivar, në Strugë e më pas drejtor i shkollës "Idadije" në qytetin e Dibrës. Ky është Haziz Lila, që më vonë do të bëhej myfti, zhvilloi një aktivitet të gjerë fetar dhe patriotik në periudhën para shpalljes së Pavarësisë. Ai solli me vete mjaft libra në gjuhën shqipe dhe i shpërndau ato fshehurazi, propagandoi te bashkëfshatarët, në mes të të cilëve banonte, frymën patriotike dhe, mbi të gjitha, përhapi alfabetin shqip, duke propaganduar njëkohësisht mospajtimin me politikën serbe dhe duke iu kundërvënë propagandës serbe dhe përpjekjeve për pushtimin e tokave shqiptare.

Aktiviteti patriotik dhe antisllav i tij i ra në sy naçalnikëve serbë, të cilët e arrestuan, e shoqëruan me një njësit ushtarësh prej tetë vetash dhe e vranë me të shtëna armësh, në vendin e quajtur "Gezden të Stebleves", më 7 qershor 1915. Haziz Lila i përket martirëve të gjuhës dhe të shkollës shqipe.

## **HOXHË MUGLICA MARTIRI I ARSIMIT SHQIP**

Historia e martirëve shqiptarë ka regjistruar në vitin 1915 edhe Hoxhë Muglicën, i cili ra nga plumbat e ushtarëve serbë te Ara e Sheremetit të Muglicës, me thirrjen burrërore: "Rroftë Shqipëria! Rrofte kombi

shqiptar!" Kjo thirrje i tmerroi ushtarët serbë, të cilët kishin bërë shumë përpjekje që ta kapnin këtë hoxhë arrogant, por elokuent, këtë hoxhë që, së bashku me fjalët e Zotit, luftoi edhe për Shqipërinë e lirë.

Hoxhë Muglica lindi në katundin Okshtun të Gollobordës më 1856. Ai që propagandist i shquar i arsimit kombëtar, i librit në gjuhën shqipe dhe i shkollës në gjuhën amtare në zonën e Dibrës. Mori pjesë në Kongresin e Dibrës (1909) dhe në Kongresin e dytë të Manastirit (1910). Qe një ndër përkrahësit e shkollës së parë Normale, të cilën e furnizoi me kontigjente nxënësish nga Golloborda, Okshtuni etj. Ai arriti të organizojë një qendër mësimore në zonën e Dibrës dhe t'u mësojë nxënësve gjuhën e shkruar shqipe dhe besimtarëve fenë islame.

Në shtëpinë e tij shpesh janë strehuar rilindës që ndiqeshin nga turqit, midis tyre dhe Abdyl Frasheri, gjatë udhëtimit të tij për në Prizren.

## **HOXHË VOKA**

### **PERSONALITETI I SHQUAR REXHEP VOKA**

Personaliteti i shquar Rexhep Voka lindi në fshatin Shipkovicë të Tetovës më 1847. Arsimin fillor e mori te hoxha i fshatit, ne Shipkovicë, dhe atë të mesëm fetar në qytetin e Tetovës, kurse arsimin e larte fetar e kreu në Stamboll, ku mori ixhazetin (diplomën) e myderizit. i vlerësuar për rezultatet e tij të shkëlqyera u emërua pedagog pranë fakultetit, ku kishte bërë edhe studimet.

Më 1895 u kthye në vendlindje ku fitoi një reputacion të madh. Më 1903 emërohet myfti i vilajetit të Manastirit, i cili atë kohë përfshinte rreth 2 mijë fshatra shqiptarë. Si shumë patriotë të tjerë, edhe Rexhep Voka në fillim mbajti anën e turqve të rinj. U aktivizua në tubimin e Bukureshtit të vitit 1906, përkrah Ismail Qemalit, në atë të Ferizajt të vitit 1907, si edhe në Kongresin e Dibrës.

Në një artikull në "Shqypoja e Shqyperisë" të vitit 1910 shpreh gabimin e vet për çështjen e alfabetit. Çështjen e alfabetit Rexhep Voka e pa në dritën e politikës xhonturke. Ai e konceptoi atë si diçka të lidhur me fenë. Punoi që gjuha shqipe të shkruhej me alfabet arab të përshtatur me fonetikën shqipe. Sipas Hasan Kaleshit, në muajin mars të vitit 1910, tetovari Rexhep Xhudi, i biri i Nuredin Vokës, i paraqiti parisë së Janinës një trajtesë, ku rekomandon alfabetin arab për shkrimin e gjuhës shqipe. Në vijim të këtij qendrimi, Rexhep Voka, pasi përpiloi alfabetin shqip me shkronja arabe, hartoi dhe abetaren po me këto shkronja, të cilën e titulloi "Abbeja skip". Abetarja u botua në Stamboll, më 1910, dhe kishte 20 faqe. Më 1911 ai botoi edhe "Gramatikën elementare shqipe", si edhe një tekst mësimor fetar "Ilmihali i hollësishëm shqip", ku trajtohen parimet fetare islame.

Për të kuptuar personalitetin e Rexhep Vokës dhe qendrimin e tij, duhet vlerësuar përmbajtja e veprës së tij "Mendime", botuar në Stamboll më 1910. Vepra u shkrua në të folmen e Tetovës. Me interes këtu paraqiten pjesët "Disa fjalë vëllezërve shqiptarë", "Din e dije"(vjershë), "Mësime" etj. Në këtë vepër Rexhep Voka mbron pikëpamjen që "Shkollat t'i hapim dhe në mos paçim mundësi të ndërtojmë ndërtesa të mëdha, në kolibe me kashtë t'i tubojmë fëmijët vetëm që të mësojnë", "Ne shqiptarët është turp të mbesim më poshtë se popujt e tjerë". Të tilla qendrimë janë të shumta në këtë botim.

Në faqet e shtypit shqiptar të Kosovës, si edhe të atij të Maqedonisë, rrallë është diskutuar ndonjë figurë sa ajo e R.N.Vokës. Veprimtarisë së tij për arsimin shqip islam, si dhe veprimtarisë së tij atdhetare, i kushtohet një kapitull i veçantë në librin voluminoz "Mësuesit për kombin shqiptar".

Rexhep Voka ishte i lidhur shumë me fenë dhe njëkohësisht ishte një atdhetar i madh. Ai lëshoi kushtrimin që "të bashkohemi për t'i dhënë kombit dije, edukim e arsim". Ai nuk ishte dogmatik në qendrimin e tij dhe që në gjendje që qendrimet e tij t'i shikonte me sy objektiv. Pikërisht ky qendrim i tij objektiv e bëri të heqë dorë nga pikëpamja e parë. Ai preferoi të privohej nga çdo privilegj i ofruar, të jetojë duke shitur lule nepër sokaket e Stambollit dhe të vdesë i varfër për të mbetur besnik i idealeve kombëtare dhe i atyre fetare, të cilave u kishte shërbyer. E parë me syrin kritik, vepra e Rexhep Vokes ka pasur një ndikim pozitiv në përhapjen e diturisë për arsimin në gjuhën amtare, për kulturë islame, si dhe për shkrim-leximin në gjuhën shqipe, larg ndikimit të shkollave sllave.

Rexhep N. Voka vdiq në vitin 1917 (?) në varfëri të thellë në Stamboll.

Në Shipkovicë është ngritur një përmendore në nderim të tij. Janë organizuar veprimtari, në mes të cilave një simpozium, ku kanë mbajtur kumtesat e tyre personalitete të shquara të kulturës e të fesë në ato treva shqiptare. Ato hedhin dritë mbi vlerat gjuhësore të veprës së R.Vokës, mbi pikëpamjet pedagogjike, mbi pikëpamjet filozofike e sociale, etj. Vepra e Vokës është lënë në hije nga paragjykime indoktrinuese sllavokomuniste.

Rexhep Voka ka botuar shumë artikuj gjatë kohës së qendrimit të tij në Stamboll, por që nuk janë studiuar.

## **KADRI LUTFULLA PRISHTINA, LUFTËTAR PËR BASHKIMIN KOMBËTAR**

Në çerekun e parë të shekullit XX, një rol parësor dhe shumë - dimensional në historinë e Shqipërisë luajti Kadri Lutfulla Prishtina, luftëtari për bashkimin kombëtar. K. L. Prishtina mbaroi studimet teologjike në Stamboll, dhe krahas tyre, bëri dhe normalen e Lartë të Stambollit, si dhe Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Stambollit.

Si burrë shteti, ai qe për Shqipërinë etnike dhe demokratike. Kryesoi Komitetin për Mbrojtjen Kombetare të Kosovës, përfaqësoi Kosovën si deputet i parlamentit të parë shqiptar (1921), u emërua Ministër i Drejtësisë në kabinetin e Qeverisë Shqiptare (1921), që kryesohej nga Hasan Prishtina. Si jurist u shqua për mbrojtjen e tij parimore. Si publicist dhe teolog, ai drejtoi revistën "Udha e s'vërtetës", ku shprehu pikëpamjet e tij politike, sociale, filozofike e teologjike.

Më gjerë platformën e tij e paraqiti në revistën "Bashkimi i Kombit", ku theksonte se "ka për qëllim kryesor me këshillue bashkëfetarët tanë, me ua mësue këtyre parimet e thjeshta të fesë, me i pshtue prej zhatërrimit të kryekputshëm, me edukue tek ata ndjenjën e bashkimit e të jetuarit tok në shoqërinë njerëzore, me i ba gjymtyrë të dobishëm për jetën shqonore kombëtare tonën gjithë ata gjysëmdijetarë tonë, tue iu folun këtyne mbi baza të shëndosha e të vërteta të besimit, me i dhanë një zhvillim mendor krejt popullit, përderisa të na mbrijë fuqia në lëme të filozofisë, të sociologjisë e të politikës".

Ai përpiqet të krijojë një opinion shoqëror pozitiv lidhur me fenë, duke e parë atë si një element bashkimi, si një doktrinë që nuk pengon përparimin e shkencave, si një fuqi"që ruan rregullin dhe disiplinën në mes njerëzvet".

Nëpërmjet artikujve që botoi dhe forumeve që drejtoi ose mori pjesë, shtroi probleme të rëndësishme, që kishin të bënin me zhvillimin e arsimit në atë kohë, duke i trajtuar ato nga këndvështrimi shoqëror e politik. Që më 1920 kërkoi që arsimit fillor të behej i detyruar, ndërsa arsimit gjysmë i mesëm falas, por jo i detyruar. Këtë projekt i shtoj hapja e konvikteve për nxenesit e zonave të largëta. Përsa i përket administrimit të hallkave të ndryshme, ai që i mendimit që shkollat fillore dhe ato qytetese të administroheshin nga keshillat administrative të pushtetit lokal, ndërsa shkollat e mesme dhe institucionet e arsimit të lartë të ngriheshin dhe të administroheshin nga shteti. Në baze të punës edukative-arsimore ai vuri edukimin patriotik, karakterin praktik të njohurive dhe aftesimin e nxenesve për të përballuar në menyrë të pavarur nevojat e jetesës.

## **VILDAN FAIK DIBRA**

### **MROJTËSI I ALFABETIT SHQIP**

Reka e Dibrës është një nga vendet ku kanë lindur shumë personalitete të lëvizjes kombëtare. Ata nuk janë vetëm luftëtarë me armë, por edhe luftëtarë me penë. i tillë ishte edhe Vildan Faik Dibra, nga Rîmnica e Rekës.

Vildani arsimin fillor dhe atë të mesëm e bëri në Dibër, ku kishte një arsim të zhvilluar në gjuhë të huaj turko-arabo-persiane, nga ku dolën shumë patriotë të shquar si Haxhi Vehbi Dibra, Said Najdeni (Hoxhë Voka i Dibrës), Hfz.Maliq Tanusha, nga Tanusha e Rekës, idhtar i zjarrtë i Klubit të Stambollit, Hfz.Abdurrahim Dauti, propagandues dhe mësues i gjuhës shqipe etj.

Studimet e larta i vazhdoi në Stamboll, kur, si shumë shqiptare të tjerë, dhe ky pati rezultate të shkëlqyera në përfundimin e medresesë së lartë. i vlerësuar për përgatitjen e lartë që kishte fituar, u emërua profesor në medresenë e lartë të Yskydarit. Në këtë pjesë të Stambollit, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të kaluar dhe sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit tonë, ku ky shërbente aty, pati shumë shqiptare në këtë qytet. Më vonë aty u hap edhe një shkollë shqipe, shkolla "Kosova" me nxënës refugjatësh shqiptarë.

V.F.Dibra u aktivizua në lëvizjen kombëtare të fillimit të shekullit XX, duke përqafuar programin e saj. Mori pjesë në Klubin "Bashkimi" të Stambollit dhe e përfaqësoi atë në Kongresin e Manastirit të 1908-ës.

Qëndrimi i tij në këtë Kongres, pro ose kundër alfabetit të Stambollit, kishte një peshë të madhe. Shumë nga pjesmarrësit prisnin nga do të anonte Hfz.Vildani. V. Dibra, duke shprehur pikëpamjen e tij në bazë të thënieve Kur'anore, theksoi: "Feja dhe Kur'ani nuk kanë kurrfarë lidhje me alfabetin. Mësimi i gjuhës shqipe me alfabetin latin nga pikëpamja fetare s'ka asnjë ndalim". Duke pasur parasysh anen praktike, ai tha se mësimi i gjuhës shqipe me këtë alfabet është më i lehtë.

Hfz.V.F.Dibra është autor i disa veprave letrare-fetare e filozofike në gjuhët e Lindjes. Gjithashtu ai është autor edhe i monografive në lëmin e drejtësisë, në kuadrin e të drejtës së Sheriatit.

Ai, me cilësinë e përfaqësuesit të Komitetit të Stambollit mbajti një varg ligjeratash gjatë vitit 1908 në disa qytete të Shqipërisë. Këto ligjërata dëshmojnë për erudicionin e tij, pathosin patriotik dhe elokuencën profesionale. Vdiq në Stamboll më 1925.

## HOXHË HASAN VOGLI GJUHËN SHQIPE DO TA MBROJMË EDHE ME GJAK

Çerek shekulli i parë i historisë së zhvillimit të kulturës dhe të arsimit në Tiranë lidhet ngushtë me emrin dhe veprimtarinë e Hoxhë Hasan Vogli. Hapja e alfabetit të Stambollit, funksionimi i shkollës fillore "Ylli" në Tiranë, qendresa heroike ndaj persekutimeve që iu bënë patriotëve nga Shevqet Durgut pasha e më vonë nga Esat Toptani, themelimi i jetimores së Tiranës dhe shumë vepra bamirëse, e bënë shumë të dashur dhe të nderuar emrin e Hasan Voglit.

Hasan Vogli rrjedh nga një familje tiranase me tradita atdhetare. Ai kreu shkollën plotore (Ruzhdië) në Tiranë, kurse në Shkodër vazhdoi shkollën pedagogjike me gjuhë mësimi turqishten, "Darumualiminë". Sipas të dhënave, ai ndoqi edhe arsimin e lartë në Stamboll, ku u pajis me një kulturë të lartë teologjike. Që në fillim u ingranua në lëvizjen patriotike. Si kredo të vepimtarisë së tij shoqërore ai kishte parullën "Jam shqiptar, flas shqip dhe gjuhën shqipe do ta shkruaj edhe me gjak".

Kësaj motoje ai nuk i devijoi asnjëherë. Shërbeu si mësues i shkollës fillore shqipe të Tiranës, që drejtohej nga Filip Hashiku, duke e filluar punën me 1901. Njëkohësisht shërbeu si mësues edhe në shkollat e tjera turke, gjithmonë duke iu përmbajtur parimeve të tij. Me shpalljen e Pavarsisë punoi si mësues në disa shkolla të Tiranës, derisa vdiq në moshën 58- vjeçare. Në këto shkolla dha lëndë të profilit fetar, paralelisht me lëndë të tjera të kulturës së përgjithshme.

Më 1910 dhe më pas me ardhjen e rrebelëve të Esat Toptanit, siç thotë Hfz.Ibrahim Dalliu, në librin e tij "Patriotizma në Tiranë", ai u ndoqi dhe u persekutua, në mënyrën më çnjerëzore, derisa mbeti i gjymtë.

H.Vogli i përkiste atij grupi njerëzish me karakter të fortë, që nuk përkulen dhe që as nuk i nënshtrohen dhunës. Shkonte i pari në xhami dhe dilte i fundit. Që nga më kryesorët që mbrojti vendimet e Kongresit të Lushnjes dhe u radhit krah për krah me ithtarët e qeverisë që doli nga ky Kongres. Ai nuk shkroi ndonjë vepër, por fjala e tij qe aq e fortë si para xhematit në xhami, ashtu edhe para nxënësve në shkollë.

H.Vogli ishte prototipi i myslimanit të devotshëm. Kudo që do të ndërmerrej ndonjë nismë për të ndihmuar nevojtarët ose për të ngritur ndonjë institucion që mungonte, ai do të zgjidhte kuletën e tij, do të angazhohej me tërë autoritetin që gëzonte. Shumë vajza jetime i kanë gëzuar martesat e tyre në sajë të ndihmave që ai u ka dhënë. Jetimorja e Tiranës është ndihmuar nga ky burrë i madh, i cili, pas vdekjes, ullahtet e tij ia kaloi si pasuri këtij institucioni.

## **HAXHI ALI ELBASANIT PËRFAQËSUESI I UNITETIT KOMBËTAR**

Jeta dhe veprimtaria e Haxhi Ali Elbasanit shtrihet më se gjysmë shekulli në shekullin e kaluar dhe më se një çerek në të sotmin. Ai përjetoi ngjarje të dhëmbshme të vëllezërve të tij: betejat, copëtimin e vendit, mërgimet e detyruara, varfërinë e popullit, përçarjen që mbillte propaganda e huaj greke e sllave etj.

I pajisur me kulturën e lartë fetare, të cilën e kishte fituar në aulat e Universitetit të Stambollit, dhe i frymëzuar nga idealet kombëtare, Haxhi Ali Elbasani fitoi besimin e popullit, i cili e zgjodhi deputet e

më pas dhe anëtar i Senatit. Vajtja në Haxh e pasuroi botëkuptimin e tij me ndjenja fisnike të moralit Islam.

Në mënyrë të vaçantë Haxhi Ali Elbasani u shqua si publicist, veprimtar shoqëror e patriot. Gjatë kohës që qe në Turqi, drejtoi gazetën "Zemra" ("Yrek"), që botohej në dy gjuhë: shqip dhe turqisht, me alfabet arab. Në dalje të saj, kjo gazetë u bë tribunë e pikëpamjeve lidhur me nevojën e organizimit të arsimit në Shqipëri. Haxhi Ali Elbasani ishte dhe kryetar i Klubit "Bashkimi", i cili kishte si organ të vetin gazetën "Fjala e drejtë".

Pikëpamjet e Haxhi Ali Elbasanit lidhur me arsimin, mirëkuptimin në mes besimtarëve të feve të ndryshme etj, janë pjesë e ideve të rilindësve. Ai propagandonte tolerancën e mendimit, në bazë të së cilës shtronte bashkëpunimin në mes myslimanëve dhe kristianëve: "Myslimanët duhet t'u shtrijnë dorën kristianëve, sepse kjo e forcon kombin shqiptar".

Më 1913-1914 ai drejtoi "Komitetin e Zgjimit dhe të Besës Shqiptare", me qendër në Elbasan. Me qëndrimet e tij, me kulturën që zotëronte si myderiz dhe përvojen që kishte fituar sa kohë shërbeu në organet legislative të Turqisë, Haxhi Ali Elbasani fitoi një popullaritet jo vetëm në Elbasan, por dhe në të gjithë zonën e Shqipërisë së Mesme.

Haxhi Ali Elbasani vdiq i nderuar në vitin 1928.

## **QAMIL BALA DREJTORI I PARË I MEDRESESË (TIRANË)**

Në vitet '20 ishte pjekur mendimi për të krijuar një shkollë të mesme fetare islame me fizionomi bashkëkohore. Ithtarë të kësaj ideje dhe iniciatore të kësaj ndërmarrjeje u bënë personalitete të shquara të politikës shqiptare të atyre viteve. Me shkatërrimin e Halifatit, ngritja e një shkolle të tillë shtrohej si një çështje emergjente. Grupi i iniciatorëve kryesorë përfaqësohej nga Hfz.Vehbi Dibra, senatori Sali Vuçiterni, intelektualët e shquar Qamil Bala, Mehdi Frashëri, e Ferit Vokopola etj.

Medreseja që do të ngrihej synonte të përgatiste klerikë të ditur, të pajisur me njohuri të larta fetare, filozofike e shkencore, në përkatësi me arritjet e arsimit bashkëkohor.

Drejtimi i kësaj medreseje iu caktua Q.Balës. Qamil Bala i lindur në Gilan të Kosovës, dhe që kishte mbaruar studimet në Stamboll, kishte një përvojë të gjatë pedagogjike si mësues në gjimnazet e Janinës, Selanikut dhe Manastirit, si dhe drejtor i gjimnazit në Jeruzalem, drejtor arsimit në Damask e Elbasan. Ai kishte marrë pjesë në Kongresin arsimor të vitit 1922 dhe qe anëtar i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës".

Këtij personaliteti iu besua drejtimi i Medresesë të Tiranës më 1 mars 1924. Ai paraqiti planin mësimor të kësaj shkolle fetare, ku do të jepeshin lëndët: Kur'ani, Fikhu,gjuha arabe, gjuha shqipe, gjuha frënge, historia e Shqipërisë, gjeografia, shkencat, aritmetika e gjeometria, higjena dhe lëndët e djathtësisë (vizatim, gjimnastikë dhe muzikë).

Për nga programi dhe plani mësimor, kjo medrese ishte e barazvlershme me gjimnazet bashkëkohore. Në këtë traditë eci ajo, nga bankat e së cilës dolën klerikë të aftë, studiues, shkrimtarë e deri akademikë.

## **MEHMET AKIF ERSOJ**

### **PERSONALITET SHQIPTARO TURK**

Ndër shqiptarët që kanë bërë emër në fushën e letrave në Perandorinë Osmane, është edhe Mehmet Akif Ersioj, me origjinë nga Shushica e Pejës, nga një familje intelektual, myderizi.

U muar që herët me poezi, ndonëse studimet i ndoqi për veterinari, duke u diplomuar në vitin 1836, në sajë të një pune këmbëngulëse, duke kaluar edhe situata të vështirësive materiale, mbasi i ati e la që herët.

"Që në shkollën e mesme kishte mësuar mirë arabishten, e cila ishte gjuha e Kur'anit dhe persishten, gjuha e letërsisë osmane. Më vonë në Paris përvetësoi edhe frëngjishten. Thëksojmë se Mehmet Aqifi zotëronte bukur edhe shqipen, që e kishte gjuhë amtare...".

"Pas vitit 1912 për afro 4 vjet shërbeu si veterinar në Rumeli e sidomos në Shqipëri, (dy vjet në Kosovë) ku kishte shkuar edhe në Pejë për t'u çmallur me të afërmit".

Bëri emër si poet. Në vitin 1895 u botua poezia e tij e njohur "Kur'an - a Hitap". Një vit më pas filloi të botojë në revistën "Resimli Gazete". Në vitin 1908 filloi botimi i revistës "Sirati-i-Mustakim", duke qenë kryeredaktor i saj Mehmet Akifi. Atje boton shumë nga poezitë e tij, disa prej të cilave me pseudonimin "Sa'di".

Një vend të dukshëm zë në krijimtarinë e Mehmet Akifit vepra e quajtur "Asim", e cila është botuar në vitin 1919 e deri në vitin 1924. Po ashtu edhe vepra në pesë vëllime, "Bir Gece", "Bir Ariz", "Ne eser", "Ne de Semer", Derviş Ahmet", "Sa'di Pasa Imami", etj.

Mehmet Akifi thurte vjersha duke pasqyruar ngjarjet tragjike që sundonin në atë kohë. Ka shkruar vjersha elegjike edhe për Luftën Ballkanike 1912-1913, për Luftën e parë Botërore 1914-1918.. Ai luftoi jo vetëm me shkrime e vjersha, por mbante edhe ligjërata nëpër xhami më Kastamonu e vilajete të tjera".

Mehmet Akifi njihet si autor i Hymnit të Turqisë, duke konkuruar me rreth 700 poetë që paraqiten krijimet e tyre në konkurs, por Mehmeti e kishte sjellur me porosi të disa shokëve të tij, përfshirë edhe ministrin e Arsimit Hadullah Suphiu, e të tjerë. Ky hymn u pranua zyrtarisht me 1 mars 1921, duke u botuar në gazeta e kartolina, në tabela, etj, duke u afirmuar në të gjitha anët.

Mehmet Akifi ishte një personalitet i shquar i poezisë dhe i arsimit dhe i kulturës në Turqi, duke qenë edhe ministër për një kohë. "Ai ishte patriot dhe demokrat, urrente despotizmin perandorak dhe imperializmin perëndimor, të ashtuquajtur "qytetërim". M. Akifi ishte pan-islamist. Po ai urrente edhe kritikonte pan-turanistët ose pan-turkistët...partinë Itthat-Terakki, që kishte ardhur në fuqi me revolucionin e vitit 1908".Gjimnazi privat turko-shqiptar në Tiranë, sot mban me respekt emrin e tij.

## **HAXHI VEHBI DIBRA (AGOLLI)** **KOMENTATORI MË I MIRË I KUR'ANIT NË GJUHËN SHQIPE**

Haxhi Vehbi Agolli (Dibra) lindi në Dibër të Madhe me 12.03.1867. Pas kryerjes së studimeve teologjike dhe specializimit në fushën e filozofisë islame, logjikës, shkencave juridike etj, emërohet myfti i Dibrës, detyrë që e ushtroi deri më 1912. Në vitin 1909 merr pjesë në Kongresin e Dibrës, ku u

zgjidh kryetar i tij. Më 1912 shkon delegat në Kuvendin Historik të Vlorës, ku zgjidhet kryetar i Pleqësisë (Senatit) (Organ konsultativ në ndihmë të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës), zëvendësonte Ismail Qemalin kur ai mungonte.

Zotëronte arabishten dhe turqishten. Haxhi Vehbi Dibra u emërua myfti i Shqipërisë pas shpalljes së Pavarësisë, post që e mbajti deri më 1929. Gjatë kësaj kohe Komuniteti Musliman mori ngjyrë kombëtare dhe zgjidhi shumë probleme. Sistemoi të gjitha pronat e vakëfeve, i evidentoi këto me dokumentacionin përkatës të përpiktë, normalizoi shërbimin fetar në qytete e fshatra, realizoi një varg reformash centralizuese, sidomos në drejtim të vartësisë së faltoreve dhe kuadrove, ai hodhi edhe idenë për formulimin e statutit.

Komuniteti që fitoi njohjen juridike, filloi të botojë revistën e përmuajshme "Zani i Naltë". Ai ndikoi në hapjen e "Medresesë së Naltë" në Tiranë. Në këtë mënyrë autoriteti i Komunitetit Musliman Shqiptar u rrit shumë dhe vendosi lidhje me shumë vende islame. Më 1935 H.V.Dibra shkon për herë të dytë në Qabe, ku u afirmua si një dijetar islam i kohës.

H.V.Dibra ishte një nga komentatorët më të shkëlqyer të Kur'anit në gjuhën shqipe. Këto konferenca të mbajtura në xhami janë botuar në revistën "Zani i Naltë". Ndërsa në vitin 1993 botohen të plota në SHBA nga Imam Vehbi Ismaili, nën titullin "Ç'urdhëron Kur'ani?"

Të gjitha cilësitë e teologut islam përsônifikoheshin te V.Dibra, imam dhe haxhi, kryemyfti dhe kryetar senati, vaiz dhe komentator i Kur'anit. Kryesoi dhe drejtoi për vite me radhë teologët më të shquar shqiptarë. Haxhi Vehbiu, me mendimet e tij të larta e progresive, i ftonte njerëzit ta shfrytëzojnë inteligjencien e tyre.

Në komentin që i bënte Haxhi Vehbiu disa citateve Kur'anore thoshte:

"Me zgjedhë të aftin e të meritueshmin dhe me e vu në krye të detyrës, e pastaj ky me veprue e me gjykue me arsye, me drejtësi...".

Në planin politik te Haxhi Vehbiu gjejmë një propagandist të shkëlqyer, që punonte gjithmonë për mbarëvajtjen e kombit e të atdheut. Në unitetin dhe bashkimin e gjithë shqiptarëve shihte të vetmen rrugë për të siguruar të ardhmen tonë. Ai do të thoshte në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 se "Kristiani e myslimani janë vëllezër shqiptarë të pandarë". "Armikut të atdheut i pritet hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë". "Naltësimi e përparimi i një vendi varet në sigurimin e qetësisë së brendshme. Atje ku mungon qetësia, nuk mund të përparojë industria, tregtia e burimet e tjera ekonomike që e lumturojnë një popull".

Si mendimtar dhe bartës i vizionit të islamit ndër shqiptarët, Haxhi Vehbiu kuptoi qartë problemet dhe vështirësitë para të cilave gjendej Komuniteti Musliman Shqiptar, të cilin ai e kryesonte. Ai kuptoi se islami në Shqipëri duhej t'i hynte një rrugë të re për të vazhduar misionin dhe rolin e tij mirëbërës e civilizues në ndërtimin e të ardhmes së atdheut. Ai theksonte se: "Injorancën s'mund ta justifikojmë me pleqërinë tonë, as me mungesën e shkollave në atdheun tonë... pse jemi urdhnue për të studue deri kur të vdesim, jemi urdhnue me udhtue deri në vendet më të largëta për të studiue ". Sipas tij trashëgimia islame e mbetur prej të parëve duhej të bëhej e vazhdueshme në mënyrë që të barazohej me arritjet moderne, "duke i shtyrë kufijtë e diturisë në horizonte me të largëta se ç'kanë parafytyruar teologët dhe dijetarët e parë të trevave tona".

Sa herë që fatet e Shqipërisë ishin në rrezik, ai frymëzohej nga porosia e Muhammedit (a.s.) "Dashuria për atdheun është pjesë e besimit". Vdiq në Tiranë në vitin 1937.

## **SALI NIAZI DEDE**

### **KRYEGJYSHI BOTËROR I BEKTASHINJVE**

Është një nga figurat më të rëndësishme të lëvizjes bektashiane shqiptare. Kryesoi Kryegjyshatën e Tiranës menjëherë pas krijimit e saj nga Këshilli Gjyshnor i Shqipërisë.

Përgatitjen si dervish dhe pastaj në gradat më të larta të hierarkisë klerikale ai e mori në Anadoll, pranë teqesë së Haxhi Bektashit.

Në Starje të Kolonjës, që ishte vendlindja e tij, kishte bërë vetëm arsimin fillor. Në atdheun e tij erdhi më 1908 për herë të parë dhe më 1932 për herë të dytë dhe përfundimisht, ku u vendos në krye të Kryegjyshatës.

S.N.Dede e udhëhoqi me sukses Kryegjyshatën, e cila fitoi një reputacion të madh dhe shtoi radhët e saj me shumë personalitete të shquara të vendit.

S.N.Dede dallohej për talentin e tij poetik.

Ai ra viktimë në vitin 1942 në rrethana të paditura.

## **MULLA HASAN MASURICA HOXHA INOVATOR**

Mulla Hasan Masurica është bir i një familjeje kosovare të madhe nga Krileva e Kamenicës.

Studimet e para i bëri në shkollën ruzhdije të Gjilanit, kurse shkollën normale të fesë islame e mbaroi në Shkup në vitin 1907. Që nxënës në normale, Hasan Masurica u dallua për një imagjinatë dhe fantazi krijuese të pasur, për një kujtesë fenomenale, për aftësi aplikative për t'u admiruar. Që në shkollë plotore ai kishte përvetësuar gjuhët turke, arabe dhe perse, gjuhë të cilat i dhanë mundësi të shfrytëzonte literaturën islame.

Gjatë kohës që ishte student, edhe më vonë, atij i pëlqente letërsia fetare dhe ajo shkencore. Me pasion të madh lexonte çdo libër fizike, matematike apo të shkencave teknike, që i binte në dorë. Në mënyrë të veçantë ai ishte i dhënë pas astronomisë. Astronomia dhe astrologjia ia ushqenin atij fantazinë, i nxitnin ëndrrat dhe dëshirat për të shpikur diçka. Frymëzimet që i vlonin në mendje dhe që nuk e linin të qetë filloi t'i vizatonte në fletë të bardha. Ai kërkonte bashkëpunëtorë në ndërmarrjet e tij.

Pasi i drejtonte lutjet Allahut(xh.sh.) dhe pasi i kryente më së miri detyrat e tij si imam, Mulla Hasani jepte mësim, mbante vaze, ku, veç të tjerave, u tregonte nxënësve të tij si dhe xhemmatit, qysh në vitin 1900, se njeriu brenda pak dhjetëvjeçarëve do të arrijë në planete të tjera, se do të mund të komunikojë me të afërmit e tij nga një vend i largët, se do të zbulojë aparate që do të flasin dhe do të shihen brenda dhomës etj.

Ai vetë ishte i pajisur me një intuitë prej shpikësi të mrekullueshëm. Me guxim të madh filloi ndërtimin e një mjeti fluturues (ballone) dhe për këtë punë kërkoi ndihmën e farkëtarit të fshatit. Për këtë ballonë

përdori dërrasa plepi, pelhurë të lyer me dyllë dhe në prani të fshatarëve të Zarbicës, në vitin 1899, bëri provë me djalin e tij 12 -vjeçar, i cili u ngrit në një lartësi 50-70 metra, duke përshkuar një largësi rreth katër kilometra.

Mulla Hasan Masurica ishte një "Edison" i vërtetë, por në kushtet e vendit të tij ai u kufizua vetëm me projektimin, ndërtimin dhe aplikimin e disa aparateve që mbetën si relike, duke dëshmuar gjeninë shqiptare. Ai ngriti mullirin e fshatit me ndihmen e ujit e të erës, ndërtoi mullirin e kafesë etj. Më vonë ai projekttoi dhe ndërtoi një tip armë, e cila mbushej dhe zbrazej disa herë, shpikje për të cilën u vu në dijeni edhe Sulltani.

Aktiviteti i Hasan Masuricës që i shumanshëm, ai shtrihej edhe në veprimtarinë fetare, si imam dhe mësues feje, edhe si aktivist i hapjes së shkollave për mësimin e gjuhës shqipe. Ai zotëronte një bibliotekë shumë të pasur.

Në vitin 1916 ai luftoi me armë në dorë për të mbrojtur trojet shqiptare nga pushtuesit bullgarë. Bullgarët ia dogjën shtëpinë dhe bibliotekën, ku ishte edhe kalendari mbi poziten e planeteve në gjithësi, të cilin e kishte filluar ta ndërtonte që me 1911 e që e rikapi më vonë për ta përfunduar në vitin 1925. Vdekja e tij u shndërrua në një manifestim popullor.

## **ISMAIL NDROQI**

### **NJË JETË KUSHTUAR ISLAMIZMIT DHE ÇËSHTJES KOMBËTARE**

Diaspora shqiptare e Stambollit qe shumë aktive gjatë fundit të shekullit të kaluar dhe dhjetëvjeçarit të parë të shekullit tonë. Lëvizjen rilindëse shqiptare atje e përkrahnin dhe e ndihmonin edhe studentët e shumtë që vazhdonin shkollat dhe medresetë e kryeqytetit të Perandorisë, si dhe fakultetet e Universitetit të Stambollit. Aty studionin disa dhjetëra talebe për hoxhallarë, juristë, mjekë, ushtarakë etj. Në këtë periudhë bënte studimet e mesme dhe ato të larta edhe Ismail Ndroqi.

Pas revolucionit të turqve të rinj, shumë studentë, laureatë dhe intelektualë shqiptarë, të mbushur me ideale kombëtare, u kthyen në atdhe të vendosur për të luftuar për pavarësinë e Shqipërisë. Një ndër ta ishte dhe Ismail Ndroqi, që kishte mbaruar studimet fetare në Medresenë e lartë të Stambollit . Ai u kthye në atdhe më 1908, tashmë i pjekur dhe plot dëshira për t'i shërbuer atij.

Me t'u kthyer në atdhe u radhit në trupin mësimor të medresesë së Tiranës, ku punoi 5 vjet.

Si intelektual, zhvilloi, krahas edukatës fetare, edhe veprimtari patriotike. Nxënësit dhe një pjesë e popullit mësuuan prej tij, gjatë kësaj kohe, gjuhën shqipe dhe historinë e kombit. Këtë punë ai e bënte fshehurazi. Me veprimtaritë që zhvilloi në dobi të lëvizjes kombëtare, u ingranua në të dhe u bë shpejt një nga anëtarët më aktivë për zonën e Tiranës.

Viti 1912 qe, për të, viti që vulosi qëndrimin e tij në dobi të pavarësisë shqiptare. Ai u solidarizua plotësisht me nismën e Ismail Qemalit. Qe nga më kryesorët që ngriti flamurin kombëtar në Tiranë. i ofroi ndihmë Ismail Qemalit dhe punoi për zbatimin e direktivave të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Këto veprimtari ngjallën armiqësi tek Esat Pashë Toptani, i cili, për të menjanuar dhe për të

izoluar veprimtarinë e tij, u bë faktor që ai të transferohej myfti në Shijak (1913-1914) e pastaj në Kavajë (1914-1915). Megjithatë, popullariteti i tij u rrit dhe, më 1916 emërohet myfti në Tiranë.

Niveli i lartë fetar i tij, si dhe aftësitë organizative të treguara gjatë periudhës 1908-1916, bënë që ai të zgjidhej kryetar i Katundarisë (Bashkisë) së Tiranës.

Gjatë kohës që kryesoi bashkinë u përpoq për hapjen e shkollave shqipe, organizoi batalionin vullnetar të Tiranës, që mori pjesë në Luftën e Vlorës dhe mbështeti qeverinë e Sulejman Delvinës. Ai gjithashtu qe kundërshtar i lëvizjes esadiste. Në prill të vitit 1920 iu drejtua Konferencës së Paqës, me kërkesën për të njohur kufijtë etnikë të Shqipërisë. Këtë dokument të rëndësishëm e nënshkroi ai vetë në emër të tridhjetëmijë vetave që morën pjesë në miting.

Konsequent në idealin e tij për një Shqipëri që përfshinte krejt trojet shqiptare, ai iu drejtua edhe një herë qeverive evropiane me një telegram, në tetor të vitit 1921, ku theksonte se populli shqiptar nuk do të njihte asnjë vendim diplomatik që do të cenonte kufijtë e Shqipërisë.

Si klerik i lartë mysliman e një intelektual i mirëfilltë, iu kundërvu intelektualëve dhe besimtarëve obskurantistë dhe fanatikë. Në vitin 1928, ai u tërhoq nga jeta politike dhe iu kushtua plotësisht shërbimit fetar. Gjatë periudhës 1928-1939 shërbeu si myfti i Durrësit, ku mbajti shumë vaze me nivel të lartë teorik. Populli i Shqipërisë së Mesme e përcolli me nderime të mëdha, duke e konsideruar si një nga bijtë e tij më të nderuar.

## **HAFIZ YMER SHEMSIU PRISHTINË 1895 - SAZLI 1945**

Pinjoll i një familjeje intelektuale hafizësh dhe haxhijs, Ymer Shemsiu ndoqi mësimet e mesme fillimisht në medresenë e Prishtinës e pastaj në atë të Shkupit. Por për arsye madhore nuk arriti t'i përfundojë ato. Formimin fetar dhe intelektual të tij ai e vazhdoi në rrugë autodidakte. Me vullnet të patundur arriti të zotërojë disa gjuhë të huaja si: arabishten, persishten, turqishten, gjermanishten dhe serbishten. Krahas zotërimit të këtyre gjuhëve, ai u thellua edhe në studimet letrare e, në mënyrë të vçantë, në studimet filozofike, duke formuar kështu fizionominë e intelektualit të mirëfilltë islam. Titullin Hafiz ai e mbrojti publikisht në xhaminë e boshnjakëve.

Ymer Shemsiu është një figurë poliedrike. Ai ishte imam, poet, luftëtar, veprimtar, mësues. Në periudhën e Luftës së Parë Botërore Ymer Shemsiu hapi në fshatin Sazli një shkollë shqipe. Shkolla fatkeqësisht pati jetë të shkurtër. Pushtuesit bullgarë, kur hynë këtu, e mbyllën menjëherë këtë shkollë dhe mësuesin e saj shqiptar, Hafiz Ymerin, e lidhën me veriga dhe e burgosën në burgun e Ferizajt.

I ngritur nga ana botëkuptimore islame, botëkuptim që e respekton lirinë dhe lufton për te, Hfz.Ymeri, i mburjtur me dashuri për kombin, u aktivizua në shërbim të Komitetit për çlirimin Kombëtar të Kosovës dhe bëri pjesë në partinë politike shqiptaro-myslimane "Bashkimi", që kryesohej nga Ferhat Draga. Në këtë kohë, Hfz.Ymeri shpërtheu me tërë përsonalitetin e tij, bashkëpunoi me lëvizjen kaçake kombëtare, këndoi me çifteli këngë që evokojnë të shkuaren e lavdishme të kombit, formuloi ilahi dhe thuri poezi me metrika të ndryshme, por ku mbizotëron vargu popullor.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së Hfz. Ymer Shemsiut është edhe organizimi i mësimin të gjuhës shqipe fshehurazi. Në xhaminë e Talimocit, ku shërbente si imam i saj, ngriti Komitetin e Kosovës. Në këtë kohë ai jepte mësimin e gjuhës shqipe fshehurazi dhe, në të njëjten kohë, mbante dhe mejtepin. Mësimin, në lokalitë e ngritur nga vetë populli, e vazhdoi që nga viti 1934 deri me 1941. Në këtë mejteq, Hfz.Ymeri zhvilloi një punë pedagogjike përtej programit që zhvillohej në mejteq. Përveç shkrim-leximit në gjuhët orientale, ai u mësoi nxënësve dhe shkrim-lexim në gjuhën amtare shqipe dhe i përgatiti ata me njohuri dhe aftësi të vlefshme për jetën e përditshme.

Në veprimtarinë e tij zë një vend të rëndësishëm edhe krijimtaria si rapsod i talentuar. Talenti i rapsodit kronikan shoqërohej nga virtuoza e tij si vallëtar i shkëlqyer. Ai i hartonte vetë këngët, i këndonte me çifteli dhe i kërcente me lëvizje karakteristike shqiptare. Protagonistë dhe tema të rapsodive dhe të këngëve të tij qenë heronjtë e kombit, betejat, bëmat e ndryshme, duke na dhënë kështu tabllo realiste të kohës. Nga krijimtaria e tij spikat poema "Nazmi Gafurri".

Për këto cilësi, Hfz.Ymer Shemsiun studuesit e quajtën "Bard i Kosovës". "Bardi i Kosovës" e sfidoi policinë serbe duke u mësuar shqip nxënësve dhe popullit, duke shkruar shqip dhe duke shtypur shqip. Ai hartoi rreth 30 ilahi shqip, që kapin rreth 1000 vargje dhe përçoi te nxënësit dhe populli besimin islam. Ai ka një qëndrim të prerë dhe një mendim të qartë për bashkimin e popullit, për luftën kundër përçarjes fetare dhe asaj kombëtare."Të mbrosh fenë islame për kohën e poetit ishte luftë për kombin shqiptar, ta mbrosh gjuhën shqipe ishte heroizëm kombëtar, të përpiqesh për lirinë, ta ndihmosh rezistencën shqiptare kundër denacionalizmit të Kosovës, kundër shpërnguljes së shqiptarëve, ishte luftë patriotike, ishte sakrificë e heroizëm kombëtar". Hfz.Ymeri ishte për një Shqipëri etnike. Ai mori pjesë aktive për realizimin e kësaj ideje, duke ngjallur armiqësinë e pushtetit serb ndaj tij. Vdiq në mënyrë të dhëmbshme, por të madhërishtme, që konkretizohet në fjalët e fundit të tij: "Lamtumirë o

populli im! Për ty dhashë atë që mund ta jepnja: pasurinë, familjen, veten. Për ty do të vijmë ditë më të mira".

## **ARIF SHALA**

### **VËLLEZËR MOS E BRAKTISNI DRENICEN**

Arif Shala është biri i Drenicës së Kosovës. Lindi më 1909 dhe që në moshë të re, kur ishte ende nxënës në mejtepin e Mulla Rifatit, shquhej në mes të shokëve të tjerë për zgjuarsinë e tij, shkathtësinë dhe karakterin e fortë. Duke qenë ende i ri, ai arriti të mësojë Kur'anin përmendësh dhe të dallohej për deklarin e bukur që bënte. Më 1927 mbaroi medresenë e Gjakovës dhe në ato vite të rënda për Kosovën vazhdoi gjimnazin në Tiranë. Në fshatin Koroticë e Epërme, ku u caktua si imam, ai, së bashku me mësimit e fesë, u mësoi nxënësve në mënyrë ilegale dhe lexim-shkrimin e gjuhës amtare shqipe. i tronditur nga krimet që bënte xhandermaria serbe mbi popullin shqiptar, i dërgoi më 1933 letër proteste krajlit serb, Pjetrit. Më 1935, me anë të një panfleti, ftoi popullin e Kosovës të bojkotonte zgjedhjet. Por, ajo që e bëri popullor imam Arifin ishte kushtrimi i tij për te mos u shpërngulur kosovarët në Turqi, por të qëndrojnë në trojet e veta. Falë aktivitetit të tij, asnjë familje shqiptare nga Drenica nuk emigroi në Turqi.

Imam Arif Shala iu kundërvu fashizmit italian. Ai mori pjesë në çlirimin e Prishtinës dhe të Ferizajt. Arifi ishte njeri me karakter të fortë, me botëkuptimi të qartë islamik, me devocion patriotik deri në

vetëmohim, me një dashuri të papërshkruar për vendlindjen dhe për Kosovën. Demokrat me ndjenjë dhe me zemër.

Arifi nuk mund të pajtohej me politikën diskriminuuese sllave antishqiptare dhe antikosovare. Ai doli ilegal, komit për të luftuar për lirinë e popullit dhe lirinë e besimit islam. U ndesh disa herë me patrullat e UDB-së dhe më 1 janar 1947 policia serbe, pasi e diktoi, e rrethoi dhe e vrau në mënyrë barbare, pikërisht në ditën e parë të vitit të ri. Me gjithë kundërshtimet e policisë serbe, populli i Miranit e varrosi me nderime imamin nga Drenica, Arif Shalën.

## **BABA ALI TOMORRI NJË NGA VIKTIMAT E KOMUNIZMIT**

Baba Ali Tomorri ka lindur në Shalën e Tepelenës nga fundi i shekullit të XIX. Është një nga shkrimtarët dhe historianët e rinj të bektashizmit. Shkrimet e tij nënshkruhen edhe me emrat Varfe Ali Prishtina ose me pseudonimin "Turabi". Botimet e tij janë të karakterit fetar bektashian. Ndër to dallohen: "Bektashinjtë e Shqipërisë", Korçë, 1921. "Leteratyra e Bektashinjtë" (pa vend botimi, pa datë). "Histori e Bektashizmës", Tiranë, 1929. "Nefese dhe Gazele bektashiane", (pa vend e pa datë botimi).

Botoi edhe shumë shkrime dhe vjersha të veçanta në organet e shtypit të kohës. Një poezi e tij i është kushtuar flamurit kombëtar: "Flamurit të Shqipërisë".

B. Ali Tomorri qe një nga organizatorët kryesorë të tre Kongreseve Bektashiane: Kongresit të Parë Bektashian që i zhvilloi punimet në Prishtinë, ku ishte edhe selia e parë e teqesë së tij(në 1922). Kongresit të Dytë që u mbajt në Gjirokastrë, më 1926 dhe Kongresit të Tretë në Turan të Korçës, më 1929.

Më 1921 B. Ali Tomorri nxori dhe drejtoi fletoren "Reforma". Më 1947 u dënua me vdekje nga gjyqi komunist dhe u ekzekutua me akuzen se ka bashkëpunuar me anglezët.

## **MA'RUF AL-ARNAUTI SHKRIMTARI I SHQUAR ARAB ME ORIGJINË SHQIPTARE (1892-1948)**

Një shekull e gjysëm më parë, familja shqiptare e Hasan Agë Mevlan Jusufit mori rrugën e mërgimit. U vendos në Bejrut, atëherë pjesë e territorit të Perandorisë Osmane. Hasan Aga, me zgjuarsinë dhe besnikërinë që e dallonte në marrëdhëniet me njerëzit, fitoi besimin e autoriteteve të vendit, të cilët e emëruan shoqërues ushtarak të Kryetarit të Bashkësisë, Halil Pashës.

Hasanin bejrutasit e mbiemëruan Al-Arnauti dhe ky llagap i mbeti. Këtë mbiemër përdori dhe i biri Ahmeti dhe i nipi Maërufi, i cili u edukua në një mjedis besimtarësh të devotshëm për traditat fetare islamike. Në mënyrë të veçantë, me dashuri ndaj fesë islame, ndikoi e ëma, që e njihte mirë historinë dhe jetën e peygamberit (a.s.).

Maërufi ndoqi arsimin fillor pranë një shkolle private të Bejrutit. Shkolla të tilla, në fillim të shejullit tonë, kishte me shumicë në këtë zonë. Fuqitë e Evropës Perëndimore kishin filluar të interesoheshin me të madhe për këtë pëllg, dhe kërkonin të depërtonin me kulturën e tyre. Kjo pati efektin e vet në dy drejtime: kultura evropiane dëshirohej, por edhe rreziku ç'arabizues ekzistonte.

Fatiu i Maërufit që se pati për mësues një pedagog shumë të aftë Hasan El-Habalin, i përmendur për kulturën e tij fetare, për simpatinë ndaj halifatit osman, si dhe për taktin e tij pedagogjik. Mësimet që mori nga ky pedagog, që ishte njëkohsisht edhe drejtor i gazetës "EBABIL", ushtruan një ndikim të fuqishëm në edukimin e karakterit dhe përgatitjen e djaloshit me prejardhje shqiptare. Maërufi mësoi përmendësh pjesë të Kur'anit dhe u pajis me njohuri të shumta fetare.

Duke zotëruar një përgatitje solide në gjuhën arabe, turke, frënge si dhe në lëndë të tjera, si dhe duke qenë i etur për dituri, Maërufi u regjistrua student në Fakultetin Islamik të Osmanllinjve, që drejtohej nga teologu me famë Ahmed-Ab-Bas El-Ezmeri. Trupi mësimor i këtij fakulteti shquhej për ndjenjat e tij përparimtare, liridashëse dhe islamike. Nga mësuesit, në mënyrë të veçantë, kishte tërhequr simpatinë e studentëve Jusuf Harfushi, pedagogu i frëngjishtes. Me aftësitë e tij prej didakti dhe psikologu ai, Jusufi, nëpërmjet komenteve që u bënte veprave të klasikëve francezë dhe atyre lindorë-islamike, diti të ngjallë në zemrat e mendjet e studentëve të tij besimin në të drejtën dhe luftën e arabëve për pavarësi dhe liri si dhe njohjen e revolucioneve në botën perëndimore.

Maërufi u shqua shpejt në mes shokëve të fakultetit për zgjuarsinë, talentin dhe kulturën e tij. Ai ishte ligjërues i shkëlqyer. Që në moshën 16 vjeçare debutoi me vjrrshat e tij para një auditori intelektualësh turko arab, që e bëri menjëherë të njohur e popullor emrin e tij. Këtu fillon edhe karriera e tij si poet, si shkrimtar, si publicist e si përkthyes.

Para tij u hapën, portat e shtypit. Gazetat, revistat e kishin për nder të botonin shkrimet e Maëruf-Arnautit. Ai zotëronte të shkruarit në mënyrë të përsosur të arabishtes, turqishtes dhe frëngjishtes. Por vallë, a e njihite gjuhën shqipe? Fatkeqësisht nuk dimë gjë për këtë. Dimë vetëm se ai e kishte për krenari prejardhjen e tij shqiptare dhe e ruante mbiemrin domethënës: Shqiptari -Arnauti.

Ai u bë i njohur kryesisht në Siri dhe në Liban. Shkrimet e tij reklamoheshin në vitrinat e librave të Damaskut e të Bejrutit.

Më 1914 plasi Lufta e Parë Botërore, Maërufi u rekrutua nizamë. Detyrimin ushtarak i takoi ta bënte në brigjet e Bosforit. i ndodhur shpesh në Stamboll, Maërufi i afrua në qarqet intelektuale turke, ku u bë i njohur me disa poetë turq.

Nga gjërat që kishte marrë me vete nga shtëpia kur qe nisur për luftë qe libri i shenjtë i Kur'anit, që e ëma ia kishte porositur që ta mbante pranë për të pasur mbështetjen e Zotit dhe të Pejgamberit.

Meqenëse fatet e luftës filluan të duken, dhe Perandoria Osmane bënte pjesë në grupin e aleatëve që po e humbnin atë, Maërufi parashikoi se qendra e Kalifatit Islam nuk mund të mbehte më në Turqi. Ai duhej të kthehej përsëri në vendet arabe, ku kishte filluar lëvizja e fshehtë për kryengritje, me qendër në Hixhaz.

Pa pritur ende mbarimin e luftës, Maërufi iku nga ushtria. Ishte viti i tretë i saj, 1916-ta. Turqia ndodhej në një kaos të madh. "Dola nga lufta i mërzhitur shumë për përfundimet që po merrte-. shkruante Maërufi shqiptar, në shkrimet e veta,- Me humbjen e luftës parashikoja dhe copërimin e Kalifatit. E shikoja me dhimbje të madhe. E doja shumë...".

Pas shumë endjesh të vështira, të shkaktuara nga zhvillimi i luftrave Maërufi arriti në Zhleh, i lodhur dhe i dëshpëruar. Dëshpërimi i tij u rrit, kur në shtëpi nuk gjeti babanë. Ahmed El-Arnauti, tregtar i njohur i Damaskut, Kishte ndërruar jetë, duke e pasur të birin, Maërufin, në frontin e luftës.

Maëruf El-Arnauti filloi jetën e tij të pavarur. U bashkua me ushtrinë e sherifit Husejn, i cili më 1918 hyri si fitimtar në Damask.

Në periudhën e pasluftës Maërufi iu kushtua terësisht punës intelektuale, kryesisht shtypit. Në bashkëpunim me publicistin e njohur sirian Kasim Uthmanin nxori Gazetën "El Istintal el-Arabi", e më vonë "Ej-lim al-Arabi". Por në mënyrë të veçantë ai u lidh me gazetën "Felal Arab", të cilën e drejtoi deri sa vdiq.

Maëruf Arnauti "Shqiptari, me botimet e tij të shumta bën pjesë në plejadën e shkrimtarëve dhe poetëve të shquar arabë të Lindjes së Mesme dhe asaj të afërme të gjysmës së parë të shekullit tonë. Ai zë vend në mes atyre figurave të shquara që trangu shqiptar i dha njerëzimit në fusha të ndryshme të shkencës, kulturës, teologjisë, teknikës e artit siç i njih historia e që janë Arkitekt Kasemi, aktori Aleksandër Moisiu, Mehmet Ali, Pashë Misiri themeluesi i egiptologjisë, brezat e Qyprilive politikanë e burra shteti, ndërtuesi i hekurudhës të Semeringut Karl Gega etj. Në periudhën tonë emri i shqiptarit Maëruf Arnauti është tashmë i njohur në tërë lindjen si poet e shkrimtar i madh, si publicist i shquar.

## **MULLA IDRIZ GJILANI**

### **UDHËHEQËSI SHPIRTËROR, POLITIK E USHTARAK**

Në historinë e re të gjysmës së parë të shekullit tonë, çfaqet dhe figura e Mulla Idriz Gjilanit. Studjuesi Muhamet Pirraku e portretizon si "Fetar atdhetar konseguent, orator e mjeshtër i penës, i zoti i punës, besnik i fjalës, predikues fetar dhe mualim-mësues iluminist, ideolog dhe luftëtar i lirisë, i vendosur në idealet e veta liridashëse, si bjeshkët e Kosovës, të cilat i mbrojti me fjalë, me pushkë, me gjak, burrërisht, trimërisht, i pathyeshëm, me plagë në zemër e në trup, nuk u dorëzua, u bë legjendë si Basho Muji".

Mulla Idriz Gjilani lindi në Velekincë, katund në periferi të Gjilanit, më 4 qershor 1901. Ndoqi studimet fillestare në mejtepin e Cernicës, të cilin e mbaroi në vitin 1911, kurse studimet e mesme i vazhdoi në medresenë "Atik" në Gjilan. Më 1926 u diplomua, pas një ndërprerjeje të shkollës. Në moshën 25-vjeçare u bë imam dhe fitoi titullin Mulla. Shërbeu në detyrën e Imamit në Karadak e në Hogoshtë. Më 1941 u zgjodh në postin e Bashvajizit në Ulema-mexhlizin e Kuvendit fetar-arsimor të Vakufit të Shkupit.

Në karrieren e tij prej fetari ai u nis nga disa parime kur'anore dhe hadithore që përcaktonin vlerat e arsimit, të kulturës dhe të edukatës: "Pa shkollim - thotë ai, - nuk ka fe të mirëfilltë", "Talebet (nxënësit) tonë nuk duhet të mësojnë më vetëm për leximin e Kur'anit, por edhe për njohjen e mjeshtërisë së shkrimit. Talebet tonë duhet t'i nisim në rrugën për ta njohur islamit dhe jo për ta prezantuar si diçka statike", "S'ka fe pa atdhe", "Të ndihmojmë njëri-tjetrin me fjalë, me penë, me pasuri, të duhemi si vëllezër", "Pa një atdhe të lirë feja nuk mund të mbahet, nuk mund të ushtrohet", "Lexoni te mualimë

të urtë sa e mirë dhe sa e kuptueshme është feja islame, kur shpjegohet shqip, në gjuhën e Zotit për shqiptarët".

Gjatë kohës si hoxhë dhe bashvaiz zhvilloi një veprimtari intensive në fushën e edukimit fetar me frymë atdhetare. Hapi mejtepin e Pidicit për mësimin e djemve dhe të vajzave, organizoi ilegalisht mësimin e shkrim-leximit me alfabetin e gjuhës shqipe, futi mësimin shqip në medresenë "Atik", ushquu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin vëllazëror me bazë kombëtare shqiptare në popullsinë muslimane-katolike të zonës së Karadakut. Kur qe mësimdhënës në tre mejtepe njëkohësisht, shfrytëzoi sistemin monitor: përgatiti nxënësit më të mirë dhe me moshë më të madhe për ta zëvendësuar kur ai mungonte.

Në prill të vitit 1937, në kushte ilegaliteti, themeloi në Arllat të Drenicës Organizatën e Rinisë Përparimtare "Drita" të Kosovës. Aktivitetet e tij fetare nuk dalloheshin nga ato atdhetare e humane. Kudo, kurdo e me këdo ato ishin të pranishme.

Mulla Idrizi ishte kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Në funksion të kësaj bindjeje atdhetare e humane ai programonte në xhami, në konake, në kuvende e deri në ceremonitë e vdekjes. Në formë kushtrimi ai thërriste: "Jemi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit. Nuk guxojmë të heqim dorë prej tyre t'i lëmë të shkreta për t'i lavruar derrat e naçalnikëve sllavë! Jo vetëm në Turqi, por as në Shqipëri nuk bën të shkojmë. Zoti në Kur'an na ka bërë përgjegjës për vatanin dhe kombin!"

Ai, personalisht, u printe aksioneve për ndërtimin e urave, rrugëve, çesmeve, mejtepeve, xhamive, mirëmbajtjes së varrezave, të cilat i shikonte si mjete dëshmuese të bashkimit të popullsisë shqiptare. Uniforma e ndihmoi për të maskuar aktivitetin e tij patriotik. Mulla Idriz Gjilani ishte një "rilindës" në kuptimin e vërtetë të fjalës në kushtet që kalonte Kosova. Në kohën kur Mulla Idriz Gjilani ushtronte

detyrën e bashvaizit, numri i nxënësve të ""Atik medresesë" të Gjilanit arriti në 734, nga të cilët 326 ishin femra. Po ashtu i organizoi shkollat lëvizëse me mësues shetitës. Vetëm në zonën e Gjilanit u hapën 39 shkolla të tilla fetare, që zgjuan te brezi i ri ndjenjat fetare dhe ndërgjegjën kombëtare.

Nga prilli 1941 Mulla Idriz Gjilani iu kushtua plotësisht veprimtarisë politike. Si hoxhë me forcën e Zotit, si mësues me forcën e fjalës, si luftëtar me forcën e armës, si komandant me besnikërinë e ushtarit, ai luftoi për unitetin territorial të trevave shqiptare, luftoi kundër genocidit serb e bullgar, kundër komunizmit.

Në qershor të 1944 -ës drejtoi betejën e Kikës, ku shqiptarët e udhëhequr prej tij dolën fitimtarë kundër ushtrisë sllavo-komuniste. Veprimtaria e Mulla Idriz Gjilanit është heroike. E tillë është edhe periudha 1944-1949 dhe kallja e tij në zjarr më datën e 25-26 nëndorit 1949 për të mbetur shembull te pasardhësit si dhe luftëtar, qëndruar dhe vdekur si shqiptar.

## **HAFIZ IBRAHIM DALLIUT BURRI QË NUK U MPOSHT NGA PERSEKUTIMET**

Zhvillimi i kulturës islame, shtypi publicistik dhe ai fetar, beteja dhe lufta për mbrojtjen e pavarësisë, lidhen me emrin dhe veprat e Hafiz Ibrahim Dalliu. Me Kur'an në dorë dhe me pushkë nën sqetull, ai u priu vullnetarëve të Tiranës si komandant për ta mbrojtur vatanin kundër agresorëve jugosllavë.

Hafiz Ibrahim Dalliu si një figurë patriotike, i shërbeu arsimit në përgjithësi dhe atij pedagogjik në veçanti. Gjatë viteve të rinisë, pa mbushur ende 18 vjeç, në rrugë klandestine, përvetësoi alfabetin shqip

dhe më 1901, së bashku me Filip Ashikun dhe Hoxhë Voglin, shërbeu si mësues i shkollës shqipe në Tiranë.

Më 1908 ai hapi shkollën e vajzave në Tiranë, ku u pregatitën mësueset e para vajza myslimane, si Servete Maçi etj. Mori pjesë në Kongresin Kombëtar për problemet e Arsimit, që u mbajt në Elbasan në shtatorin e vitit 1909. Së bashku me Luigj Gurakuqin dhe Aleksandër Xhuvanin, Hafiz Ibrahim Dalliu qe nga të parët që themeloi Normalen e Elbasanit, e cila u hap me vendim të Kongresit të mësipërm.

Luigj Gurakuqi shkruan se normalja e Elbasanit kishte në themelet e saj djersjen e mundin e Hafiz Ibrahim Dalliu, të Aleksandër Xhuvanit, Sotir Pecit, të tyre (të Luigj Gurakuqit, R.Z)e të atdhetarëve të tjerë.

Pas vitit 1912 Hafiz Ibrahim Dalliu iu kushtua publicistikës dhe letërsisë satirike. Më vonë drejtoi gazeten politike "Dajti". Duke nisur nga viti 1918 deri më 1924 botoi një varg veprash satirike duke u bërë kështu ndër të parët poetë satirikë që çanë rrugën e humorit në letërsinë shqipe. Këto vepra janë "Grenxat e kuqe"(1918), "Dokrat e hinit"(1920), "Kabineti i Xhafer Ypit" (1922) etj. Shkroi gjithashtu edhe librin me vjersha patriotike "Kreshniku i atdheut", si dhe monografinë "Patriotizma në Tiranë"(1930). Por njohjen si poet ai e fitoi me elegjinë kushtuar Avni Rustemit, kurse popullaritetin e fitoi nga qëndrimi i tij stoik kundër torturave që atij i bënë pushtuesit e Shqipërisë.

Burrëria dhe heroizmi i Dalliuat vihet në dukje dhe në një nga këngët e "Lahutës së Malësisë", ku poeti Gjergj Fishta mbi të tjera shkruan: *"a isht' "Shqiptar" apo "Osmanli", u përgjegj me trimëni: jam shqiptar me gjub e fis.*

Hafiz Ibrahim Dalliu ishte një ndër mbështetësit konseguentë të lëvizjeve demokratike të viteve 1920-1924. Vrasja e atdhetarit të shquar Avni Rustemi e brengosi pa masë. Por ai gjeti forca dhe i thuri këtij martiri të shquar, një këngë e cila gjeti jehonë jo vetëm në Shqipërinë e Mesme, por në mbarë viset shqiptare.

Hafiz Ibrahim Dalliu edhe më vonë u përdoq nga forcat rrebele dhe nga rregjimi komunist. Ai njohu qelitë e burgut të Manastirit, Selanikut, Tiranës. Herën e fundit e akuzuan për botimin e poemës "Grenxat e kuqe", se ka sulmuar pansllavizmin. Por karakteri shumë i fortë, besimi në islam e ushqente atë për të mbrojtur të drejtën dhe lirinë.

Vlen të përmendet edhe kontributi i tij i paçmuar gjatë viteve '30 për botimet e shumta që bëri në shërbim të edukimit fetar. Numërohen gjithsej 15 vepra, përkthime, por shumica origjinale. Ndër të gjitha këto shquan "Tefsiri shqip i Kur'anit" në dy vëllime, përkthyer nga arabishtja.

Libra të tjerë me karakter fetar janë: "Udha muhamedane" (vepër afër 500 faqesh), botuar në Tiranë më 1936, "E lemja dhe jeta e të madhit Muhammed alejhiselam", vepër në vargje, me një vëllim prej 238 faqesh, Tiranë, 1933, "Mësime teorike dhe praktike të besimit islam", Tiranë, 1935 etj. Qe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

## HAXHI HAFIZ ISMET DIBRA I ARRESTUAR PËR BINDJE FETARE

Dibra është vendlindja e Haxhi Hafiz Ismet Dibrës, Stambolli është vendi ku bëri studimet e larta. Tiranë është vendi ku zhvilloi veprimtarinë e tij. Revista "Zani i Naltë" është tribuna ku shpalosi njohurit e tij në fushën e legjislacionit islam, të filozofisë islame, tefsirit, hadithit, logjikës, teorikës etj. Medreseja e Lartë e Tiranës që institucioni ku ai zbatoi në praktikë edukatën islame dhe mjeshtërinë e mësimdhënies. Kishte një kulturë të gjerë, një qëndrim demokratik dhe patriotik. Zotëronte më së miri gjuhën arabe, perse dhe atë turke.

Kur mbaroi studimet i ofruan katedren në një shkollë të lartë të Stambollit, por ai e refuzoi, duke parapëlqyer të shërbente më mirë në atdhe. Ai është drejtori i dytë i Medresesë së Lartë të Tiranës pas Qamil Balës. Duke ndjekur traditat e të parit aktivizoi trupin mësimor, personel të përgatitur siç qenë: Hafiz Ali Korça, Haki Sharofi, Sheh Qazim Hoxha etj.

Në tërë veprimtarinë e tij ai udhëhoq nga mësimet e Kur'anit dhe në përshtatje me përbërjen e popullit shqiptar ai nisej nga toleranca në mes besimeve dhe besimtarëve. Medreseja e Lartë e Tiranës, e drejtuar nga I.Dibra, ruante dhe vazhdonte traditën e edukimit të nxënësve, krahas asaj të fesë, dhe të frymës patriotike dhe kalitjes së ndërgjegjës kombëtare.

I.Dibra vizitoi varrin e Profetit (a.s.) dhe fitoi të drejtën të quhej Haxhi.

Në vitet '30 të shekullit tonë zhvilloi një aktivitet të gjerë intelektual, fetar e patriotik. Janë të përmendura ligjëratat e tij të njëpasnjëshme që patën për subjekt temën "A ka dyshim në qenien e Zotit?". Në këto ligjëratat Hafiz Ismet Dibra, duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit, zbërtheu shumë

teza dhe koncepta që në ato vite ishin bërë objekt bisede në qarqet intelektuale. Ligjëratat bënin pjesë në luftën që kleri islam po i shpallte ideve komuniste, që kishin filluar të përhapen në Shqipëri. Hfz. Ismet Dibra iu referua shumë figurave të shquara të rrymave të ndryshme filozofike si: Dekartit, Berksonit, Spenserit etj.

Më vonë ato ligjëratat u botuan në faqet e "Zanit të Naltë" dhe më 1993 u botuan edhe në Miçigan të SHBA-së. Pushtuesit fashistë dhe ata gjermanë, më vonë, i ofruan ofiqe dhe dekorata, por ai, ashtu si më 1919 që nuk pranoi postin e profesorit të katedres nga Turqia, edhe kësaj radhe nuk pranoi nga pushtuesit e rinj asnjë dekorim, as post. Pushteti komunist, të cilit ai iu nënshtrua, e arrestoi në moshën 60 -vjeçare dhe e dënoi pa asnjë arsye, por vetëm për bindjet e tij fetare, antimaterialiste, me 12 vjet heqje lirie, të cilat i bëri si shumë e shumë të tjerë në burgjet e diktaturës komuniste. Vdiq në moshën 69- vjeçare.

## **ABDULHAQIM HIQMET DOGANI PEDAGOGU NGA GOSTIVARI**

Abdulhaqim Hiqmet Dogani (1880-1955) ishte pinjoll i një familjeje qytetare nga Gostivari. i ati ishte myfti në Gostivar. A.Dogani ndoqi rrugën e mësuesisë. Nga studimet që bëri në Stamboll mori arsim laik. A.Dogani shërbeu gjatë gjithë kohës së punës së tij si mësues në shkolla laike dhe fetare. Është ndër të rrallë që, si laik, shkroi edhe tekste me karakter fetar. Në idadijen e Shkupit, kur shumicën e

nxënësve e përbënin shqiptarët, lënda e gjuhës shqipe iu ngarkua A.Doganit, nga klubi shqiptar "Rinia Patriotike" ("Shubani vatan").

A. Dogani që i vonuar dhe fillimisht nuk ishte për alfabetin e Manastirit të miratuar nga përfaqësuesit e njëzetegjashtë shoqërive e klubeve, në nëntor të vitit 1908. Por shpejt e kuptoi dhe reagoi drejt. Në atë periudhë ai botoi një abetare shqip me alfabet arab, një abetare tjetër e botoi në vitin 1946, në gjuhën shqipe dhe me alfabet arab, me të cilën mësuuan brezenitë shqiptare të Ish -Jugosllavisë për vitin shkollor 1946-47.

Tekstet e tjera të tij janë shkruar në gjuhën turke, por kanë shërbyer për edukimin e nxënësve shqiptarë në shkollat që ndiqnin. Veprat e tij të njohura deri më sot, të paracaktuara për shkollat laike dhe fetare, janë: "Saban Yildizi yahot Musavver Osmanli Elifbasi" ("Ylli i mëngjesit apo abetare e ilustruar e osmanishtes"). "Yeni Elifba-Nes'h harflariyla tab'edlimis ueni imla ilifbasi" ("Abetarja e re- Abetarja portografike e botuar me shkronjat nesh"). "Muslumanlik" (Feja islame). "Arnavutca elifba-Arap harflariyla" (Abetare shqip- me alfabet arab). "Pedagogji kavaidine mutabik yeni sistem elifba" (Sistemi i ri i abetares sipas parimeve pedagogjike). "Kur'ani Kerim Derslaerine Baslangic" (Hyrtje në mësimin e Kur'anit të nderuar). "Birinci Kisim Turkçe Dersleri Elifba" (Pjesa e parë e mësimave të turqishtes-Abetarja). "Ikinci Kisim Turkçe Dersleri"(Pjesa e dytë e mësimave të turqishtes). "Uçuncu Kisim Turkçe Dersleri"(Pjesa e tretë e mësimave të turqishtes). "Doruncu Kisim Turkçe Dersleri"(Pjesa e katërt e mësimave të turqishtes). "Birinci Kisim Din Dersleri"(Pjesa e parë e mësimave të fesë). "Ikinci Kisim Din Dersleri"(Pjesa e dytë e mësimave të fesë). "Uçuncu Kisim Din Dersleri"(Pjesa e tretë e mësimave të fesë). "Dorduncu Kisim Din Dersleri"(Pjesa e katërt e mësimave të fesë). "Birinci Kisim Dersleri" (Pjesa e parë e mësimave të historisë). "Abetare", në gjuhën shqipe shtypur nga Shtypshkronja "Kultura", Shkup, 1946.

Nga veprat e mësipërme, të një rëndësie të veçantë janë "Sistemi i ri i mësimi fetar sipas parimeve pedagogjike", si dhe "Hyrye në mësimin e Kur'anit të nderuar".

Kontributi i tij në arsim dhe në edukatën islame ishte i veçantë. Abdulhaqim Dogani ka shkruar proza të shumta për fëmijë, një pjesë e të cilave ruajnë edhe sot vlerat e tyre arsimore dhe edukative. Ka botuar edhe artikuj studimorë, sidomos për historinë e Gostivarit e të viseve të tjera shqiptare.

Përsonaliteti i tij është paraqitur në librin monografik "Gostivari dhe Abdulhaqim Dogani".

## **HAFIZ ALI KORÇA HOXHA I PËRNDJEKUR**

Midis hoxhallarëve të përndjekur nga pushtuesit, nga fanatikët dhe komunizmi për idetë, pikëpamjet dhe veprimtarinë e tyre është dhe Hafiz Ali Korça. i rritur në një mjedis patriotik, fetar e kulturor Korçar të pastër, ai u brumos me bindje dhe parime bazë, që e ngriten lart emrin e tij. Për këto ai, në vitin 1893, kur ishte në moshën 20 vjeçare, u internua në Sinop, sepse ndërsa udhëtonte me trenin Sofie-Stamboll, iu kapen librat shqip, atëherë të ndaluar. Më 1900, u internua në Anadoll, për aktivitetin në mësonjëtoaren e Korçës. Pas Kongresit të Dibrës ia shkatërruan shtëpinë. Më pas, Kabineti i Telat Pashës e dënoi me vdekje, por me ndërhyrje u fal. Më 1924 u përjashtua nga Këshilli i Lartë i Sheriatit. Më 1925 botoi në Tiranë pamfletin "Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit".

Hfz. Ali Korça zhvilloi një veprimtari intensive në disa drejtime dhe kryesisht në fushën e kulturës, të fesë dhe të publicistikës. Ai ka shkruar një varg veprash origjinale në prozë e poezi fetare dhe laike. Ndër to shquhen:

"Mevludi" (1900). "303 fjalë të Imam Aliut" (Botuar në Korçë më 1910). "Historia e shenjtë dhe të katër halifetë" (Botuar në Tiranë më 1931, fq.288). "Jusufi me Zelihane" (Botuar në Elbasan më 1923). "Gjylistani", përkthim nga Saadiu, (1918). "Shtatë Ëndrrat e Shqipërisë", poezi, (Botuar në Tiranë më 1944). "Tefsiri i Kur'anit", (mbetur dorëshkrim, me një vëllim prej 2000 faqesh, R.Z.) punuar gjatë viteve 1920-1924. "Rubaijati Khajjam"(Hajjam, përkthim nga O. Kajami, 1930- Ribotim 1942 në Tiranë).

Një rëndësi të veçantë kanë gjithashtu edhe tekstet shkollore si : "Abetare shqip" (1910). "Fe Rrëfenjësi, morali" (1914). "Gramatika, Syntaksa shqip—arabisht edhe fjalime", (1916). Hafiz Ali Korça ka lënë edhe një numër të konsiderueshëm dorëshkrimesh e përkthimesh.

Hafiz Ali Korça, duke përkthyer kryeveprat si "Gjylistani", "Rubairat" si dhe "Jusufi me Zelihane", i bëri të flasin shqip poetët e mëdhenj si Saadiun, O.Kajamin etj.

Hafiz Ali Korça qe ndër mësuesit e parë të mësonjëtores së parë shqipe në Korçë dhe bashkëpunoi ngushtë me Pandeli Sotirin, drejtorin e mësonjëtores së parë shqipe të Korçës. Aty dha pa pagesë edukatë islame . Pas shpalljes së Pavarësisë, iu ngarkuan detyra të rëndësishme. Qe këshilltar i Ministrisë së Arsimit, Drejtor i Përgjithshëm po i kësaj Ministrie, Shef i Fetva-minit pranë Këshillit të Lartë të Sheriatit në Shqipëri, pedagog në Medresenë e Lartë të Tiranës etj.

Gjatë jetës së tij Hafiz Ali Korça bashkëpunoi me një varg figurash që luajtën rol të rëndësishëm në historinë e kohës së re të Shqipërisë, siç janë: Kristo Luarasi, Jusuf Turabi Kërçova, Pandeli Sotiri, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci, Sali Nivica etj.

Jeta e tij është një shembull i përsosur i atdhetarit të devotshëm, që nuk ndan fjalën nga veprat e poetit që fton bashkëpunëtorët të punojnë për mëmëdheun, të mos e braktisin.

## **PERSONALITETE TË KULTURËS ISLAME QË KANË USHTRUAR AKTIVITETIN E TYRE EDHE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XX**

### **SADIK BEGA DREJTOR I REVISTËS "KULTURA ISLAME"**

Sadik Bega Rrjedh nga një familje gjirokastrite me përkushtim fetar. Pasi mori mësimet e para në vendlindje, studimet e mesme i ndoqi në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës, të cilën e përfundoi me rezultate shumë të mira në vitin 1932. Sadik Bega i përket kontigjentit të parë të maturantëve që nxori kjo Medrese. Studimet e larta i vazhdoi në Kajro, ku u pajis me një kulturë të gjerë fetare. Zotëronte disa gjuhë.

Me t'u kthyer në atdhe, ai u angazhua në një punë të gjerë kulturore islamike. Në bashkëpunim me Sherif Putrën themeloi revisten fetare-letrare-ditunore dhe artistike "Kultura islame", organ i

Komunitetit Musliman Shqiptar. Me aftësi ai diti të mbledhë në këtë revistë intelektualë të sferave të ndryshme dhe të konfesioneve të ndryshme, duke e bërë këtë organ një nga revistat më të lexuara në shtresat myslimane.

Më 1942 përktheu dhe publikoi në shqip tri temat që Prof. Aleksandër Koire mbajti me rastin e 300-vjetorit të botimit të "Diskutimit mbi metodën" të Dekartit. Këtë libër (100 faqesh) ai e titulloi "Tre mësimet mbi Decartes". Këto janë "Bota e pasigurt", "Kozmisi i zhdukur" dhe "Gjithësia e gjetur rishtazi". Përmes këtij libri, lexuesit njiheshin me rolin që luajti mendimi i Dekartit, i cili bëri një kryengritje të vërtetë shkencore e filozofike në kohën e tij.

Sadik Bega ka përkthyer edhe nga arabishtja. Një nga këto përkthime, më të njohura të tij, është "Jeta e Muhammedit", vepër e shkrimtarit të njohur egjiptian Muhammed Hysein Hejqlit (Ministër i Arsimit të Mbretërisë Egjiptiane-R.Z.).

Një nga fushat që ka lëvruar si studiues ka qenë dhe ajo biografike me profil kontributi i figurave të shquara islame në historinë e Shqipërisë.

Sadik Bega vdiq në korrik të vitit 1960.

## FERID VOKOPOLA PËRFAQËSUES I MISTIÇIZMIT ISLAM

Në shtypin shqiptar të viteve '20-'30 ndriçon edhe pena e fuqishme e Ferid Vokopolës, një prej figurave poliedrike të kohës. Ai ishte politikan, ekonomist, teolog, poet, filozof, eseist, poliglot.

Më 28 Nëntor 1912, Ferid Vokopola e firmosi dokumentin e Shpalljes së Pavarësisë si delegat i Vlorës. Më 1914 bëri pjesë në ekipin e Ministrisë së Bujqësisë të Qeverisë së Durrësit. Pikërisht në këtë kohë ai hartoi kriterin e përkthimit dhe të komentimit të Kur'anit. Më 1919 boton "Fluturimet e Shpirtit". Në Kongresin e Lushnjës (21.01.1920) zgjidhet sekretar. i frymëzuar nga kjo ngjarje historike, ai shkroi himnin e Kongresit të Lushnjës.

Po në këtë vit botoi "Symbyllurazi me ëndërrime". Gjatë periudhës 1920-1928 u zgjodh deputet i Vlorës, kurse gjatë viteve 1928-1939 deputet i Beratit. Pikërisht në këtë kohë, në bashkëpunim me Sali Vuçiternin e të tjerë ai bëhet një nga organizatorët kryesorë për themelimin e Komunitetit Musliman Shqiptar dhe jep një kontribut të ndjeshëm për ngritjen e Medresesë së Përgjithshme të Tiranës.

Më 26.10.1927 deri më 10.05.1928 Ferid Vokopola mbuloi postin e Ministrit të Bujqësisë në Qeverinë Shqiptare.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, Ferid Vokopola u tërhoq nga jeta politike dhe administrata shtetërore, duke iu kushtuar krejtësisht aktivitetit fetar. Në këtë kohë themeloi në Tiranë organizatën fetare "Drita Hyjnore", që pati si organ të vetin revistën "Njeriu", e cila doli rregullisht nga korriku 1942 deri në qershor 1944. Në këtë revistë ai botoi një pjesë të shkrimeve të tij, ku shquhen në mënyrë të veçantë poezitë e tij simbolike me theks filozofik. Duke qenë njohës i mirë i mistikës islame, ai e përçon

këtë frymë pothuajse në të gjitha poezitë e tij. Kjo frymë ndihet sidomos në veprën e tij poetike "Gjëmimi i Tomorrit". Stili i tij është joshës, gjuha plot figura, metrika e respektuar. Figurat e përdorura në poezinë e tij kanë karakter simbolesh, gjithmonë brenda botës së madhe të islamizmit.

Pushteti komunist e burgosi. Në qelinë e burgut nuk ra as në dëshpërim, as në pesimizëm. i bindur në pikëpamjet e tij islame, ai iu dedikua përkthimit të Kur'anit, punë të cilën ai e vazhdoi dhjetë vjet. Kjo vepër me vlerë ruhet sot në dosjet e arkivit personal të familjes Vokopola në Durrës.

Kur doli nga burgu, ai gjeti rreth e rrotull mjedise të tjera, larg lirisë së fjalës e të mendimit, kundërshtare deri në armiqësi ndaj fesë. Në këto rrethana, duke zotëruar gjuhët orientale, ai iu ofrua Institutit të Historisë si bashkëpunëtor, duke i kaluar vitet e pleqërisë si përkthyes i dokumentave nga osmanishtja.

## **HAXHI HAFIZ MAHMUT DASHI**

### **STUDJUES I APASIONUAR DHE LIGJËRUES I RRALLË**

Shkenca e edukimit bashkëkohor, përfshirë edhe pedagogjinë, shkrijnë në një, veprimtarin edukative të teologut, pedagogut, didaktit, kur këto fusha janë zhvilluar në nivelin e duhur. Këto drejtime veprimtarie janë harmonizuar e shkrirë natyrshëm në personalitetine Haxhi Hafiz Mahmut Dashit nga Tirana.

I lindur në Tiranë në vitin 1873, Mahmut Dashi trashëgoi traditën e pasur të familjes e të paraardhësve të tij, në fushën fetare e atdhetare, me aftësinë e theksuar rrezatuese tek mikro e makromjedisi i tyre

nëpërmjet fjalës së zgjedhur e të argumentuar, e cila natyrshëm shkonte drejtë e në zemrat e mendjet e të pranishmëve. Ai ishte një interpretues i aftë i Kur'anit dhe të Hadithit. Punoj si profesor i jurisprudencës islame në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës, deri në vitin 1961, kur u mbyll ky institucion nga regjimi monist, vit në të cilin ndërroi jetë edhe hafizi.

Mahmut Dashi i dha përparësi të veçantë punës edukative me njerëzit, duke nënvizuar se nuk njeri të paedukueshëm, se me njeriun duhet menduar e i gjetur gjuha, që edhe ujku të zbutet, e të mos mbetemi duke u marrë vetëm me qingjat.

Veprimtaria e tij ishte shumë e gjerë, ai nuk mjaftohej vetëm me ngarkesën mësimore në Medresenë e Tiranës, por punoi edhe si predikues në xhaminë e rrugës së Kavajës, e cila sot quhet "Xhamia e Haxhi Hafiz Mahmut Dashit".

Veprimtaria e tij pedagogjike la gjurmë të thella tek shumë nxënës të tij, mjaft prej të cilëve punuan e u afirmuan si personalitete të shquara kombëtare e fetare, arsimore e kulturore, nëmes të cilëve shquhen studiues të shquar orientalistë si Vexhi Buharaja, teolog e studiues si Hasan Selami, Ejub Faslia, Hakil Repishti, studiues si Shaban Demiraj në fushën filologjike, etj.

Veprimtaria atdhetare e Mahmut Dashit është vlerësuar me dekoratën për veprimtari patriotike", për një aktivitet të pandërprerë në dobi të kulturës kombëtare.

Kështu teologu dhe pedagogu i shquar ka hyrë me dinjitet në historinë e kulturës shqiptare e të arsimit në veçanti, duke mbetur një shembull i madhërishtëm i edukatës dhe i kulturës shqiptare.

## **OSMAN MUDERRIZI**

### **STUDIUS I VEPRAVE LETRARE ME ALFABET ARAB**

Një nga specialistët tanë më të shquar në lëmin e studimeve, të krijimtarisë fetaro-letrare myslimane me shkronja arabe është Osman Muderrizi. Për gati dy dekada ai punoi me ngulm, duke hulumtuar, grumbulluar, studiuar dhe vlerësuar dokumente, dorëshkrime e botime të autorëve shqiptarë që shkruan e krijuan vepra shqip me alfabetin arab gjatë tre shekujve të fundit. Ai i gjurmoi ata në tërë trevat shqiptare, që nga Shkodra e deri në Konispol e thellë në Çamëri, që nga Elbasani e deri në Dibër, Tetovë e Vuçiternë. La një trashëgimi të pasur prej "mijëra faqe dorëshkrime, dhjetëra tekste të transliteruara e të transkriptuara, të pajisura me studime introductive, me aparatën shkencor e me glosar për orientalizmat e pazakonshme për shqipen, që ruhet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë".

Në mënyrë të vëçantë O.Myderrizi ka bërë studime të thelluara për vlerat e Ibrahim Nezim Frakullës, Hasan Zyko Kamberit, Mulla Hysen Dobraçit, Mulla Sabri Patës, Mahmud Margëlliçit, Muhamet Kuçukut, Ismail Floqit, Tahir Gjakovës, Dalip Frashërit, Shahin Frashërit, Daut Boriçit, Hafiz Ali Riza Ulqinakut etj.

Më 1954 O.Myderrizi, pas një pune të gjatë dhe intensive, përfundoi një monografi me temë: "Literatura shqipe me alfabet arab". Pjesë të këtij punimi ai ia bëri të njohur studiuesve dhe publikut nëpërmjet "Buletinit të Shkencave Shoqërore" gjatë vitit 1950.

Në vitin 1959 doli në qarkullim vëllimi i parë i librit "Historia e Letërsisë Shqipe", ku kapitujt 12-15 janë mbuluar nga O. Myderrizi.

Kritika jonë, kontributin e tij e ka vlerësuar në drejtim të asaj që ai "përpunoi një koncept terësor për gjenezën e këtij fenomeni, për shtrirjen, thelbin dhe veçoritë e tij. Përfundimet në të cilat arrin ai janë shpesh origjinale dhe i kanë qëndruar kritikës së kohës".

O.Myderrizi është i njohur edhe si publicist. Ai njihet edhe si filolog dhe autor tekstesh shkollore. Ka qenë një nga bashkëpunëtorët shkencorë të Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë të Akademisë së Shkencave në Tiranë.

## **HAFIZ ALI KRAJA TEOLOGU I LARTË**

Hafiz Ali Kraja është një nga përfaqësuesit e intelektualëve myslimanë shqiptarë. Mësimet e para i mori në vendlindje (Shkodër), ku bashkësia islame trashëgonte një traditë të pasur, për të cilën kontribuoi medreseja e qytetit ("Mehmet Pashë Bushatliu") dhe biblioteka pranë saj. Vazhdoi studimet e larta për teologji, filozofi e jurisprudencë islame në Kajro. Në përfundim të studimeve iu dha titulli "Teolog i lartë".

Mori pjesë aktive në problemet sociale dhe ato politike të vendit. Më 1934 botoi në Shkodër panfletin "A duhet feja? A e pengon bashkimin kombëtar?" Kjo veper u botua në atë periudhë kur flukset e propagandës komuniste dhe në mënyrë të veçantë përhapja e ateizmit ishin dendësuar në qarqe të caktuara intelektuale. Në kohën e vet ky material pati jehonë. Ai vazhdoi ta sulmojë me guxim komunizmin. Më 1944 mbajti ligjëratën "Ç'është Komunizmi dhe pasojat e tij për popullin shqiptar", në

xhaminë më të madhe të Shkodrës. Para dëgjuesve të shumtë ai demostroi pasojat tragjike që do të pësonte Shqipëria në rast se do të fitonte kjo ideologji.

Hfz. A. Kraja mbante lidhje të ngushta me të gjitha personalitetet politike të kohës. Me rastin e vdekjes së Fishtës, ai, nëpërmjet një ligjëratae prekëse, vajtoi poetin që kishte shkruar një vepër të denjë për historinë e kombit shqiptar.

Më 1943 pushtuesit italianë e internojnë në Portopalamo. Më 1947 pushteti komunist e dënoi me njëzet vjet heqje lirie, të cilat i kaloi në burgun e Burrelit.

## **ESAT MYFTIA PERSONIFIKIMI I MODESTISE**

Esat Myftia i përket asaj plejade njerëzish që nuk e ndajnë fjalën nga veprat, që ofiqet ose përgjegjësitë nuk i ndanin nga njerëzit, që ushtrimin e fesë e bënte me sakrificat të mëdha.

U lind në Shkodër më 1911. Mësimet fillore dhe ato plotore fetare i mori në qytetin e lindjes, ku vazhdoi edhe medresenë. Në moshë fare të re ngarkohet me detyrën e imamit dhe njëkohësisht me atë të mësuesit të besimit. Kur më 1944 një grup intelektualësh myslimanë themeluan Komitetin Bamirës Musliman, i cili ngriti edhe medresenë, Esat Myftia u vu në krye të këtyre dy institucioneve. Njeri me kulturë të gjerë, zotëruar i pesë gjuhëve të huaja, njohës i filozofisë islame dhe i orientalistikës në përgjithësi, intelektual, nacionalist i devotshëm, posedues i një biblioteke të pasur, Esat Myftia nuk u pajtua asnjëherë as me pushtuesin as me diktaturën komuniste.

Me vendosjen e pushtetit komunist në Shqipëri u vu në shënjestër, si shumë intelektualë të tjerë, dhe në dhjetorin e vitit 1945 arrestohet. Autoriteti që kishte si dhe simpatia e madhe që gëzonte në popullin shkodran i detyruan organet e sigurimit të shtetit që ta lironin, por ata e kishin mbyllur Komitetin Bamirës Musliman.

Në këto vite Medreseja e Tiranës vazhdonte të mbijetonte me vështirësi nga persekutimet e vazhdueshme që i bënin kuadrove të saj. Në këto kushte e emëruan Esat Myftinë drejtor të medresesë, por ai, duke mos dashur të verë në jetë orientimet e partisë lidhur me edukimin e nxënësve, dha dorëheqjen me preteksin se ishte i sëmurë.

Ai vendosi t'i kushtohet tërësisht çështjes teologjike. Esat Myftia ishte nga të paktë klerikë shqiptarë që kishte mbetur gjallë. Kështu më 1966 u caktua në postin e kryetarit të Komunitetit Musliman Shqiptar, detyrë të cilën e mbajti më pak se një vit. Gjatë kësaj kohe ai përjetoi dhimbjen e humbjes së djalit të vetëm në ushtri, dhe menjëherë më pas dhembjen tjetër të kryqëzatës kundër fesë në Shqipëri. Në këto kushte ai u mbyll në shtëpi, për të jetuar vetëm me bibliotekën e tij, e cila ishte shumë e pasur. Në këtë bibliotekë gjendeshin relike shumë me vlerë, libra unike si edhe dy tahtet astrologjike të Hasan Tahsinut që ia kishte dhuruar familjes së tij kur kishte qenë në Shkodër.

Pasi ia shtetëzuan bibliotekën, ai punoi si nëpunës i thjeshtë i saj, por gjithnjë i përgjuar, i mënjanuar si përsos i dyshimtë dhe fetar.

Esat Myftia vdiq në vitin 1975. Populli i Shkodrës, që kishte një respekt të madh për të, pa marrë parasysh opinionin e regjimit komunist, e përcolli me nderime të mëdha.

## MULLA REXHEPI DRENICE 1905 - 1976

Në vitet e shkëputjes së Kosovës prej trungut Amë, shovinistët serb përdorën dy rrugë kryesore për asimilimin e popullit shqiptar në atë pjesë, gjysmë, të mbarë viseve shqiptare: të mbyllnin çdo vatër dije në gjuhën amtare, pra shkollat shqipe dhe, së dyti, të nxisnin e impononin largimin pa kthim të shqiptarëve në krahinat e Turqisë.

Mulla Rexhepi iu kundërvu kësaj politike antishqiptare, duke përdorë njohuritë e tij, si medresist i diplomuar për mësimin e fesë, nëpërmjet mejtepit, edhe për mësimin në mënyrë ilegale të gjuhës shqipe. Këtë veprimtari e zhvilloi që nga viti 1934 e deri në vitin 1944, kur u hapën kurset e shkollat në gjuhën shqipe.

Mulla Rexhepin e zgjodhën kryetar të shoqërisë "Drita", e cila kishte në programin e saj mësimin e gjuhës amtare shqipe, mbledhjen e pasurisë gojore, të folklorit të pasur në ato treva dhe kundërvënien ndaj emigrimeve në Turqi, si strategji antikombëtare shqiptare e serbëve.

Duke mbajtur lidhje të mira me studentët e medresesë të Shkupit, mulla Rexhepi gjeti mbështetje nga ana e tyre dhe kolegëve, çka e gjallëroi veprimtarinë e tij ilegale .

Edhe mbas Luftës së Dytë Botërore, ai vazhdoi veprimtarinë e tij atdhetare, duke i shërbyer fesë dhe kombit të vet, duke përdorë edhe detyrat shoqërore, ku u zgjodh në mbrojtje të popullatës nga sulmet e OZN-së. Më 1949 e burgosën si bashkëpunëtor i Rifat Berishës, duke i qëndruar besnik idealeve të tij deri në vdekje.

Mulla Rexhepi zë vendin e tij të nderuar edhe në historinë e arsimit shqiptar, si një inkurajues e përhapës i gjuhës amtare në kushtet e rënda të veprimtarisë ilegale. Prandaj radhitet në radhët e hoxhallarëve atdhetarë të shquar ë të mësuesve të gjuhës amtare.

## **HAKI SHAROFI**

### **DREJTOR I REVISTËS "ZANI I NALTË"**

Haki Sharofi lindi në Dibër të Madhe, por veprimtarinë e tij si mësues, publicist dhe perkthyes i zhvilloi larg lindjes, në Gjyrash të Manastirit (1912), në Peshkopi (1914), ku hapi shkollën e parë shqipe, në Trujak dhe në Sllovë të Dibrës (1916 dhe 1920), në Kastriot (1923), në Krumë (1928), në Vlorë (1929). Pas viteve '30, ai vendoset përfundimisht në Tiranë ku zhvillon një veprimtari të dendur si drejtor i Medresesë së Tiranës, si drejtor i revistës "Zani i Naltë" (organ i Komunitetit Musliman Shqiptar), në krye të së cilës ai qëndroi në vitet 1930-1939.

Haki Sharofi kishte arsim pedagogjik. Kishte studiuar në normalen e Elbasanit si dhe kishte ndjekur shkollën pedagogjike "Darul-Mualiminë" të Dibrës.

Gjatë punës së tij në fushën e botimeve u dallua për trajtime serioze të temave me karakter fetar, social, etik dhe filozofik. Shkroi edhe shumë poezi. Në mënyrë të veçantë ka meritën për hartimin e serisë së librave "Edukatë fetare e morale", tekste mësimore këto që u shfrytëzuan për mësimin e besimit në shkolla shtetërore, ku jepej dhe mësimi i fesë. Te librat "Edukata fetare e Morale" spikasin disa kërkesa të moralit islam në kushtet tona, ku zënë vend disa parime themelore të këtij morali, të shpjeguara

thjesht e për masat e të gjitha moshave, të asaj periudhe me shtrirje të kufizuar të arsimit laik. Këto tekste kanë një ndërtim dhe strukturë delikate shumë të përshtatshme për kohën që u botuan. Duke u nisur nga këto vlera, biblioteka myslimane shqiptare e Miçiganit (USA) i ka ribotuar ato kohët e fundit.

Krahas veprave të mësipërme, duhet shënuar se edhe "Kalendari mysliman" që u botua për disa vite me radhë është vepër e tij.

Haki Sharofi në vitet e fundit të jetës së tij ka bashkëpunuar me Arkivin Qendror të Shtetit dhe Arkivin e Institutit të Historisë, duke dhënë një kontribut të vyer në përkthimin e dokumenteve me rëndësi historike, që ishin në gjuhët e Lindjes: arabe, turke dhe persiane. Gjithashtu ai ka lënë një trashëgim të pasur me përkthime, siç janë: "Tefsiri shqip", "Parimet e nalta të islamit", "Ajete të Kur'anit" etj.

## **VEXHI BUHARAJA ORIENTOLOGU ME DIMENSIONE TË MËDHA**

Vexhi Buharaja ishte studjues me dimensione të mëdha në fushën e orientalistikës. Janë të rrallë studiuesit shqiptarë që kishin përgatitjen dhe intuitën e Vexhi Buharasë.

Ai zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhët klasike të Lindjes islame: arabishten, persishten dhe osmanishten së bashku me turqishten e re. Zotëronte gjithashtu gjuhët kryesore të Perëndimit: anglishten, gjermanishten, frëngjishten dhe italishten. Pas vitit 1966, kur filloi punën në Institutin e Historisë si bashkëpunëtor shkencor, përvetësoi edhe rusishten.

Kultura dhe sidomos gjuhët e vjetra orientale që kishte fituar në Medresenë e Lartë të Tiranës, të cilën e mbaroi në vitin 1940, ishin një kapital i madh që Vexhi Buharaja do ta shfrytëzonte në funksion të kolegëve historiane e më gjerë, duke iu vënë në dorë atyre përkthime dokumentesh osmane të të gjitha periudhave, interpretime të sakta shkencore të dokumenteve të ndryshme, gjykime me vlera shkencore të përmbajtjeve, të para në kuadrin historik, që vetëm ai i njihte aq mirë.

Vexhi Buharaja që i pajisur më moralin islam, kështu që në punën e tij shkencore u shqua për vlerësime reale, të drejta, të sakta shkencërisht, pa politizimet e kërkuara. Të gjitha këto e bënë të padëshirueshëm qëndrimin e tij në Institutin e Historisë si bashkëpunëtor shkencor, megjithëse ai ishte i vetmi zotërues i dhjetë gjuhëve, megjithëse kishte një bagazh kulturor që të detyronte respekt, megjithëse kishte një përvojë dhjetëvjeçare në punën shkencore. Vexhiu pushohet nga puna duke iu përmendur vitet e burgut dhe internimet në kënetën e Maliqit, studimet në shkollën fetare dhe akuza se bënte propagandë fetare myslimane. Ai u tërhoq në vendlindjen e tij, në Berat, ku u zhyt në botën e vetmisë, të punës individuale e të punëve ordinere për të siguruar ekzistencën.

Vexhi Buharaja ishte i dashuruar pas kolosëve të poezisë klasike persiane, sidomos pas Saadiut dhe Firdeusit, të cilët dhe i përktheu në gjuhën shqipe, duke e pasuruar kështu fondin bibliotekar letrar shqip. Ai përktheu në mënyrë të shkëlqyer në gjuhën shqipe edhe vëllimin "Tehajulat" (Endërrime) poezi, të Naimit, shkruar në gjuhën persiane, ku shihet delli i tij poetik, që Vexhi Buharaja e provoi dhe në hartimin e poezive origjinale.

Një ndihmesë të madhe dha ai në fushën e biografisë shqiptare, duke hapur siparin e një shkence të re në fondin e punimeve shqiptare. Vepra e tij "Monumente turko-arabe në Shqipëri" përmban rreth 300 mbishkrime turko-arabe, që datojnë nga shekulli XV deri në shekullin XX.

Si njohës i mirë i gjuhëve klasike lindore, Vexhi Buharaja i transliteroi, i transkripto, i përktheu dhe u bëri zbërthimet përmbajtëse, duke hedhur kështu bazat e kësaj dege të re të Historisë së kulturës sonë. Për pasojë, gjeneza e sekteve fetare islame në territoret shqiptare, historiku i institucioneve të kultit dhe të dhëna të tjera dritëdhënëse, rreth krijimit dhe veprës së tyre, u shpalosën në një optikë të re.

Vexhi Buharaja, me sa dimë, ka lënë një pasuri trashëgimore, krijimtari të pasur, që në të ardhmen duhet bërë objekt studimi për historianët tanë. Terreni mbi të cilin ka punuar Vexhi Buharaja është ende i paeksploruar. Orientalistika shqiptare, duke ecur në gjurmët e tij, ka shansë të mëdha për të krijuar fondin e saj origjinal.

Kohët e fundit, studiuesi Ahmet Kondo botoi një monografi kushtuar Vexhi Buharasë, e cila është pritur mirë, si përpjekje e parë për njohjen e dimensioneve të këtij personaliteti.

## **SALI EFENDI MYFTIA. THEMELUESI I QENDRES ISLAMIKE SHQIPTARO - AMERIKANE**

Në fillim të viteve '40, njëra nga bibliotekat më të mëdha të Shkodrës ishte biblioteka e familjes Myftia, pjesërisht e trashëguar nga pararendësit e kësaj familjeje me tradita fetare dhe patriotike dhe pjesërisht e pasuruar nga pinjulli i këtij trangu, Sali Efendi Myftia.

Saliu lindi në Shkodër në vitin 1891, atje dhe u arsimua. Më 1927, ai u emërua myfti në Krujë dhe pastaj kryemyfti i Shkodrës dhe deri në vendosjen e komunizmit edhe myfti i Kosovës. i zgjuar nga natyra, njeri me takt të jashtëzakonshëm dhe me kulturë të gjerë fetare, fitoi autoritet te të gjithë.

I mbrujtur me ndjenja kombëtare ai iu kundërvua regjimit pushtues fashist dhe, si rrjedhojë e këtij rregjimi, u përdoq nga Italia dhe për një kohë të gjatë vuajti internimin në Gjirokastrë. Më pas u shqua në qëndrësën antifashiste shqiptare, ku me armë në dorë dhe me Kur'an nën sqetull u bë frymëzues i luftës për liri.

Më 29.09.1944 ai mërgoi nga Shqipëria dhe për një kohë relativisht të gjatë vazhdoi për të jeta mërgimtare. Përshkoi njeri pas tjetrit vende të ndryshme: Italinë, Egjiptin, Sirinë, Libanin dhe Amerikën, ku do të ndalej për pjesën tjetër të jetës që i kishte mbetur.

Tridhjetë e katër vjet në SHBA ai iu kushtua pothuajse krejtësisht jetës fetare. Me aftësitë e tij organizuese arriti të themelonte Qendrën Islame Shqiptaro -Amerikane për shtetet New York dhe New Jersey. Me mësimin e tij, duke pasur për bashkëpunëtor Imam Isa Hoxhën, në vitin 1972, bleu xhaminë, hapi shkollën fetare kombëtare pranë saj dhe u bë vetë mesimdhënës. Ai arriti të bashkojë edhe muslimanët e Kanadasë dhe u zgjodh kryetari shpirtëror i tyre.

Sali Myftia ka qenë një komentator i shkëlqyër i Kur'anit dhe i Haditheve. Për këtë aftësi ai qe njohur jo vetëm në Shkodër, por edhe nga studentët shqiptarë që studionin në Aleksandri, kur ky komentonte çdo javë Kur'anin në një nga xhamitë e qytetit. Ai ishte një orator i shquar në mënyrë të veçantë kur zberthente biografinë e Profetit (a.s.) gjatë mevludit. Ende mbetet e gjallë në kujtesën e dëgjuesve fjala e mbajtur prej tij në vitin 1935, në përkujtim të ditëlindjes së Profetit (a.s.).

Më 19 maj 1978, në moshën 87 -vjeçare, zemra e këtij myslimani të madh, e këtij patrioti të shquar, e ish- kryemyftisë së Shkodrës, Kosovës, të themeluesit të Qendrës Islame Shhqiptaro- Amerikane, pushoi së rrahuri. Tabuti i tij u mbulua me flamurin tonë kombëtar dhe me lule të shumta. Në New York ia bëhen bashkëatdhetarë të tre besimeve nga të gjitha shtetet e Amerikës dhe nga Kanadaja, për t'i bërë homazhet e fundit njeriut të tyre të dashur e të respektuar.

## **HAMID GJYLBEGAJ**

### **DEMOKRATI I PAKORRUPTUAR**

Pinjoll i një familjeje të dëgjuar shkodrane me tradita patriotike Hamid Gjylbegaj, u shqua me veprimtarinë e tij si një intelektual me formim solid, si demokrat i pakorruptuar dhe atdhetar i paepur.

Lindi në Shkodër në vitin 1888. Mësimet fillore i bëri në vendlindje, ndërsa ato të mesme në Shkodër e Manastir. Mbaroi akademinë ushtarake në Stamboll. Mbajti qëndrim patriotik, që dëshmohet me pjesëmarrjen e tij kundër lëvizjes së Haxhi Qamilit, ithtarëve të "Sedai Miletit", antifashist dhe antikomunist.

Hamid Gjylbegaj ka një aktivitet të pasur si intelektual. Ka botuar 14 përmbledhje poezish, shkrime të ndryshme, ndër të cilat po përmendim: "Flutura ndër lule"(1921), "Monumenti i atdheut" (1934), "Drita e së vërtetës"(1933), "Çikrime filozofie" (1934), "Fyelli i barive" (1943) etj.

Hamid Gjylbegaj kishte një formim fetar ku mbizoteronte në mënyrë të veçantë panteizmi bektashian. Ishte njohës i thellë i tesavufit islamik, pra misticizmi që e përshkonte botëkuptimin e tij ishte i

mpleksur me mjaft pikëpyetje, ku mbisundonte drita e së vërtetës me trinomin e drejta, e mira dhe e bukura. Në këtë hapësirë mendimi mbizotëronte madhështia e njeriut, njohja e vetvetes. Siç e dimë Muhammedi (a.s.), në mes fjalëve të tjera ka thënë: "Që të njohësh Zotin duhet të njohësh më parë veten". Biseda rreth këtij subjekti Hamid Gjylbegaj, siç tregojnë bashkëkohësit e tij, zhvillonte pothuajse çdo ditë nën hijen e çinarit pranë shtëpisë së tij.

Hamid Gjylbegaj ishte një përfaqësues i mendimit më të përparuar. Ai ishte një teist liberal, i cili në poezitë e tij filozofike përçoi filozofinë islame dhe në mënyrë të veçantë ai propagandoi tolerancën fetare, që e transmeton filozofia islame në kushtet e vendeve shumëkonfesionale.

Vdiq në vitin 1979 në Elbasan.

## **BINAZE KACABAÇI-DAUTI HOXHA HANMI**

Binaze Kacabaçi-Dauti me pseudonimin "Hoxha Hanëm" ushtroi profesionin e mësueses së besimit dhe të edukatores islame.

Binazja është nga rrethi i Leskovcit. Qyteti i lindjes së saj është Prizreni. Duke qenë e detyruar të ndiqte prindërit e saj, ajo bëri një jetë endacake. Shkollën fillore e bëri në Edrene, ndërsa atë normale në Stamboll, ku edhe shërbeu si mësuese për pesë vjet. Më vonë ajo u shpërngul në Gjilan.

Në vitin 1920, në moshën 29- vjeçare, ajo hapi një shkollë për vajza në shtëpinë e saj në Gjilan.

Në kushtet e pushtimit të Kosovës nga Jugosllavia, shkollat me gjuhë mësimi shqipen qenë krejtësisht të ndaluara. Në këto rrethana të vetmet institucione për arsimimin e shqiptarëve ishin mejtepet dhe medresetë, ku mësimi jepej nga klerikë muslimanë. Është e natyrshme që regjimi sllav nuk i shihte me sy të mirë këta klerikë, të cilët ishin brumosur me botëkuptimin armiqësor ndaj sllavëve, gjë që përbënte një rrezik për shtetin jugosllav. Përveç asaj, dihet se shumë prej tyre bënë pjesë në Komitetin e Kosovës dhe kishin lidhje me udhëheqës si Ferhat Draga, Hasan Prishtina, Bajram Curri etj.

H.Hanmi e përjetoi ndjekjen që u bëhej shqiptarëve. Ajo vërtet nuk u aktivizua në lëvizjen kombëtare, por ajo e shndërroi shtëpinë e saj në shkollë për vajzat shqiptare, dha mësim në mënyrë klandestine, duke kontribuar kështu në frymën e besimit musliman për unitetin kombëtar.

## **MULLA ISMAILI ATDHETAR DHE FETAR I PATREMBUR**

Mulla Ismaili gjatë gjithë jetës së tij u shqua në mbështetje të forcave përparimtare, për zhvillimin dhe emancipimin shoqëror të bashkatdhetarëve të tij.

U lind në Komogllavë të Moravës së Epërme, ndoqi studimet në medresenë e Shkupit, të cilat ia ndërpreu, duke e mobilizuar ushtar në ushtrinë e Mbretërisë Jugosllave. Mbështeti dhe predikoi luftën antifashiste dhe bashkimin kombëtar. Veprimtaria e tij u përqendrua në këto drejtime:

Së pari, në kryerjen me ndërgjegje të lartë të detyrës së tij si hoxhë, duke kapërcyer pa lëkundje presionet që i bëheshin për t'u tërhequr nga ndërtimi i xhamisë së madhe në Ferizaj (ndërtimi i

minaresë), e cila u ngrit. Duke qenë edhe Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Komunës, ai rrezatoi edhe në drejtime të tjera për përballimin e situatës së vështirë në mbrojtje të institucioneve islame.

Si përkrahës i së resë, ai nuk mbështeti klerikët fanatikë që pengonin arsimin e femrës. Përkundrazi predikonte se "Dituria është obligim Kur'anor". Vetëm njeriu i ditur mund t'i kuptojë në thellësi dhe t'i respektojë me vetëdije porositë e Zotit xh.sh. Ishte kundërshtar i kolegëve fanatikë, që kundërshtonin marrjen me sport, futboll, arte figurative e muzikore, garderobën elegante, që nuk ishte e tepëruar e nuk i shkaktonte dëm individit as shoqërisë.

Së dyti, ishte mbështetës i fuqishëm i arsimit dhe i shkollës në gjuhën amtare shqipe. i mirëpriti dhe i ndihmoi iniciativat për hapjen e shkollës shqipe në Komogllavë, në vitin 1946, duke lëshuar dhomat e babait të vet dhe të kushërinjve për banesa të mësuesve. Bëhet shembull për djemtë e vet dhe vajzat e kushërinjve, që të shkolloheshin më tej, në arsimin e mesëm e të lartë.

Së treti, flet hapur dhe kundërshton emigrimet masive në Turqi, duke predikuar: "Këtu kemi lindë, këtu do të vdesim. Nuk e luftuam (Osmanin) për t'u tretur e braktisur në Anadoll, por që të jetojmë të lirë në trojet tona."

Së katërti iu kundërvu mbledhjes së armëve, çarmatimit të popullit shqiptar nga ana e serbëve, prandaj edhe e rrahën publikisht dhe e masakruan, por nuk u thye.

## **VEJSEL XHELADIN GUTA FE E ATDHE JANË TË PANDARA**

Në plejadën e hoxhallarëve të shquar kosovarë të shekullit tonë, që binomin fe e atdhe, din e vatan, e konceptuan të pandarë dhe që kësaj bindjeje i kushtuan gjithçka: mundin, talentin, sakrificat dhe vetëmohimin, bën pjesë dhe Vejsel Xheladin Guta nga Zaskoci i Ferizajt.

Arsimin fillor Vejsel Guta e mori në vendlindje, kurse të mesmin fetar e përfundoi në Prizren në vitin shkollor 1937-1938 në medresenë "Mehmet Pasha", ku Vejseli vazhdoi studimet për dymbëdhjetë vjet. Aty i jepej rëndësi e madhe, krahas lëndëve të tjera, edhe mendimit letrar shqip me alfabet arab, si dhe gjuhës e kulturës shqiptare.

Ai u shqua në mes bashkënxënësve të tij maturantë për aftësitë e tij në gjuhët orientale, si dhe për njohuritë që kishte fituar në letërsinë shqipe, që lexohej ilegalisht në atë kohë. Për këto rezultate ai u caktua mësues i medresesë, por nuk punoi aty, sepse u vendos në Voinoc, ku qëndresa kundër politikës shkombëtarizuese sllave ishte në apogje. Në këtë fshat ai organizoi mejtepin, që fitoi të njohur në tërë zonën dhe ku numri i nxënësve rritej çdo ditë. Ai iu kushtua poezisë.

Në shkollën (mejtepin) e Vejsel Gutës, veç lëndëve fetare, zhvilloheshin edhe lëndë të tjera si: matematika, astronomia, gjeografia dhe historia. Ajo u bë qendër e përhapjes së diturive në gjuhën shqipe, e cila mësohej ilegalisht. Gjatë viteve 1941-1945, mejtepi i Vejsel Gutës u bë një shkollë kombëtare-fetare, ku nxënësit merrnin njohuri edhe nga historia e Shqipërisë dhe gjuha e letërsia shqipe.

Vejsel Guta ishte poet i lindur. Ai i thurte mendimet e tij me lehtësi të madhe në vargje. Në ndërtimin e poezive ndoqi teknikën e poetëve persë, gjuhën dhe veprat e të cilëve ai i njihte shumë mirë. Ilahitë që bëri i thuri në formën e kasideve, që i përngjanin poezive perse edhe nga përmbajtja, por ai në përmbajtjen e tyre trajtonte probleme sociale e politike si dhe probleme morale. Të përmendura janë poemat: "Çohu prej gjumit more vlla", "Mos e le udhën, o insan", "Fjalim shqip a than", "Ej ju të par ehli vatan" etj.

Si mësues e myderriz ai diti të sinkretizojë edukimin fetar me atë patriotik, punën legale me atë ilegale. Shumë nga tekstet dhe poezitë fetare që përshkoheshin nga fryma patriotike u mësoheshin nxënësve në klasa, duke sfiduar kështu ndjekjet e organeve policore serbe. Shumë ilahi dhe kaside të Vejsel Gutës u bënë tema mësimi për talebet e medresesë "Alaudin" të Prishtinës. Këto ranë në sy të organeve policore dhe u bënë shkak për ndjekjen e tij.

Vejsel Xheladin Guta, i njohur nga populli i Kosovës edhe me emrat "Mulla Vejseli" dhe "Mulla Vejsel Vionoci", la pas një trashëgim të pasur në krijimtarinë e tij poetike, la një emër të mirë me punën që bëri si mësues, fitoi autoritet në veprimtarinë e tij si imam dhe si patriot i madh.

## **MULLA ZEKË BËRDYNA**

### **NJË JETË PËR BESIMIN ISLAM, ARSIMIM NË**

### **GJUHËN AMTARE DHE KOMBIN SHQIPTAR**

Mulla Zekë Bërdyna u lind rreth vitit 1918 në fshatin Novosellë të Pejës, në një mjedis prapanikërie kulturore, ku nuk kishte as mejtep e shkollë, ku analfebitizmi ishte në shtrirje absolute.

Në vitin 1926 e fillon medresenë në Pejë, për ta vazhduar më tej te mësuesi Fahri Efendiu, i njohur për dijenitë e gjera. Kështu, Zeneli (Mulla Zeka i ardhshëm) u përgatit që edhe ai t'u japë mësim të tjerëve. Ishte koha kur shkollat laike shqipe qenë mbyllur nga ligjet e rrepta të pushtuesit, për asimilimin e brezërive të reja. Por, pati edhe prej mësuesve të njohur për fusha të tjera të shkencave, si gjuha e letërsia shqipe, historia, matematika, gjeografia etj.

Një nga mësuesit që e kreu shkëlqyeshëm këtë detyrë, qe Mulla Zeka, i cili ngriti një mejtep në fshatin Radavc, pikërisht në vitin 1938, i cili, përveç lëndëve të besimit dhe të gjuhës amtare e shkencave shoqërore me karakter kombëtar, u mësonte nxënësve edhe lëndë nga psikologjia.

Prej vitit 1941 e deri në vitin 1944 Mulla Zeka qe në frontin e Rozhajës dhe Novi Pazarit, duke iu kundërvënë çetave çetnike me çetat vullnetare. Në njërën prej këtyre betejave, në vitin 1943, në masakrën e Bihorit, plagoset rëndë edhe Mulla Zeka, i cili ishte në detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të çetave vullnetare.

Në vitin 1948 burgoset dhe kalon nëpër burgjet e rënda të ish -Jugosllavisë të "Bella Kuça-s" në Nish, ku kaloi katër vite, dhe në Goli Otok nga vitet 1952-1960, i dënuar me motivacion të shpifur e fals

tërësisht, si prostalinian. Atje Mulla Zeka i qëndroi burrërisht torturave më të egra, duke mbetur i papërllyer dhe i nderuar. Në një rastë duke kujtuar momente nga burgu i Goli Otokut ai pat thënë "më e vështira për mua ishte të bart gurë...!? Po të ishte për të ndërtuar diçka do ta bëja me dëshirë..! Por ne ishim të detyruar t'i bartnim gurët sa në një anë sa në anën tjetër".

Mulla Zeka pasi doli nga burgu përveç si imam i fshatit Novosell, ku organizonte edhe mësim besimin me nxënësit e fshatit, ai u aktivizua sidomos në pajtimin e gjaqeve dhe konflikteve mes njerëzve. Prandaj me të drejtë e quajtnë edhe pioner i pajtimit të popullit në Podgor. Ato probleme që nuk i zgjidhte ligji i shtetit të instaluar i zgjidhte Mulla Zeka. Vdiq po në robëri, me 12 janar 1987. Në varrimin dhe ngushëllimin e familjes së tij mori pjesë e pothuajse tërë Kosova.

## **HASAN EFENDI NAHI DIJETARI, MYDERRIZI GOJËMBËL**

Hasan Efendi Nahi është nga personalitetet islame që la një emër të nderuar dhe një vepër që jeton në pasardhësit e vet, që me aq kujdes, dashuri e besim i përgatiti që të shërbejnë në gjuhën e vet amtare. Atdhetar, alim dhe hoxhë-myderriz i shquar, la emër në Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Prishtinë e në tërë Kosovën.

U lind më 12 mars 1905 në Gjakovë nga një familje intelektuale, me formim të shëndoshë fetar. Mësimet fillestare, si dhe medresenë i kreu në vendlindjen e tij, prej nga nisët, në vitin 1930, në Egjipt, për studime të larta, në Universitetin e njohur "El-Azhar".

I diplomuar në universitet, caktohet në detyrën e predikuesit shëtitës, duke dhënë mësim edhe në Medresenë e Ferizajt. Vazhdon me pasion të madh punën e myderrizit, prandaj në vitin 1943 e emërojnë drejtor i Medresesë "Mehmet Pasha" në Prizren, duke qenë njëkohësisht edhe Kryemyfti. Me mbylljen e medresesë, në vitin 1948 e deri në vitin 1958 e kryen detyrën e imamit në Gjakovë.

Ai luftoi hapur për shkollën në gjuhën shqipe dhe për ruajtjen e medresesë nga sulmet për ta shkatërruar, duke filluar me mbylljen e saj. Kur më 1956, u vendos mbyllja e medresesë në Gjakovë, Hasan Efendi u tha hapur e prerë pushtetarëve: "Ma mirë kallne Gjakovën, se sa ta mbyllni Gjinnazin".

Në shtator të vitit 1958 caktohet profesor në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë, ku shërben dy dekada, duke dhënë një ndihmesë të çmuar në përgatitjen e kuadrit të ri, në arsimimin e disa gjeneratave të vetme në gjuhën shqipe, të arsimit islam.

I dalur në pension në vitin 1978, Hasan Efendiu nuk pushoi së punuari për fe e atdhe, duke u marrë me studime, e sidomos me përkthimin e Kur'anit të Madhëruar, duke i dhuruar lexuesit shqiptar, pas dhjetë vjetësh punë, një vepër aq shumë të pritur (në vitin 1988-R.Z.).

Ai ishte një personalitet i rrallë në sytë e rinisë, të cilët e mbanin dhe e çmonin për misionar, alim, profesor dhe vizionar të shquar. Pleqtë, në anën tjetër, e respektonin shumë miqësinë e tij, nga se edhe ai i nderonte pa masë.

## **HAXHI RASHID EFENDI OSMANI MËSUES E PROFESOR I NDERUAR**

Hoxhë e mësues, sinonimin e njohur Haxhi Rashid efendi Osmani e zgjati edhe më tej, mësues, hoxhë, profesor në medrese, të gjitha fusha të drejtpërdrejta edukimi islam dhe atdhetar.

Punoi rreth shtatë vjet si mësues, duke vazhduar edhe arsimin laik, shkollën normale, si dhe duke vazhduar studimet islame, me të cilat nuk ndahej që nga fëmijëria e parë e gjatë gjithë viteve të arsimit laik e më pas atij fetar. Shumë vite kaloi edhe në sektor administrativ në Bashkësinë Islame, si dhe në medresenë e ultë dhe atë të mesme në Prishtinë.

Në vitet 1964-1968 u emërua drejtor i medresesë e më pas vazhdoi si arsimtar. Atje dha disa lëndë, por me përkushtim të posaçëm zhvilloi lëndën e fikhut (të drejtës islame), të cilën e njëjtte si rrallë kush në Prishtinë.

Duke qenë një mësimdhënës me formim të mirë fetar, pedagogjik, me intuitë psiko-pedagogjike, ai shquhej për një organizim të mirë të procesit mësimor, për orët interesante që zhvillonte, për shpjegimin e qartë para nxënësve. Afrimi me nxënësit u bë kurdoherë natyrshëm, sinqerisht, duke iu gjendur të gjithëve e sidomos atyre që kishin ndonjë shqetësim. Ish -nxënësit e tij flasin për plot raste, kur myderrizi i tyre iu gjend pranë si një prind, si njeriu i tyre, prandaj edhe e kujtojnë me respekt, duke u dhënë nxënësve të tij edhe një mësim të madh: atë të qëndrimit të vëmendshëm ndaj njerëzve dhe në gatishmëri deri në sakrificë për t'i ndihmuar ata.

Edhe pas daljes në pension, në vitin 1978, Haxhi Rashid efendi ishte përherë i mirëpritur dhe i nderuar në qendrën e madhe islame: në medresenë e Prishtinës. Vdiq i nderuar në vitin 1991.

## **MULLA HYSEN LATIFI THEMELUES I QENDRËS SHQIPTARE ISLAME NË BRUKSEL**

Mulla Hysen Latifi është një nga teologët e shquar të Kosovës, nga Gjlani. Ai kalon me sukses të gjitha hallkat e arsimit fetar në vend dhe në Kajro, duke përfunduar universitetin, Mulla Hyseni punoi rreth 18 vjet si profesor në Universitetete të Arabisë Saudite.

Ai ishte shfaqur gjithnjë i shqetësuar për fatet e atdheut të vet të cunguar, për Kosovën e tij të shumë vuajtur, malli për të cilën e përvëloi gjatë gjithë viteve.

Edhe kur transferohet imam në qendren Islamike në Belgjikë, Bruksel, ku edhe krijohet Bashkësia Muslimane Kulturore Shqiptare, Mulla Hyseni punon me një entuziazëm të jashtëzakonshëm, duke ligjëruar në gjuhën amtare shqipe, duke u bërë kështu edhe një propagandues i madh për njohjen e historisë së popullit tonë e të popujve të tjerë, duke ua transmetuar këto njohuri besimtarëve të të gjitha moshave.

Mulla Hyseni u shqua për punën e kualifikuar që zhvilloi me breznitë e reja në emigracion në edukimin fetar e atdhetar, me ndjenja të larta atdhetarie e humanizmi, duke u pergatitur plejada të rinjsh kundër asimilimit të huaj, që ishte një rrezik real dhe i drejtëpërdrejtë.

Mulla Hyseni, mësuesi i apasionuar i breznive shqiptare, në fushën fetare, historike e sociale, vdiq në Stamboll me 2 tetor 1993, në kulmin e mallit për të parë Kosovën e tij. Këtë mall, si për Kosovën dhe

Tiranën Mulla Hyseni e ka shfaqur edhe shumë herë, duke e shoqëruar edhe me udhëtime të veçanta për të dy trevat e Atdheut të copëtuar.

## **SHUAJB MUHARREM ARNAUTI**

### **HULUMTUES I NJOHUR I LIBRAVE TË KULTURËS ISLAME**

Shuajb Muharrem Arnauti lindi në qytetin e Damaskut në vitin 1928. Në familjen e tij, ku tradita shqiptare dhe kultura islame ishin gjithnjë të pranishme. Shuajbi mësoi nga i ati dijet elementare të islamit.

Qysh i vogël mësoi përmendësh shumë pjesë nga Kur'ani, ndërsa dëshira për t'u thelluar edhe më tepër në sekretet e librit hyjnor e bëri atë që qysh nga mosha 17 vjeçare t'i përkushtohej mësimit të gjuhës arabe dhe gramatikës së saj. Kështu, për më se dhjetë vjet radhazi, Shuajb Efendiu vazhdoi të ndjekë ligjëratat e gjuhës nëpër xhamitë dhe medresetë e vjetra të Damaskut, veçori e të cilave ishte se nxënësi ishte i lirë të zgjedhte dijet, që i interesonin, dhe askush nuk kishte të drejtë ta detyronte nxënësin që të mësonte atë që nuk i interesonte ose nuk i përshtatej.

Gjatë kësaj kohe Shuajb Efendiu mësoi nga dijetarët më të mirë të gjuhës arabe që kishte Damasku dhe lexoi librat më të njohur si: "Sherh ibni Akil" dhe "Kafijen" e Ibni Haxhibit të komentuar nga Mulla Xhabi, "El Mufas-sal" të Zemalsheriut, "Shudhur e dh-dheheb" të Ibni Hisham el-Ensariut, "Esrar el-Belaga" dhe "Delail el-Iexhaz" nga Abdulkadër el-Xhurxhami etj. Nga mësuesit e tij më të njohur prej të

cilëve mësoi dijet e gjuhës arabe ishin: Muhamed Salih el-Ferfur, Arif Ed-Devgji, Sulejman Gavoqi (shqiptar) etj.

Dhe pas këtij udhëtimit të gjatë në thellësinë e gjuhës arabe, në të cilën arriti një nivel mjaft të lartë, Shuajb Efendiu e pa të nevojshme t'i kushtonte një kohë edhe mësimin të shkencave juridike islame (Fikhut islamik). Për këtë qëllim lexoi librat më të njohur të kësaj fushe, sidomos në Medhëhebin Hanefi, si: "Meraki El-Felah" të Sherenblalit, "El-Ihtijar" të Musulit, "El-Kitab" të Ebi Haseb El-Kudurit, "Hashiet Ibni Abidin" që njihet si "Redd El-Muhtar Ala Ed-dar El-Muhtar" etj.

Kështu Shuajbi i kaloi më tepër se shtatë vjet duke mësuar Usuli Fikhun, Tefsirin e Kur'anit, Mustalah El-Hadithin, leximin e librave të moralit etj. Eshtë kjo kohë, kur ai kishte kaluar të tridhjetat.

Ajo që i ra në sy Shuajbit gjatë studimeve të tij e që pati ndikim të rëndësishëm në formimin e tij shkencor si dijetar që se te profesorët e tij ndihej një mungesë e theksuar në njohjen e rangjeve të hadithit. Ose thënë ndryshe, hadithet e dobëta (Daif) dhe të mbathurat (Mevdu) të cilat përdreshin më tepër në shpjegimet, ligjëratat dhe literaturën islame të asaj kohe.

Prandaj e pa të nevojshme që të specializohej në këto dije, për të mundur të rishikonte dhe rivlerësonte librat e hadithit dhe të syetit të Pejgamberit a.s., në mënyrë që të krijohej një mbështetje për studiuesit dhe të bëhej një sqarim i domosdoshëm për lexuesit e literaturës islame në përgjithësi.

Kështu që në vitin 1955, kur në Damask filloi të punojë si mësimdhënës i gjuhës arabe dhe i edukatës islame, pa se kjo nuk i linte kohë të mjaftueshme për studimin e traditës dhe të librave të hadithit. Prandaj që në vitin 1958 filloi një punë të re në "Bibliotekën islame të Damaskut", ku kryesoi grupin e seksionit që merrej me kritikën dhe korrigjimet e literaturës burimore islame.

Në bibliotekën islame ndenji afro njëzet vjet plot dhe gjatë kësaj kohe hulumtoi, identifikoi dhe korrigjoi mbi shtatëdhjetë vëllime librash të ndryshëm me karakter historik, fetar islamik dhe letrar, si: "Sherh Es-Sunne" të Begaviut (gjashtëmbëdhjetë vëllime), "Zadul Mesir" të Ibni Xhevzis (nëntë vëllime), "Revdatu Et-talibin të Neveviut (dymbëdhjetë vëllime), "El-Mubdi fi Sherh El-mukni" të Ibni Muflikit (dhjetë vëllime), "Muhedh-dheb el-egani" të Ibni Mendhurit (dymbëdhjetë vëllime) etj.

Më parë Shuajb Efendiu e pa të arsyeshme të largohet që andej, ngase rregullorja e atyshme si dhe jeta përgjithësisht në Siri nuk i krijonte mundësi pune e hulumtimi. Kështu që në vitin 1982 ai shkoi në kryeqytetin e Jordanisë, Aman, ku filloi të punojë në fondacionin "Err-risale" dhe u angazhua të kryesonte seksionin e kulturës. Kontributi i Shuajb Efendisë nga koha kur erdhi në Aman e gjer më sot është i pallogaritshëm për shkencat islame dhe kulturën arabe në përgjithësi. Ne, sa për ilustrim, po përmendim disa:

"Siretu ealam en-nubela" të Dhehebiut (në njëzet e dy vëllime), "El-ihsan fi takrib sahih Ibni Hb-ban" (tetëmbëdhjetë vëllime), "El-avasim ve el-kavasim" të Ibnu El-Vezirit (nëntë vëllime), "Zadul Mead" të Ibnul Kajimit (pesë vëllime) etj.

Numri i librave që ka punuar vetë e me bashkëautorë, ose ka qenë mbikëqyrës i tyre, arrin në mbi njëqind e gjashtëdhjetë vëllime, në të cilat përfshihen libra në shkencat e hadithit, fikhut, tefsirit, akides, libra të përkthyer etj.

Shuajb Efendiu, ose si e quajnë në Jordani Shejh Shuajbi, edhe pse i lindur jashtë atdheut e jetuar atje, flet rrjedhshëm gjuhën shqipe. Pas viteve '90 ka vizituar edhe Shqipërinë, të cilën asnjëherë nuk e harron.

## **NASRUD-DIN ALBANI (SHQIPTARI) HADITHOLOGU MË I SHQUAR I KËTIJ SHEKULLI**

Nasrud-din Albani (Shqiptari) është hadithologu më i shquar i këtij shekulli dhe personaliteti më i njohur i kolonisë shqiptare të Shamit (Sirisë) në Lindjen e Afërme, e cila në hapësirën kohore dyshekullore, e diktuar në rrethana të caktuara historike për t'u shkëputur nga trangu i saj në Ballkan, arriti të ruajë me përpjekje e sakrifica të ndërgjegjëshme identitetin e vet. Mbi të gjitha, pjesëtarët e saj ruajtën gjuhën, traditën, mallin dhe nostalgjinë për vendlindjen, emrin dhe krenarinë për dheun e të parëve.

Vendasit që në fillim ata i quajtën Arnautë e ndonjëherë Albanë. Iformacione të natyrave të ndryshme përcjellin jetën dhe veprimtarinë e tyre. Por për fat jo të mirë, ata ende nuk kanë marrë vendin e tyre të merituar në historiografinë dhe publicistikën tonë, pa çka edhe përfundimet përgjithësuese rreth çështjes shqiptare në tërësi do të jenë të mangëta.

Nasrud-din Albani, rrjedh nga një familje shkodrane e shtresës së zanatçinje të qytetit. Në vetet '30 emigroi së bashku me familjen e tij në Damask të Sirisë. Arsimin fillor e bëri në shkollën shtetërore "Isaf Hajrie", ku mësoi gjuhën arabe.

Nasrud-dini nuk u mjaftua vetëm me këtë, por ndoqi mësimet që zhvilloheshin në shkollat e vjetra të Damaskut, ku dëgjoi ligjëratat e dijetarëve më të shquar të kohës. Dhe si i ri u njoh me literaturën burimore të gjuhës dhe të letërsisë arabe, si: "Sherh Ibni Akil", "El -mufas-sal" të Zemasheriut, "Shudhur Edh-dheheb" të Ibni Hishamit etj. Kështu, pas një rruge të gjatë me njohjen e gjuhës arabe,

të cilën arriti ta përvetësojë më së miri, ai filloi të njëhej nga të gjithë për forcën e interpretimit dhe mundësitë e mëdha që kishte në të argumtuarit e vlerave gjuhësore e letrare.

E gjithë kjo e mundësoi atë që të orientohej në studimin e Fikhut dhe të jurisprudencës islame, mësimet e para të së cilës i mori nga profesori i njohur Seid El-Burhani, para të cilit lexoi autorët më të njohur të medhehebit Hanefi, si: "Merakil Felah" të Sherniblalit, "El Kitab" të Ibni Hasen El-Kud-Durit etj. Në këtë kohë ai u njoh edhe me shkencat tjera islame si: Usuli fikhun (bazat e fikhut), Tefsirin (komentimin e Kur'anit), Mustalahul hadithin (terminologjia e hadithit), Ahlakun (vepra mbi moralin), edukatën, kulturën, historinë etj.

Kështu edhe, pse në moshë të re, ai arriti të hetojë vlerat e mëdha që bart me vete trashëgimia islame me opusin e saj madhështor në fusha të ndryshme të shkencës dhe jetës së popujve. Kjo e shtyu atë të mendojë për një angazhim më serioz në klasifikimin e vlerave reale të haditheve të Profetit të fundit, Muhamedit a.s. Kjo bëri që ai të diplomohet në këtë shkencë duke pasur si prof. Ragip al Tab-bah. Ai këtej e tutje qëndronte me orë të tëra në bibliotekën Ez-zahirijje të Damaskut, duke hulumtuar mbi dorëshkrimet që gjendeshin aty. Nasrudin Albani frekuentoi edhe biblioteka të tjera, duke grumbulluar të dhëna, që e bënë atë të jetë një autoritet shkencor në shkencën e Hadithit.

Me kalimin e kohës shqiptari nga Shkodra filloi të bëhej i njohur si studiues dhe mendimtar i niveleve botërore në lëmin e shkencës së hadithit. Por famën e arriti me projektin e tij të madh (madje lirisht mund të themi më të madhin në historinë e hadithit të kohës së re) në klasifikimin e haditheve të Profetit a.s. Ai bëri klasifikimin e njohur tashmë si frut i punës së tij, duke i ndarë hadithet në dy grupe të mëdha me titujt: "Silsilet el ehadith el-sahiha" -(vargu i haditheve të vërteta) dhe "Silsilet el ehadith ed-daife"-(vargu i haditheve të dobëta). Edhe pse ky studim do dekada e i kalon dhjetëra vëllime, ende është në qendër të aktivitetit të Nasrud-din Albanit.

Opusi i tij tani përfshin mbi 136 vepra shkencore, prej të cilave 16 prej tyre janë kritika shkencore, 55 vepra dorëshkrime të pabotuara, 29 vepra të botuara disa herë, 30 cenzurime shkencore në lëmin e shkencës së hadithit, 6 retushime të librave të njohur si: El-Uluv, Sahih Muslim, Sahih Buhari, Shemail Muhammedije etj. Për këtë ai konsiderohet në botën islame si një nga autorët më prodhimtarë të shekullit tonë, në fushat e hadithologjisë, letërsisë artistike arabe, historisë, kritikës letrare, sociologjisë, etikës, pedagogjisë etj.

Kështu ky erudit i shkencës dhe i kulturës botërore, e në veçanti asaj islame, duke shërbyer si pedagog në Universitetin e Medinës (Arabi Saudite), e pastaj si profesor i qendrave më të mëdha akademike studimore të Libanit, Emirateve të Bashkuara Arabe, Jordanisë etj. arriti të çmohej nga të gjithë bashkëkohësit e tij: "Muhad-dith El Asr" (shkencëtar i shekullit në lëndën e hadithit).

Sot punonjësit shkencorë të islamologjisë moderne i referohen veprës së Nasrud-din Albanit.

Fatkeqësisht duhet thënë se Nasrud-din Albani edhe pse i gjakut tonë, dhe megjithëse krijimtaria e tij shkencore dhe letrare kap një periudhë mbi 30 -vjeçare, në Shqipëri mjerisht njihet pak, dhe, më saktë, nuk njihet me madhështinë e tij intelektuale.

Gjatë periudhës së sundimit të shtetit totalitar, ku interesat kombëtare iu nënshtroheshin interesave partiake, dhe ku pothuaj çdo gjë që krijohej jashtë kufijve shtetërorë shqiptarë dhe që nuk i përgjigjej ideologjisë marksiste leniniste konsiderohej e padëshiruar, nuk çoi vetëm në cungimin e kulturës kombëtare, por edhe në cungimin e vetë kombit. Ky kolos i kulturës islame i përket edhe kulturës shqiptare. Ne shpresojmë që jo vetëm veprat e tij, por edhe fizikisht ta kemi përballë intelecencës sonë shqiptare për çështje të caktuara.

## **ABDULKADËR ARNAUTI**

### **KOLOS I KULTURËS DHE DIJEVE ISLAME**

Bir' i trojeve shqiptare në Kosovë, u bë objekt i shpërnguljeve të imponuara nga politika antishqiptare serbe duke marrë udhët e kurbetit, Kadriu i vogël i vazhdoi udhët e largëta i prirë nga i ati dhe pjesëtarë të tjerë të familjeve, duke u stabilizuar në Siri.

Mbasi përfundon me sukses të gjitha hallkat e shkollimit islam, Abdylkadër Arnauti vazhdoi veprimtari intensive fetare, duke u bërë një nga dijetarët më të njohur të fushës së Hadithit për Sirinë.

Ai ligjëron në disa medrese e institucione të tjera të larta islame, duke filluar nga shkolla e mesme teologjike: Isaf Tullab El Ulum El Islamie në Damask të Sirisë. Ligjëron edhe në medrese të tjera lëndën e hadithit, duke kryer njëkohësisht edhe rolin e ligjëruesit në një xhami, "Mesxhidul Muhammedijje".

Veprimtaria pedagogjike e studimore harmonizohet, duke rritur ngarkesën sa në një fushë e në një tjetër, sa si ligjërues në medrese e sa në xhami, sa si lektor, sa si redaktor e korektor i shtëpisë botuese në Damask, në mbi 90 komplete veprash, si:

- 1.Zadul mesit-9 vëllime.
- 2.Rreudatul taibin-12 vëllime.
- 3.Zadul mead-6 vëllime.
- 4.El Kafi-3 vëllime.

5.El Furkan bëjnë evlijaur-rahman ve evlijahush-shejtan.

6.El Furkan bejnel hakki vei batil.

Dhe vepra të tjera.

Ky personalitet i shquar, me ndjenja të pastra atdhetare, megjithëse në kushte të vështira shëndetësore (paralizë e pjeshme), mban kontakte të vazhdueshme me studentë shqiptarë, nga të gjitha viset, duke u dhënë shumë prej këtyre edhe mësimë individuale apo në grupe, nën drejtimin e kualifikuar të tij. Në porosinë dhe këshillat që jep Abdulkadri, e vë theksin në lidhjen e fjalës me veprën, në harmoninë e padiskutueshme të tyre, deri në shkrirje natyrore. Ai porosinë pareshtur që shqiptarët të ruajnë moralin, nderin e tyre, idealin atdhetar e fetar.

## **HAXHI VEHBI SULEJMAN GAVOÇI STUDIUES I APASIONUAR DHE LIGJËRUES I RRALLË**

Është një nga personalitetet më të shquar shqiptarë, që ka dhënë një ndihmesë të veçantë në kulturën Islame në Shqipëri dhe në përgjithësi në çështjen kombëtare. Autor i rreth 50 veprave të botuara në gjuhën arabe dhe shqipe, i qindra artikujvestudimor dhe propagandistik, pedagog e ligjërues në disa universitete.

Ka lindur në Shkodër me 17-5-1923. i rritur në një mjedis familjar arsimdashës, fetar dhe me tradita atdhetare, u shkollua dhe u specializua në vende arabe, si në Siri, etj, ku përfundoi edhe diktaturën për

fushën juridike fetare. Qendroi gjatë në Kajro, ku mësoi shumë mirë gjuhën arabe dhe atë angleze, hodhi baza të thella dhe solide në fushën e edukimit, fesë etj.

Një vend të veçantë zë veprimtaria e Vehbi Sulejman Gavoçit në fushën e arsimit, si mësues i apasionuar e me horizont të gjerë, duke filluar nga shkolla femërore e Halepit, pastaj si pedagog Istitutin që përgatiste mësues dhe në Universitetin e Damaskut. Punoi edhe në Universitetin e Riadit në Arabinë Saudite më pas në Universitetin e Medinës, ku do të rikthehet më vonë po në këtë institucion, por si studiues.

Haxhi Vehbiu, zëvendësoi babanë e vet, duke zhvilluar ligjërata në xhaminë "Arnauti", të ndërtuar nga i jati, ku edhe vazhdoi për tre vjet si i ati edhe si imam e vaiz.

Mbas vitit 1974, kur me gjithë kërkesat për të vizituar atdheun dhe vendlindjen e tij, të cilat i refuzohen nga shteti ateist, ai çmallet duke iu afruar tokës shqiptare, madje drejtëpërdrejtë në të, si ligjërues në Shkup e në Prishtinë, ligjërime të bëra në gjuhën amtare shqipe. Pas kësaj vizite, me t'u kthyer në Siri filloi të shkruante e të botojë libra në gjuhën shqipe, sidomos pas vitit 1974, me botimin e librit "Si dhe pse?" dhe pas kthimit nga vizita që bëri tek bashkëatdhetarët e vet në Belgjikë, shkroi përkthimin e vet "Parimet e Islamizmit", edhe kjo vepër në gjuhën amtare shqipe.

Vitet e fundit, pas proceseve demokratike, Sulejman Gavoçi e vizitoi disa herë vendlindjen e tij, duke mbajtur edhe ligjërata në xhaminë e lagjes Parrucë, ku la përshtypje të veçanta për thellësinë e mendimit, ligjërimin e qartë, problematik dhe me argumente e sidomos me emocione tek besimtarët e shumë që e ndiqnin në ligjërimin e tij.

Në vizitat e bëra në Shqipëri Haxhi Vehbi Sulejmani është treguar shumë aktiv si në ligjëratat e zhvilluara në shkolla e institucione, para publicistëve, në ceremoni përrurimi të xhamive, etj, ku ka

treguar jo vetëm aftësi, horizont e kulturë të gjerë, por edhe urti e modesti, dashamirësi e bujari, sidomos në rastet kur ka ndihmuar edhe me fonde e dhurata në jetimore e institucione të ndryshme.

Shqiptarët, nga të gjitha viset që gjinden në Siri, përfshirë edhe studentët e shkruar atje për studime, gjejmë tek Vehbi Gavoçi dhe djemtë e tij pritje bujare, dashamirësi e ndihmë të gjithanëshme. Kështu, edhe tani, ndonëse në moshë, Haxhi Vehbi Sulejman Gavoçi, vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e tij për edukimin fetar të masës, si dhe për edukimin atdhetar të bashkatdhetarëve të vet nga të gjitha trevat.

Si përfundim, Haxhi Vehbi Sulejman Gavoçi, është një personalitet i shquar fetar e atdhetar, didakt i arsimit dhe edukimit islam, ligjërues i rrallë, studiues i apasionuar dhe një shëmbëlltyrë e lidhjes së fjalës me veprimin, të mendimit teorik me zbatimin e mësimëve të Islamit. Ai, me veprën dhe tërë veprimtarinë e tij e pasqyron me dinjitet shumë të lartë atdheun e vet.

## **HILMI MALIQI (SHEH MALA) PERSONALITET I SHQUAR FETAR, ARSIMOR DHE KOMBËTAR**

Hilmi Maliqi (Sheh Mala), personaliteti i shquar fetar, arsimor dhe kombëtar është një nga bijt e denjë të Kosovës e të mbarë viseve shqiptare. Studimet i kreu në Medresenë e Mehmet Pashës në Prizren, ku u pais me bazat e njohurive islame, duke u ngritur më pas në nivele të larta të mendimit islam, veçanërisht në fushën e tesavufit. Punoi fillimisht si imam e pastaj si myfti në rrethin e Rahovecit. Shtëpia modeste e tij, alias teqe e Melamive, u kthye në një qendër të rinisë për edukatën islame. "Melami" do të thotë të kritikosh vetveten, të jesh autokritik.

Sot teqet e melamive, si vëllazëri dervishësh, ndodhen në Suhadoll të Mitrovicës, në Prizren e në Rahovec. Këtij tarikati i përkisnin shehlerë të fortë fetarë si Ymer Lutfi Paçarizi nga Prizreni, Sheh Jonuzi nga Suhadolli, Sheh Mala nga Rahoveci, Sheh Sulejmani nga Gjakova, etj. të cilët, përveç se udhëhiqnin teqetë e veta, lanë dorëshkrime që dokumentojnë për një punë shumë të dobishme në fushë të historisë së letrave dhe të shkrimit shqip në këto troje.

Sheh Hilmi Maliqi ka shkruar disa poezi, të cilat këndoheshin si ilahi nëpër teqe. Krijimtaria poetike e Hilmi Maliqit, si dallim nga ajo e shkruar në prozë, do të tërheqë vëmendjen e studiuesve dhe amatorëve të shumtë të fjalës së shkruar shqipe. "Divani" i tij do të bëhet objekt studimesh edhe për vlerat e tij gjuhësore nga akademik Idriz Ajeti, si dhe studiues të tjerë, veçanërisht për të interesuarit në çështje fetare e kulturore.

Ky personalitet ka hyrë në historinë e arsimit e të shkollës, madje edhe të mendimit pedagogjik, për veprimtarinë e tij me vlerë, krahas asaj fetare, edhe në fushën e arsimit. Në shkollat e asaj kohe, si në mejtepet, iptidaijet, ruzhdijet, idadijet dhe medresetë, në të cilat mësonin shqiptarë, u dalluan disa myderrizë ndër të cilët dhe Sheh Hilmi Maliqi nga Rahoveci.

Halim Maliqi ka ushtruar edhe mësuesinë, duke shkruar vepra në gjuhën shqipe me alfabet arab. Veprat e tij kanë dhe ide pedagogjike. Ka ushtruar veprimtari fetare dhe arsimore në Rakovec.

Në teqen e ndërtuar me ndihmën e popullit kontribuoi si arsimtar dhe klerik, madje më tepër si arsimtar. Në teqe, ku kishte hapur shkollën, përveç mësimit fetar, zhvillonte edhe aritmetikë, gjeografi e lëndë të tjera. Vlerësonte edukatën e punës dhe rekomandonte punë fizike për nxënësit, duke i çmuar të gjitha llojet e punës. Natyra e tij e drejtë bënte t'i vlerësonte njëlloj, sipas aftësive reale, të gjithë

nxënësit, t'i trajtonte ata pa përdorur ndëshkime fizike, duke krijuar një mjedis të ngrohtë e duke nxitur miqësinë në mes tyre.

## **HAFIZ SABRI KOÇI PUNËTORI I SHQUAR PËR BESIMIN ISLAM**

Veprimtaria për besimin islam në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore dhe sidomos në vitet e demokratizimit të vendit, ringjallja e institucioneve të besimit islam jo vetëm në Shkodër e në Veri të vendit, por në mbarë Shqipërinë, është e lidhur ngushtë edhe me veprimtarinë e Haxhi Hafiz Sabri Koçit.

I lindur më 14 maj 1921 në Nerenë të Librazhdit, por i mbetur shpejt pa baba, erdhi me të ëmën në Shkodër, në lagjen që sot quhet "Vojo Kushi" e në rrugën, që mban emrin e mësuesit dëshmor "Shyqyri Haxhia".

Që në moshën 7 vjeç filloi mësimet në medresenë e qytetit, duke mësuar me zell të madh leximin e Kur'anit, texhvidin dhe rregullat tjera nga parimet bazë të fesë islame. Në moshën 16 vjeç filloi të ushtrojë detyrën e mual-limit nëpër xhamitë dhe mejtepet e Shkodrës. Djaloshi i zgjuar, por i varfër, i detyruar për nevoja ekonomike familjare, nuk arriti të ndjekë studimet e larta, duke u aktivizuar si imam në Drisht, një fshat i Shkodrës. Në vitet e Luftës, 1939 deri më 1943, shërbeu imam në xhaminë e lagjes "Dudas" e më vonë në "Rus". Hafiz Sabri Koçi nuk pushoi së studiuar si autodidakt, duke shfrytëzuar me mençuri edhe mundësitë e mëdha që kishte Shkodra, si një qendër e vjetër e kulturës shqiptare,

përfshirë edhe kulturën islame, si vatër e përgatitjes dhe e shërbimit të shumë hoxhallarëve të shquar, ndikimi i të cilëve ishte i pranishëm edhe për Hafizin e ri, që gjithnjë e më shumë po tërhiqte vëmendjen e xhematit të tij, respektin e adhurimin e tij.

Duke punuar e studiuar pareshtur, Hafiz Koçi zgjeroi edhe më tej nivelin e tij, duke fituar njohuri të thella për Sarfin, Navfin, Usulifikhun, Usul hadithin, Tefsirin, Akaidin, Allakun etj.

Te Hafiz Sabri Koçi lanë gjurmë në formimin e tij disa personalitete, sidomos Hafiz Muhamet Kastrati, Haxhi Muhamet Bekteshi, Hfz. Sabri Bushati, Sheh Qazim Hoxha, etj. Ixhazetin e mori nga myderrizi Muhamet Bekteshi.

Afirmimi i tij në Shkodër nuk i pëlqente regjimit, prandaj e transferuan në Krujë, ku, me kërkesë të banorëve atje, caktohet Myfti i Krujës. Me kërkesë të tij, Komuniteti Musliman e kthen në Shkodër sërish, por gjithnjë me presion të pushtetit nuk e lejoi që të punonte si imam dhe aq më pak të mbante ligjërata. Më 1955 e caktojnë Myfti në Kavajë, ku vazhdon të punojë deri në vitin 1959.

Hafiz Sabri Koçi shquhej për pasionin e madh në detyrë, për vazet që mbante, për energjinë e tij në kryerjen e dhumë detyrave fetare, për aftësitë që kishte në tërheqjen e njerëzve të asaj kohe e sidomos rininë në xhami dhe në mjediset shoqërore, ku ndodhej, duke u përhapur gjerësisht nami i tij si një gojëtar i shquar për problemet e besimit islam. Por kjo nuk shikohej me sy të mirë nga shteti antifetar, madje i krijonte shqetësim, sepse vinte në kundërshtim me strategjinë e tij ateiste. Prandaj edhe i shtuan lëvizjet, vëzhgimet agjenturore, kontrollet ndaj ligjëratave të tij, madje filluan përgatitjet për izolimin e arrestimin e tij.

Për shkaqe familjare, me kërkesë të tij, kthehet në Shkodër, ku pas 6 muajsh e caktojnë si imam në xhaminë e lagjes "Rus", ku qëndroi deri në vitin 1964, kur në muajin Ramazan, pas faljes së namazit të

taravisë, filluan ndjekjet sistematike nga sigurimi i shtetit. Më 4 korrik 1966, në kohën kur po shkonte në xhami për faljen e ylesë, arrestohet dhe në shtator të atij viti dënohet me njëzet e tre vjet e pesë muaj burg, duke u liruar më 22.X.1986. Por nuk mjaftoi burgosja e gjatë e tij, mbasi pësoi reperkusione edhe familja e të afërmit, një praktikë kjo e monizmit për të dënuarit e rëndë.

Nga dalja prej burgut e deri në vitin 1990, Hafizi edhe pse në moshë të thyer, u detyrua të punojë në punë fizike, çka nuk përputhesh askund me profesionin e tij.

Me fillimin e proceseve demokratike u ngjallën shpresat edhe për besimtarët islamë. Më 1.XI.1990 Hafizit i shkojnë në vendin e punës një grup të rinjsh nga Shkodra dhe kërkojnë prej tij të bashkohej me ta për hapjen e Xhamisë së Plumbit. Entuziazmi i tyre e ringjallën Hafizin, duke ua plotësuar kërkesën me përkushtim të madh. Në datën 6 nëntor 1990, në prani të mijëra e mijëra qytetarëve e fshatarëve të periferisë, në një solemnitet të ashtëzakonshëm, fillon detyrën. Të nesërmen themeloi Komunitetin Musliman në Shkodër, në krye të të cilit u vu Hafizi, gjë që u konfirmua edhe nga një mbledhje e besimtarëve nga të gjitha trevat në Tiranë, më 18 janar 1991, me rastin e hapjes së xhamisë së parë në Tiranë. Që nga ajo kohë, Hfz. Sabri Koçi është kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë.

Kontributi i tij për kohën që është në krye të hierarkisë më të lartë islame shqiptare është i madh. i gjendur përpara institucioneve islame plotësisht të shkatërruara, para një mungese shumë të madhe në kuadër, para një baze materiale të asgjësuar, para brezave të rinj e të rritur pa njohuritë elementare islame, para një mungese të bibliotekës islame, e filloi punën me një entuziazëm të madh, duke zgjidhur gradualisht një varg detyrash komplekse, të cilat vijnë edhe tani, kur kemi një popull të arsimuar, një inteligjencë të madhe në numër, një rini të shkolluar, por me predispozita për të përqaftuar besimin e vet, në kushte të një Evrope me rrezatime të gjithanshme kulturore e fetare.

Hafiz Sabri Koçi punoi me ngulm për njohjen e Shqipërisë në botën islame, në sigurimin e ndihmave për ngritjen e institucioneve fetare, sidomos të xhamive, në përgatitjen urgjente dhe perspektive të kuadrit fetar etj.

Ai u bë misionar i njohjes së Shqipërisë në vendet islamike dhe më gjerë. Nga respekti që gëzon, është zgjedhur edhe Kryetar Nderi i Këshillit Islamik për Evropën Lindore.

## **IMAM VEHBI ISMAILI PERSONALITET I SHKENCËS ISLAME NË TË GJITHA MJEDISËT SHQIPTARE**

Imam Vehbi Ismaili është personalitet i shkencës islame në të gjitha mjediset shqiptare. Në fondin e bibliotekës islame në gjuhën shqipe, ai zë një ndër vendet më dinjitoze, për atë punë këmbëngulëse që ka bërë në fushën e studimeve dhe të botimeve islame. Është autor i mbi tridhjetë veprave, kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar për kontinentin e Amerikës Veriore dhe imam në Qendrën Islame Shqiptaro-Amerikane në Miçigan.

Jeta e Imam Vehbi Ismailit është e mbushur me veprimtari për besimin islam dhe e mbushur nga malli për atdheun e tij, të cilin prej gati gjashtë dekadash e ka dëshiruar.

Është lindur në Shkodër më 25 nëntor 1919, në një familje intelektuale, të njohur për dije e të rrethuar me respekt nga qytetarët dashamirës të dijes dhe kulturës.

Në vitin 1937 regjistrohet në Universitetin Al-Ezher të Kajros ku studioi deri në vitin 1945, duke u diplomuar në teologji.

Rrethanat e krijuara në Shqipëri ia bënë të pamundur kthimin e tij në atdhe. Vazhdoi punën e nisur që kur ishte student, duke përkthyer në gjuhën arabe novela nga letërsia shqipe, duke i botuar në dy revistat e përjavshme letrare "El-Risaleh" (Mesazhi) dhe "Eyh-thakafeh" (Kultura). Përveç këtyre, botoi edhe në disa revista të tjera, si në "El-Hilal" dhe "El-Katib", në të cilat shkruante tregime të nxjerra nga historia islame. Shumica e novelave u botuan në përmbledhjen "El-Medudhehebi" (Djepi i artë).

I ftuar nga Shoqëria Shqiptaro-Amerikane Muslimane në Detroid, në fund të prillit 1949 arriti atje si udhëheqës i tyre fetar, ku u prit shumë mirë. Në mes punëve organizuese, u mor edhe me botimin e një reviste fetare kulturore, me titull: "Jeta myslimane shqiptare", që dilte katër herë në vit, me nga 64 faqe, në gjuhën shqipe dhe angleze, e cila vazhdoi për tetë vjet, deri kur u ndërpre për arsye ekonomike.

Më 6 qershor 1951 u hap një ndërtesë e adoptuar si vatër e aktiviteteve fetare e kombëtare, dhe më 23 shkurt 1963 u hap xhamia e re, Qendra Islame Shqiptare, e cila u pasua nga të tjerat. Sot në Amerikë ka me mijëra xhami të ndërtuara dhe një numër të konsiderueshëm shkollash e qendrash muslimane.

I zhuritur nga malli për atdhe, imam Vehbiu ka vizituar tri herë Kosovën, duke parë nga larg atdheun e tij. "Më dukej sikur e shikoja nga larg atdheun, sidomos kur shkoja në Dibër, në Hot... e hiqsha një pjesë të mallit" ka deklaruar në një intervistë që i ka dhënë organit "Thirrja Islame" që del në Amerikë.

Pas 49 vjetësh, në nëntor të vitit 1988 vjen në atdhe dhe për herë të dytë në kohën e proceseve demokratike në krye të një delegacioni. Pas kësaj vizite ka dhënë mendime se çfarë duhej bërë për besimin islam në Shqipëri.

Në vargun e botimeve të shumta e me vlerë që ka bërë Imam Vehbiu, ka mbledhur edhe shkrime të zgjedhura të botuara nga personalitete shqiptare. Me shpirtëgjërësi e pa paragjykim i ka botuar ato duke nxitur kështu tërheqjen e mendimit dhe të punimeve të intelektualëve shqiptarë në dobi të kulturës islame e asaj shqiptare.

Imam Vehbiu vazhdon të punojë edhe në fushën e shkencës së islamit e t'i japë lexuesit vepra me vlerë për të gjitha nivelet e mbarë viset shqiptare.

## **SHERIF AHMETI PËRKTHYESI NË SHQIPE I KUR'ANIT**

Sherif Ahmeti, përkthyesi në shqip i Kur'anit, jetoi e punoi kur Kosova me të gjitha trevat e saj me shqipe të kulluar, për vetë rrethanat e veçanta të krijuara që pas dekadës së parë të këtij shekulli, në përpjekje për të mbijetuar nga sundimi kompleks serb, pati shumë raste, kur hoxhallarë të niveleve të ndryshme, u bashkuan në një çështje të madhe. Përveç veprimtarisë fetare, ata angazhohen edhe në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, madje shumë herë edhe duke i zhvilluar paralelisht të dy detyrat. Fillimisht kjo e ka burimin në moslejinin e mësimin në gjuhën amtare nga organet pushtuese dhe, në periudhën e mëvonshme, edhe në frenimin e ushtrimit të fesë për arsye indoktrinuese, ateiste.

Sherif B. Ahmeti, arsimin fillor dhe atë të mesmin (medresenë) i bëri në Prishtinë. Duke pasur edhe formim në gjuhën amtare, ai punoi si mësues në fshatrat Banullë, Gadime, Sllovijë, duke vazhduar

paralelisht edhe shkollën normale, të cilën e përfundon me sukses. Veprimtaria e tij arsimore la mbresa në nxënësit e atyre fshatrave dhe në prindërit e tyre.

Në vitin 1965 e ngarkojnë si mësimdhënës në medresenë "Alauddin" të Prishtinës, ndërsa në vitin 1970 e deri në vitin 1984 ishte drejtor i saj. Më 1985 u ngarkua me detyrën e Myftiut të Prishtinës, të cilën e kreu deri në vitin 1990, kur kishte mbushur moshën 70 vjeç dhe e nxjerrin në pension. Por, që me hapjen e Fakultetit Teologjik në Prishtinë, Sherif Ahmeti angazhohet edhe si mësimdhënës i "Akaidit"...

Veprimtaria e tij shumë me vlerë është edhe në fushën e studimeve dhe të botimeve që bëri. Që në vitin 1968 ai ishte kryeredaktor i revistës fetare "Buletini", që i para priu "Edukatës Islame", në të cilën qe njëkohësisht si drejtues deri në vitin 1983.

Ai bëri emër të nderuar edhe në fushën e përkthimeve. Në vitin 1987, pasi kishte përkthyer më parë nga arabishtja suren "Jasin", dorëzoi në shtyp përkthimin e Kur'anit me komentim, i cili u ribotua në Tripoli në 50 mijë kopje, në Kairo në 30 mijë dhe në Medinë në një milion kopje.

Sherif Ahmeti është edhe autor i veprës dinjitoze "Komente dhe mendime islame", prej afër 400 faqesh, botuar në Prishtinë, më 1995, e cila është një ndihmesë e çmuar për ngritjen e vetëdijes islame të popullit shqiptar, ku përmbledhen punime, një pjesë e të cilave të shkruara në kohën e censurës ateiste.

## **HOXHALLARË DHE MËSUES NJËKOHËSISHT, QË PROUVAN EDHE BURGJET E SERBIT**

Medreset e Prishtinës, të Shkupit dhe të Tiranës etj, u bënë dhe vatra të përgatitjes së mësuesve shqiptarë në gjuhën amtare për mjaft shkolla të vendit. Vetë specifikat e arsimit në viset shqiptare, ku kishte një nevojë shumë të madhe për kuadro të arsimit, në atë zhvillim të hovshëm që mori shkolla shqipe për disa etapa, lindi edhe nevojën e organizimit të nxënësve të medreseve për të përballuar këto nevoja për kuadër arsimor. Kjo tregon edhe për ndikimin e fuqishëm edukativ të medreseve në përgatitjen e kuadrit, çka u vërtetua katërcipërisht këtej e andej kufirit shtetëror shqiptar, mbasi ish-nxënësit e tyre, duke vazhduar kurse pedagogjike për plotësimin e përgatitjes profesionale, disa edhe shkolla të plota deri fakultete, shërbyen si punonjës të dëvotshëm të arsimit dhe të kulturës shqiptare, me ndërgjegje të lartë profesionale dhe me pretendime cilësore në arsimimin e edukimin e brezërive shqiptare. Kuadro të tillë janë të shumtë. Po ndalemi në ndonjë prej tyre.

## **RAMADAN GOVORI (MULLA RAMA)**

Njeriu i thjeshtë dhe i madh Ramadan Govori, ose Mulla Rama, kaloi një jetë të vështirë, të mundimshme e me vuajtje të shumëllojshme fizike e psikike, por qëndroi me dinjitet si fetar, ai atdhetar i papëkukur e i pa-njolllosur, duke e mbyllur jetën e tij i nderuar, duke fituar mirënjohjen e popullit për veprat që bëri. Lindi në Herticë të Podujevës më 16.IX.1908. Punoi e studioi pa ndërprerje për të kryer me dinjitet detyrën e tij fetare. Por Mulla Rama nuk mund të qëndronte indiferent ndaj fateve të fesë e

të atdheut, nuk mund të toleronte ndaj atyre që kërkonin nëpërkëmbjen e të dyjave. Të parët këtë vendosmëri Lëvizja Nacionaldemokratike Shqiptare (LNDSH), ku u pranua anëtar i Komitetit (si organ udhëheqës i Lëvizjes), duke e emëruar kryetar i organizatës për LNDSH për Llap e Gollak, ku u angazhua me të gjitha forcat, pa asnjë rezervë, deri sa ra në gjurmë të pushtesit dhe burgoset. E dënojnë me vdekje, por pastaj dënimi kalon në 20 vjet, i cili, pas një amnestie zbutet në 15 vjet. Dënimin e kreu ditë më ditë në burgjet e rënda të ish-Jugosllavisë, duke dhënë prova të një fetari dhe atdhetari të papërkulur, i qëndrueshëm dhe bujar me shokët e miqtë e vet të vuajtjeve.

Mulla Rama, banor i lagjes Kodra e Trimave në Prishtinë, ndërroi jetë më 23 tetor 1993.

## **H. HAJDAR EF. JASHARI**

Lindi në vitin 1909 në fshatin Orizare të Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Rezhanovë e pastaj mësimet i vazhdoi në medresenë e Kumanovës, ku mori edhe "ixhazetin" nga dijetari i shquar Nuhi ef. Jusufi.

Më vonë, për shkak të aktivitetit të tij të madh, emërohet edhe mësimdhënës në medresenë e Kumanovës, ku mori titullin myderriz. Në vitin 1946 dënohet me 12 vjet burgim nga ana e sllavo-komunistëve, për shkak të pikëpamjeve të tij patriotike e demokratike.

Pas nëntë vjetësh burgimi të rëndë, ai lirohet për të vazhduar misionin e tij si fetar, atdhetar e liridashës. Për qëndrimet e tij të palëkundura gjithnjë që halë në sy për pushtetin maqedonas të asaj kohe. Më vonë punoi si imam në fshatin Llojan e pastaj në fshatin e lindjes Orizare, ku kontriboi në edukimin e brezit

të ri me kulturë islame dhe traditën shqiptare. Vdiq në vitin 1991 duke lënë prapa shembëlltyrë që e bënë të mos harrohet.

## **SADRI PRESTRESHI**

Kishte mbaruar medresenë e Pirinazit në Prishtinë si dhe një kurs pedagogjik. Në vitet e para pas lufte punoi imam në një xhami dhe në fillim të vitit 1946 u inkuadrua në Organizatën Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar për rrethin e Sitnicës, me seli në Lipjan, por në shkurt të vitit 1944 u zbulua nga UBE-ja dhe u denua me katër vjet burg të rëndë. Më pas punoi në arsim, si mësues në shkollat fillore. Nga viti 1953 deri më 1969 punoi imam i xhamisë në Miradi të ulët e në Prishtinë dhe prej afro 15 vjetësh si pedagog në medresenë "Alaudin" në Prishtinë.

## **HAXHI HAFIZ JAKUP DUGAGJINI**

Lindi në Prizren në vitin 1919. U diplomua në medresenë e atij qyteti, ku prej vitit 1947 dha mësim po aty dhe pastaj punoi myezin dhe imam në xhaminë e Sinan Pashës. Duke jetuar me situatën e vendit, u preokupua dhe u aktivizua në çështjen kombëtare, duke përdorur në këtë rrugë arsimin dhe kulturën shqiptare. Prandaj, duke qenë në Organizatën Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar, si i papajftueshëm me regjimin sllavo-komunist, e arrestojnë dhe vuan një kohë të gjatë në burgjet e ish-

Jugosllavisë prej vitit 1950 e deri në vitin 1962. Fillon pune si imam i xhamisë së Imam Pashës në Prizren, duke zhvilluar vaze, ligjërata me efekt të theksuar edukativ për masat, te të cilat gëzon respekt e prestigj të lartë.

## SUMMARY

The study on subject "The Developmet of the Islamic Culture Among Albanians During the 20th Century" spans over the entirety of Albanian territories as well as the diaspora, enhancing in this way the knowledge of the Albanian Islamic World. From the temporal viewpoint the study is concerned with this century. But, for the sake of continuity and in order to offer the readers some introductory notes, it includes also a retrospective overview, without pretending that the latter is exhaustive.

The study is the result of many years of intensive efforts and commitment in consulting not only the archives and libraries of the Republic of Albania, but also those of the Islamic schools in Prishtina and Gjakova in the Republic of Kosova, as well as the "Is'hak Beu" library of the Islamic school of Skopje, and the Islamic Community of Podgorica in the Republic of Montenegro. Through various connections it has been possible to utilize also the publications of the Albanian Islamic center of Michigan, and those of New Jersey and New York in the United States of Amerika.

With the aim of conducting a comprehensiv study to the fullest extend possible, attention has been given to the activity of other centres of the Albanian Diaspora, like those of Toronto (Canada), Brussels

(Belgium) etc., which have published considerably, though no full studies on the topic of this paper, as well as to publications in Albanian of various Eastern countries.

The bibliography on the subject of this study is relatively rich. It includes books, monographs, collections of studies etc., which have treated among others, questions or aspect of the Islamic culture in general, and the Albanian Islamic culture in particular. In this context, mention deserve publications of scholars such as Muhamed Pirraku, Dr. Haki Kasumi, Dr. Jashar Rexhepagiqi etc., of theologians and researchers like Hfs. Ibrahim Dalliu, Hfs. Ali Korça, Father Ali Tomori, Ilo Mitke Qafzesi, Haki Sharofi, Sherif Ahmeti, Vehbi Ismaili, Vexhi Demiraj, etc.. At the same time, there are foreign authors that have touched upon the Islamic religious matters in the Albanian territories as Dr. Branko Babiq, Bozhina Ivanoviq, Roberto Marozzo della Rocca, Edwin E. Jacques etc..

Besides a speech or two in Albanian at international scholarly gatherings or an article appearing in a magazine, to the present, there is no study as such or monograph dealing with Albanian Islamic culture directly.

In the Republic of Albania, after the Second World War, the various religions have been subject of several publications, though all adhering to the anti religious policy of the time, such as "Scientifik Atheism", published by the University of Tirana in 1986, "Charges on Religion", published by the Higher Pedagogical Institute of Shkodra, "What Is Religion", "The People Overrule Religion", etc.. In all these works prevails the idea of the denigration of religion, denial of the religious culture, to the extent that it is even presented as anticulture; its mission: "to leave the people in darkness and ignorance, to legitimate the rule of the rich classes" etc..

Neither do scholarly papers such as the article "The Frontal Attack Against Religion in the 60s", which distinguishes for its rich factual material and an overall realistic historical overview, escape the politicisation and other handicapping features of the period.

The study has proceeded on the basis of the collection, selection, classification and arrangement of the body of material facts gathered from the archives and libraries within the country and abroad.

The material has been arranged according to the following topics: The anti religious policy and its consequences, Islamic theological and cultural institutions, publications, and the distinguished personalities of the Islamic culture.

Reliance on the analytic and synthetic approach, hand in hand with the comparative study, has enabled the evidencing of new cultural phenomena, unknown or misinterpreted as a consequence of the politicization of historical events and cultural processes. This approach has made it possible to consider the development of the Islamic culture as part and parcel of the overall cultural, ethical and social development of the Albanian people.

The role of the Islamic theological and cultural institutions in Albania, and the flux of the Islamic media, are considered in the framework of the inter-confessional understanding (a characteristic of our country) aiming at an all-nation harmony. At the same time they are conceived in the spirit of repudiation of atheistic ideas, as well as anti-religious and communist policies.

The study reserves special attention to the contemplation of the role played by the Islamic centres of the Albanian diaspora in the consolidation of the national consciousness.

For study purposes the research on Islamic culture among Albanians, as part of the overall Albanian culture, has been construed in four planes, reflecting both in general and particular its development and issues at stake, namely: The anti religious policy and its consequences on the Islamic culture. These are the main chapters of this monograph.

The first chapter offers a general view of the survival of the Islamic doctrine and the role it played in the preservation of the national identity. Here emphasis is given to the anti religious policies and their consequences on the Islamic culture, beginning at the start of the century up to the events of the recent years, after the religious revival in the country.

The second chapter is concerned with the Islamic education. The first section is dedicated to the first level education in the Albanian territories, dealing with its network, structure and organization. Reference is found in the archives of Kosovo, Macedonia and Montenegro, though not of the schools of Cameroon, were according to oral evidence, the network was very powerfully built.

The chapter continues with a description of the secondary education, the distribution of schools in Albanian territories, their historical evolution and the syllabuses.

Mention is made of the texts used, with an attempt to analyze also their content. The material facts on this level of education is greater. The material facts on this level of education is greater. The evolution of the latter has had its ebb and flow., determined in the first place by historical turning points. Certainly, the Islamic secondary schools of the last years find a wider reflection, because the information at disposal is greater. In order to give a clearer idea about their structure, organization and role, the study dwells also on their rules and statutes. The differences between these schools have necessitated in certain cases separate analysis of those in Kosovo, Macedonia, etc..

A separate section of the second chapter deals with the higher Islamic education. Its features come into evidence through the description of the higher school of Islamic education in Prishtina. Elements of higher education were also comprised in the syllabus of the General Islamic school of Tirana.

The third chapter considers extensively the Islamic publications and press in the Albanian territories and diaspora. The work has been laborious, because the Albanian diaspora is scattered in five continents: Europe, America, Asia, Australia and Africa. To facilitate the study, it was considered useful to group the religious publications in Albania, on the basis of their physiognomy under: periodicals, text books for learning the Muslim faith, translations of the Holy Qur'an in Albanian, Mevluds etc., making thus for the first time a complete classification of such works.

For the first time this paper offers full analyses of periodicals. They have been very difficult to get hold of because the majority are completely unknown to the Albanian public, as for instance "Our Endeavour" which comes out in New Jersey, "The Light of Lahore" (India) etc..

An important section of this chapter is taken by the translations in Albanian of extracts from Tefsir (interpretation of Qur'an), besides those of Hadiths. During the research of translations of Qur'an we have come across manuscripts by Albanian theologians or groups of Albanian theologians who were well acquainted with the religious terminology and the exact corresponding terms in Albanian. Here are included also the mevluds, which besides their significance as part of the religious literature, have a special linguistic value, as they are written by authors from different regions of Albania, as Shkodra, Ulqini, Korça, Kosova, Tetova, as well as from the Albanians of the diaspora etc..

The fourth chapter dwells on the personalities of the Islamic culture, and their contributions to the national question. These are distinguished clerics as Hfs. Ismet Dibra, Hadji Vehbi Dibra, Ismail

Ndroqi etc., writers and publicists as Hfs. Ali Korca, Sadik Bega; distinguished scholars of the Orient such as Vexhi Buharaja; spiritual and military leaders as Mulla Idriz Gjilani, mystics and philosophers as Ferit Vokopola, Father Ali Tomori, innovative muezines as Mullah Hasan Masurica. Among them there are personalities who in their powerful writings forewarned of the communist danger three quarters of a century in advance. Well-known are the pamphlets of Hfs. Ali Tarja, Hfs. Ali Korça, etc..

Female personalities are also mentioned as that of H. Hanmit. The number of the notables in total is fifty five, with an activity spans the beginning of the 20th century to the present.

The study includes references to the literature found in different libraries and archives.

Here I have to acknowledge a debt of gratitude, in the first place, to the Institute of History at the Academy of Sciences of the Republic of Albania, for the assistance in consulting the archive documents. My thanks go also to the Directorate of State Archives of the Republic of Albania, as well as to the archives of the schools in Prishtina, Skopje, Podgorica, and of Shkodra, for the readiness in putting at my disposal important documents relevant to my topic.

Without pretending to present you with an exhaustive study that leaves little room for further investigation on the topic, I trust that this paper is of service to my country and the Islamic culture, the latter an indivisible part of our national heritage.